monumentet



DO NOT COPY

15-16, 1978

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

15-16, 1978

DO NOT COPY

Kopertina e parë: **Kulla-muze e Heroit të Popullit Mic Sokoli**

OLEGJUMI I REDAKSISË

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës

Adresa e redaksisë: Rruga Alqi Kondi nr. 7

Kopertina e parë:

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Shpresa Prifti
– Restaurimi i banesës së patriotit të rilindjes kombëtare Pashko Vasa. 5

Leonard Sulí
– Restaurimi i kullës së Mic Sokolit 25

Robert Ballauri
– Një monument historik me vlerë në Elbasan 45

Fatos Tartari
– Arkitektura e disa varreve të shek. II-IV në Dyrrah 65

Apollon Baçe
– Arkitektura e dy kishave paleokristiane dhe e varreve në kështjellën në Paleokastër 73

Stilian Adhami
– Katedralja «Fjetja e shën Mërisë» në Voskopojë 89

Sulejman Dashi
– Një xhami e vjetër në Berat 101

Ferid Kola
– Restaurimi i objekteve prej druri në banesën e Pashko Vasës 111

Emin Riza
– Ansamblet ndërtimore të pazareve dhe restaurimi i tyre 117

Genc Samimi
– Të dhëna mbi arkitekturën e banesës popullore në krahinën e Skraparit 139

Koço Zheku
– Banesa fshatare në fshatrat krahinore përreth qytetit të Tiranës 163

Emin Riza
– Banesa popullore në fshatrat e rrethit të Vlorës 185

Valter Shtylla
– Të dhëna arkitektonike mbi banesën e vjetër fshatare të rrethit të Lushnjës 221

Frederik Stamati
– Përdorimi i tanineve për konservimin e objekteve prej hekuri 237

Gjerak Karaiskaj
– Kështjella e Ishmit 243

– Kronikë e punimeve restauruese (1976-1977) 249

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Pages

Shpresa Prifti

– Restauration de la maison de Pashko Vasa, illustre patriote de notre renaissance nationale 22

Leonard Suli

– Restauration de la Kulla de Mic Sokoli 42

Robert Ballauri

– Un important monument historique a Elbasan 62

Fatos Tartari

– L'architecture de certains tombeaux des II-IIIe siecles a Dyrrah 71

Apollon Baçe

– Architecture des deux eglises paleochetiennes et des tombeaux de la forteresse de Paleokastra 86

Stilian Adhami

– La cathedrale «Le sommeil de sainte Marie» a Voskopoje 99

Sulejman Dashi

– Une ancienne mosquee a Berat 109

Ferid Kola

– Restauration des objets de bois se trouvant dans la maison de Pashko Vasa 115

Emin Riza

– Les ensembles des marches et leur restauration 134

Genc Samimi

– Donnes sur l'architecture de l'habitation populaire dans la region de Skrapar 160

Koço Zheku

– L'habitation rurale dans les villages s'etendant sur les collines aux environs de Tirana 182

Emin Riza

– L'habitation populaire dans les villages du district de Vlore 214

Valter Shtylla

– Donnes architectoniques sur l'ancienne habitation paysane du district de Lushnje 235

Frederik Stamati

– La conservation des objets de fer au moyen de substances tanniques. 241

Gjerak Karaiskaj

– La forteresse d'Ishme 248

– Chronique des travaux de restauration (1976-1977) 269

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

pjesën qëndrore të banesës, i treti në pjesën e krahut të djathtë dhe dy të fundit në pjesën e mbrapme, ku ai qëndrori, bri hyrjes shërben si ambient ndërlidhës i katit. Ambienti nr. 1 dhe ai nr. 2, që shërben si odë banimi, nga vendi që zenë në planimetri, teknika e ndërtimit dhe kompozimi i brendësisë së tyre kuptohet se janë ambiente të sajuar më vonë në çardak. Balli i tyre ndërtohet me mur tulle të mbështetur në kollona betoni, ku ai i odës së banimit është më i dalë për arsye të sajimit në pjesën qëndrore të një korridori që lidhet me ambientin nr. 3 të banesës. Tavani i tyre është i thjeshtë me dërrasa të afruara. Të dy ambientet ndriçohen respektivisht nga dy dritare të zakonëshme dykapakëshe.

Ambienti i krahut të djathtë me mjaft rëndësi dhe që dallon nga gjithë të tjerët, si nga funksioni e proporcionet, ashtu dhe nga trajtimi i brendshëm arkitektonik, është oda e miqve. Në kompozimin e saj planimetriko-vëllimor, ajo ruan skemën e zakonshme të ambienteve të banimit të banesës qytetare shqiptare gjatë shekujve XVIII – XIX. Në gjendjen e sotme, ky ambient na vjen me transformime e dëmtime të vogla, të cilat megjithëkëtë nuk ia ulin vlerën që ka.

Ambienti është i ndarë në mes me perde të hollë materiali të lehtë, duke sajuar kështu dy ambiente për banim. Ai ka formën e drejtëkëndëshit dhe ndahet në hapësirë në dy pjesë: në volumin karakteristik musandër-trapazan dhe në hapësirën e odës. Volumi musandër-trapazon, në pjesën fundore ndahet në lartësi në dy pjesë. Piesa e sipërme trajtohet me 6 ha-



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

pësira në formë llozhe e ruajtur mirë me përjashtim të parmakëve që mungojnë krejtësisht e ndriçuar nga dy dritare të vogla, ndërsa pjesa e poshtme vjen pjesërisht e dëmtuar duke u ruajtur në gjendje origjinale krahu i majtë. Në anë ndodhet açik rafti e mbas tij dera e hyrjes e vendosur diagonalisht punuar me spekie të dalluara. Faqja ballore e hapësirës së odës përbëhet nga dy dritare të zakonshme të modifikuara po në vendet e dritareve ekzistuese dhe bri tyre dy kamare të ulta të gdhendura në dru. Dy dritare të njëjta me të parat ndodhen dhe në faqen juglindore të odës. Hapja dhe mbyllja e dritareve origjinale bëhet me lëvizje në drejtim horizontal nëpërmjet konstruksionit të kasave të vendosura në brendësi të mureve me skelet druri.

Dekorin e këtij ambienti e pasuron shumë tavani i tipit kazan, fig. 4, punuar në pjesën qëndrore në formë tetëkëndëshi në sturo-reliev, ndërsa pjesa tjetër anësore në nivel më të ulët me dërrasa të punuara ku në çdo qoshe ndodhet një trekëndësh i gdhendur, fig. 5. Fusha është e thjeshtë me dërrasa të afruara dhe çibuke të vendosur paralelisht. Rozetë nuk ka mbasi dhe gjurmë nuk duhen.

Ambientet nr. 4 e nr. 5 ndodhen në pjesën e mbrapme të banesës. Ato ndahen në mes tyre nga një rruginë, në fundin e së cilës duken gjurmat e derës për në ambientin sanitar, i cili sot nuk ekziston. Ambienti nr. 4, i vendosur në krahun e majtë, ka pësuar transformime. Ai ka tavan të thjeshtë dërrase dhe

ndriçohet nga 3 dritare të vendosura në faqen përballë. Në hapsirat mes tyre ndodhen dy kamare. Gjurmët e një dere të ndodhur në faqen nga çardaku tregojnë se ky ambient ndërlidhej me pjesën e krahut të majtë. Trajtimi i varfër i këtij ambienti, transformimet e bëra si dhe gjysmët e dala gjatë restaurimit na bëjnë të mendojmë se ajo ka shërbyer si shtëpi zjarri. Ambienti ngjitur me të trajtohet mjaft pasur përsa i përket brendësisë së saj. Vendin kryesor e ze tavani mjaft dekorativ, fig. 6, ku fusha tetëkëndëshe, në mesin e së cilës ndodhet një rozetë gjithashtu tetëkëndëshe e daltuar, fig. 7, e cila ndahet me anë të çibukëve në rombe të vegjël, që mbushin gjithë fushën. Në katër qoshet e tavanit janë vendosur trekëndësha të daltuar me mjaft mjeshtëri, fig. 8. Volumi kryesor i zakonshëm, trapazan — musandër, ndodhet në faqen e hyrjes, i transformuar krejtësisht në pjesën e poshtëme, duke u mbyllur me perde të holla çamaje. Pjesa e sipërme ruhet pjesërisht, ajo formohet nga pesë hapsira në formë llozhe, rrethuar me parmakë të ulët. Oda merr dritë nga tre dritare, ndërsa ajo e katërta është mbyllur më vonë. Dhe në këtë odë në faqen përballë tri dritareve, ndodhen kamare, të cilat sëbashku me muraturën e dalë në fasadë në pjesën e mesit të odës vërtetojnë se do të ketë pasur oxhak. Brendësinë e odës e plotëson dhe rafti i daltuar, Fig. 9, i ndodhur në faqen nga çardaku. Kjo ornamentikë e pasur e këtij ambienti që konkuron atë të ambientit Nr. 3, bën që ai të konsiderohet si ambient i dorës së parë, si odë e mirë për këtë pjesë banese, mbasi faktet dhe argumentat e dala gjatë restaurimit e nxjerrin atë jo të njëkohëshme me ndërtimin e pjesës së krahut të djathtë të banesës.

Banesa është e ndërtuar në katin përdhe e gjitha me mur guri, — në katin e sipërm krahas murit të gurit gjejmë dhe mure me skelet druri si dhe mur tulle, në faqet ballore të ambienteve Nr. 1 e Nr. 2. Muratura e gurit shkon në gjerësi 60-65 cm. e ndërtuar me gurë lumi dhe pjesërisht me gur kave të lidhura me llaç gëlqereje. Në katin përdhe llaçi është përdorur në sasi të mëdha, duke bërë që muratura të duket si të jetë e suvatuar. Teknika e mureve me skelet druri karakterizohet nga një sistem shtyllash të vendosura në distancë 2-2,4 m. të kurorëzuara sipër me jastëk druri të punuar. Shtyllat lidhen midis tyre me binarë horizontalë, përforcuar nga binarë të tjerë vertikalë, të cilët përkufizojnë hapësirat e dritareve, fig. 10. Mbi to mbështeten në dy anë paretkat e dërrasës, që pastaj suvatohen. Për arsye të shtesave të bëra më vonë, si dhe rindërtimeve të suvasë origjinale, suvatimet i gjejmë të teknikave të ndryshme. Duke vrojtuar gjurmët që duken, si dhe ato të dala gjatë punimeve, vërejmë se suvatimi më i vjetër, i cili ruhet pjesërisht në ambientin Nr. 5 është dy duarësh, — dora e parë



TEKNIKA E PUNIMIT TE PERDEVE ME SKELET DRURI

Fig. 10

është dhënë me llaç gëlqereje përzjerë me kashtë, ndërsa dora e dytë thjeshtë llaç gëlqereje. Në ambientin Nr. 3 haset një teknikë tjetër, — dorë e parë prej llaç gëlqereje, përzjerë me kashtë, ndërsa dora e dytë është patinaturë me gëlqere me fije kashte. Suvatimet e tjera i gjejmë me llaç gëlqereje të zakonshëm. Dyshemetë e kateve janë me dërrasa të gjera të afruara, ndërsa ato të trapazaneve shërbejnë njëkohësisht si dysheme e tavan janë me paturë. Dyertë e ambienteve janë të gjitha njëflegërshe druri, të pajisura me prag të lartë. Ato të ambientit Nr. 3 janë të punuara me skema e figura rombike, ajo e ambientit Nr. 5 trajtohet me fashatura të punuara, ndërsa të tjerat, të zakonëshme, me dërrasë të bashkuara me pature, mbërthyer me gozhda kovaçi. Nga gjurmët që duken del se ato kanë qenë të pajisura në pjesën e sipërme me drasë të daltuar njëlloj me origjinalin i ndodhur në derën e ambientit Nr. 5. Çatia është me konstruksion vendi, me strehët kanë qenë të dala nga muratura rreth 1,80 m. në pjesën e krahut të djathtë. Në pjesët e tjera ajo është transformuar me kohë. Në gjendjen e sotme, banesa vjen me shumë transformime, të cilat vetkuptohet nuk janë bërë me të njëjtën trajtim, duke coptuar kështu disi unitetin e veprës Fig. 1. Duke e vrojtuar atë të bie në sy kontrasti midis ftohtësisë dhe ngurtësisë të pamjes së pjesës qëndrore dhe asaj të krahut të majtë, me gjallërinë dhe ngrohtësinë e pamjes jugperëndimore Fig. 11 e juglindore të pjesës së krahut të djathtë të banesës, e arritur kjo nga efekti dritë-hije i strehave të dala mbi muraturë, vendosjes së dritareve me rrjetë hekuri si dhe kompozimet e fashaturave prej druri të dritareve në muraturën e suvatuar.

DOKUMENT



Fig. 11

NDRYSHIMET QË KA PËSUAR BANESA NË KOHË

Banesa ka pësuar transformime të rëndësishme qoftë në planin kompozicional, ashtu dhe në atë arkitektonik. Ajo nuk ruan një skemë të ngjashme, tipologjike me banesat e tipit me çardak, të zhvilluara gjatë shekujve. XVIII-XIX (Tab. I, II, III). Me kalimin e kohës bëhen ndërtime shtesë, të cilat vendosen pa ndonjë kriter të caktuar apo lidhje logjike e funksionale, të para këto në tërësinë e monumentit. Për këtë, studimi i fazave të ndërtimit ishte një problem mjaft i ndërlikuar. Për t'ia arritur kësaj ishte e nevojëshme të përcaktohej, — nëse kemi të bëjmë me një banesë të vetme që në fazën fillestare, apo me pjesë të veçanta ndërtimi dhe nëse kështu, në ç'raport kohor qëndronin ato karshi njera-tjetrës, a ka pasur çardak banesa, çfarë zgjidhjeje planimetrike e kompozicionale është përdorur dhe çfarë konfiguracioni planimetrik ka patur pjesa e krahut të majtë.

Për të sqaruar këto pikpyetje, u desh të bëhen një sërë vrojtimesh e sondazhezh, u morën për bazë të dhëna historike, po ashtu u studiuan të dhënat gojore të grumbulluara. Në sondazhet e kryera në dy vendtakimet e mureve veriperëndimore e atij jugperëndimor të pjesës së mbrapme me pjesën e krahut të majtë u duk fugë ndërtimi. Të dy muret i mbështeteshin pjesës krahut të majtë, po ashtu teknika e ndërtimit të tyre nuk është e njëjtë! Këto të dhëna tregojnë se dy pjesët e lartpërmendura nuk janë të njëkohëshme dhe pjesa e majtë është më e herëshme se ajo e mbrapme. Nga vrojtimi i bërë teknikës së ndërtimit të kollonave të hajatit të pjesës së krahut të djathtë, rezulton se ajo nuk është e njëjta me atë të kollonave të hajatit qendror, që korespondojnë me pjesën e mbrapme të banesës, duke lëvizur ato dhe në dimensione. Si teknikë më e herëshme konsiderohet ajo e kollonave të hajatit qendror. Nga sa parashtruam është e mundur të vendosen tre faza ndërtimi të monumentit, të vendosura vetëm në kronologji relative, për arsye të mungesës së datimeve dhe dokumentave që hedhin dritë mbi këtë problem.

Fazës së parë të ndërtimit i përgjigjet pjesa e krahut të majtë të banesës e ardhur në gjendjen e sotme krejtësisht e transformuar, duke vështirësuar mjaft përcaktimin e konfiguracionit planimetrik fillestar të saj. Variantet e shumta të supozuara, përfundimisht na çuan te banesa në krah të saj, e cila është banesë me çardak në ballë. Vrojtimet e kujdesëshme të bëra asaj, dhe pjesës në studim, si dhe të dhënat e përfituara, dhe pikërisht: hapi i njejtë i ambienteve të katit për të dy krahët, vazhdimësia e dy mureve gjatësore pa patur shkëputje, ndërprerja e shkallës, vendosja nën një vijë kulmi çatie, skema e njejtë e strehës së çatisë asaj origjinale në pjesën e mbrapme të ndërtesës bashkëngjitur dhe pjesës në studim nga dokumenti fotografik, përputhja e simetrisë së ambienteve dhe elementëve të veçantë të pjesës së rikonstruktuar në bazë të të dhënave gojore, (kjo pjesë nuk i është nënështruar akoma projektit të restaurimit) me atë të banesës në krah, e cila ruan pastër skemën fillestare, na bindin plotësisht se pjesa e krahut të majtë në fazën fillestare ka qenë pjesë e banesës në krah: banesë me tre ambiente dhe çardak në ballë. Me kalimin e kohës, banesa ndahet pikërisht në mesin e shtëpisë së zjarrit, kështu secilit krah i takon gjysma e shtëpisë së zjarrit dhe oda tjetër në krah, të lidhura midis tyre nga rrugina, që i shërben volumit karakteristik trapazan-musandër të odës së mirë. Më vonë, për arsye që nuk dihen, pjesës në studim i hiqet plotësisht çardaku. Që ai ka ekzistuar na bindin disa gjurmë të pamjes së jashtëme të para në dokumentin fotografik[4]. Me realizimin e projektit të restaurimit për këtë pjesë banese, do të qartësohen shumë gjera dhe caktësohen supozimet e bëra.

Fazës së dytë të ndërtimit i takon pjesa e mbrapme e banesës. Këtu hedhim hipotezën, se dhe pjesa qëndrore deri te kolona e dytë e ndodhur në hajat është e njëkohëshme me të dhe ka funksionuar si çardak. Për këtë na ndihmon fakti, se kolona ndodhet në një vijë me faqen juglindore të pjesës së mbrapme

4) Fotografi e Marubit, sipas të dhënave gojore, e bërë rreth viteve 1888 — 1890.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

po ashtu teknika e ndërtimit të saj është e njëjtë me atë të faqes jugperëndimore, që i përket ahrit. Qënia e kësaj sipërfaqe çardak, përveç argumentave të nxjerra më poshtë, është plotësisht e justifikuar, për sipërfaqen e saj relativisht të vogël, duke menduar këtu ndërtimin e një ambienti tjetër, gjithashtu si rrjedhim i gjendjes së re të krijuar, mendojmë që dhe shkallët ekzistuese janë ndërtim i kësaj faze dhe kjo e plotëson më shumë qënien e kësaj sipërfaqe të hapur, si ambient komunikues për katin.

Fazës së tretë të ndërtimit i përket pjesa e krahut të djathtë dhe pjesa qëndrore, deri te kolona e dytë, që ka funksionuar si çardak në vazhdim të atij të parit.

Si konkluzion i përgjithshëm mund të themi se banesa e Pashko Vasës është një ndërtim i krijuar nga shtesa të bëra në kohë të ndryshme, të cilat nuk kanë ndjekur një kriter të caktuar në përshtatje ky me ecurinë e zakonshme të banesës shkodrane me çardak të zhvilluar gjatë shekujve XVIII – XIX-të.

Krahas fazave të ndërtimit që ka pësuar monumenti, kemi dhe rikonstruksionet e ambienteve origjinalë, si çardaku dhe ambientet Nr. 3, 4, 5.

Lidhur me pohimin se ambientet Nr. 1 e Nr. 2 janë ndërtuar më vonë në çardak shërbejnë këto argumenta:

Së pari, na ndihmojnë disa karakteristika krejt të ndryshme të tyre në formulimin planimetriko-volumor të banesës. Dalja e volumit të ambientit Nr. 2 shpjegohet thjesht me nevojën e krijimit të koridorit të vogël për ndërlidhje. Në kontrast me ambiente të tjera, të bie në sy varfëria e brendësisë dhe mungesa e elementeve të veçantë si trapazani, rafti, etj.

Së dyti, vendi që zënë në planimetrinë e banesës është pa kriter dhe s'ka asnjë lidhje llogjike dhe funksionale me ambientet e tjera.

Së treti, teknika e ndërtimit të muraturës në faqen ballore është e vonë. Kjo përforcohet dhe nga fuga e ndërtimit me murin e odës së miqve.

Së katërti, nga punimet e restaurimit mbasi u bë prishja e ambientit Nr. 2 doli në faqen veriperëndimore të pjesës së krahut të djathtë, në murin e kallkanit që sheh në çardak një dritare me kapak terri, fig. 12, që shërben për të hypur në çati. Po në këtë faqe dolën gjurmë të traut horizontal, fig. 13, që kalon mbi jastëket e shtyllave të drurit, ndërsa në faqen jugperëndimore të ambientit Nr. 5, doli një dritare që sheh në çardak.

Së pesti, në dyshemenë e ambientit Nr. 1, në drejtim të faqes juperëndimore të pjesës krahut majtë, u gjendën gjurmë të kllapave të shtyllave të drurit, origjinaliteti i të cilave vërtetohet nga gozhdët e kovaçit. Po ashtu, dëshmi bindëse të qënies të çardakut janë dhe elemente të veçantë arkitektoniko-konstruktiv të gjetura në pjesë të ndryshme të monumentit.

Nga dokumenti fotografik i përmendur, shohim se këto ambiente kanë patur dhe një fazë të ndërmjetme fig. 14, që konsiston në trajtimin e ndryshëm arkitektonik të pamjeve, interierit dhe teknikën e ndërtimit. Muratura që sot e gjejmë me mur tulle, është e realizuar me konstruksion druri suvatuar në dy anë, i njëjtë me perden ekzistuese ndarëse të këtyre dy ambienteve. Ambienti Nr. 1 ka tre dritare në ballë, ndërsa ai Nr. 2, pesë të tilla. Pamjet e këtyre dy volumeve trajtohen pastër dhe bukur, ndërprerë nga fashatura druri, që i vijnë rreth e qark dritareve dhe ndajnë muraturën në drejtim horizontal. Mbështetja konstruktive e tyre bëhet mbi shtylla druri me jastëk të daltuar.



Fig. 14



Fig. 15

Kjo fazë ndërtimi e vetë çardakut, pasqyron me vërtetësi të gjitha karakteristikat e periudhës rreth fillimit të shekullit 19-të, ku vërehet mbyllja e çardakut dhe modifikimin e tij në ambiente banimi, kalimi i kësaj faze në gjendjen e gjetur është mjaft i justifikuar, mbasi ka të bëjë thjesht me zëvëndësimin e materialit relativisht të dobët të drurit me materiale të reja të kohës që janë më të qëndrueshëm.

Ambienti kryesor, ai i odës së miqve, i ndodhur në pjesën e krahut të djathtë nuk ka pësuar transformi të mëdha. Përveç dëmtimit të krahut djathtë të pjesës poshtme të trapazanit si dhe ndryshimeve në trajtim të dritareve ekzistuese, nga gjurmët e dala të hapsirës së derës gjatë punimeve të restaurimit në faqen juglindore në hapsirën e trapazanit, bindemi se ky ambient në analogji dhe me ambientet e tjera ka patur nyjen e vet sanitare, e dalë kjo jashtë konfiguracionit të odës, në formë xhepi, — po ashtu çveshjet e suvasë në vendin e oxhakut, ndërmjet kamareve, hodhën dritë fig. 15 mbi ekzistencën e oxhakut dhe pak a shumë mbi formën e dekorit të tij. Qënia e tij përforcohet dhe nga të dhënat gojore. Punimet e restaurimit në ambientin Nr. 4, oda e zjarrit, treguan se ky ambient ka pësuar transformime në të gjitha faqet e tij. Punimet në çati, në faqen nga dritaret, sollën gjurmë bloze të cilat të përforcuara nga muratura e dalë në fasadë në pjesën qendrore si dhe qenia e dy kamareve na detyruan të bëjmë sondazhe në muraturë, në pjesën e sipërme dhe të poshtëme të dritares së mezit. Përfundimi i sondazhit të bërë nxorri qartë formën e oxhakut fillestar, i futur ky në muraturë në formë 1/2 harku me majë konike sipër. Në faqen veriperëndimore dolën gjurmët e një rafti të vogël, në faqen bri rruginës gjurmët e derës që të lidh me ambientin sanitar, ndërsa në faqen që i takon pjesës krahut të majtë, doli një kamare e ulët, që komunikon me pjesën tjetër mjaft interesante dhe e dyshimtë për funksionin e mirëfilltë të saj, e ndërtuar me shpatulla e hark guri të thelluar 2 cm në muraturë. Qënien e këtij ambienti si shtëpi zjarri, e përforcuam edhe nga forma primitive e oxhakut, mund të mendojmë pra se ky ambient ka qenë me vatër zjarri bri oxhakut, pa tavan, duke lënë lirisht tymrat të dilnin nga çatia. Pavarësisht nga mungesa e gjurmëve për pjesën e poshtme të trapazanit të ambientit Nr. 5, në analogji me skemën e zakonshme, faktet ekzistuese dhe të dhënat gojore, del se ka pasë vendin e arkës së nuses, musandrën dhe në fund derën që të çonte për në ambientin sanitar. Detajet e ndryshme të dala gjatë punimeve të restaurimit si sqolli i futur gjysmë hark në mur, në faqen verilindore i ndodhur në qoshe nga perdja e trapazanit, gjurmët e dritares që del në çardak, po ashtu dhe dy duar suvatimi, ku ajo e herëshmja është patinim me gëlqere e fije kashte, na shtyjnë të mendojmë se ky ambient ka pësuar rikonstruksion që është i njëkohshëm me atë të shtëpisë së zjarrit. Dalja e sqollit të bën të dyshosh lidhur me funksionin fillestar të këtij ambienti, e konsideruar tani jo më si odë e mirë, por si odë e zakonshme ndejtjeje. Kjo na zgjidh dhe pikëpyetjen lidhur me raportin kohor ndërmjet dekoracionit të brendësisë së këtij ambienti dhe atij të odës së miqve, meqenëse ky i fundit konsiderohet si më i hershëm dhe ky fakt na çorientonte në përcaktimin kohor të këtyre dy pjesëve në tërësi. Kështu që përfundimisht mund të themi se, rikonstruksioni i ambientit Nr. 5 ka përfshirë jo vetëm suvatimin e të gjitha faqeve të tij, i ardhur ky si rezultat i mbylljes së sqollit, zgjerimit të dritareve dhe mbylljes së oxhakut, gjurmët e të cilit duken në pamje, por rikonstruksionit i është nënshtruar dhe tavani, trapazani dhe rafti i murit, të bëra këto në një kohë më të vonë. Hedhim këtu mendimin se ky rikonstruksion është i njëkohshëm me fazën e ndërmjetme të çar-

DO NOT COPY



Fig. 16

dakut, kur u ndërtuan të dy ambientet e lartpërmendura.

RESTAURIMI

Krahas transformimeve që kishte pësuar banesa në kohë theksojmë se dhe gjendja ekzistuese në përgjithësi si dhe ajo e elementeve formues në veçanti, ishte mjaft e dëmtuar. Çatia pjesërisht e rrëzuar, dyshemetë e dëmtuara keqas, tavanet e kalbura, suvatimet e shkepura, paraqisnin domosdoshmërinë e ndërhyrjeve restauruese. Duke u mbështetur në gjendjen teknike e konstruktive të monumentit, në të dhënat që na ofroi ai, si dhe duke gjykuar mbi vlerat arkitektonike të tij, u hartua projekti i restaurimit, i cili do



Fig. 17



Fig. 18

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të mbante qëndrim si karshi kompozimit në tërësi, ashtu dhe karshi elementeve të veçantë arkitektonikë të banesës, duke mbajtur në të dy rastet një qëndrim të dyfishtë. Kështu kur shtesat apo rikonstruksionet e elementeve të veçanta arkitektonike paraqesin interes si dëshmi të kohës, mbartin në vetvete vlera dhe qenie të lidhura organikisht me banesën, ato u ruajtën, ndërsa në rast të kundërtë, u hoqën. Mbi këto parime u vendos që pjesa qëndrore të kthehej në fazën fillestare, çardak në ballë[5], po ashtu dhe për pjesën e krahut të majtë, mendimi i sotëm është për kthimin në fazën fillestare. Ndër punimet e restaurimit, ato më të rëndësishme u kryen në pjesën qëndrore, për rindërtimin e çardakut përbri odës së miqve, i cili sipas gjurmëve u pajis dhe me qoshkun karakteristik fig. 16. Gjithashtu u rindërtua dritarja me



Fig. 19



Fig. 20

5) Megjithëse ambientet Nr. 1 e Nr. 2 në fazën e ndërmjetme marrin vlera që pasqyrojnë kushtet ekonomike të asaj periudhe, ato u panë të arsyeshme të hiqen, mbasi qëllimi ynë ishte rindërtimi i çardakut, kthimi i tij në fazën e parë.

DO NOT COPY



Fig. 21

kafaz druri si dhe dera, elemente këto të faqes pjesës krahut të majtë që del në çardak. Punime me karakter rindërtimi u bënë dhe në ambientin Nr. 4 e Nr. 5, si rindërtimi i oxhakut, i raftit të murit dhe kamares e derës që të lidh me pjesën e krahut majtë, po ashtu u rindërtua dritarja që del në çardak si dhe sqolli i duarve, ndërsa pjesa e poshtme e trapazanit nuk pësoi rindërtim. U restaurua në bazë të pjesëve origjinale tavani dhe pjesa e sipërme e trapazanit dhe u rindërtua plotësisht tavani i shtëpisë së zjarrit. Tab. V.

Për momentin historik, ambienti i odës së miqve, i cili, sipas të dhënash gojore lidhet ngushtë me jetën e patriotit Vaso Pasha, u pat kujdes të rikonstruktohej në gjendjen që lidhet me këtë periudhë. Për këtë na ndihmoi mosndryshueshmëria e ambientit në kohë si dhe qënja e elementeve arkitektonike origjinal, Tab. IV. Për rikonstruksionin e pjesës munguese, të krahut të djathtë të trapazanit u bënë përpjekje për rikompozim në bazë të gjurmëve të dala dhe në analogji me skemën e zakonshme trapazan-musandër të banesave shkodrane të shekullit 18 – 19. U rindërtua pjesa e sipërme e trapazanit, fig. 17 si dhe dritaret lëvizëse, u restaurua tavani dekorativ dhe fashaturat e sergjia e odës. U vendos që oda të pajisej me oxhak, fig. 18, rikonstruksioni i të cilit u bazua në gjurmët e dala gjatë punimeve, ndërsa tipi, forma dhe niveli i dekorit të tij u zgjodh në përshtatje me periudhën që i takon ndërtimit të vetë ambientit në analogji me ambientet e tilla të asaj periudhe. Pas restaurimit, ky ambient fitoi vlera të reja arkitektonike, duke u afruar mjaft me gjendjen në periudhën kur jetoi Pashko Vasa. Krahas ambienteve të katit dhe ato të katit përdhé, iu nënështruan punimeve të restaurimit. Kështu u çlirua plotësisht hajati nën ambientin Nr. 3, u rindërtuan dritaret si dhe dera e ahrit, u kryen suvatime simbas teknikës origjinale. Në këtë kuadër u bë rikonstruksioni i përgjithshëm i çatisë, me të cilën një vend të rëndësishëm zuri rindërtimi i streheve të dala, fig. 19, u rikonstruktuan pjesërisht perdet me skelet druri, u bë restaurimi i disa dyerve dhe rindërtimi i atyre mungueseve, fig. 20, restaurimi i plotë i fashaturave brenda e jashtë ambientit, rindërtimi i të gjitha dritareve. Po ashtu u bë rindërtimi i plotë i dyshemesë i gjithë banesës, suvatimi e patinimi i mureve si dhe rindërtimi e restaurimi i shkallës së jashtme.

Punime u bënë dhe në truallin rreth banesës, si rindërtimi i plotë i kalldrëmit të hajatit, pusit, plotësimet e mureve të avllisë, u rindërtua plotësisht porta e hyrjes bashkë me çatinë e saj si dhe deriçka e oborrit. U sistemua oborri para banesës, duke iu kushtuar kujdes pajisjeve karakteristike si pusit, govatës, lugut e qypave të gurit.

Me kryerjen e punimeve të plota të restaurimit, përveç pjesës së krahut të majtë, të cilës iu bë suvatimi i jashtëm dhe suvatimi i strehës provizore, monumenti fitoji mjaft vlera, të cilat i kishte humbur në rrjedhje të kohës. Fig. 21.

Sot banesa e Pashko Vasës, cilësuar monument

kulture, është kthyer në muze të Degës së Lidhjes së Prizrenit për qytetin e Shkodrës Tab. V. Oda e miqve ku ka jetuar Pashko Vasa është kthyer në dhomë muze ku paraqitet veprimtaria patriotike e këtij ideologu të rilindjes sonë kombëtare.

Një vend të rëndësishëm zë veprimtaria e tij letrare ku spikat vjersha si kushtrim lufte «O moj Shqypni e mjera Shqypni», po ashtu dhe vlerësimi që iu bë ceremonisë të ardhjes së eshtrave të patriotit në atdhe. Krahas karakterit historik të këtyre dhomave u plotësua dhe ana etnografike e tyre me vendosjen e disa pajisjeve karakteristike të odës shkodrane. Dy dhomat e tjera iu kushtuan aktivitetit të Degës Lidhjes Shqiptare të Shkodrës, të viteve 1878--1880. Në dhomën e parë, shtëpinë e zjarrit janë paraqitur fillimet e këtyre lëvizjeve, ndërsa në odën ngjitur, lufta me armë në dorë për mbrojtjen e tokës nga ushtritë pushtuese malezeze.

Me realizimin e punimeve të restaurimit[6] dhe kthimit në muze të kësaj banese, monumenti fitoi vlera të mëdha si në aspektin historik, ashtu dhe në atë arkitektonik të banesës shqiptare të shekullit 18 – 19, si pasqyruese besnike e kushteve ekonomiko-shoqërore të kohës.

6) Punimet e restaurimit u kryen gjatë vitit 1976 – 1978 nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës – Shkodër, nën drejtimin e vetë autorit.

DO NOT COPY

BANESE E PASHKO VASES
Shkodër

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
(GJENDJA EGZISTUESE)



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
(PAS RESTAURIMIT)



0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 3670

TAB II

BANESE E PASHKO VASES
– Shkodër



PLANIMETRIA E KATIT I
(GJENDJA EGZISTUESE)

0 1 2 3 4 5m.



PLANIMETRIA E KATIT I
(PAS RESTAURIMIT)

DO NOT COPY

BANESE E PASHKO VASES
– Shkodër



GJENDJA EKZISTUESE



GJENDJA MBAS RESTAURIMIT

0 1 2 3 4 5M

DO NOT COPY

BANESE PASHKO VASES
- ODA E MIQVE -
Shkodër



GJENDJA PARA RESTAURIMIT



GJENDJA MBAS RESTAURIMIT

DO NOT COPY

BANESE PASHKO VASOS

AMBIENTET E KTHYERA NE MUZE - Pas restaurimit

Shkodër











DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

RESTAURATION DE LA MAISON DE PASHKO VASA, ILLUSTRE PATRIOTE DE NOTRE RENAISSANCE NATIONALE

RESUME

Cet article se propose de presenter le résultat des études faites pour la restauration d'une habitation de la ville de Shkodër (Fig. 1), qui constitue un cas typique de monument ayant à la fois le caractère d'un document historique et celui d'une oeuvre d'art. Il s'agit d'une maison qui se rattache à la vie de l'illustre patriote de notre Renaissance nationale que fut Pashko Vasa, lequel s'est battu par les armes et la plume pour la libération de l'Albanie du joug de l'occupation turque, pour défendre les terres albanaises de la menace de morcellement de la part des grandes puissances et des chauvins balkaniques, en apportant ainsi une importante contribution au mouvement national des années 1860-1880.

Pashko Vasa naquit à Shkodër le 17 septembre 1825. Il fit ses premières études dans sa ville natale. En 1847, par suite des contacts fréquents qu'il avait eu avec des insurgés italiens, il se rendit à Rome. C'est ici qu'il fit ses premiers pas dans la carrière militaire. Toute son activité témoigne d'une vaste culture et d'une intelligence vive. Ce fut en même temps un politicien aux idées larges, un organisateur doué, un homme de lettres, un économiste et un ethnographe remarquable. Son activité plus intense, tant sur le plan politique, social que littéraire, se rattache à la période de la Ligue de Prizren, dont il fut un des promoteurs les plus insignes. En 1878, avec d'autres patriotes illustres, entre autres Jani Vreto et Sami Frashëri, il participa à la création de l'alphabet de la langue albanaise et à la fondation de la Société patriotique de Stamboul. A l'époque de la Ligue de Prizren, il prêta son concours à la rédaction de plusieurs propositions et mémorandums en défense des droits Albanais. Son activité en tant qu'homme de lettres et écrivain politique comprend maints ouvrages, dont une bonne part devint un programme de lutte pour tout le peuple albanais.

Parmi ses meilleurs ouvrages en français mentionnons tout d'abord «La vérité sur l'Albanie et les Albanais», «L'Albanie des Albanais», «Bardha e Temalit»; puis la poésie en langue albanaise «Albanie, pauvre Albanie», qui devint aussitôt un appel au combat pour tout notre peuple qui éprouvait une haine profonde à l'égard des grandes puissances qui voulaient donner les régions albanaises de Hot et Gruda au Monténégro.

La maison de Pashko Vasa se situe dans le quartier de Perash, qui s'êtend dans la partie est de la ville; elle est encore entourée par une multitude d'anciennes habitations aux hautes murs de pierre, aux lourds portes de bois et par un environnement caractéristique, qui lui conférent la couleur du temps des quartiers du XIXe siècle.

Elle s'étend sur un terrain plat (Fig. 2), en conservant encore une bonne part de ses murs d'enceinte qui cernent deux cours divisés par un mur peu élevé. La cour situé sur l'aille droite de la maison est relativement spacieuse; elle était destinée à la culture d'arbres fruitiers et de légumes. En ce qui concerne l'autre cour, située devant la maison, on y voit encore toutes les installations habituelles de la maison shkodrane: puits, cuvier et auge.

Par suite des adjonctions dont elle a été l'objet dans le temps, cette habitation se caractérise de nos jours par une planimétrie irrégulière comportant trois parties de constructions reliées entre elles par le tchardak, qui a subi des transformations dans son état actuel (Tab. I, II, III). Toutes ces trois parties sont à deux étages avec une extension égale pour les deux étages. Les deux dernières parties, celle située à l'arrière de la maison et celle se trouvant sur l'aile droite, communiquent avec l'extérieur à travers un escalier à une rampe, où les quatre premiers degrés en pierre sont circulaires et les autres en bois. L'escalier original n'existe plus. Le manque de traces et de sources orales ne nous permettent pas de préciser leur emplacement et la manière de leur traitement.

La division fonctionnelle des étages de cette maison ne se distingue pas de la division fonctionnelle des autres habitations de type tchardak, *qui ont connu une si vaste diffusion non seulement à Shkodër, mais aussi dans les autres villes du pays. L'étage au rez-de-chaussée comporte les pièces auxiliaires et le premier étage les pièces destinées à l'habitation.*

DO NOT COPY

Modifications enregistrées par cette maison dans le temps

Cette habitation a subi d'importantes transformations soit sur le plan de la composition que sur le plan architectonique. Elle ne conserve pas actuellement un schéma semblable, typologique à celui des maisons à tchardak *mises en place pendant les XVIIIe-XIXe siècles (Tab. I, II, III). Dans le passé on y a construit des annexes, dont la disposition ne s'est guidée sur aucun critère préétabli ou n'a tenu compte d'aucun lien logique et fonctionnel, envisagés dans la complexité du monument. Aussi l'étude des différentes phases de construction se présentait assez difficile. Il s'agissait tout d'abord d'établir si nous avions affaire à une seule habitation dès sa phase initiale ou à des constructions particulières, et s'il en était ainsi il fallait déterminer le rapport temporel existant entre ces diverses constructions, apporter une solution à la question de savoir si cette maison avait eu un tchardak, et enfin éclaircir d'autres problèmes comme la solution planimétrique et de composition employée et la configuration planimétrique de son aile gauche.*

Afin de donner une réponse à ces questions, il fut nécessaire d'effectuer une série d'observations et de sondages, d'étudier les données historiques et les sources orales recueillies. Les sondages effectués au point de rencontre des murs N.-O. et du mur S.-O. de la partie arrière avec l'aile gauche ont mis en lumière une jointure. Ces deux murs s'appuyaient à la partie de l'aille gauche; de même la technique de construction n'était pas égale. Ces données montrent que les deux pièces susmentionnées ne sont pas contemporaines et que la partie gauche est plus ancienne que la partie arrière. L'étude de la technique de construction des colonnes du hayat, *relevant de l'aile droite, a montré que celle-ci n'est pas analogue à la technique employée pour la construction des colonnes du* hayat *central, qui correspondent à la partie arrière de l'habitation et se caractérisent aussi par des dimensions différentes. La technique plus ancienne est celle des colonnes du* hayat *central. De ce que nous venons d'énoncer plus haut, il ressort que nous avons affaire à trois phases de construction, chacune d'elle ayant une chronologie relative, en l'absence de datation et de documents pouvant élucider ce problème.*

A la première phase de construction correspond l'aile gauche, entièrement transformée à son état actuel, ce qui rend assez difficile la question de déterminer sa configuration planimétrique initiale, Après avoir pris en considération les différents variantes, notre choix s'est porté sur la maison contiguë, qui est un type d'habitation à tchardak *dans sa partie frontale. A la suite d'un examen attentif et d'une confrontation minutieuse de ces deux habitations, nous avons relevé les constatations suivantes: les pièces du premier étage ont la même extension sur les deux ailes; les deux murs longitudinaux se prolongent sans interruption; l'établissement scolaire provoque une intersection; les deux habitations se trouvent sous un même toit; l'auvent du toit dans la partie arrière a un schéma analogue à celui de la maison objet de cette étude, comme il ressort de la documentation photographique; les différentes pièces et éléments de la partie reconstruite ont une symétrie analogue à celle de la maison contiguë (d'après les donées recueillies par les habitants du pays), qui conserve fidèlement le schéma initial. Tous ces faits nous induisent à conclure qu'à sa phase initiale l'aile gauche faisait part de l'habitation contiguë, qui comporte trois pièces et un tchardak dans sa partie frontale.*

A la deuxième phase de construction appartient la partie arrière de la maison. A ce point qu'il nous permis d'avancer l'hypothèse que la partie centrale jusqu'à la deuxième colonne, située dans le hayat, *est contemporaine de celui-ci et a fait fonction de* tchardak. *En témoigne aussi le fait que la colonne se trouve sur une même ligne que la face S.-E. de la partie arrière. Par ailleurs, sa technique de construction est analogue à celle de la face S.-E. La présence de cette surface* tchardak, *outre les autres arguments qui seront exposés ultérieurement, est entièrement justifiée par sa surface relativement petite, en envisageant à ce point la construction d'une autre pièce, afin de pouvoir faire face à la nouvelle situation qui s'était fait jour. Donc, à notre avis l'escalier également constitue une construction appartenant à cette même phase, ce qui rend plus compréhensible la présence de cet espace libre en tant que pièce servant à la communication avec l'étage.*

A la troisième phase de construction appartiennent la partie de l'aile droite et la partie centrale, jusqu'à la deuxième colonne, qui a fait fonction de tchardak *en continuation du premier.*

Et pour conclure nous pouvons affirmer que la maison de Pashko Vasa constitue une construction comportant diverses adjonctions effectuées à différentes époques, sans toutefois suivre un critère se conformant à l'évolution générale de la maison shkodrane pendant les XVIIIe-XIXe siècles.

Restauration

De pair aux modifications enregistrées par cette maison dans le temps, il convient de souligner que son état actuel en général et celui de ses éléments constitutifs en particulier laissaient beaucoup à désirer. Partant de la situation technique et de construction de ce monument, des données que nous avons pu y recueillir et de ses valeurs architectoniques, nous avons élaboré le projet de sa restauration en tenant compte de la composition générale de cette maison et de ses différents éléments architectoniques. Ainsi, chaque fois qu'une adjonction ou la reconstruction d'un élément architectonique présentait un intérêt en tant que témoignage de l'époque, ou bien comportait en soi une valeur et des éléments rattachés organiquement à l'habitation, celles-ci furent conservées. Par contre, tous les autres éléments furent éliminés. C'est à partir de ce critère qu'il fut décidé de ramener à sa phase initiale la partie centrale de l'habitation, qui avait un tchardak *par devant. A notre avis, il convient de ramener à sa phase initiale même la partie de*

DO NOT COPY

l'aile gauche. Les travaux de restauration ont concerné principalement la partie centrale, afin de reconstruire le tchardak à proximité de la chambre des amis, qui fut dotée aussi du qoshk caractéristique (Fig. 16) en suivant les traces observées sur les lieux. Il fut procédé également à la reconstruction de la fenêtre à grilles de bois ainsi que de la porte, en tant qu'éléments relevant de la partie de l'aile gauche qui donne sur le tchardak. Des travaux de reconstruction furent entrepris aussi dans les pièces N° 4 et N° 5. Par ailleurs la cheminée, l'étagère du mur, la niche et la porte mettant en communication avec l'aile gauche, ainsi que la fenêtre donnant sur le tchardak et l'évier pour se laver les mains furent aussi restaurés. Tandis que la partie inférieure du trapazan ne fut l'objet d'aucune restauration. A partir des éléments originaux fut entamée la reconstruction du plafond et de la partie supérieure du trapazan, ainsi que la restauration totale du plafond de la maison du feu (Tab. V).

En considération de son importance historique et en raison du fait qu'elle se rattache étroitement à la vie du patriote Pashko Vasa, la chambre des amis fut l'objet d'une restauration très attentive. La présence même des éléments architectoniques originaux et le fait qu'ils n'ont subi aucun changement dans le temps (Tab. IV), nous a énormément facilité la tâche. Pour la reconstruction de la partie manquante de l'aile gauche, nous nous sommes fondé sur les traces existantes et sur le schéma habituel trapazan-armoire à mur des habitations shkodrane des XVIIIe-XIXe siècles. Il fut procédé à la reconstruction de la partie supérieure du trapazan (Fig. 17) ainsi que des fenêtres amovibles, à la restauration du plafond orné de décorations, des frises et de l'étagère. Il fut décidé aussi de reconstruire la cheminée (Fig. 18), et cela à partir des traces découvertes durant les travaux de restauration; quant au type, à la forme et au niveau de la décoration, nous avons tenu compte de la période à laquelle appartenait la pièce en question en analogie avec les pièces similaires de la même époque. A la suite de sa restauration, la chambre des amis s'est enrichie de nouvelles valeurs architectoniques, en se rapprochant assez à la période au cours de laquelle a vécu Pashko Vasa. Tout comme les pièces de l'étage supérieur, les pièces du rez-de-chaussée furent restaurées. A la suite de quoi fut entièrement libéré le hayat situé au-dessous de la pièce N° 3; les fenêtres et la porte de «ahrit» furent reconstruites et l'on procéda au crépissage des murs selon la technique originale. C'est dans ce cadre qu'il fut aussi procédé à la reconstruction générale du toit, notamment à celle des auvents en saillie (Fig. 19), à la reconstruction partielle des écrans en chassis de bois, à la resturation de certaines fenêtres et à la reconstruction de celles qui manquaient (Fig. 20), à la restauration totale des frises intérieures et extérieures, ainsi qu'à la reconstruction de toutes les fenêtres. Dans le même temps tout le plancher de cette habitation fut reconstruit totalement; il fut procédé aussi au patinage des murs et à la reconstruction et à la restauration de l'escalier extérieur.

Des travaux furent aussi effectués sur le terrain de cette maison. On procéda, entre autres, à la reconstruction totale du pavé du hayat, du puits, à la réparation des murs de la cour, à la reconstruction totale de la porte extérieure et de sa couverture ainsi que de la petite porte de la cour. L'avant-cour aussi fut remis en ordre, en accordant une attention particulière à ses installations caractéristiques comme puits, cuve, auge et jarres en pierre.

A la suite de la conclusion des travaux de restauration, à l'exception de la partie de l'aile gauche où il fut procédé au crépissage extérieur et au crépissage de l'auvent provisoire, le monument en question à acquis de nouveau nombre des valeurs qu'il avait perdu dans le cours des temps (Fig. 21).

Aujourd'hui la maison de Pashko Vasa, qualifiée de monument de culture, sert de musée à la Filiale de la Ligue de Prizren pour la ville de Shkodër (Tab. V). La chambre des amis, dans laquelle a vécu Pashko Vasa, a été convertie en une chambre-musée illustrant l'activité patriotique de cet idéologue de notre Renaissance nationale.

Par suite de la réalisation des travaux de restauration et de la transformation de cette habitation en musée, le monument en question a acquis de nouvelles valeurs tant sur le plan historique que sur le plan architectonique de l'habitation albanaise de XVIIIe-XIXe siècles, du fait qu'elle reflète fidèlement les conditions économiques et sociales de l'époque.

Leonard SULI

RESTAURIMI I KULLËS SË MIC SOKOLIT

Afër qytetit malor të Bajram Currit në rrethin e Tropojës në jug të tij, ndodhet fshati Bujan. Në pjesën juglindore të fshatit, mbi një terren të lartësuar ngrihet madhërishëm kulla e vjetër (fig. 1) e Heroit të Popullit Mic Sokoli[1]. Kulla, muret e së cilës janë goditur disa herë nga topat e pushtuesve të huaj, është një dëshmi e luftërave të vazhdueshme të malësorëve trima, për të mbrojtur trojet e vendit të tyre. Në njërën nga këto beteja, ndërmjet forcave Shqiptare të Lidhjes të Prizrenit dhe ushtrisë turke të komanduara nga Dervish Pasha, e cila u zhvillua më 22 prill të vitit 1881 në Shtimlje drejtë grykës së Cernalevës, afër fshatit Slivovë, u vra heroikisht prijësi i shquar popullor, i cili megjithëse i plagosur me gjoksin e tij mbuloi grykën e topit armik[2]. Kulla është e padatuar por nga të dhëna të ndryshme ajo duhet të jetë ndërtuar nga fundi i shek. XVIII[3]. Krahas vlerës historike si ndërtim që lidhet me jetën e patriotit dhe luftëtarit të shquar, kulla ka një vlerë të madhe përsa i përket zhvillimit tipologjik të banesës së vjetër në Malësinë e Gjakovës. Nga studimet e arkitekturës popullore për këtë krahinë rezulton se mbas shembullit të gjetur në fshatin Babinë, i cili përfaqësonte tipin e banesës tre katëshe prej guri dhe pjesërisht prej druri[4], kulla e Mic Sokolit mbetet i vetmi shembull që mbart karakteristikat e përmendura më sipër.



Fig. 1

Kulla[5] në shqyrtim, në prak të punimeve res-

1) Mic Sokoli lindi rreth vitit 1839 në fshatin Bujan. Ai rridhte nga një familje atdhetare dhe luftëtarësh. I ati i tij Sokol Rama dhe një i afërmi i tij Binak Aliu të njohur si udhëheqës të shquar popullorë drejtuan në vitin 1845 kryengritjen e banorëve të Gjakovës kundër zbatimit të reformave të tanzimatit. Shih **Historia e Shqipërisë**, vol. II, Tiranë 1965, fq. 57.

2) **Vep. cit.** faqe 190.

3) Nga të dhënat gojore, prej të moshuarve, mësuam se kulla është ndërtuar nga gjyshi i Mic Sokolit. Kjo e dhënë përputhet dhe me trajtimin e banesës me teknikat e gurit dhe drurit, e cila në këtë krahinë është më e hershme se teknika thjeshtë me gurë.

4) P. Thomo **Banesat e fortifikuara në Malësinë e Gjakovës,** Studime historike Nr. 3, 1973, fq. 74.

5) Rilevimet janë të autorit, F. Zarshatit, G. Samimit dhe B. Penxhës, vizatimet të F. Zarshatit, fotot të autorit G. Samimit, dhe R. Veselit. Projekti i restaurimit u hartua nga autori i artikullit. Punimet restauruese u zbatuan nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës së Shkodrës gjatë viteve 1976-1978 nën drejtimin e autorit dhe Sh. Priftit.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY

tauruese ndodhej në një gjendje mjaft të dëmtuar, ajo kishte humbur çatinë dyshekllëkun prej druri në katin e tretë dhe konstruksionin e dyshemeve ndërmjet kateve. Ky dëmtim ka ardhur, kryesisht si pasojë e zjarrit të rënë në kullë në vitin 1945. Në gjendjen e sotme nuk duken gjurmë muresh ose të ndonjë teknike, të ndonjë materiali tjetër me të cilat të ketë qenë qarkuar fillimisht kulla.

Ndërtimi është trekatësh (Tab. II, III, IV, V), ai në planimetri ka formën e një katërkëndëshi këndrejtë. Skema kompozicionale e vendosjes të ambienteve për çdo kat të kullës pas studimit në vend rezultoi e tillë: Kati përdhes, përmbante vetëm «ahrin», kati parë «sobën e grave» dhe një koridor që e paraprinte, ndërsa kati i dytë «odën e miqve» dhe «divanhanen» përpara saj. Ndërsa në të dy katet e sipërm jasht volumit të ndërtimit kanë qenë ambientet sanitare. Ndërlidhja ndërmjet kateve arrihej nga brenda dhe nga jashtë me anë të shkallëve njërampëshe prej druri. Ahri (Tab. II, 1) ka shërbyer për strehimin e bagëtisë dhe kuajve. Ashtu si në gjithë banesat e vjetra të krahinës, ahri dhe këtu ka qenë ambienti më i sigurtë. Numri i madh i frëngjive të vogla njëshe dhe dyshe, në të katër faqet, të cilat i jepnin një ndriçim dhe ajrim të paktë këtij ambienti të errët të lënë të kuptosh se përveç funksionit të përmendur më sipër ahri ka shërbyer gjerësisht për mbrojtje. Dera e ahrit, e ndërtuar në pamjen veriore (Tab. II, 1, IV, 1) nga jashtë ka qenë e mbuluar me hark, ndërsa nga brenda muratura e pjesës së sipërme mbështetej mbi arkitrarë prej druri, gjurmët e të cilëve kanë mbetur ende (fig. 2). Dera sigurohej nga brenda nëpërmjet

të një binari, të cilin vendasit e quajnë «drang». Drangu futet në vrimën që ndodhet në shpatullën e djathtë të muraturës së portës. Gjithashtu në faqen ku është vendosur dera e hyrjes duket vendi i thelluar në mur, për të mbështetur «qyprin» (trau gjatësor, mbi të cilin mbështeteshin trarët e dyshemesë së sobës së grave).

Kati i parë i kullës (Tab. II, 3) në të cilin zhvillohej jeta e gjallë e familjes, nga gjurmët e mbetura kuptohet se ka pasur një ambient të vetëm, sobën e grave ose «odër e zjarrit». Hyrja për në këtë kat, bëhej nga dera e ndërtuar në pamjen perëndimore tek e cila të çonin shkallët e jashtme njërampshe prej guri, të cilat në prag të restaurimit nuk ruheshin. Për qënien e tyre dëshmonin disa gjurmë të zbehta në faqen e jashtme të muraturës si dhe të dhënat gojore. Mendojmë se shkallët, fillimisht, kanë qenë prej druri, por këtë problem do ta argumentojmë më poshtë. Dera e hyrjes, që përmendëm më sipër ashtu si dhe ajo e ahrit nga ana e jashtme ka qenë mbuluar me hark rrethor (fig. 3). Kjo kuptohet lehtë nga vendet e mbetura në pjesën e sipërme ku mbështeteshin themrat e harkut. Muratura e pjesës së brendshme mbështetej mbi arkitrarë prej druri siç e dëshmojnë vendet e inkastrimit të tyre në brendësi të murit. Porta prej druri njëflegërshe, ashtu si dhe ajo e ahrit sigurohej nga brënda me anën e drangut. Për këtë qëllim është dhe vrima nëpërmjet së cilës futej ai, e ndërtuar kjo në brendësi të shpatullës së majtë të muraturës. Nivelin dhe sasinë e trarëve të dyshemesë të humbur në këtë kat si dhe në atë të sipërmin, e bënë të qartë vrimat në brendësi të muraturës në faqet lindore dhe perëndimore (VI, 1, 3). Gjithashtu vumë re se në faqen lindore, afër derës së ambientit sanitar, në gjurmët e pakëta të suvasë që kishte mbetur pa u dëmutar dukeshin shenjat ku ka qenë mbështetur një shtyllë vertikale, e cila na çon në mendimin se ajo ishte fillimi i një ndarje me skelet druri e veshur me dërrasa, ndarje të cilat janë thuajse të njejta në të gjitha banesat e vjetra. Kjo ndarje kufizonte siç duket sobën e grave me koridorin nëpërmjet të cilit kalohej tek ambienti sanitar. Dera e hyrjes e këtij ambienti e vendosur në fillim në faqen lindore, më vonë është murosur, por qenia vërtetohet qartë nga fuga vertikale (Tab. VI, 1, 3). Sipas të dhënave që parashtruam deri tani për këtë kat u bë e mundur të njihej skema planimetrike e kompozimit të tij. Tani po japim përshkrimin e elementeve përbërës funksional dhe arkitektonik të secilit ambjent. Soba e grave ndricohet dhe ajroset nga dritare me përmasa të vogla të harkuara nga ana e jashtme, ndërsa brenda ato mbulohen me arkitrarë prej druri. Përveç dritareve në faqe të ndryshme të sobës së grave janë ndërtuar frengji të vogla dyshe dhe treshe. Në faqen jugore, dallojmë gjurmët e oxhakut dhe të kamares anash tij (Tab. VI, 2, 4, fig. 4). Ky element i rëndësishëm i këtij ambienti ishte mjaft i dëmtuar, por mbas arsyetimeve që do të parashtrojmë më poshtë, duke u bazuar kryesisht në gjurmët e mbetura, mundëm të formojnë idenë e formës së tij fillestare. Dy gurët e mbetur në të dy anët e kanalit të tymit mbi të cilat mbështeteshin dy shpatullat anësore prej guri, gjithashtu dhe dy vendet e gurëve që inkastroheshin në mur dhe mbanin pjesën e sipërme të shpatullës të çojnë në përfundimin se oxhaku nuk ka qenë me kosh por i tipit me tambur me seksion katërkëndëshkëndrejt.



Fig. 4

Kati i dytë i kullës (Tab. III, IV, V) është ai më i dëmtuari, por duke i kushtuar kujdes të veçantë studimit dhe interpretimit të gjurmëve të mbetura, u bë e mundur të krijohej ideja e skemës planimetrike të ambjenteve që përfshinte ky kat dhe qënies të ndonjë

DO NOT COPY



Fig. 5

elementi të veçantë. Rrjedhimisht ky përcaktim bëri, që në fillim të njiheshin me tipin dhe vendin që zinte kulla në tipologjinë e banesës popullore të kësaj krahine. Kati përmbante në mbrendësinë e tij, odën e miqve e cila paraprihej nga «divanhania», që zinte një sipërfaqe më të vogël se oda e miqve. Ajo kufizohej në të gjithë pamjen perëndimore dhe pjesërisht në atë veriore me dyshekllëk prej druri. Nga divanhania kalohej në koridorin e ngushtë, përbri odës së miqve, i cili të çonte në ambientin sanitar, i ndërtuar në pamjen lindore. Ndërsa shkallët një rampshe prej druri, të vendosura në divanhane të ndërlidhin me katin e parë (Tab. III, 2). Më poshtë po parashtrojmë argumentat që na çuan në përcaktimin e mësipërm, të kompozimit të këtyre ambienteve. Në gjendjen përpara ndërhyrjes restauruese odës së miqve i kishin mbetur vetëm dy muret kufizues perimetral nga ana jugore dhe lindore. Megjithatë siç do ta shohim m poshtë, këto dy mure në faqet e tyre përmban thuajse të gjithë gjurmët e elementeve arkitektonik e funksionale të odës së miqve. Muratura e këty mureve ashtu si dhe mureve perimetralë të dy kate të poshtëm ishte ndërtuar me gurë kave të lidhur m llaç gëlqereje e qarkuar kjo me breza druri të ma kuar në të dy faqet e muraturës. Në faqen lindo të odës së miqve shofim të ndërtuar oxhakun pr të cilit kishin mbetur pothuajse ato gjurmë të ele menteve përbërës të tij si në katin e parë, fakt ky q na shpie në mendimin se dy oxhaqet kanë pasur fo më dhe trajtim thuajse të njëjtë. Në të majtë të oxha kut ndodhet dritarja e harkuar dhe në fund të faqe hapsira e derës të ambientit sanitar, gjurmët e pa turës të së cilës (Tab. III, 1, Tab. VI, 1, 3, fig. 5) t lënë të kuptosh se ky ambient ka qenë i ndërtuar ja shtë volumit të ndërtimit. Ndërsa në të majtë të oxha kut ka frengji të zakonshme (Tab. VI, 1, 3). Kurse në faqen jugore shohim të ndërtuar dritaren, frengjinë dhe gjurmët e kanalit të tymit, që i përkiste oxhaku të sobës së grave dhe në vazhdim pjesa e murit që kufizonte në këtë anë divanhanen (Tab. VI, 2, 4). Dy çatmatë ndarëse të brendshme, që kufizonin odën e miqve me koridorin dhe divanhanen nuk ndodheshin, por nuk e patëm të vështirë të përcaktonim fillimisht pozicionin e tyre të përafërt. Ndërprerja e muraturës në faqen veriore (Tab. IV, 1, fig. 5) me faqe të rrafshët vërtetoi se divanhania kufizohej në këtë drejtim dhe në të gjithë pamjen perëndimore me dyshekllëk prej druri. (Skelet prej shtyllash vertikale i verbër me dërrasa të trasha). Në të kundërtën po të supozonim se këto dy faqe kufizoheshin me mure të holla prej guri duhet të kishte mbetur lidhja organike midis murit perimetral dhe murit kufizues të hollë prej guri. Duke mos e gjetur këtë gjurmë u përforcua në mënyrë të padiskutueshme qenia e dyshekllëkut prej druri në drejtimet e përmendura më lart.

Restaurimi

Restaurimi i këtij monumenti me vlerë të dyfishtë, si nga ana tipologjike dhe ajo historike, shtronte përpara nesh disa probleme të mënyrës së trajtimit të këtij monumenti, për të arritur në një projekt të bazuar për restaurimin e tij. Duke qenë monumenti i pambuluar, disa struktura sidomos pjesa e sipërme e mureve perimetralë kishin humbur qëndrueshmërinë. Prandaj së pari shtrohej problemi i rindërtimit apo konsolidimit të këtyre strukturave. U pa e arsyeshme të bëhej konsolidimi i tyre me qëllim që të ruhej struktura e vjetër pa ndikuar negativisht në qëndrueshmërinë e tyre pavarësisht nga vështirësitë teknike që mund të

DO NOT COPY

delnin gjatë konsolidimit. Së dyti shtrohej problemi i rindërtimit ose jo, të disa elementeve të veçantë arkitektonikë dhe konstruktivë të dëmtuar. Në këtë rast u mbajt ky qëndrim: në qoftë se ruheshin gjurmë të plota të cilat justifikonin dhe bënin të mundur rindërtimin e tyre, ky rindërtim ishte i pranueshëm. Problemi i tretë, që për mendimin tonë ishte dhe më kryesori në këtë restaurim, qe ai nëse duhej të bëhej apo jo në këtë monument rindërtimi i pjesshëm i tij (pjesët munguese që përmendëm më lart). Për zgjidhjen e këtij problemi duhej gjykuar për vlerën e dyfishtë të tij. Për vlerën tipologjike, kompozicionale të trashëguar, për të cilën folëm fillimisht, duke pasur parasysh gjurmët jo të pakëta që na çonin në gjendjen fillestare të tij, rindërtimi, ishte një rrugë e pranueshme. Në anën tjetër ky rindërtim do të siguronte dhe qëndrueshmërinë e pjesës origjinale të monumentit[6]. Së dyti, restaurimi i pjesëve munguese, kishte dhe një arsye madhore për t'u ndjekur, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe historike të këtij monumenti, i cili lidhej me figurën e heroit të popullit Mic Sokoli. Për disa elemente mungues si p.sh. dyshekllëkun prej druri qenia e të cilit vërtetohej nga gjurmët ekzistuese u bë në analogji[7] me banesat e të njëjtit tip në zonën përreth. Monumenti siç e argumentuam fillimisht në gjendjen e tij, na çonte me siguri në përcaktimin e kompozimit të elementeve origjinale, ndërsa analogjia me numrin e madh të banesave të vjetra, dhe të disa banesave të vjetra me dyshekllëk prej druri të zonës përreth kësaj krahine, na lejonte të hartonim projektin e restaurimit. Veçanërisht me rëndësi qe analogjia për trajtimin e katit të tretë, i cili është ai më standarti[8], në të gjitha banesat e Malësisë së Gjakovës, si nga zgjidhja planimetrike ashtu dhe nga pajisja dhe trajtimi i elementeve, kështu që kjo ishte një rrugë e sigurtë. Mbi bazën e këtyre parimeve u hartua projekti i restaurimit nëpërmjet të cilit po shtjelloj dhe teknikën e ndërtimit dhe trajtimit të elementeve të mbetur në vend dhe atyre që mungojnë por që i morëm për bazë duke shfrytëzuar anallogjinë tipologjike. Në katin përdhes (Tab. II, 2) u rindërtuan në faqen veriore shkallët e brendshme njërampshe prej druri të cilat mbështeten mbi një bazament të ulët prej guri. Kurse në qoshen veri-perëndimore u rindërtua grazhdi i kalit[9]. Shkallët e jashtme u rindërtuan prej druri (Tab. V, 2). Në pjesën e poshtëme ato mbështeten mbi një bazament të formuar nga një skelet binarësh katërkëndësh i mbushur me gurë, ndërsa në pjesën e sipërme mbështeten mbi traun konsol të sheshpushimit, i cili ashtu dhe pjesa e rampës së shkallëve është e mbuluar me një streh të lehtë që vendasit e quajnë «krevet». Shkallët nuk u rindërtuan prej guri, sepse u provua se ato nuk i përkisnin fazës fillestare, mbasi ndërtimi i tyre do të bënte të pafunksionueshme frengjinë e katit përdhes në këtë faqe, gjithashtu banesat e tjera me dyshekllëk druri shkallët e jashtme i kanë pasur gjithashtu prej druri. Kompozimi planimetrik e volumor i ambjenteve të katit të parë doli siç u parashtrua fillimisht (Tab. II, 4). Meqënëse në këtë kat u gjetën gjurmë të shtresës së suvasë, muret perimetralë u suvatuan plotësisht me llaç gëlqereje. Shkallët e brendshme prej druri u ndërtuan në faqen perëndimore me anë të cilave realizohet ndërlidhja me divanhanen e katit të dytë (Tab. VII, 2), sepse në të kundërtën po të vendoseshin në koridor (në faqen veriore) pjesa e sipërme e tyre do të dilte në koridorin e katit të dytë kundrejt ambientit sanitar. Mos qenia e gjurmëve, na kushtëzuan që në kompozimin planimetrik volumor të katit të parë të mos bënte pjesë «qyleri»[10]. Në zgjidhjen e skemës planimetrike të ambienteve në katin e dytë (Tab. III, 2) që u bazua kryesisht nga të dhënat që na afroi monumenti dhe u parashtruan fillimisht, një vend të rëndësishëm zë trajtimi i odës së miqve. Duke qënë se të dhënat për teknikën e ndërtimit dhe të trajtimit të elementeve të veçantë ishin të pamjaftueshme me që këto elemente janë mjaft të tipizuar u morën në analogji me ato të disa banesave të vjetra, të cilat i përmbanin mjaft mirë këto elemente[11]. Oda e miqve në krahasim me sobën e grave është më komode, më e ngrohtë përsa i përket trajtimit dekorativ të elementeve të ndryshëm konstruktivë dhe funksionalë. Sipërfaqja e odës së miqve ndahet në dy pjesë, nga një rrugicë e ngushtë që fillon nga dera e hyrjes deri tek vatra. Pjesa e majtë quhet «Markëza e vogël» në të

6) E. Riza, **Kriteret dhe metodika e restaurimit të banesave popullore;** Material i pa botuar i cili ruhet në arkivin e I.M.K. fq. 26.

7) E.Riza **Vep. e cituar,** fq. 35.

8) P. Thomo, **Vep. cit.** fq. 70.

9) Rindërtimi i grazhdit të kalit u bë duke u bazuar në të dhënat për këtë element, që u morën në fshatin Pepaj si dhe në bazë të orientimeve të mjeshtrave vendas të fshatit Bujan.

10) «Qyleri», ose oda e fjetjes për çifte të rinj është një ambient që gjendet në katin e parë në të gjitha banesat e vjetra, por ai zakonisht ndërtohet më vonë se banesa. Prandaj duke u bazuar në mungesën e gjurmëve të këtij ambienti, dhe se skema kompozicionale e katit të parë ishte ajo e gjendjes fillestare u bindëm se një ambient i tillë nuk ekzistonte fillimisht.

DUKAGJINI

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

cilën rri i zoti i shtëpisë, ndërsa «markëza e madhe» në të djathtë rezervohet për miqtë. Dyshemeja e odës së miqëve ashtu si ajo e sobës së grave shtrohet me dërrasa të afruara mbi të cilat vendoset një shtresë e hollë me gjethe dushku mbi të cilën hidhet një shtresë dheu (Tab. III, 4) e cila ngjishet mirë[12]. Sipër shtresës së dheut shtrohen hasrat, qilimat dhe postiqet për ndejtje, kurse anash mureve vihen jasteqet për mbështetje. Në fund të markëzës së vogël lihet një sipërfaqe e vogël e pashtruar me dhe, vend ky që shërben për të lënë këpucët ose për të vënë sofrën mbas të ngrënit. Trarët e tavanit të odës në dy faqet anësore të këtyre kanë të thelluar nga një kanal që shkon gjatë gjithë gjatësisë së traut. Në këto kanale vendosen me rradhë dërrasat e shkurtra (Tab. III, 3) të cilat zakonisht janë të profiluara. Ndërsa konstruksioni ndarës prej druri formohet nga shtylla vertikale dhe këtu në të dy faqet anësore të tyre thellohet një kanal si ai i trarëve të tavanit ku vendosen pastaj dërrasat horizontale. Faqja e brendshme e kësaj ndarje suvatohet me llaç gëlqereje (Tab. III, 5). Në shtyllat e drurit që zakonisht nuk mbulohen me suva vendosen në pjesën e sipërme të tyre kunja druri që shërbenin për të varur rrobat dhe pushkët. Për trajtimin e elementeve të tjerë të katit të dytë, veçanërisht të dyshekllëkut prej druri të divanhanes përveç banesës së vetme dykatshme që ruhet ende në këtë krahinë, në qytetin e B. Currit dhe përmbante akoma këtë element (në gjendjen e sotme pjesërisht e transformuar) (Tab. X, 3), u morën për bazë kryesisht të dhënat që na ofronin banesat e krahinës fqinjë të Hasit, të cilat kanë një ngjashmëri të madhe si për zhvillimin planimetrik formulimin volumor, dhe në trajtimin dhe teknikën e ndërtimit me banesat e malësisë së Gjakovës[13]. Veçanërisht në Has banesat me dyshekllëk druri janë të shumëta dhe të ruajtura mjaft mirë[14]. Divanhania nuk është thjesht një vend komunikimi por dhe një ambient që shërbente për kryerjen e punëve të shtëpisë, ndërsa në stinën e verës ajo shërbente si vend çlodhjeje dhe fjetjeje. Në murin kufizues prej guri në brendësi të divanhanes zakonisht ndërtohej oxhaku i kafes, gjurmët e të cilit në kullën që po shqyrtojmë nuk i gjetëm. Elementi më karakteristik i divanhanes është dyshekllëku (Tab. III, 2, Tab. VII, 2, 3), ai e kufizon divanhanen në dy drejtime dhe del rreth 20 cm nga faqja e jashtme e mureve

11) Detajet për trajtimin dhe teknikën e ndërtimit të elementeve të veçantë, siç ishin tavanet, dyshemetë dhe çatmatë ndarëse u morën në vend në disa banesa të vjetra të shpallura monument kulture, të cilat janë të ndërtuara në fshatrat Shoshaj, Babinë, (P. Thomo, **vep. cit.** Tab. 1 fig. 91, Tab. 11 fq. 101).

12) Gjatë ndërtimit të çdo banese të re sipas më të moshuarve kur vinte rradha e procesit të ngjeshjes së dheut (shtresës së sipërme), mblidheshin një pjesë e mirë e nuseve të fshatit dhe e ngjishnin me lugë mbarë sipërfaqen, duke arritur një shtresë mjaft kompakte.

13) P. Thomo, **vep. cit,** fq. 74-75.

14) Për ndërtimin e dyshekllëkut të kullës, dhe të disa elementeve të çatisë u morën kryesisht të dhëna që na afroi një banesë e ndërtuar në lagjen e sipërme të Krumës (Tab. X, 1, 2)



Fig. 8



Fig. 9

perimetralë fig. 7. Ashtu si dhe gjithë elementët e tjerë të drurit dhe dyshekllëku është prej dru lisi, ku dërrasat që kanë një trashësi rreth 8 cm, kllaposen në shtyllat ndërmjetëse prej druri. Në sipërfaqen e dyshekllëkut janë ndërtuar dritare të shumta të cilat ashtu si kollonat e brendshme që mbajnë konstruksionin e çatisë së divanhanes janë trajtuar me një përkujdesje të veçantë (Tab. VIII, 1, 2, 3, 4, 5, Tab. III, 6, 7 fig. 8)[15]. Çatia është e tipit Stropil dhe e mbuluar me furde. Qoshet e çatisë janë të rrumbullakuara gjë që realizohet duke dalë bishtat e çatisë në formë radiale nga një pikë e mahis. Bishtat e çatisë kanë të njëjtin përpunim si ato të dyshekllëkut (Tab. VIII, 6, 7).

Kulla në shqyrtim na paraqet një volum prizmatik prej guri dhe pjesërisht prej druri, e cila kurorëzohet nga një çati katërujëshe e mbuluar me furde (dërrasa). Vlera arkitektonike e pamjeve të kullës është e diferencuar, ajo vjen duke u rritur nga një pamje në tjetrën duke përjashtuar këtu atë ku janë vendosur ambjentet sanitare. Pamja jugore ka një trajtim të thjeshtë plani i rrafshët i muraturës së gurit që përfshin pamjen e tre kateve thyhet deri në një farë shkalle në hapësirat e frengjive dhe të dritares së vetme të harkuar. Këtë pamje e pasuron streha solide, por elegante prej druri. Shkallët dhe ambientet sanitare të vendosura në plan të dytë krijojnë një lëvizje të volumeve që ndikon në gjallërimin e pamjes duke arritur një kontrast me masën e ftohtë të muraturës së planit të parë. Një vend të veçantë në trajtimin arkitektonik zënë pamjet veriore dhe veçanërisht ajo perëndimore fig. 9, ku përdorimi gjerësisht i dy materialeve me cilësi e ngjyrë të ndryshme, ka dhënë mundësi që përveç zgjidhjeve logjike e konstruktive, të arrihet një realizim me vlerë arkitektonike. Pjesa e muraturës e ndërtuar prej druri në katin e sipërm dhe shkallët elegante po prej druri në pjesën e poshtëme i japin kullës një ngrotësi të efektshme ku pjesa e poshtëme prej guri të krijon përshtypjen e një prizmi të fortë solid ku mbështetet pjesa e sipërme e lehtë dhe plot drit dhe me një përpunim të pasur arkitektonik.

Restaurimi i kullës së Mic Sokolit u krye në kuadrin e përvjetorit të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Për të përjetësuar, heroizmin e luftëtarit dhe patriotit të shquar Mic Sokolit, kulla e tij e lindjes u kthye pas restaurimit në shtëpi-muze. Kjo paraqet nëpërmjet dokumentash dhe objektesh jetën dhe veprimtarinë e heroit dhe të afërmëve të tij, të cilët janë shquar gjithashtu si patriotë dhe luftëtarë të vendosur për çështjen shqiptare. Restaurimi i këtij monumenti me vlerë të veçantë në gjininë e tij, bëri të mundur që ai të rifitojë formën e tij fillestare duke kontribuar kështu në ruajtjen dhe forcimin e traditës në fushën ndërtimore të trashëguar nga të parët tanë. Gjithashtu kthimi në muze i kullës së heroit do të shërbejë për edukimin patriotik dhe revolucionar të masave të gjera punonjëse.

15) Në restaurimin e kullës një kontribut të mirë dhanë mjeshtrit vendas sidomos në punimin e elementeve të drurit të cilët dhe në banesat e vjetra e kanë pasur traditë t'i kryenin vetë, ndërsa muratura e gurit ndërtohej nga mjeshtrit dibranë.

DO NOT COPY

TAB I

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI TROPOJES

PERSPEKTIVE - Skicë
PAS RESTAURIMIT



PLANI I PERGJITHSHEM
SHKALLA 1:200



DO NOT COPY

DO NOT COPY

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJES



TAB III

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJES



1

KATI I II
GJENDJA PARA RESTAURIMIT



2

KATI I II
PAS RESTAURIMIT

DETAJI I TAVANIT TË ODES SE MIQVE



3



4

DETAJI I ÇATMAVE TË ODES SE MIQVE DHE TE GRAVE



5

DETAJI "Ë"



6



7

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KULLA E MIC SOKOLIT
FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJES

PAMJE NGA VERIU
PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



1



2

PAMJE NGA LINDJA
PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



3



4

0 1 2 3 4m.

TAB V

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJES



1



2

PAMJE NGA PERENDIMI
PARA DHE MBAS RESTAURIMIT



3



4

PAMJE NGA JUGU
PARA DHE MBAS RESTAURIMIT

0 1 2 3M

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJËS



PRERJE "C-C"

1



0 1 2 3м

2

PRERJE "D-D"



3



4

DO NOT COPY

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJES



PRERJE "A-A"



PRERJE "B-B"



DETAJI I DYSHEKLLEKUT
DHE I ÇATISE

DO NOT COPY



DRITARE E DYSHEKLLEKUT



DETAJI C.



DETAJI D.

DETAJI B. - SHTYLLA QOSHES E DYSHEKLLEKUT





DETAJI I STREHES I DYSHEKLLEKUT

PRERJE 1-1





DETAJI I STREHES NE PJESEN E MURATURES

0 10 20cm

TAB IX

DO NOT COPY

KULLA E MIC SOKOLIT

FSHATI BUJAN - RRETHI I TROPOJES

DERE E ODES SE MIQVE





B - B



A - A



PRERJE 1-1



WC E KATIT II

PRERJE TERTHORE

DO NOT COPY







Leonard SULI

DO NOT COPY

RESTAURATION DE LA KULLA DE MIC SOKOLI

RESUME

A proximité de la ville de Bajram Curri, dans la partie S du district montagneux de Tropojë, se situe le village de Bujan. Dans la partie S.-E. de ce village, sur un terrain élevé se dresse majestueusement l'ancienne kulla *(fig. 1) de l'Héros du Peuple Mic Sokoli. Cette tour, dont les murs ont été frappés plus d'une fois par les obus des envahisseurs étrangers, est un témoignage des luttes incessantes de nos braves montagnards pour défendre la terre de leurs aïeux. C'est au cours d'une de ces batailles, entre les forces albanaises de la Ligue de Prizren et les troupes turques commandées par Dervish Pasha, bataille qui eut lieu le 22 avril 1881 à Shtimje en direction du col de Cernaleva, aux environs du village de Slivove, que le guide insigne de notre peuple Mic Sokoli est tombé en héros en couvrant de son corps le canon de l'ennemi pour défendre ses camarades. Cette* kulla, *selon toute vraisemblance, fut construite vers la fin du XVIIIe siècle. Outre l'intérêt historique qu'elle présente du fait qu'elle se rattache à la vie de l'illustre patriote et combattant, cette* kulla *occupe une place importante dans l'évolution typologique de l'ancienne habitation dans la Malësi de Gjakova, car nous avons affaire à un exemplaire unique représentant la* kulla *à trois étages, construite de pierres et comportant un* dyshekllëk *de bois à l'étage supérieur. Avant d'entreprendre les travaux de restauration, la* kulla *de Mic Sokoli se trouvait dans un état fort peu satisfaisant; son toit, le* dyshekllëk *de bois au troisième étage et la construction des planchers séparant les étages manquaient complètement. Cette dégradation était dûe principalement à un incendie qui l'avait réduit en cet état en 1945. Le schéma compositionnel de la disposition des pièces à chaque étage est le suivant: au rez-de-chaussée il n'y avait que l'*ahr, *au premier étage la chambre du feu* (soba e grave) *destinée aux femmes et précédée par un couloir et au troisième étage, «la chambre des amis» et, par devant celle-ci, la* divanhane. *L'*ahr *(Tab. II, 1) servait d'abri au bétail et aux chevaux. Le nombre élevé de meurtrières nous induit à penser que cette pièce a servi largement à la défense de la* kulla. *C'est au premier étage (Tab. II, 3) que se faisait la vie familiale. Des traces que l'on peut encore relever, il ressort que cet étage comportait la chambre du feu destinée exclusivement aux femmes et un couloir conduisant à la toilette. Le deuxième étage (Tab. III, IV, V) est celui plus endommagé de la* kulla. *Une étude minutieuse des traces existantes nous a permis de reconstruire le schéma planimétrique des pièces de cet étage (Tab. III, 2). Et par là nous avons pu établir dès le début le type et la place qu'occupe cette* kulla *dans la typologie de la région examinée. Plus bas nous exposerons les arguments qui nous ont conduit à la définition du schéma planimétrique. L'interruption de la maçonnerie sur la façade N (Tab. IV, 1, fig. 6), avec des parements unis, montre que la* divanhane *limitait en cette direction et le long de toute la façade N. le* dyshekllëk *de bois (avant une charpente à colonnes verticales et des planches épaisses à encastrement). Si l'on admet au contraire le fait que ces deux faces étaient limitées par des murs peu épais de pierre sur la face N, nous aurions dû relever la liaison organique entre le mur du périmètre et le mur limite peu épais de pierre. Par ailleurs, les traces de l'ouverture du cabinet du toilette (Tab. III, 1, Tab. VI, 1, 3 fig. 5) sont là pour indiquer que celui-ci se caractérisait par une construction indentique à celui du premier étage, c'est-à-dire qu'il faisait saillie du volume de la construction. Dans le même temps, les traces relevées dans le foyer, élément d'importance dans la chambre des amis, nous ont permis de tirer la conclusion que celui-ci, tout comme la chambre à feu des femmes, appartenait au type à tambour ayant une section quadrangulaire.*

La restauration

La restauration de ce monument d'un double intérêt, typologique et historique exigeait la solution de divers problèmes

concernant son traitement afin de pouvoir dresser un projet de restauration bien-fondé, et cela surtout en raison du fait que nous étions en présence d'une construction manquant de sa couverture et dont certaines structures, surtout dans la partie supérieure des murs du périmètre, avaient perdu leur stabilité. C'est pourquoi il fallait tout d'abord aborder le problème de leur reconstruction ou de leur consolidation. Il a été jugé convenable de procéder à leur consolidation indépendamment des difficultés à surmonter. Ensuite se posait le problème de reconstruire ou non certaines éléments architectoniques et de construction endommagés. Dans ce cas nous avons agi de la façon suivante: s'il y avait des traces complètes de ces éléments justifiant et permettant leur reconstruction, il a été procédé dans ce sens. Le troisième et plus important problème à résoudre était, à notre sens, celui de la reconstruction partielle du monument, en reconstituant les pièces qui y manquaient. La solution de ce problème dépendait de la valeur typologique compositionnelle héritée, que nous avons abordé au commencement, et cela sur la base des nombreuses traces conservées encore et conduisant à l'état initial du monument. Par ailleurs, cette reconstruction allait assurer aussi la stabilité de la partie originale du monument. Deuxièmement, la restauration des éléments qui manquaient s'imposait du fait que nous avions à faire à un monument de grande importance historique se rattachant à la figure de l'héros du peuple Mic Sokoli. En ce qui concerne certains éléments qui manquaient, entre autres le dyshekllëk de bois, dont l'existence était attestée par les traces présentes, il a été reconstruit en analogie avec celui des autres maisons de même type se trouvant dans la zone environnante. Cette analogie a été d'une grande aide surtout pour certains éléments particuliers du troisième étage, qui est l'étage le plus habituel dans les maisons de la Malësi de Gjakova et de la zone avoisinante. C'est sur la base de ces principes que fut dressé le projet de restauration. Plus bas nous décriverons brièvement les travaux de restauration et la technique de construction. Dans la pièce dite ahr il fut procédé à la reconstruction du râtelier des chevaux; de même fut reconstruit en bois l'escalier extérieur, du fait que sa construction en pierres empêchait le fonctionnement de la meurtrière située sur le côté gauche de l'escalier et que les anciennes maisons à dyshekllëk de bois ont un escalier de bois. La composition planimétrique-volumétrique des pièces du premier étage résulta être comme nous l'avons exposé, plus haut (Tab. II, 4). Du fait que dans cet étage ont été relevées des traces de crépi, il fut procédé au crépissage des murs du périmètre avec du mortier de chaux. L'escalier de bois intérieur fut aménagé sur la façade occidentale (Tab. VII, 2), et cela pour établir la communication avec la divanhane du deuxième étage, car en le mettant dans le couloir (sur la façade septentrionale) sa partie supérieure aurait débouchée dans le couloir du deuxième étage face au cabinet de toilette. Par suite de l'absence de traces, la composition planimétrique-volumétrique du deuxième étage ne comprend pas le qyler (la pièce servant de chambre à coucher aux jeunes époux). Dans la solution du schéma planimétrique des pièces du deuxième étage (Tab. III, 2), principalement sur la base des données offertes par le monument lui-même et que nous avons illustré au commencement, une place importante revient au traitement de la chambre des amis. Les données complémentaires relatives à la technique de construction des divers éléments furent empruntées aux anciennes habitations de même type, en procédant par la méthode de l'analogie. La chambre des amis, en comparaison à la chambre de ménage des femmes, est de loin plus commode, plus chaude en ce qui concerne la décoration des différents éléments de construction et fonctionnels. Sa surface est divisée en deux par un sentier étroit, dont la partie gauche dénommée «markëza e vogël» est réservée au maître du logis et l'autre partie, la «markëza e madhe», aux hôtes. Quant au traitement des autres éléments du deuxième étage, en particulier du dyshekllëk de bois de la divanhane, outre l'unique habitation à deux étages encore conservée dans cette région, dans la ville de Bajram Curri, et ayant ces mêmes éléments (encore que partiellement transformés) (Tab. X, 3), nous nous sommes fondés principalement sur les données offertes par les habitations de la région avoisinante de Has (Tab. X, 1, 2), qui ont une grande ressemblance avec celles de la Malësi de Gjakova du point de vue de l'évolution planimétrique, de la formulation du volume, du traitement et de la technique de construction. La divanhane n'est pas seulement un lieu de communication, mais aussi une pièce où l'on effectuait les travaux du ménage et, pendant la saison d'été, elle servait de lieu de repos et de chambre à coucher. C'est dans le mur de pierre limitant l'intérieur de la divanhane que se trouvait d'habitude le foyer du café, dont on n'a pu rétrouver les traces dans la kulla que nous sommes en train d'examiner. Comme dans les autres habitations, dans cette kulla aussi l'élément le plus caractéristique de la divanhane est le dyshekllëk. (Tab. III, 2, Tab. VII, 2, 3). Il est en bois de chêne et fait saillie des parements des murs du périmètre en forme de console (Fig. 7). Dans la surface du dyshekllëk il y a de nombreuses fenêtres, lesquelles, tout comme les colonnes intérieures supportant la construction du toit de la divanhane, sont traitées avec grand soin (Tab. VIII, 1, 2, 3, 4, 5; Tab. III, 6, 7, Fig. 8). Cette kulla se présente sous la forme d'un volume prismatique, en partie en pierre et en partie en bois, et se termine par un toit à quatre pentes couvert de planches. La valeur architectonique des aspects est différenciée, elle croît d'un aspect à l'autre. Une place toute particulière revient dans le traitement architectonique aux vues septentrionale et surtout à celle occidentale (Fig. 9), où l'utilisation dans une large mesure de deux matériaux de construction différents quant à leur qualité et leur couleur a créé les conditions requises pour apporter des solutions logiques et de construction et d'obtenir, dans le même temps, une réalisation d'intérêt architectonique. La partie des murs construite avec du bois à l'étage supérieur et l'élégant escalier toujours en bois dans la partie inférieure confèrent à cette kulla une note de chaleur plein d'effet, et cela du fait que la partie inférieure en pierre crée l'impression d'un prisme solide sur lequel repose la partie supérieure, qui est légère et pleine de lumière et se caractérise par un traitement architectonique plus riche.

DO NOT COPY

La restauration de la kulla de Mic Sokoli a été effectuée dans le cadre de la commémoration du 100e anniversaire de la fondation de la Ligue albanaise de Prizren, en vue de perpétuer l'héroïsme de l'illustre combattant et patriote que fut Mic Sokoli. Après sa restauration, ce monument où est né le remarquable héros, à été converti en une maison-musée où sont exposés des documents et des objets concernant la vie et l'activité de Mic Sokoli et de ses proches, qui se sont également faits remarquer comme des patriotes et des combattants résolus de la cause albanaise. La restauration de ce monument d'un intérêt particulier en son genre lui a redonné sa valeur initiale, en apportant ainsi une contribution à la conservation et au renforcement des traditions dans le domaine de la construction. De même, le fait d'avoir converti son habitation en une maison-musée contribuera à l'éducation patriotique et révolutionnaire des vastes masses populaires.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Robert BALLAURI

NJË MONUMENT HISTORIK ME VLERË NË ELBASAN *)

Le të kemi parasysh Elbasanin e fundit të shekullit XVIII dhe të fillimit të shekullit XIX, me rrugica të shumta, dhe që gjarpërojnë sa andej këndej, duke krijuar parcelat e banimit me planimetri të çrregullta që nuk i përngjasin njëra-tjetrës. I tillë shtrihet qyteti brenda mureve të kalasë dhe që sot është një dëshmi e gjallë e shekujve të kaluar. Elbasoni filloi të ketë një rritje të dukshme në gjysmën e dytë të shek. XV, kur pushtuesit osmanë duke bërë rikonstruksionin e kalasë, njëkohësisht inkurajuan edhe ripopullimin e lagjeve, brenda dhe jashtë saj, me popullsi shqiptare nga fshatrat përreth[1].

Në rrjedhën e kohës, Elbasani pësoi transformime të dukshme, aq sa në fund të shek. XVI ai kishte një varosh të madh rreth kalasë[2] dhe zona e banuar brenda mureve të saj kishte rimarrë fizionominë që ka pak' a shumë sot. Si e tillë, ajo kaloi deri në shekujt XVIII-XIX, periudhë që do të flasim në studimin tonë, duke bërë për objekt një banesë dykatëshe, të ndodhur në mes të lagjes brenda kalasë, në një rrugicë mesjetare të shtruar me kalldrëm. Në këtë shtëpi në vitin 1830 lindi dhe kaloi kohën e njomë të fëminisë gjuhëtari dhe atdhetari i shquar, Kostandin Kristoforidhi[3].

*
* *

Shekulli XVIII karakterizohet nga një organizim më i plotë i tregtisë dhe esnafëve[4] dhe krijoi kushte të tilla që jeta qytetare të marrë ritme të shpejta zhvillimi, qoftë përsa i takon mënyrës së jetesës, ashtu edhe përsa i takon rritjes së popullsisë qytetare. Kështu kërkesat në qytete u rritën dhe u zhvilluan shumë zejet. Në Elbasan çdo të diel bëhej tregu publik me njerëz të ardhur nga qytetet dhe krahinat rreth e rrotull[5], siç tregon Evlia Çelebiu. Traditë kjo që u ruajt edhe në shekujt e mëvonshëm, deri në kohët tona. Kjo solli si rrjedhim që Elbasani të bëhej një qendër rrugore me rëndësi[6], që lidhte qytetet e bregdetit me ato në brendësi të vendit, deri edhe me Shkupin, Dibrën, Manastirin, Ohrin, Selenikun, e përtej deri në Bullgari, Turqi e Rumani.

*) Rilevimet dhe projekti i restaurimit u përfunduan në v. 1977, ndërsa restaurimi dhe kthimi në shtëpi-muze u bënë gjatë v. 1978, në kuadrin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren. Rilevimet dhe vizatimet janë të K. Qatipit dhe të autorit, fotografitë të R. Veselit, H. Çollakut dhe të autorit.

1) M. Barleti – Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut – Tiranë 1967 – fq. 485-486.

2) Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, III – Tiranë 1967, 164.

3) Simon Shuteriqi – Jetëshkrimi i Kostandin Kristoforidhit, Manastir 1911. Në faqen 6 mësojmë se prindërit e tij ishin Anastas Nelkoja dhe Vasilija Josifi, nga familje të njohura të Kungonjës (lagje e Kalasë). (Kostandin Kristoforidhi banoi në këtë shtëpi deri në vitin 1847, kur shkoi në Janinë, për të ndjekur mësimet e mesme në Gjimnazin Zosimea).

4) Z. Shkodra – Esnafët Shqiptarë (shek. XV-XX) – Tiranë 1973, f. 84.

5) Burime të zgjedhura të Historisë së Shqipërisë, vëll. III, f. 183.

6) A. Çaushi – Transporti në Elbasan gjatë shekujsh – Etnografia II, f. 146-147.

Organizimi i esnafëve krijoi kushte shumë të favorshme për zhvillimin me ritme të shpejta të jetës qytetare.

Qysh në shekujt XVII-XVIII në Elbasan kishte shumë zejtarë, midis tyre argjendarët, të cilët bënin punime të bukura dhe të rralla në ar, argjend dhe tunxh, që shiteshin në të gjithë vendin[7].

Sipas Çelebiut, në shek. XVII Elbasani vetëm argjendarë ka patur 13. Siguristh, me kalimin e kohës, ky numër zanatçinjsh u rrit akoma. Kështu në gjysmën e dytë të shek. XVIII edhe gjyshin e Kostandin Kristoforidhit e gjejmë ndër argjendarët elbasanas dhe mbahej si një mjeshtër i filigranës[8].

Babaj i Kristoforidhit trashëgoi zanatin e të jatit[9]. Sot gjenden në Elbasan objekte të punuara nga ai. Mjeshtria e argjendarit i solli të ardhura familjes, e cila ekonomikisht paraqitej në gjendje disi të mirë. Këtej lind edhe kërkesa për të patur një banesë në rangun dhe nivelin që e kërkonte kjo gjendje ekonomike.

*
* *

1 — RESTAURIMI

Shtëpia ku lindi Kostandin Kristoforidhi është një banesë e gjysmës së dytë të shek. XVIII, siç janë edhe shtëpi të tjera që rrjeshtohen nga njëra dhe tjetra anë e saj. Ajo paraqet të gjitha tiparet e banesës me çardak[10], megjithëse pësoi më vonë disa rikonstruksione dhe ridimensionime të sipërfaqes së banimit.

Në faqen e jashtme të murit të banesës ngjitur, në drejtim të lindjes, duken qartë gjurmët e trarëve të tavanit dhe të perdeve të mureve ndarëse që i kanë takuar kësaj banese që po trajtojmë (Tab. VI — 2, 3). Duke i analizuar e matur këto gjurmë bindemi për faktin se fillimisht kjo shtëpi ka patur në katin e parë 3 dhoma banimi dhe çardakun e hapur (Tab. I, 1, 2) kurse poshtë bodrume. Këtë përfundim e përforcojnë edhe pohimet e banorëve të moshuar të rrugës Mihal Hasa, ku ndodhet banesa në fjalë, të cilët përveç të tjerave flasin edhe për dhoma me tavane të dekoruar në dru, për dollape me dru të gdhendur, me një fjalë për pajisje me kërkesa estetike të qarta[11]. Siguristh gjatë rikonstruksioneve të mëvonshme, këto u prishën dhe u zëvendësuan me më të thjeshta. Këto ndërtime të njëpasnjëshme sollën ndryshime edhe në planimetrinë e banesës. Me kalimin e kohës strukturat mbajtëse të saj u degraduan, filluan kështu të zvogëlohen ambientet e banimit. Numëri i tyre nga 3 që ishte, mbetej vetëm në 1 dhomë dhe çardaku i hapur, që vazhdonte të qëndronte në të gjitha variantet (Tab. III). Edhe pozicioni i shkallëve lëvizi, ato u futën më brenda. Gjatë rilevimit të banesës, në dhomën e vetme që ndahej nga çardaku me një mur çatmaje, u vu re në mënyrë shumë bindëse se ai nuk ishte në vendin e tij, për dy arsye: së pari, sepse mbështetej pa asnjë bazament mbi dyshemenë e katit të parë dhe pa patur ndonjë mur mbajtës në katin përdhe (Tab. IV — 1), së dyti, pozicioni i tij nuk na jepte ambientin e dhomës së zjarrit, ku zakonisht boshti i oxhakut është edhe aks simetrie për faqen e murit të dhomës. Duke e lëvizur këtë mur ndarës dhe duke e mbështetur mbi murin mbajtës që ndan ambientet e bodrumit, ne jo vetëm ndërtuam murin ndarës ashtu si duhet, por përfituam gjithashtu dhomën e zjarrit ku vatra qëndronte në faqen lindore të saj (Tab. IV, 2). Kështu u arrit që të bëjmë, mbi të dhënat e mësipërme, një rikonstruksion mjaft bindës të banesës. Mendojmë se ky rikonstruksion hipotetik na e jep banesën ashtu siç ishte, kur gjyshi i Kostandin Kristoforidhit e pat ndërtuar atë, në gjysmën e dytë të shekullit XVIII (Tab. I, 1, 2).

Funksioni dhe skema planimetrike fillestare e saj janë të thjeshta dhe komunikuese. Ato mbështeten mbi kriteret e njohura të banesës qytetare të Elbasanit, duke shfrytëzuar në mënyrë sa më harmonike terenin, që në rastin tonë është një parcelë më shumë e gjatë se e gjerë (Tab. II, 1), afërsisht në raportin 1 me 4.

Gjendja që trashëguam është një riduktim maksimal i kësaj skeme planimetrike: një dhomë me një çardak (Tab. VI, 1) që shtrihen në afro gjysmën e sipërfaqes së banesës. Përveç që paraqiste një degradim të thellë të gjithë godinës, asaj i mungonin shumë elemente përbërëse, që mund të ndihmonin në një farë mënyre në restaurimin e saj. Gjendja para restaurimit ishte mjaft e ndërlikuar dhe kërkonte në radhë të parë një argumentim të saktë për atë pjesë që do të restaurohej. Prandaj së pari u grumbullua dokumentacioni mbi çdo gjë ekzistuese dhe këto të dhëna

7) Z. Shkodra, Vep. cituar f. 62.
8) Nga sa thuhet në një monografi, që ndodhet në Muzeun Historik të Elbasanit, gjyshi dhe babaj i K. Kristoforidhit kanë qenë argjendarë të njohur në Elbasan.
9) U.SH.T. — Historia e Letërsisë shqipe, II, f. 244.
10) Emin Riza — Tipologjia e banesës qytetare gjatë shek. XVIII-XIX. Studime historike, 3/1976 — faqe 108.
11) Emin Riza — po aty f. 111: Një karakteristikë e banesës me çardak është ornamentika e pasur, kryesisht në dru.

DOKTORATURA

u përputhën me një nga skemat tradicionale të banesës qytetare të Elbasanit, që ndeshen kudo në lagjen brenda kalasë.

Restaurimi u përcaktua kështu mbi kombinimin si më lart dhe mbi këtë bazë u argumentua gjithë puna restauruese. Në gjendjen para restaurimit, shkallët që të shpinin në katin e parë kishin zënë një pozicion kyç të tillë që përcaktonin gjithë zgjidhjen planimetrike (Tab. IV, 1). Në rast se do të ngriheshin të tri ambientet dhe çardaku i hapur, ashtu si ishte fillimisht banesa, shkallët medoemos do të zhvendoseshin në drejtim të jugut, gjë që nuk do të përputhej me të dhënat e rilevimit. Varianti më i pranueshëm mbetej që godina në fjalë të kishte një dhomë zjarri dhe një çardak të hapur, dmth po aqë ambiente sa gjetëm dhe kështu shkallët të mos lëviznin nga pozicioni që kishin. Në këtë mënyrë sipërfaqja e katit të parë do të rritej dhe shkallët do të ndryshonin skemën e tyre planimetrike ndaj çardakut të hapur: nga mbështetja anësore që kishin në variantin e ri, do të futen në sipërfaqen e çardakut. Si rrjedhim sipërfaqja e përgjithshme e katit të parë do të rritet në rreth 12 m^2 (Tab. III).

Gjurmët në faqen lindore, që u përmendën më lart, janë kaq të qarta dhe bindëse, sa që mund të procedohej me lehtësi të madhe për ndarjen e ambienteve, me që duken qartë edhe shenjat e tullave të mureve ndarëse (Tab. VI, 3). Mbas çlirimit të mureve nga suvatimi dolën shumë komponente të rinj që e pasuruan dokumentimin ekzistues dhe mendimi i formuluar për rikonstruksionin e banesës gjeti kështu një aprovim tjetër të mbështetur në fakte bindëse.

Një kërkesë po aq e rëndësishme ishte edhe formulimi i arkitekturës dhe i çdo elementi arkitektonik në veçanti. Siç u theksua më lart banesa është e llojit me çardak të hapur, gjë që përkon edhe me klimën e butë të qytetit të Elbasanit. Një trajtim të tillë arkitektonik kanë edhe shtëpi të tjera[12], brenda mureve të kalasë të të njëjtës kohë ndërtimi, prej të cilave morëm elementet arkitektonike që përdorëm, si shkallët, parmakët e shkallëve, dyert, dritaret dhe deri tek grila metalike në dritaren e bodrumit. Komponentet arkitektonike të interierëve, që u gjetën në banesa, shërbejnë si model për të riprodhuar pjesët e tjera që mungonin, siç është rasti i kapakëve prej druri të gdhendur për dy dollapet, ku ishin vetëm kapakët e një dollapi (Tab. VI, 2) dhe mbi modelin e tyre u punuan ata të dollapit tjetër. Ndërsa në rastin e portës të hyrjes ajo ruante elemente interesante të teknikës së dyerve, në vend të mendesheve, kanatet e saj rrotulloheshin mbi një aks që formohej prej dy zgjatimesh druri lart e poshtë, të cilat futeshin në dy

12) E. Riza — po aty: f. 111-112.

TAB V



fole po të drunjta (Tab. VIII, 4). Mirëpo kjo portë ishte shumë e degraduar aqsa nuk mbante ndërhyrje restauruese. Prandaj mbi modelin e saj u ribë një portë e re, sigurisht elementet metalike, dryni, dorezat, gozhdët u ruajtën dhe iu aplikuan portës së re (Tab. VII, 5).

Interes paraqiti një kapitel që u gjend në bodrumin e shtëpisë dhe që ishte përdorur në sistemin e pajantimit të dyshemesë, që ishte e degraduar. Ky element i banesës u kishte rezistuar prishjeve dhe adoptimeve. Një tjetër kapitel u përdor (Tab. VII, 6) në kollonën e katit të parë, që mban traun anësor të çatisë. Dimensionet e tij janë 70 x 10 x 16 cm. dhe në pjesën e poshtme ka një dekoracion nga të dy anët e jastekut, ku mbështetet mbi kollonë. Duke vlerësuar të gjitha këto punime druri që u gjetën: dollapi me kanatat në dru të skalitur, kapitelet dhe porta e hyrjes, mund të arrihet në konkluzionin se niveli i këtyre punimeve rrjedh nga një kërkesë relativisht e ngritur. Ky është një tregues tjetër që na vë në dukje se në ndërtimin e shtëpisë janë angazhuar mjeshtër dhe ustallarë të mirë dhe është bërë punë me vlera estetike.

Më lart trajtuam llojin e banesës, e cila shtrihet mbi një planimetri me funksion bazë: kati përdhe

DO NOT COPY

DO NOT COPY

me ambientet për gatim dhe për shërbim e për ruajtjen e zahiresë e të druve të zjarrit, ndërsa kati i parë që fillimisht ka patur dhomën e zjarrit dhe dy ambiente të tjera, njëra dhomë e miqve dhe tjetra si dhomë fjetje. Mirëpo tek kjo shtëpi u trashëgua vetëm një dhomë lart dhe çardaku i hapur. Mbi këtë trashëgimi bëmë studimin për restaurimin e banesës në fjalë. Planimetria e re, bazë mbi të cilën mbështetet puna restauruese, ndryshon nga ajo para restaurimit (Tab. III), ndryshim që u arrit në formulimin drejt të planimetrisë së dhomës së zjarrit, ku si e përmendëm edhe më lart, aksi i oxhakut duhet të jetë edhe aks simetrie për dhomën. Ky mendim u përforcua edhe me faktin se duke marrë parasysh këtë aks simetrie, muri ndarës i dhomës së zjarrit u vendos pikërisht mbi murin e bodrumit të katit përdhe.

Dhoma e zjarrit fillimisht nuk ka patur dritare në rrugë, ajo është ndriçuar nga një baxhë, me dimensione 105 x 190 cm dhe nga një dritare e vogël rreth 60 x 100 cm që binte në çardak.

Rikonstruksionet dhe adaptimet e mëvonshme kësaj dhome i kishin hapur edhe një dritare tjetër nga ana e veriut (Tab. VII, 7) mbi rrugën mbrapa shtëpisë. U mendua që kjo dritare të mbyllej dhe të ruhej origjinaliteti i dhomës së zjarrit, që do të ndriçohej me dritën e baxhës dhe të dritares në çardakun e hapur. Edhe tavani ka qenë vetëm me trarë. Trarët e çatisë dhe sistemi i mahive u veshën nga poshtë me dërrasa tavanore, për të krijuar një pastërti, me që do të jetë një objekt i vizitueshëm (Tab. VIII, 8, 9).

Çardaku i hapur në faqen lindore të tij ruan një dollap, një kamare dhe një sergjen të cilët u kanë takuar dhomave të gjumit në gjendjen fillestare të banesës. Por, duke kërkuar që këto elemente të ruhen, menduam se edhe pa qenë funksionale në ambientin e çardakut ku janë sot, ashtu siç janë, ato qëndrojnë shumë mirë përbri eksponateve të shtëpisë muze. Bile në të ardhmen, duke u shtuar reliket dhe dokumentacioni mbi Kostandin Kristoforidhin, do të ketë mundësi që këto të ekspozohen brenda në kamaret dhe në dollapet e dhomës e të çardakut.

Ndërtimi i themeleve dhe i mureve kryesore të banesës, deri në nivelin e katit të parë, janë bërë me gurë gëlqerorë, zakonisht të marrë në shtratin e lumit të Zaranikës, si gjithë ndërtimet e kësaj kohe në Elbasan. Gjerësia e këtyre mureve është rreth 50 cm. dhe ka ndihmuar në ngritjen e tyre me breza druri horizontale, 90-100 cm. larg nga njëri-tjetri. Si material lidhës për to është përdorur balta e përzier me kashtë. Gurët në pjesën më të madhe janë të papërpunuar, porse të rrumbullakosur dhe kanë forma të ndryshme paralelopipedike. Muret e katit përdhe nuk kanë qenë të suvatuar.

Muratura e katit të parë është e ndryshme. Për murin e jashtëm, që bie mbi rrugën prapa, fillimisht ka qenë mur guri, si vazhdimi i murit të katit përdhe. Porse, me ndryshimet që pësoi banesa, ne gjetëm para restaurimit një mur të gjerë 12 cm, me trarë druri 8 x 8 cm. të vendosur vertikalisht dhe horizontalisht në largësi 50 dhe 60 cm. nga njëri tjetri. Hapësirat e formuara kështu ishin mbushur me tulla (Tab. VII, 7). Kurse muret anësore dhe muri që ndante dhomën e zjarrit me çardakun kanë qenë çatma, sigurisht të suvatuara nga të dy anët dhe pjesërisht mur guri (Tab. VIII, 10). Çatia kishte dy kullime dhe e tillë mbeti, veçse kulmi i saj nga 1.85 m që ishte u lartësua në 2.20 cm si rezultat i shtimit të sipërfaqes mbi të cilën u ngrit banesa pas restaurimit.

*
* *

Hapja e objektit shërbeu për të thelluar më tej studimin mbi këtë banesë. Në radhë të parë u përforcua mendimi që shpuri në hartimin e projektit të restaurimit se fillimisht ishin tri dhoma dhe çardaku i hapur. Muri lindor, që e ndan nga shtëpia fqinje, kur u hoq suvaja nxori në shesh shenjat e lidhjes së tij me murin prej çatmaje që ndante dhomën e zjarrit me dhomën fqinje. Kurse bukur doli silueta impozante e oxhakut në formë tamburi, dy kamaret anash dhe mënyra e ndërtimit të tyre (Tab. VIII, 11) që paraqit një vijë harmonike të formës, ku gërshetohet mirë guri me drurin (Tab. IX, 12). Në ndarjet prej çatmaje dolën veç të tjerave disa ndërhyrje për meremetime në kohë të ndryshme, kryesisht për teknikën e ndërtimit dhe materialin prej druri që ishte përdorur. Në shumë raste ishin futur edhe ripa druri nga bordurat e kamareve dhe dollapeve. U gjend i gozhduar në çatma edhe një fragment druri i gdhendur, pjesë sigurisht nga një tavan i banesës (Tab. IX, 13). Muret anësore ku pjesërisht ishte çatmaja, strukturën e drunjtë e kishin të kalbur dhe paraqiste një degradim të theksuar, sa që gjatë zhveshjesh nga suvaja një pjesë e saj u rëzua në tokë. Për të arritur një muraturë solide, muret perimetrale prej çatmaje u zëvendësuan me mure tulle 25 cm. Vetëm faqja ku ishin dollapi dhe kamaret, në çardakun e hapur, u ndërtua çatma.

Rrjeti i trarëve të dyshemesë së katit të parë dhe të çatisë u vendos duke ruajtur hapin që kishte banesa para restaurimit. Veçse për të krijuar një mbështetje të mirë për trarët e çatisë, në muret perimetrale u vu një brez betoni, mbi të cilin do të vendoseshin anët e trarëve. Një pjesë e mirë e tyre, që nuk paraqesin shenja degradimi u përdorën rishtaz në objekt, pjesa tjetër u zëvëndësua (Tab. IX, 14).

Në tavanin e hapur të odës së zjarrit është ba-

xha e cila ndriçon pjesërisht dhomën. Në anën e poshtëme të tyre, trarët e çatisë u veshën me dërrasa tavanore, gjë që krijon ambientin e dëshiruar për një shtëpi muze. Ndërsa oxhaku u restaurua mbi linjën e gjendjes ekzistuese dhe u arrit të ndërtohej kështu, së bashku me kamaret dhe dollapin e restauruar (Tab. IX, 15) një interier bindës dhe funksional. Të gjitha muret e brendshme u suvatuan.

Shkallët që të çojnë në katin e parë kanë tre bazamakët e parë të gurtë, ndërsa të tjerët janë prej dërrase (Tab. X, 16). Parmaku i shkallëve ngjitet lart dhe rrethon çardakun e hapur (Tab. X, 17).

Në katin përdhe shtrihet në një pjesë të vetme bodrumi, që ruan tiparet e ambientit ashtu si ka qenë fillimisht. Dera, prej dërrase masive, e dekoruar dhe një dritare me rrjetë hekuri sipas motivit të Elbasanit, ndriçojnë bodrumin (Tab. II, 2,3).

*
* *

Detyra e restaurimit u plotësua, si rezultat i kombinimit të drejtë të punës kërkuese studimore dhe të punës së gjallë në objekt, gjatë gjithë kohës së punimeve. U arrit kështu një restaurim i plotë i një monumenti historik me rëndësi të madhe jo vetëm për Elbasanin, por për gjithë vendin (Tab. X, 18).

2. SHTËPIA – MUZE

Tipologjia e kësaj banese të hapur me çardak e bën të domosdoshme edhe ruajtjen në mënyrë sa më besnike të konceptit jetësor e funksional të banesës, ambientin jashtë dhe interierët, së bashku me pajisjet dhe mobilimin, në mënyrë që të formojnë një tërësi karakteristike për ndërtimet e gjysmës së dytë të shek. XVIII (Tab. V). Restaurimi i dha vlera të reja banesës, si në pamjen arkitektonike dhe funksionale, ashtu dhe në arritjen estetike të godinës në tërësi dhe elementeve përbërës të saj në veçanti.

Trashëgimia arkitekturale nuk përbën vetëm një dëshmi estetike të së kaluarës, por ajo duhet të jetë edhe një komponente dinamike në jetën tonë të sotme, duke i sjellë kësaj frymën dhe individualitetin e traditave tona më të mira kulturore e patriotike. Pikërisht për këtë, muzeu si një institucion edukues, fiton akoma më shumë interes në planin kulturor dhe shoqëror kur ay vendoset brenda një monumenti historik.

Nga kjo pikëpamje faza e dytë për trajtimin e këtij monumenti ishte detyra për kthimin e tij në një qendër të vizitueshme, në një shtëpi-muze për figurën e Konstandin Kristoforidhit.

Platforma[13] e muzeut u mbështet në faktet historike dhe momentet kyçe të jetës dhe veprimtarisë së patriotit të madh.

Muzeografia marksiste-leniniste shqiptare i trajton ngjarjet dhe figurat të lidhura ngushtë me idealet dhe aspiratat e masave, me dinamikën e lëvizjeve të fuqishme popullore. Prandaj figura e Kostandin Kristoforidhit, në zhvillimin e ngjarjeve, është futur në lëvizjen e madhe të Rilindjes Shqiptare, e rrethuar nga shokë e miq të tij, që tërë së bashku punuan dhe u përpoqën për lirinë dhe vetëqeverimin e Shqipërisë.

E gjithë jeta e Kostandin Kristoforidhit është shumë aktive dhe dinamike. Patrioti i shquar mbaroi gjimnazin Zosimea të Janinës (më 1850), punoi si mësues në Shqipëri e në vise të jashtme, vazhdoi studimet e larta në Angli dhe përsëri filloi të punojë si mësues (në Tuniz, më 1859) ku edhe u martua.

Prej vitit 1864 Kostandin Kristoforidhi filloi të përkthejë libra kishtare në të cilat futi dialektet dhe gjuhën e pasur të popullit të tij, që e vlerësoi dhe e përhapi me zell të madh. Në Stamboll (1864) ai u njoh me Pashko Vasën, Hasan Tahsinin, Ismail Qemalin dhe së bashku me ta u përpoqën të krijonin një shoqatë Shqiptare me karakter kulturor dhe arsimor[15]. Kristoforidhi ndoqi me vëmendje dhe me shpresë ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren duke e cilësuar këtë lëvizje (1880) kështu, ndër të tjera... **«edhe pse është fort e re, po përhapet me shpejtësi të madhe»** dhe **«do të bëhet shumë e fortë për Derebejtë dhe për Portën e Lartë[16]».**

Dhe më vonë (1888) Kristoforidhi ngrihet kundër feudalëve dhe klerit kur thotë që **«Ndë thenc për bejlerëtë e agallarëtë e zotëritë, ata nukë apënë ndihmë, sepse kanë frikë Derën e Lartë»** Ai e ka besimin tek vegjëlia ku ka nisur të zgjohet ndërgjegja kombëtare e ku gjen **«shqiptarë të kulluar»**[17]

Një letërkëmbim i gjerë me patriotë dhe atdhetarë bashkëkohës hedh dritë mbi jetën dhe veprimtarinë e madhe të Kristoforidhit. Ay njohu shumë të huaj

13) U përgatit nga Muzeu i Rrethit dhe nga shoqata e historianëve të Elbasanit.
15) Historia e Shqipërisë, Vol. II – f. 97.
16) Turkey, 1880 London – Vol. I dok. 64. Nga një bashkëbisedim që ka patur Kristoforidhi me të dërguarin e posaçëm të Anglisë në Stamboll, Lordin Fitzmaurice.
17) Gazeta e Korçës, 16 dhe 30 janar 1927. Letër që Kostandin Kristoforidhi i dërgon Nikolla Naços nga Elbasani, më 25 janar 1888.

BOTIME

DO NOT COPY

që kishin edhe ata qëllime dashamirësie ndaj vendit tonë, gjuhës shqipe dhe çështjes së lirisë e pavarësisë së popullit Shqiptar. Rreth vitit 1850 ay u njoh me shkencëtarin Gjerman G. Hahn[18], me të cilin edhe shetiti në vise të ndryshme të Shqipërisë. Periudha pas vitit 1878 do të kurorëzonte punën e madhe të Kristoforidhit, porse pengesa të shumta dhe kushte të vështira bënë që të plotësohej vetëm një pjesë e barrës së rëndë që ai i kishte vënë vetes.

Më 1884 Kristoforidhi u kthye për ngahera në Atdhe, me qëllimin e lartë që të hapë një shkollë, për t'u mësuar bashkatdhetarëve gjuhën shqipe. Këtë qëllim ai e realizoi dhe deri në fund të jetës, u bë mësuesi i dashur i fëmijëve, të afërmëve të tij dhe zanatçinjve të qytetit të Elbasanit, të cilëve u shkonte shtëpi më shtëpi e dyqan më dyqan, për t'u mësuar shqipen.

Vdiq në Elbasan, më 1895 nga një sëmundje e rëndë, në varfëri të plotë, por i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë.

Kristoforidhi la një trashëgimi të pasur në fushën e letërsisë dhe një kontribut të vyer në pedagogjinë shqiptare. Si shkencëtar, ay bëri një punë të çmuar në lëmin e leksikografisë shqipe. Më 1904 u botua fjalori i tij, që është kontributi më i shquar që ai i bëri gjuhës shqipe.

*

Për ta kthyer në një shtëpi muze banesën ku lindi Kostandin Kristoforidhi duhej në radhë të parë që të gjithë elementet muzeale të futeshin në ambientin e vet dhe në sfondin e traditës popullore dhe patriotike. Më të përshtatshmet do të ishin pajisjet prej druri, me një motiv dekoracioni të shekullit të kaluar dhe me një vijë arkitektonike të epokës ku lindi dhe jetoi ai. Pikërisht një trajtim i tillë do të plotësonte ambientin e brendshëm të banesës dhe do të harmonizohej me elementet arkitektonike që u arritën aqë mirë gjatë restaurimit (Tab. XI, 20), ku mbizotëron sidomos druri në raport me muret e lyer me gëlqere të bardhë. Kështu që pajisja e këtyre ambienteve me struktura druri të thjeshta dhe të lehta (Tab. XI, 19) nuk e rëndoi aspak interierin, përkundrazi ndihmoi në zgjidhjen sa më harmonike të elementit etnografik, të gërshetuar me përmbajtjen historike e muzeale.

Dhoma e zjarrit, me vatrën dhe pajisjet e tjera jetësore të nevojshme, është mjaft e madhe. Atje është vendosur edhe ekspozita muzeale, e cila duke patur në plan të parë figurën e Kostandin Kristoforidhit, paraqet në sfond jetën e varfër qytetare të Elbasanit të fundit të shek. XVIII dhe të fillimit të shek. XIX, lëvizjen e madhe të Rilindjes sonë Kombëtare, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe luftën e patriotëve kundër pushtuesve të huaj osmanë dhe bejlerëve e sundimtarëve vendas. Shumë nga objektet etnografike kanë qenë përdorur më parë nga njerëz të familjes së Kristoforidhit (Tab. XII, 21). Përpos kësaj arritjeje, një notë optimiste dhe të kohës solli oborri i gjatë dhe kalldrëmi me gurë që të shpie tek shkallët e shtëpisë. Në tavanet prej dërrase dhe në kollonën e shkallëve janë varur ndriçuesë elektrikë prej bakri karakteristikë, që harmonizohen me banesën, kurse vitrinat ku janë ekspozuar fotografitë, dokumentet, faksimilet dhe objektet muzealë ndriçohen nga një dritë intensive, jo direkte, që jo vetëm nuk stonon në dhomën e zjarrit, ku drita e ditës vjen nga baxha, por përkundrazi ndihmon në soditjen e pajisjeve etnografike e jetësore aq me interes, të vendosura në këtë ambient.

18) Historia e Letërsisë shqipe, vol. II f. 244-245.

DO NOT COPY



1 PLANIMETRIA Shk 1:100

2 PRERJA GJATESORE Shk 1:100

RIKONSTRUKSIONI HIPOTETIK
FILLESTAR I BANESES
- fundi i shek XVIII



2

DO NOT COPY



1

1 PLANI I PERGJITHSHEM PAS RESTAURIMIT Shk. 1:200

2 FASADA KRYESORE (JUGORE) Shk. 1:100

3 GRILA METALIKE E DRITARES SE BODRUMIT Shk. 1 20

4 JASTEKU I KOLONES KU MBESHTETET TRAU I GATISE Shk. 1:20



3



2



4

DO NOT COPY



Legjendë

PARA RESTAURIMIT NE KATIN E PARE

-"- NE KATIN PERDHE

PAS RESTAURIMIT

V

PLANIMETRIA Shkalla 1:100

KATI PËRDHE



KATI I PARË



0 1 2 3 M

DO NOT COPY



1 ▭ GJENDJA E BANESES PARA RESTAURIMIT ▨ PJESA QE U SHTUA PAS RESTAURIMIT

SHK 1:200

2 PRERJA GJATESORE E BANESES PAS RESTAURIMIT

SHK 1:100





1



2



3

DO NOT COPY

DO NOT COPY



4



5



6



7

DO NOT COPY



8



9



10



11

TAB IX



12



13



14



15

DO NOT COPY

DO NOT COPY



16



18



17

DO NOT COPY



19



20

DO NOT COPY



Robert BALLAURI

DO NOT COPY

UN IMPORTANT MONUMENT HISTORIQUE A ELBASAN

RESUME

Imaginons la ville d'Elbasan vers la fin du XVIIIe siècle et le commencement du XIXe, avec ses nombreuses ruelles se développant en lignes sinueuses en toute direction et créant de la sorte les parcelles d'habitation d'une planimétrie irrégulière ne ressemblant pas les unes aux autres.

Au cours des temps Elbasan a subi des transformations évidentes, au point que vers la fin du XVIe siècle il avait un grand varosh hors des murs d'enceinte et que la zone habitée à l'intérieur de ceux-ci avait déjà acquise la physionomie qu'elle a plus ou moins actuellement.

Notre étude aura pour objet une maison de deux étages, située au centre du quartier se dressant à l'intérieur de la forteresse dans une ruelle pavée moyennageuse, où, en 1830, est né et a passé sa première jeunesse l'insigne linguiste et patriote que fut Konstandin Kristoforidhi.

o
o o

Le XVIIIe siècle se caractérise par une organisation plus complète du commerce et des corporations d'artisan, il créa les conditions requises au développement à des rythmes rapides de la vie urbaine, soit pour ce qui concerne le mode de vie que l'accroissement de la population citadine. Les exigences accrues de la part de la population des villes entraînèrent l'essor des métiers. A Elbasan, chaque dimanche était jour de marché et une multitude de gens y venaient des villes et des contrées avoisinantes. – Ainsi Elbasan devint un important centre de communication, reliant les villes du littoral à celles de l'intérieur du pays.

Dès les XVIIe-XVIIIe siècles il y avait à Elbasan une foule d'artisans, entre autres des orfèvres, qui préparaient des pièces jolies et rares en or, argent et bronze et dont les ouvrages étaient vendus dans tout le pays. Les orfèvres, à eux-seuls, étaient au nombre de 13. Avec le temps, naturellement, le nombre de ces artisans s'accrut. Ainsi, pendant la deuxième moitié du XVIIIe siècle, parmi les orfèvres de la ville figure aussi le grand-père de Kostandin Kristoforidhi, considéré à l'époque comme maître dans l'art de la filigrane. Son père, lui aussi, exerça la même métier. De nos jour encore on trouve à Elbasan des objets qui sont sortis de sa main.

o
o o

1 – La restauration

La maison objet du présent article est une habitation appartenant à la deuxième moitié du XVIIIe siècle, comme le sont les autres maisons qui lui sont contiguës. Elle comporte tous les traits caractéristiques de l'habitation à tchardak, *malgré les reconstructions dont elle a été l'objet et les modifications apportées aux dimensions de sa surface d'habitation.*

Dans l'habitation contiguë, en direction est, on relève clairement les traces des poutres du plafond et des cloisons des murs de refend appartenant à la maison de Kristoforidhi. De l'analyse de ces traces et de leur mesurage, il ressort qu'au début cette habitation avait à son premier étage trois chambres et un tchardak *ouvert (Tab. I – 1, 2) et en bas de caves. Ces conclusions sont confirmées aussi par les affirmations des personnes âgées habitant la rue Mihal Hasa, où se trouve la dite maison; ceux-ci racontent, entre autres, que les chambres avaient un plafond de bois travaillé, des armoires de bois sculpté, bref des éléments d'un art raffiné. Dans le courant des années les parties portantes de cette maison se dégradèrent et les pièces destinées à l'habitation commencèrent par devenir plus petites. De 3 qu'elles étaient au début, il n'en est resté qu'une seule et le* tchardak, *que l'on retrouve dans toutes ses variantes (Tab. III). Même l'escalier a changé de position, il fut introduit plus à l'intérieur. Pendant les travaux de relèvement de cette habitation, dans l'unique chambre étant séparée*

du tchardak par une cloison, il fut relevé de façon convaincante que celui-ci ne se trouvait pas à sa place, et cela pour les deux motifs suivants: premièrement, en raison du fait qu'il s'appuyait sans aucun soubassement sur le plancher du premier étage et sans avoir un mur de soutènement à l'étage au rez-de-chaussée (Tab. IV – 1); deuxièmement, parce que sa position ne reproduisait pas la chambre du feu, où d'habitude l'axe de la cheminée fait fonction d'axe symétrique au parement du mur de la chambre.

Le schéma planimétrique initial de cette habitation est simple. Il se fonde sur les critères connus de la maison citadine d'Elbasan, en exploitant de façon harmonieuse le terrain qui en l'occurence est une parcelle plus longue que large (Tab. II, 1), approximativement dans un rapport 1 : 4.

La situation que nous avons héritée est une réduction maximale de ce schéma planimétrique: une chambre et un tchardak (Tab. VI, 1) occupant presque la moitié de la surface de l'habitation. Outre la dégradation marquée de tout l'édifice, on relève l'absence de plusieurs de ses composantes qui auraient pu contribuer en quelque sorte à sa restauration. La situation avant la restauration se présentait assez complexe et exigeait tout d'abord une argumentation exacte des pièces qui devaient être restaurées. Avant la restauration, l'escalier conduisant au premier étage occupait une position clé telle à déterminer toute la solution planimétrique (Tab. IV, 1). Si l'on ramenait les trois pièces et le tchardak à leur état initial, il fallait sans autre déplacer l'escalier en direction sud, ce qui ne correspondait plus aux données du relèvement. La version la plus raisonnable pour cette habitation consistait dans le fait de conserver la chambre à feu et le tchardak ouvert, soit les pièces existantes et de ne pas déplacer l'escalier de la position qu'il occupait. Après le décrépissage des murs apparurent plusieurs nouvelles composantes, qui enrichirent la documentation existante et confirmèrent encore une fois, par des faits convaincant, la conception formulée pour la reconstruction de cette habitation.

Une autre exigence, tout aussi importante, était la formulation de l'architecture en général et de n'importe quel autre élément architectonique en particulier.

Un renseignement d'intérêt fut la mise au jour dans le sous-sol de cette maison d'un chapiteau, qui avait été employé dans le système de jointage du plancher en état de dégradation. Cet élément avait résisté aux dégâts et aux adaptations.

Plus haut nous avont traité le type de cette habitation, qui se caractérise par une planimétrie fonctionnelle base, soit un rez-de-chaussée qui comprend les pièces destinées à la préparation de la nourriture, aux services et à la conservation des provisions et du bois de chauffage, et le premier étage qui avait initialement la chambre du feu et deux autres pièces: la chambre à coucher et la chambre des amis. Mais à son état actuel, cette habitation ne comporte en haut qu'une chambre et le tchardak ouvert. C'est sur cette base qu'a été effectuée l'étude de sa restauration. La nouvelle planimétrie, sur laquelle se fondent les travaux de restauration, diffère de celle précédente (Tab. III), et cette différence fut traduite dans les faits par une formulation juste de la planimétrie de la chambre du feu, où, comme on vient de le dire, l'axe de la cheminée correspond à l'axe symétrique de la chambre. Cette conception fut confirmée aussi par le fait qu'en considération de cet axe symétrique, le mur de refend de la chambre du feu fut appuyé justement sur le mur de la cave se trouvant au rez-de-chaussée.

Au commencement la chambre du feu n'avait pas de fenêtres donnant sur la rue, elle était illuminée par une lucarne de dimensions 105 x 109 cm. et par une petite fenêtre d'environ 60 x 100 cm ayant vue sur le tchardak.

Par suite des reconstructions et des adaptations effectuées plus tard, on s'est aperçu qu'on avait percé une autre fenêtre du côté nord (Tab. VIII, 7) donnant sur la rue par derrière la maison. Nous avons pensé de boucher cette fenêtre afin de conserver son originalité à la chambre du feu, qui allait être illuminée par la lucarne et la fenêtre du tchardak ouvert. Quant au plafond, lui aussi, il ne comportait que des poutres, Les poutres du toit et le système des arêtiers furent revêtus d'en bas avec les planches du plafond, afin de créer un milieu propre et adapte à être visité par le grand public (Tab. VIII, 8, 9).

Le tchardak ouvert, situé sur la face orientale, comporte des installations qui relevaient dans le passé de la chambre du feu. Malgré le fait qu'il ne s'agissait pas d'éléments fonctionnels, nous avons pensé de les conserver sur place tels qu'ils sont à l'état actuel.

La construction des fondations et des murs principaux de l'habitation, jusqu'au niveau du premier étage, a été faite avec des pierres calcaires, en général prélevées du lit du fleuve Zaranike, comme c'est le cas pour toutes les constructions édifiées à l'époque dans la ville d'Elbasan.

o
o o

L'ouverture de l'objet en question a contribué à une étude plus approfondie de cette habitation. Tout d'abord cette opérations a renforcé la conception sur laquelle s'est guidée l'élaboration du projet de restauration, à savoir qu'au commencement il y avait trois chambres et un tchardak ouvert. Le mur est, séparant cette maison de celle contiguë, a mis en lumière après son décrépissage des traces indiquant sa liaison avec la cloison qui séparait la chambre du feu de la chambre voisine. C'est ainsi qu'apparut la silhouette imposante de la cheminée en forme de tambour, que furent mis au jour deux niches latérales et leur mode de construction (Tab. VIII, 11), le tout caractérisé par une forme aux lignes harmonieuses où la pierre et le bois s'imbriquent à la perfection (Tab. IX, 12). Par ailleurs, les cloisons indiquent entre autres des traces relatives aux réparations effectuées à différentes époques et surtout à la technique de construction et au matériel de bois employé à cette fin (Tab. IX[a], 13).

L'assemblage des poutres du plancher du premier étage et du toit a été réalisé en conservant l'ouverture qu'avait l'habi-

POLICOPY

tation avant sa restauration. Toutefois, afin de créer un appui plus solide aux poutres du toit, les murs du périmètre furent renforcés d'une bande de béton armé sur laquelle allait être posées les extrémités des poutres (Tab. IX, 14).

Quant à l'escalier menant au premier étage, ses trois premiers degrés sont en pierre et les autres de bois (Tab. X, 16). Sa rampe atteint le premier étage et cerne le tchardak ouvert (Tab. X, 17).

A l'étage au rez-de-chaussée la cave n'en occupe qu'une partie, en conservant les traits de la pièce initiale. Une porte de bois massif sculpté et une fenêtre à grillage métallique assurent l'illumination de la cave (Tab. II, 2, 3).

2 — La maison-musée

La typologie de cette habitation à tchardak ouvert est telle qu'elle rend indispensable d'en conserver la conception vitale et fonctionnelle, son extérieur et son intérieur, ainsi que ses installations et son ammeublement, de manière à recréer l'unité caractérisant les édifices de la deuxième moitié du XVIIIe siècle (Tab. V). Sa restauration en a accru la valeur, tant sur le plan architectonique et fonctionnel que sur le plan esthétique de son ensemble en général et de ses différents éléments en particulier.

L'héritage architectural ne constitue pas seulement un témoignage esthétique du passé, mais il doit être aussi une composante dynamique de la vie qui est la nôtre actuellement, en lui insufflant l'esprit et l'individualité de nos meilleures traditions culturelles et patriotiques. C'est justement pour cela que le musée, en tant qu'établissement d'éducation, devient de beaucoup plus intéressant sur le plan culturel et social quand il a comme siège un monument historique.

De ce point de vue, la deuxième phase de restauration tendait au but d'en faire un centre ouvert au grand public une maison-musée digne de la figure de Kostandin Kristoforidhi.

La muséographie marxiste-léniniste albanaise a comme objet de son activité les événements et les figures liés étroitement aux idéaux et aux aspirations des masses, à la dynamique des puissants mouvements populaires. C'est pourquoi la figure de Kostandin Kristoforidhi, dans le développement des événements, a été intégrée dans le grand mouvement de la Renaissance nationale albanaise, avec tous ses compagnons d'arme et amis, qui, tous ensemble, ont oeuvré et fourni des efforts incessants pour la liberté et l'indépendance de l'Albanie.

Kristoforidhi a laissé un héritage des oeuvres importantes dans le domaine de la linguistique et apporté une contribution précieuse à la pédagogie albanaise. En tant qu'homme de science, son apport dans le domaine de la lexicographie albanaise est de premier plan.

o
o o

Pour convertir en une maison-musée l'habitation où est né Kostandin Kristoforidhi, il fallait tout d'abord remettre à leur place tous les objets qui en faisaient part, en reflétant les traditions populaires et patriotiques de l'époque. Les éléments de bois, décorés de motifs du siècle passé et ayant une ligne architectonique caractérisant l'époque durant laquelle est né et a vécu Kristoforidhi, allaient compléter l'intérieur de cette habitation. Ainsi, la mise en place dans ces pièces de structures de bois, simples et légères (Tab. XI, 19), loin d'alourdir leur intérieur, a contribué au contraire à la solution harmonieuse de l'élément ethnographique, en enchevêtrement avec le contenu historique et de musée.

La chambre du feu, avec son foyer et d'autres installations de première nécessité, est relativement large. C'est ici que sont exposés les objets de musée; cette salle en présentant en premier plan la figure de Kostandin Kristoforidhi, met en relief sur son fond la vie peu aisée que menait les habitants d'Elbasan dans la période allant de la fin du XVIIIe au commencement du XXe siècle, le grand mouvement de notre Renaissance nationale, la Ligue albanaise de Prizren et la lutte des patriotes albanais contre les occupants ottomans ainsi que contre les bey et les dominateurs du pays. Nombre des objets ethnographiques exposés ont été employés auparavant par les proches de Kristoforidhi (Tab. XII, 20). Outre ces réalisations, la cour vaste de la maison et le sentier pavé menant à son escalier extérieur ont donné un ton optimiste et authentique à cet ensemble. Des plafonds de bois et de la colonne de l'escalier pendent des lampes caractéristiques de cuivre, en pleine harmonie avec l'habitation, tandis que dans les vitrines, où sont exposés des photographies, des documents, des fac-similés et d'autres objets, sont illuminés de manière intensive, mais indirectement, ce qui ne discorde point avec la chambre du feu illuminée par une lucarne, mais au contraire rend plus aissée la contemplation de tous les objets se trouvant dans cette pièce.

DO NOT COPY



Fig. 1

gun edhe derën, e cila formohet nga vendosja e tullave në të dy qoshet në formë pilastri. Portën nga jashtë e mbyll një pllakë monolite mermeri kristalin e vendosur në këmbë. Mbi dyshemenë e varrit u gjet skeleti i një të rrituri në shpinë, me kokë nga perëndimi dhe gjymtyrë të tendosura gjatë trupit, me kafkë shumë të dëmtuar. Tek këmbët e skeletit të parë ndodhet një kafkë e dytë edhe ajo e dëmtuar. Në njërin gisht të dorës së majtë, në skeletin e parë ishte vënë një unazë e thjeshtë bronxi.

Varri Nr. 3 i takon tipit me tjegulla të vendosura në formë çatie dhe është vendosur anash varrit Nr. 2, në krahun e majtë të tij. Ruan drejtimin lindje-perëndim me një shmangie të lehtë nga veri-perëndimi. Shtrojen e varrit e përbëjnë solenët e mëdhenj, trapezoidalë 66 x 38 (43) x 2 cm me tufa vijash të ndërthurura, të bëra me gisht, ndërsa mbulesën e përbëjnë tri çifte të njëjta tjegullash të vëna për së gjati, të cilat bashkohen në kulm. Për një mbyllje më të plotë sipër janë vendosur kapilpera 68 x 15 (19) x 2 cm. Për arsye të punimeve të kryera për rreth skeleti ruhet mirë, gjer në pjesët e sipërme. Ai është i vendosur në pozicionin e shtrirë në shpinë, me duar të mbështetura mbi taz. Varrit i mungon inventari.

Varri Nr. 4 përbën shembullin më të plotë e më përfaqësues të këtij grupi varresh. Ndodhet gjithnjë në krahun e djathtë të së njëjtës rrugë dhe vetëm 7-8 metra më në lindje të varrit nr. 1, në thellësi 0.50 m nga sipërfaqja e tokës. Varri paraqet një paralelopiped të madh me përmasa 2.85 x 1.50 x 2.20 m formuar nga dhoma e varrit, mbulesa e parë prej pllakash guri e mermeri si edhe nga një mbistrukturë e dytë prej gurësh e tullash, me llaç të dobët me lartësi 80 cm që zë gjithë sipërfaqen e varrin (fig. 3, Tab, I). Dhoma si princip është e ngjashme me atë të varreve nr. 1 e nr. 3. Si element të ri kemi qemerin e rremë prej tullash, i cili ngushton nga sipër dhomën. Edhe në këtë rast ndërtimi i varrit ka filluar me dyshemenë prej tullash, të vëna mbi një shtresë të hollë llaçi 2-3 cm. Janë gjithsejt 8 rrjeshta tullash të përmasave 29 x 22 x 3 cm, me nga 5 copë në çdo radhë. Ato vendosen herë për së gjeri, herë për së gjati. Në vendosjen bën përjashtim rrjeshti i faqes perëndimore i cili i ka ato të pjerrura në një kënd 30-40° për të formuar jastëkun mbi të cilin vihej koka e të vdekurit. Faqet gjatësore të dhomës janë ndërtuar me tulla të mëdha: 45 x 31 x 4.5 cm me lidhës të



Fig. 2

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

ARKITEKTURA E DISA VARREVE TË SHEK. II-IV NË DYRRAH

DO NOT COPY

Në këtë artikull do të trajtohet arkitektura e 6 varreve të zbuluar rishtaz në Durrës, në të dy anët e rrugës automobilistike që të çon në kuotën 98 m. Për nga arkitektura e përkatësia kohore, këto varre formojnë një njësi të re në nekropolin e qytetit dhe ndihmojnë për njohjen më të plotë të shtrirjes së tij, si edhe për karakteristikat e veçanta që pati ai gjatë shekujve.

Prej këtyre varreve pesë i përkasin tipit arkë me konstruksion tulle e guri, ndërsa njëri i përket tipit me mbulesë tjegulle.

Varri Nr. 1 gjendet mbi një bregore të vogël, i formuar nga dherat e hedhura, në krahun e djathtë të rrugës automobilistike që të çon në sheshin e Parkut Rinia. Varri që është vetëm 20 cm thellë nga sipërfaqja ka formë katërkëndëshi me përmasa të jashtme 2.70 x 1.70 x 0.75 m. Dyshemeja e tij formohet prej gjashtë radhë tullash të vëna në mënyrë të alternuar me nga 4 copë në çdo rradhë, janë të ngjitura në një shtresë të hollë llaçi me gëlqere, zhavor të imët e grimca tullash. Për muraturën e tij janë përdorur tullat e rregullta katërkëndëshe me përmasa 37 x x 28.5 x 42 cm si dhe tullat gjysma, të vendosura në rreshta horizontale me fuga 4 cm. Nga muratura e dhomës ruhen 4-5 radhë tullash (fig. 1, Tab. I). Materialet e shumta të ndërtimit, që u gjetën brenda dhe jashtë varrit, tregojnë se konstruksioni para se të dhunohej do të ketë qenë shumë më i lartë. Për ta mbrojtur dhe izoluar më mirë, në të katër faqet e jashtme janë vënë tjegulla dhe copëra tullash të veshura me një shtresë të bollshme llaçi të hedhur pa ndonjë kujdes. Në këto lloj ndërtimesh sepulkrale mbi sipërfaqe qëndronte mbulesa së bashku me monumentin, siç e vëmë re edhe në varret e bazilikës së Tepes në Elbasan.[1]

Varri është i orientuar nga lindja në perëndim me derën e hyrjes nga lindja ku nga ana e brendshme e dhomës së varrit gjendet një prag 0.25 m i gjerë.

Mbi dyshemenë e varrit gjatë tërë gjatësisë së tij, u gjetën në gjendje shumë të dëmtuar 2 skelete të vendosura në shpinë. Ndërtimi i tyre i takonte një familjeje. Së bashku me dheun e futur në dhomë u mblodhën edhe fije të holla ari që i përkisnin veshjes së të vdekurve.

Materialet e përdorura, tipi arkitektonik, riti i varrimit e afrojnë këtë varr me varret Nr. 2 dhe 4.

Varri Nr. 2. Ndodhet 15 m më në perëndim të varrit Nr. 1, në një kuotë më të ulët, por gjithnjë në krahun e djathtë të së njëjtës rrugë (fig. 2, Tab. I). Si tip arkitektonik ai i përket varrit me një ambient të vetëm me hyrje të vogël nga ana lindore dhe si i tillë ngjason me varrin Nr. 1. Që të dy varret kanë të përbashkët dyshemenë prej tullash, formën planimetrike të dhomës, teknikën e ndërtimit si edhe materialet e përdorura. Ndryshimet vërehen në numrin e tullave të dyshemesë, në varrin Nr. 2 gjashtë radhë me nga tri copë, si dhe në madhësinë e vetë tullës, në varrin Nr. 2 tulla e përdorur është 35 x 26 x 4 cm. Rreshqitja e dheut nga sipër si edhe goditjet sizmike e kanë deformuar së tepërmi varrin. Kështu faqja e tij veriore është anuar dhe vende-vende ka mbushur hapësirën e brendshme, ndërsa muri gjatësor e jugor është mënjanuar jashtë. Dhoma e varrimit ka përmasa të jashtme 2.70 x 1.30 x 0.95 m. Faqja jugore që është dhe ruajtur dhe më mirë përbëhet prej nëntë radhë tullash me fuga horizontale 4-6 cm. Ana lindore ka pra-

1) A. Meksi, N. Ceka, **Bazilika e Tepes,** Buletin arkeologjik, nr. 2, 1971.

bollshëm llaçi me trashësi fuge 2.5 - 4 cm. Duke filluar nga rrjeshti i 7 e gjer në të 15-in, me vendosjen e tullave për së gjeri formohet qemeri i rremë, i cili ngushton së tepërmi pjesët e sipërme të varrit. Ana e ngushtë lindore përbëhet nga 6 radhë tullash mbi të cilat është vendosur porta e hyrjes me lartësi 60 cm. e gjerësi 54.5 cm. Ajo është mbyllur nga brenda me copëra tjegullash e tullash me lidhës të dobët. Llaçi, kurse nga jashtë me një pllakë masive shtufi të vendosur në këmbë. Që të katër faqet e sarkofakut janë suvatuar e patinuar nga brenda. Shtresa e parë e suvasë është e njëjtë me llaçin e përdorur në krejt konstruksionin kurse shtresa e dytë, e hollë 2-3 mm, është përgatitur nga pluhuri i mermerit dhe nga gëlqerja, për të hedhur mbi të pikturën murale. Në të gjitha brinjët e varrit janë konturuar vertikalisht dhe horizontalisht breza me bojë kafe në të kuqe, kurse në faqet nuk u vu re ndonjë fragment afresku.



PRERJE TËRTHORE E VARREVE Nr 5 6



Fig. 4



Fig. 3

Pas heqjes së dheut që kishte filtruar kryesisht nga dera që hapej e mbyllej, u zbulua një grumbull i madh kockash, i përqendruar sidomos në faqen perëndimore, që tregon se varri ka qenë familjar dhe se në të është përdorur riti i njohur i spostimit të skeletit pararendës. Mbi dysheme ishin vendosur në shpinë dy skelete të rriturish me duar të shtrira gjatë trupit, kurse në faqen perëndimore kafkat dhe eshtrat e katër fëmijëve. Orientimi i varrit është lindje-perëndim me kokë nga perëndimi.

Nga sipër varri mbulohej me katër pllaka guri dhe mermeri të punuara dhe të lëmuara, ndonjera prej tyre zbukuruar me katrore si edhe rozeta të brendashkruara 6 dhe 8 fletëshe, në reliev.

Inventari dhe një monedhë e madhe bronxi e Faustinës së rritur (prerje pas vitit 141 të erës sonë)

DO NOT COPY

e datojnë varrin në gjysmën e dytë të shek. II të erës sonë.

Varret 5 dhe 6, janë projektuar si një çift i pandarë gjatë së njëjtës kohë. Si formë arkitektonike ato i përkasin tipit me qemer të vërtetë i cili sigurohet edhe me një mbulesë të dytë të rrafshtë tullash, e cila ja shton volumin ndërtimit. Me varret e trajtuara më lart ato i lidh edhe prania e derës së vogël lindore, materiali dhe teknika e përdorur (fig. 4.)

Gjatë hapjes së rrugës automobilistike, janë thyer ballët e të dy varreve. Varret janë të orientuara nga lindja në perëndim me hyrje nga ana lindore. Përmasat e dhomës së varrit nga brenda janë 2.30 x 1.10 x x 1.50 m. Shtroja është gjithmonë prej tullash. Faqet gjatësore përbëhen nga 11 radhë tullash të përmasave 36 x 26 x 5 cm, të vëna në rrjeshta horizontale me fuga 3-5 cm. Mbi këto 11 rradhë fillon e formohet qemeri cilindrik i cili mbyllet në lartësinë 1.50 m me vendosjen edhe të 12 radhëve të tjera gjer në qendër. Fugat e qemerit janë 6-7 cm. Qemerat e të dy varreve zhvillohen në mënyrë të pavarur duke nisur nga muri i mesëm ndarës që është një mur i dyfishtë me trashësi 60 cm. Mbi qemerat gjendet një mbulesë horizontale prej tullash, me trashësi 8 cm, i cili i jep ndërtimit formën e një dhome kënddrejte me dy hyrje ballore. Nga brenda, varret janë suvatuar në të gjitha faqet. Për arsye të dhunimit aty nuk u gjetën skelete, dhe inventar, por ndërtimi dhe volumi të lënë të mendosh se edhe ata kanë qenë varre familjare.

Veç gjashtë varreve që përshkruam, në shpatet e të dy kodrave sidomos të atyre që shikojnë nga deti hetuam edhe mjaft konstruksione të tjera të dëmtuara, si edhe materiale ndërtimi që i përkasin po kësaj njësie të nekropolit të madh të qytetit.

* * *

Varret e Parkut Rinia i përkasin një njësie të re të nekropolit të madh të qytetit e cila duhet marrë si vazhdim kohor e hapsinor i varrezës së shek. III-I p.e.s. Nevoja për të shfrytëzuar këtë vend të ri si varrezë lindi në kohën kur po ndodhnin lëvizje të mëdha në topografinë dhe urbanistikën e Dyrrahut. Lagje të reja ndërtohen edhe në veri dhe në lindje, ndërsa ato më të vjetrat, që lidheshin me bërthama të hershme urbane, vendosur sidomos në kodra, po e humbisnin rëndësinë e tyre të dikurshme dhe dalëngadalë po braktiseshin. Një lëvizje të tillë e shpeshtoj ndoshta edhe tërmeti i shek. I p.e.s. i cili dëmtoj edhe ndërtesat e forta të zonës kodrinore, siç e dëshmojnë rrënojat e porsa zbuluara të një vile të shek. III-II p.e.s.

Mbi gërmadhat e lagjeve të braktisura, në faqe të buta kodrash, që shikonin nga deti, u formuan parcela të reja varresh. Veçanërisht të përshtatshme për këtë qëllim ishin kodrat me kuotën 98 dhe 59 m që ndodheshin më pranë lagjeve të banuara e mureve rrethuese. Varreza e kuotës 98 m përdorim më të dendur pati gjatë shek. II-V të erës sonë, kurse ajo e kodrës fqinje, më vonë, gjer në periudhën para pushtimit otoman.

Grupi i varreve të Parkut Rinia si kohë dhe arkitekturë lidhet edhe me një pjesë varresh që i përkasin nekropolit të dystë pranë kënetës së dikurshme[2], me varret me konstruksion tulle e guri në Apoloni[3] dhe me varre të shkëputura në qytetin ilir në Belsh[4]. Forma planimetrike dhe elementet e veçanta arkitektonike, arka, qemeret, mbulesa me pllaka etj., i afrojnë ato edhe me varret e bazilikës paleokristiane të Tepes[5], me varrin e Peshtanit[6] dhe ato të Paleokastrës[7], të cilët datohen si të shek. IV-V të erës sonë. Në varret me konstruksion tulle dhe guri të Durrësit ne jemi të prirur të mos shohim një ndërprerje kohore dhe një brez të kufizuar gjeografik të ndërtimeve sepulkrale ilire[8], por një vazhdim logjik e të drejtë për drejtë të kësaj tradite, nëpërmjet një evolucioni të brendshëm, në përshtatje me materialin rrethanor. Modelin e tyre fillestar ata e kanë në ndërtimet e mëdha dydhomëshe të Amanties, Matohasanajt, Bylisit, Klosit, Selcës së Poshtëme, Persqopit[9], për të vazhduar me varret njëdhomëshe me koridore të ngushta si edhe me varret prej tulle të shek. III-I

2) F. Tartari, **Rezultatet e gërmimeve të v. 1971 në skajin verilindor të qytetit të Durrësit,** Buletin Arkeologjik Tiranë 1971, 103-119.
3) A. Mano, **Nekropoli i dystë i Apolonisë,** Iliria 3, Tiranë, 1974, 156.
4) N. Ceka – L. Papajani, **Nekropoli i qytetit ilir në Belsh,** Buletin Arkeologjik, Tiranë 5, 1975, 49 e vazhdim.
5) A. Meksi – N. Ceka **Vep. cit,** 187.
6) N. Ceka **Monumente antike dhe mesjetare në luginën e Osumit,** Monumentet 5-6, 1973, 121.
7) A. Baçe, **Arkitektura e dy kishave paleokristiane dhe varreve në kështjellën e Paleokastrës,** Monumentet 15-16.
8) N. Ceka, **Ndërtimet sepulkrale të qyteteve ilire,** Monumentet, 9, 1975, 35-54.
9) N. Ceka, **Po aty,** f. 35-54, si edhe S. Anamali **Amantia** në Iliri II, 1972, 95, L. Papajani, **Gërmimet arkeologjike të v. 1974 në Kodrën e fshatit Klos,** Buletin Arkeologjik 5, 1975, 43, N. Ceka, **La ville illyriene de la Basse Selce,** Iliria II, 1972, 187-192.

DO NOT COPY

p.e.s. (përfaqësuar më së miri në Belsh)[10]. Tipat e varreve të Parkut Rinia plotësojnë atë hallkë të ndërmjeme që mungonte gjer tani, midis ndërtimeve të përmendura pararendëse, dhe atyre në antikitetin e vonë dhe mesjetë. (Tepe, Peshtan, Durrës, etj.). Varret e parkut Rinia kanë dhe ndryshime me tipet bashkëkohore të nekropolit të dystë pranë ish kënetës si dhe të qendrave të tjera.

Veçoritë kryesore të këtij grupi varresh janë:

1) Planimetria katërkëndëshe me brinjën gjatësore të dhomës së varrit 2.70 – 2.85 m, brinjët e shkurtra 1.30 – 1.70 m dhe lartësinë duke përfshirë edhe ndërtimet në sipërfaqe, 2.20 – 2.50 m.

2) Në të gjitha rastet si material bazë është përdorur tulla e plotë ose e thyer përgjysëm me trashësi 4 cm me lidhës të fortë llaçi gëlqeror, përzier me zhavor të imët.

3) Për mbylljen e varreve shërben qemeri i rremë ose qemeri cilindik (v. nr. 5, 6). Vihet re edhe mbistruktura sipërfaqësore me forma dhe përmasa si të vetë varrit.

4) Tek të gjithë varret e zbuluara vihet re prania e derës lindore (hyrja) 50-60 cm e gjerë dhe e lartë si edhe pragu në anën e brendshme i gjerë 20-25 cm për ritualin mortor.

Në hapësirën e brendshme të varrit grumbullohen skeletet e një familjeje, sipas ritualit të spostimit të kufomës paraardhëse. Në vendin tonë kjo mënyrë varrimi është e dokumentuar në Dukat për fundin e periudhës së bronxit dhe në Përmet, ndërsa për periudhën helenistike në një pjesë të varreve të vendbanimit të Belshit, në varret e qytezës së Dukajt (Tepelenë), në Sofratikë (Gjirokastër) Radhimë[11] (Vlorë) etj. Ky rrit vazhdoi të jetë në përdorim pa ndërprerje gjatë shekujve II-V erës sonë dhe në mënyrë të veçantë gjatë përhapjes së kristianizimit (Tepe, Peshtan, Durrës, Bukël[12], Kalaja e Dalmacës).

Sipas këtij riti në rast se mbi dyshemenë e varrit gjindej një skelet pararendës, mbas një kohe prej 3 vjetësh mblidhej skeleti në një qoshe të dhomës, zakonisht në atë perëndimoren, për t'i lëruar vendin kufomës të re e cila vendosej në shpinë, me duar të vëna poshtë për gjatë trupit ose mbi to. Në të tilla varre mund të varrosej një familje prej 5-7 antarësh.

Në këto shekuj ruhej edhe zakoni i inventarit (kterismatës) që shoqëron të vdekurin. Për arsye të prishjeve dhe të dhunimit nga të 6 varret e zbuluara vetëm njeri prej tyre dha inventar të plotë. Ndër objektet e gjetura dallojmë ato që i përkasin të vdekurit kur ishte i gjallë si: togëza, unaza etj., objekte që shërbenin për ritualin e funeralit: shishet e qelqit, monedhat, si dhe objekte që sipas bestytnisë shërbenin për «jetën tej varrit» si enë për të mbajtur pije ose gjellë.

Ndërtimi dhe inventari tregon se varret i përkasin shtresave të mesme të popullsisë qytetare që kishin mundësi financiare për të ngritur monumente të tilla.

Do not COPY

10) N. Ceka – L. Papajani **vep. cit.** 49 e vazhdim.

11) N. Ceka, **Gërmimi i një tume në Dukat,** Iliria III Tiranë 1974, 131. N. Bodinaku, **Rezultatet e gërmimeve të v. 1978 në tumën e Piskovës (rrethi i Përmetit). Kumtesë** e mbajtur në sesionin arkeologjik të Q.K.A. (Tiranë 24-26 nëntor 1978). N. Ceka, **Vendbanimi i hapur pranë qytezës ilire të Belshit** Buletin Arkeologjik 4, 1974, f. 55. D. Komata, **Informacion arkeologjik nga rrethi i Tepelenës,** Buletin Arkeologjik Tiranë 1971, f. 244. Dh. Budina, **Informacion arkeologjik nga rrethi i Gjirokastrës,** Buletin Arkeologjik Tiranë 1971, f. 246. D. Komata, **Informacion arkeologjik nga rrethi i Vlorës,** Buletin Arkeologjik, 1971, 243.

12) S. Anamali, **Një varrezë e mesjetës së hershme në Bukël të Mirditës,** Iliria, I, 1971, f. 212.

DO NOT COPY



PRERJE GJATËSORE E VARRIT Nr. 1



PRERJE TËRTHORE E VARRIT Nr 4



PLANIMETRIA E VARRIT Nr. 2

0 .25 1M

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE DE CERTAINS TOMBEAUX DES II-IVe SIECLES A DYRRAH

RESUME

Cette communication examine l'architecture de 6 tombeaux mis récemment au jour dans la ville de Durres, sur les deux côtés de la route nationale menant à la cote 98. Du point de vue de leur architecture et de leur datation, ces tombeaux constituent une nouvelle unité pour la nécropole de cette ville et contribuent à une connaissance meilleure de son extension et de ses caractéristiques à travers les siècles.

De leur nombre, cinq appartiennent au type en coffre avec une construction de briques et de pierre et le sixième au type avec une couverture de tuiles.

En dehors de ces six tombeaux, sur les versants de deux collines, et cela surtout de celles regardant vers la mer, ont été indentifiés plusieurs autres constructions détériorées ainsi que des matériaux de construction analogues à ceux de la grande nécropole de la ville de Durres.

Les tombeaux du «Parc Rinia» relèvent d'une nouvelle unité de la grande nécropole de la ville, qui n'est qu'une continuation dans le temps et dans l'espace du cimetière des IIIe-Ier siècles av.n.è. La nécessité de mettre en place ce nouveau cimetière est une conséquence des grands changements survenus à l'époque à Durres du point de vue topographique et urbanistique. C'est ainsi que furent édifiés de nouveaux quartiers dans la partie nord comme dans celle est de la ville, alors que les quartiers plus anciens, se rattachant aux agglomérations urbaines d'autrefois et se dressant surtout dans la zone de collines, ne faisaient que perdre de leur importance et étaient graduellement abandonnés par leurs habitants. Ce déplacement a du être accéléré aussi par suite du tremblement de terre survenu durant le Ier s. av. n.è. et qui provoqua des dégâts même aux habitations surplombant la zone de collines, comme en témoigne les ruines récemment mises au jour d'une villa des IIIe-IIe siècles av. n.è.

C'est sur les ruines des quartiers abandonnés, se dressant sur les versants peu escarpés de ces collines regardant vers la mer, que furent mises en place les nouvelles parcelles des tombeaux. Les collines situées à la cote 98 et 59, et se trouvant plus près des quartiers habités et des murs d'enceinte de la ville, étaient les plus appropriées à cette fin. Le cimetière de la cote 98 fut employé surtout pendant les IIe-Ve siècles et l'autre, celui de la cote 59, surplombant la colline voisine, fut utilisé jusqu'à la période précédant l'occupation romaine.

Le groupe de tombeaux du «Parc Rinia», en ce qui concerne sa datation et son architecture, se rattache aussi à certains tombeaux de la nécropole à ciel ouvert située à proximité de l'ex-marais de la ville comme aux tombeaux d'Apollonie en briques et pierres et à quelques tombeaux isolés de la ville illyrienne à Belsh. Du point de vue de leur forme planimétrique et des différents éléments architectoniques qui leur sont caractéristiques comme la forme en coffre, les voûtes, la couverture en plaques, etc., les tombeaux récemment découverts à Durres se rapprochent aussi des tombeaux de la basilique paléochrétienne de Tepe, du tombeau de Peshtan et de ceux de Paleokaster, datant les IVe-Ve siècles. En ce qui concerne les tombeaux avec une construction de briques et de pierres de Durres, ils ne constituent pas selon l'avis de l'auteur une interruption dans le temps et une limitation géographique des constructions sépulcrales illyriennes, au contraire ils constituent une continuité logique et directe de cette tradition, à travers son évolution intérieure et en fonction des matériaux se trouvant sur place. Quant à leur modèle initial, nous le retrouvons dans les grandes constructions à deux chambres d'Amantie, de Matohasanaj, Bylis, Klos, Selce e Poshtme, Persqop, puis dans les tombeaux à une chambre à couloir étroit ainsi que dans les tombeaux de briques des IIIe-Ier av. n.è. (abondamment représentés à Belsh). Les types de tombeaux du «Parc Rinia» constituent le maillon intermédiaire, qui nous manquait à ce jour, entre les constructions mentionnées plus haut et celles de la basse antiquité et du moyen âge (Tepe, Peshtan, Durres etc.). Les tombeaux du «Parc Rinia» se différencient aussi par rapport aux tombeaux de même date de la nécropole à ciel ouvert de Durres et des autres centres.

Ce groupe de tombeaux se distingue par les particularités que sont:

1. La planimétrie en forme d'un rectangle dont le côté lon-

gitudinal de la chambre du tombeau est long de 2.70-2.80 m, les côtés courts de 1.30 à 1.70 m et dont la hauteur, y compris celle des constructions en surface, est de 2.20 à 2.50 m.

2. Dans tous les cas le matériau base utilisé est la brique entière ou séparée en deux, d'une épaisseur de 4 cm. et liée avec du mortier de chaux solide mélangée à du gravier fin.

3. Les tombeaux sont fermés par une voûte fausse ou cylindrique (NNoo 5, 6). Quant à la superstructure de surface, sa forme et ses dimensions sont égales à celles du tombeau.

4. Dans tous les tombeaux découvers à ce jour, on relève la présence d'une porte orientale (l'entrée) large et haute de 50 à 60 cm. ainsi que d'un seuil, dans la partie intérieure, d'une largeur de 20 à 25 cm. et destiné aux rites funèbres.

A l'intérieur du tombeau sont amassées les squelettes d'une famille, selon le rite du déplacement de la dépouille mortelle précédente. Ce mode d'inhumation est documenté chez nous à Dukat et à Permet pour la fin du bronze; par ailleurs, la période hellénistique y est représentée par certains tombeaux de l'agglomération urbaine de Belsh, par les tombeaux de la cité de Dukaj (Tepelena), de Sofratike (Gjirokaster), Radhime (Vlore), etc. Ce rite continua à être employé pendant les IIe-Ve siècles de notre ère et en particulier pendant la diffusion du christianisme (Tepe, Peshtan, Durres, Bukel, forteresse de dalmace).

Selon ce rite, s'il y avait un squelette sur le plancher du tombeau, on le déplacait après 3 ans dans un angle de la chambre, en général dans son angle occidental, pour faire place à la nouvelle dépouille mortelle qui était allongée sur le dos, avec les mains le long du corps. Un tombeau pareil servait à l'inhumation des restes d'une famille de 5 à 7 membres.

Durant ces mêmes siècles, les présents, d'usage que l'on offraient au défunt constituent un rite conservé jalousement. Toutefois, dans un des six tombeaux mis au jour seulement on a découvert un inventaire complet, et cela du fait des dommages et des violations dont furent objet les autres tombes. Parmi cet inventaire on relève, entre autres, des objets qui appartenaient au défunt comme agrafes, bagues, etc., des objets relevant du rite funèbre: bouteilles de verre, monnaies, ainsi que des objets qui, selon la superstition, servaient «à la vie d'outre-tombe» comme récipients destinées à la conservation de boissons et d'aliments.

La construction de ces tombeaux et leur inventaire indique que ceux-ci appartenaient aux couches moyennes de la population urbaine, en mesure de financer l'édification de monuments semblables.

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

ARKITEKTURA E DY KISHAVE PALEOKRISTIANE DHE E VARREVE NË KËSHTJELLËN NË PALEOKASTËR

Kështjella e Paleokastrës ndodhet në mes të luginës së Drinos, lumit të Gjirokastrës, në vendin ku prej saj bigëzohet një degë që nëpërmjet luginës së Kardhiqit dhe Qafës së Skërficës të hidhte në Foinike. Kështjella që ngrihet në rripin e ngushtë dhe të rrafshtë që krijohet nga bashkimi i lumit të Kardhiqit me Drinon ka formën e një trapezi të rregullt me sipërfaqe 0.917 ha, përmasë që e rradhit ndër kështjellat për stacionimin e një kohorte këmbësore. Në brendi të kështjellës gjendeshin kapanonet e ushtarëve të cilat vijonin simetrikisht, me brinjë paralele me bazën e trapezit. Pas një shkatërrimi të dhunshëm me djegie, nga gjysma e dytë e shek. IV e.s., mbi rrënojat e kapanoneve u ndërtua një bazilikë, ndërsa jashtë rrethimit, në anën jugore, një kishë e dytë, më e vogël (fig. 1). Bazilika dhe kisha u çliruan nga dherat e rrënimet, përkatësisht në vitet 1974 dhe 1975.

Bazilika gjendet pranë brinjës lindore të kështjellës, afërsisht në mesin e saj, duke formuar me këtë anë një kënd rreth 30°. Si pasojë, cepi verilindor i saj gjendet 8,25 m larg kurtinës, ndërsa cepi juglindor 13,5 m.

Boshti kryesor kompozicional që kalon përmes nefit qendror, ka drejtim lindje-perëndim. Simetrikisht ndaj tij gjenden naosi, absida qendrore dhe narteksi (fig. 2). Në këtë mënyrë arrihet një unitet volumor, ku elementi kryesor i cili bashkon elementet e tjera me njeri-tjetrin dhe përcakton vëllimin e jashtëm është naosi, veçanërisht nefi qendror, theksimi i të cilit, pasqyrohej dhe në siluetin e bazilikës (fig. 3). Kjo simetri cenohet, por pa e prishur volumin kryesor, prej një abside në nefin e djathtë dhe dy ambientesh të vegjël që i mbështeten anës jugore të kishës.

Përmasat e naosit 11,43 x 13,85 m (raporti 1 : 1,22) e përcaktojnë atë bazilikë me raport normal naosi. Naosi ndahet në tri nefe, prej të cilëve qendrori ka gjerësi 5,23 m, ndërsa anësorët 2,40 m.

Në nefin qendror, 4,60 m larg ballit, në anën e majtë, ruhen gjurmët e një muri i cili duket se mbante



Fig. 1



Fig. 2

bazamentin e ikonostasit, duke përvijuar qartë hapësirën e presbiterit që zë 1/3 e sipërfaqes së përgjithshme të naosit.

Në ballin e nefit ndodhet absida në trajtë rrethi të zgjatur me diametër të jashtëm 5,23 m dhe gjerësi 2,75 m. Ngarkesa e mureve mbi të shkarkohej nëpërmjet «harkut të triumfit» me diametër sa absida, ndërsa sigurimi statik ndihmohej prej një diafragme murale, pak më të lartë se themeli, që e bënte atë më të lehtë dhe elastike[1]. Këtë konstruksion ka dhe absida e nefit të djathtë me diametër 2,35 m dhe gjerësi 2,17 m, si dhe absida e kishës jashtë mureve të rrethimit.

Para naosit, po aq i gjerë sa ai (11,43 m) ndodhet narteksi (11,43 x 3,39 (3,05) m). Ngjitur me të, nga ana e djathtë gjendet një ambient (4,70 x 3,75 m), ndoshta protodhiakonikoni, para të cilit u gjend i përmbysur mbishkrimi votiv i ndërtimit të kështjellës. Murit jugor të bazilikës i bashkëngjitet një ambient tjetër (1,60 x 2,15 m), mesin e të cilit e përshkon nga jashtë një hyrje, në të cilin mund të supozojmë skevofilakionin.

Muret që krijojnë ambientet e mësipërme ruhen në themel ose në një lartësi 0,15 – 0,25 m mbi nivelin e dyshemesë me rrasa guri, prej së cilës mundëm të konstatojmë gjurmë të zbeta në mes të nefit të majtë dhe fillimit të nefit qendror. Muret relativisht të ngushtë (0,60 – 0,73 m) të punuar me gurë lumi, që lidhen me llaç të një cilësie jo të lartë, nuk mund të përballonin shtytjen anësore të një qemeri eventual. Kjo dëshmon se bazilika e Paleokastrës nuk hyn në grupin e bazilikave me qemer, por në atë të bazilikave të mbuluara me kapriatë. Mbetet i hapur problemi nëse këtu kemi pasur të bëjmë me një bazilikë të mirëfilltë, ku nefi qendror diferencohet në lartësi prej nefeve anësorë, duke krijuar mundësi për një ndriçim më të mirë të tijin, ose me një pseudobazilikë me çati 2 ujëse, ku nefet nuk diferencohen në lartësi. Zgjidhja vështirësohet dhe nga fakti se mungojnë dhe elementet planimetrikë, hyrjet, arkadat, etj. Megjithkëtë duke u nisur nga gjerësia e madhe, 12,73 m jashtë për jashtë, mendojmë se bazilika ka pasur dife-



Fig. 3

1) Këtë zgjidhje, që nuk është karakteristike si për bazilikat e vendit tonë ashtu dhe të vendeve fqinjë, e gjejmë vetëm në Mogarjello (D. Basler, **Bazilika na Mogorjelu,** Nase starine, Sarajevo, 1958, V. 50) dhe Lepenicë (V. Skaric, **Altertumer von Gradac in der Lepenica,** Glasnik Zemaljskog muzeja, 1932, 11), të dyja në Jugosllavi.

DO NOT COPY



Fig. 4

rencim në lartësi dhe nefi qëndror mbulohej i veçuar. Veçanti tjetër e saja është pajisja me dy absida, rast unik ky për territorin tonë dhe mjaft i rrallë për ndërtimet paleokristiane në përgjithësi.

Në brendi të bazilikës u gjetën një sërë fragmentesh arkitektonike me mermer të bardhë kristalin.

Tryezës së alltarit (mensa sacrae), duket se i përket një fragment me kornizë të profiluar, fusha e të cilit gjëndet në një rrafsh më të ulët se korniza (tab. I, fig. 2). Prej këmbëve të tryezës ruhet një fragment në trajtë kollonete me seksion oval, krejt i njëjtë me fragmentet e ruajtura më mirë në kishën jashtë rrethimit. Fragmenti i tretë ka të gdhendur një kornizë me profil trekëndësh dhe një kollonetë me kapitel të zgjatur korinthik, të njejtë me atë të kollonetave të tryezës së alltarit të kishës jashtë rrethimit (Tab. 1 fig. 3).

Skema planimetrike e bazilikës, me narteks në gjithë ballin e fut atë në tipin e bazilikave të quajtura helenistike, që datojnë nga shek. V e më vonë[2]. Datimi në këtë shekull përforcohet prej faktit se bazilika ngrihet mbi rënojat e kapanoneve të shek. IV, të cilat siç dëshmohet nga monedhat, qenë në përdorin gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli. Logjikisht ndërtimi i bazilikës mund të kryhej pas një kohe relativisht të gjatë. Këtë e mbështet edhe gjetja përmbys në anën e djathtë të narteksit, me sa duket në rolin e pragut, e mbishkrimit votiv me emrat e Licinit e Kostansit. Po kështu elementet e dekorit të brendshëm arkitektonik i përkasin po shek. të V-të. Së fundi bazilika në fjalë paraqitet mjaft e ngjashme me atë të zbuluar në Mogorjello që daton në gjysmën e dytë të shek. V dhe ato të Krumovo kalesë, Serdikes, Jatrusit etj.[3] ndërtime të shek. V.

Kisha jashtë kështjellës gjendet rreth 100 m në jug të kështjellës, afërsisht në mes të dy lumenjëve (fig. 1). Muret e kishës që ruhen më mirë në anën nga absida, ku arrijnë një lartësi 0,60 m, vinë duke rënë në drejtim të perëndimit dhe jugut ku arrijnë kuotën zero (fig. 4, 5). Muret 0,60 m të gjerë, të ndarë qartë nga themeli prej një vetulloreje llaçi, janë punuar me gurë lumi të lidhur me llaç të bardhë me ndërfutje shumë të rrallë copash qeramike. Më mirë ruhet pjesa qendrore e kishës (4,60 x 6,40 m), në ballin e së cilës gjendet absida rrethore, paksa e përzgjatur Absida, ashtu si dhe në kishën brenda rrethimit, nuk qëndron e lirë, por i mbështetet murit ballor të kishës. Ambienti qendror ndahet në dy pjesë prej një muri 0,5 m të gjerë, nga i cili ruhet vetëm ana e majtë e prerë qartë. Gjatësisë prej 3,5 m së këtij muri, duke pranuar dhe murin e djathtë sot të zhdukur, do t'i korespondonte një hyrje 0,90 m e gjerë.

2) P. Lemerle **(Philippes et la Macedoine orientale à l'époque** chretiene et byzantine, Paris, 1945, 323-324). P. Testini **(Archaeologia cristiana,** Rome 1948, 735-6) dhe I. Barnea **(Les villes de la Scythia Minor,** Asociation internationale d'Etudes dy Sud-Est Europen, Buletin X, 2, 1972, 163) vënë në dukje se narteksi, përbën një karakteristikë të bazilikave paleokristiane të Konstandinopolit, Greqisë kontinentale dhe pellgut të Egjeut gjatë shek. V-VI.

3) D. Basler, vep. cit., 82 **Д. Овчаров Базилика № 2 в Крепоста** Крумово кале go **Трговище, София, 3, 1975, 26.**

DO NOT COPY

Nuk e kemi të qartë në se ky mur kufizonte presbiterin nga pjesa tjetër e naosit, ose shënonte kufirin midis naosit dhe narteksit. Pjesa e përparme e këtij ambienti qarkohet prej një muri 0,65 m të gjerë, duke krijuar një farë sofati të gurtë. Është për t'u vënë në dukje se absida nis e kufizuar pikërisht prej gjerësisë së këtyre mureve. Në boshtin e ambientit para murit ballor gjendet bazamenti i tavolinës së altarit. Dyshemeja e këtij ambienti ka qenë shtruar me pllaka tulle (tegulae mamatae), të cilat zenë një sipërfaqe prej 23 m^2. Deri 3 m larg ballit janë përdorur 96 pllaka me ornamente, me përmasa 0,48 x 0,24 x 0,03 m (fig. 6), ndërsa më tej vijojnë pllaka të paornamentuara me përmasa 0,64 x 0.38 x 0.03 m. Pllakat të vendosura paralel me muret e kishës, ruhen më mirë në pjesën afër altarit, me sa duket të mbrojtura nga rrënimet e dheut, ndërsa në pjesët e tjera janë dëmtuar ose grabitur. Pllakat, ashtu si dhe tullat e përdorura në muret e kështjellës, kanë të vizuara nga pas vija për lidhje më të mirë me shtresën e llaçit. Të njejta me tullat e kështjellës ato kanë dhe treguesit mekaniko-fizikë: peshën, porozitetin dhe rezistencën. Ornamentimi i pllakave është kryer i lirë me anë të vizatimit me gisht të motiveve të ndryshme dekorativë. Nga 40 ekzemplarët e lexueshëm numrin më të madh e zënë ornamentet me vija të valëzuara (15) (fig. 7) dhe me gropëza (14); në numër më të vogël hasen zbukurimet me kryq (9) (fig. 8), ndërsa 2 ekzemplarë paraqesin peshq të stilizuar.

Ornamenti i parë paraqet të stilizuar gjarpërin (Tab. II). Simboli paraqitet në trajtën e dy vijave, të hequra paralel me dy gishta, të cilat gjarpërojnë në drejtimin gjatësor. Zakonisht valëzimi është i rregullt, sinusoidal, që të kujton zbukurimin valor të enëve prej qeramike. Por në një serë pllakash të tjera vija gjarpëron në mënyrë të çrregullt, duke u intersektuar hark me hark dhe duke e dhënë të qartë simbolin e gjarpërit. Për më tepër në disa ekzemplarë fillimi traj-



Fig. 5

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6

tohet në një formë të përafërt me kokën e gjarpërit. Pllakat që bartin këtë simbol, janë konturuar me një kornizë një vijëshe, janë lënë të pakonturuara, ose janë vizuar në anët e gjata ose në fund me vija zikzake.

Ornamenti me pika i incizuar me mollëzat e gishtave, paraqet gropëza të reshtuara në vija afërsisht të drejta (tab. III, 8, 9, 10). Prej tyre rreshtat vertikale përmbajnë zakonisht 24 gropëza, ndërsa horizontalet 12, që i përgjigjet raportit 1 : 2 të gjatësisë me gjerësinë e tullës.



Fig. 7



Fig. 8

DO NOT COPY



Fig. 9

Ornamenti me kryq (Tab. III) përbëhet prej kryqit latin shtaga vertikale me dy thellime të cilit, vijon në mes të fushës në të gjithë gjatësinë e pllakës. Sipër vijat bashkohen në formë harku, ndërsa poshtë zgjerohen lehtë. Anët e shtagët horizontale përfundojnë me ovale të vogla, të vendosura zakonisht mbi shtagë. Në katër ndarjen e fushës prej kryqit, gjendet nga një rreth i vogël, vija të shkurtra zikzake, kryqe të vegjël të punuar me vija gërshet ose zikzake, ndërsa një ekzemplar i vetëm duket se ka qenë ornamentuar me katër kryqe që qarkojnë kryqin e madh të shënuar me gropëza (tab. III, 6). Dy ekzemplarë të tjerë paraqesin skematikisht peshkun (tab. III, 11, 13). I pari nëpërmjet një vije zikzake që përshkon tërë pllakën dhe një kokë të vogël vezake anash, ndërsa i dyti me vija zikzake që përfundojnë me kokë të vogël. Në këtë të fundit në pjesën e poshtme janë incizuar dy shkronja «è». Anët e pllakave me kryq qarkohen prej kornizash njëshe, ndërsa tek një ekzemplar, me kryq në pjesën e sipërme dhe një dekor të paqartë në pjesën e poshtme, kufizimi kryhet me vijë zikzake.

Pjesa e pasme e ambientit qendror e ka pasur dyshemenë të shtruar me dhe të ngjeshur, anash ambientit qendror të kishës shihen gjurmët e mureve të nefeve anësore (fig. 5). Ndarja me fugë të qartë prej ambientit qendror tregon se nefet duhet të jenë shtuar në një periudhë të dytë. Prej tyre i djathti ruhet vetëm në ballë në 1 m gjatësi, ndërsa i majti pas 2,65 m kthehet me kënd të drejtë.

Nga një fragment i vogël, i ruajtur në ballin e brendshëm juglindor, kuptohet se kisha ka qenë e pikturuar me afreske. Afresku përbëhet prej dy shtresash, ariçio dhe intonako. Prej tyre ariçio është me gëlqere të përzier me ranë të ashpër lumi, ndërsa intonakoja është hedhur e trashë dhe pastoze, me gëlqere të hidratuar mirë, të përzier me kashtë të grirë imët. Kanalet e lëna mbi intonako nga kalbja e kashtës, tregojnë për një nivel jo dhe aq të mirë teknik. Mbi patinimin, i cili ka qenë shumë i lehtë e i përciptë, dallojmë dy ngjyra, të kuqen, që ka mjaft mundësi të jetë oksid hekuri, i hidratuar natyral, ndoshta kaput mortum dhe të zezën, në formë brezi të pikturuar me qymyr druri.

Në brendi të kishës në afërsi të alltarit u gjetën fragmente të ndryshme mermeri të bardhë kristalin, që dëshmojnë për një dekor të pasur arkitektonik.

Ikonostasit duket se i përkasin 6 fragmente me kornizë të gjerë të pajisur me kanelyrë që kalon me lakim në fushën. Ikonostasit i përket dhe një fragment i cili paraqet një kryqëzim bisqesh me seksion rrethor, i punuar me traforim. Ndryshe prej të tjerëve fragmenti është punuar prej mermeri krem në të hirtë me kristale të mëdha (tab. I, 4).

Prej tryezës së alltarit u gjend «in situ» bazamenti prej guri të fortë ranor (fig. 9) (118 x 67 x 7 cm). Në pjesën e sipërme dhe faqet anësore bazamenti është thadruar rrafshët, ndërsa në afërsi të skajave gjenden thellime të cekta kuadratike (12 x 12 x 2 cm) për vendosjen e këmbëve të tryezës. Prej këtyre të fundit më e plotë ruhet pjesa e sipërme e këmbës (tab. III, 1). Në pjesën e poshtme gjendet kolloneta me seksion paksa oval, diametri i poshtëm i së cilës është 8,5 cm, ndërsa i sipërmi 7,6 cm. Mbi të gjendet një unazë e fryrë, dhe më tej kapiteli i gdhendur me daltë, që formohet prej 4 gjethesh akanthi me dhëmbëza të mëdha. Brinjët e tyre dalin qartë në pah prej thellimesh që sheshohen në sfondin e kapitelit. Nervaturat janë të thella dhe afër njera-tjetrës për krijimin e efekteve dritë-hije. Në pjesën e sipërme gjendet abaku që me sa duket mbante pllakën e tryezës, formulim ky identik me atë të ikonostasit të bazilikës. Fragmenti tjetër, 21 cm i lartë, i përket fundit, që kuptohet nga unaza e punuar keq që mbulohej nga foletë e bazamentit. Fragmenti i tretë që i përket pjesës nën kapitel, ka përmasa të njejta me fragmentin e parë.

Siç kuptohet nga fragmentet e shumta të tjegullave me profil buze në formë sqepi zogu, çatia e kishës, dikur e mbuluar me kapriata është rrëzuar vertikalisht duke dëmtuar dyshemenë. Rrëzimi duket se ka ardhur nga ndonjë tërmet pas braktisjes së saj, pasi nuk vërehen gjurmë djegie. Kjo tërthorazi dëshmohet dhe prej varfërisë së detajeve arkitektonike, të cilat nëse s'do qenë grabitur, duhet të gjëndeshin ndërmjet shtresës së soleneve dhe pllakave të dyshemesë. Lëkundja sizmike në këtë rast ka pasur drejtim

veriperëndimor pasi kjo anë ruhet më mirë, e mbrojtur prej rrënimeve.

Varret. Gjatë viteve 1974-75 u zbuluan 18 varre. Prej tyre njeri me qemer, 3 me konstruksion në formë arke, 12 me konstruksion në formë çatie me tjegulla (tegulae) dhe 2 me çati prej rrasash guri. Me përjashtim të njerit prej varreve me konstruksion në formë arke, i cili gjendet afër mureve të kështjellës, varet me qemer dhe konstruksion në formë arke u zbuluan 80 – 85 m në jug të kështjellës. Në të kundërt varret me tjegulla u gjetën bri mureve, si në anën e jashtme, ashtu edhe atë të brendshme, paralel me ta.

Në varret me konstruksion në formë çatie mungon plotësisht inventari, ndërsa në varret me konstruksion në formë qemeri osa arke, inventari është fare i varfër. Të tërheq vëmëndjen fakti se varret e fundit kanë një farë orientimi nga lindja, ndërsa ato me tjegulla, ndjekin drejtimin e brinjëve të kështjellës.

Varri 2 (fig. 10) me përmasa 2,85 x 2,2 m, mbulohet prej një qemeri cilindrik 0,30 m të trashë. Ndërsa balli nga lindja është i verbër, balli nga perëndimi përçahet në mes prej hyrjes 0,68 x 0,65 m., të mbuluar me arkitra guri. Pas varrimeve hyrja mbyllej nga jashtë me gurë të vendosur me një farë regullsie, të lidhur me baltë. Pjesa e sipërme e qemerit gjendet 0,60 m nën tabanin e tokës, që tregon se që në ndërtimin e tij varri ishte i mbuluar. Qemeri është punuar me gurë pllоçakë ranorë me madhësi mesatare, të vendosur me kujdes dhe të suvatuar nga sipër me një shtresë llaçi mjaft të fortë. Ambienti i brendshëm njëkthinësh i varrit (1,85 x 1,20 m), duket se ka qenë suvatuar me një shtresë llaçi të ashpër. Në të u gjetën tri skelete me kokën nga lindja. Ky fakt krahas mosmbylljes definitive të hyrjes, tregon përdorimin e disahershëm të varrit. Inventari i gjetur në të përbëhet vetëm prej një kandili prej qeramike të punuar dobët.

Tipi i varrit, me qemer në trajtë hipogjeu, haset shpesh në Ballkan nga gjysma e dytë e shek. V në



Fig. 10

Dalmaci, Salonë, Lopud, Orebic, Sinje[4]. Tek ne ky tip gjindet në Peshtan (rrethi i Beratit)[5], në bazilikën paleokristiane në Tepe në Elbasan[6] dhe në kishën paleokristiane të Suçit[7]. Prej tyre varri i Peshtanit ka dhe një parakthinë, ndërsa varret e kishave të Suçit dhe Elbasanit hyjnë në tipin me pusetë (it. tomba a pozetto). Ky tip varri njihet mirë dhe në Dalmaci[8]. Mendimi mbizotërues është se këto varre kanë prejardhje lindore, nga Siria dhe Mesopotami[9]. Por, pa e mohuar mundësinë e këtij ndikimi, duhet vënë në dukje se tipi i varrit me qemer ka pasur një përhapje

4) I. Bojanovski **(Kasnoantičke grobnice na čifluk i njihova prethot na konzervacja,** Nase starine, IX, Sarajevo, 1964, 104-116i. I sheh varret të gjysmës II të shek. IV-VI. Jemi të një mendimi me autorin se ky tip varresh i përket shtresës së kamur. Egger (Forschungen in Salona II, **Der altchristliche Friedhof Manestirine,** 38) i daton të 12 varret e zbuluar në këtë vend në fillim të shek. IV.

5) N. Ceka, **Monumente antike dhe mesjetare në luginën e Osumit** Monumentet 5-6, 121-137. Varri përbëhet prej një paradhome dhe dhomës së varrit mënyrë kjo mjaft e afërt me atë të varreve të shek. III para e.s.

6) A. Meksi, N. Ceka, **Bazilika paleokristiane në Tepe në Elbasan,** Buletin arkeologjik, 2, 187, 190, tab. II. Autorët i datojnë varret e mbuluara me qemere tullash në shek. V.

7) D. Kurti, S. Duka, **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit,** Buletin arkeologjik, 5, 124-127. Varri është një kthinësh i tipit me pusetë dhe mbulohet me qemer tulle.

8) I. Bojanovski **vep. cit.** 116.

9) C.M. Kaufman. **Handbuch der christlichen archaeologie,** 1922, 133, 137.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11

të madhe në vendin tonë gjatë periudhës antike, duke qenë në këtë drejtim tipi predominues i varrit monumental[10] dhe vazhdoi dhe në shekujt e parë të erës sonë.[11]

Varri 1 që ka formë arke drejtkëndëshe me përmasa të brendshme 2,10 x 0,60 x 0,70 m gjëndet 0.35 m nën taban (fig. 11). Muret anësore (0,25 x 0,35 m të gjerë) janë punuar me gurë lumi nga jashtë dhe rasa gëlqerori nga brenda. Në anën e brendshme vihet re një punim i rregullt, ndërsa nga jashtë muri është i çrregullt, në kontakt me faqen e gërmuar. Si dysheme e varrit ka shërbyer trualli prej dheu të ngjeshur ku u gjetën dy skelete në pozicione brinjas, me krye nga lindja, të pashoqëruar me inventar. Nga lart vari mbulohej me tri pllaka të çrregullta guri ranor, të niveluara me copa të vogla guri (dy të parat me përmasa 0,90 x 0,60 x 0,08 m, 1,40 x 0,08 m, ndërsa e treta e coptuar). Trashësia e vogël e shtresës së mbushjes në këtë vend, 0,35 m, dhe shtresa sterile nën të tregon se mbushja nga aluvionet në këtë zonë nuk ka arritur më tepër se 0,20 m.

Varri 3 me konstruksion në formë arke u zbulua 1,60 m në skajin jugperëndimor të kështjellës. Pjesa e sipërme e varrit gjendet 0,40 m nën nivelin e truallit përreth kështjellës.

Varri ka përmasa të brendshme 2,10 x 1,08 x 0,80 m dhe ashtu si ai Nr. 1 është punuar me gurë lumi dhe pllaka gëlqerori. Drejtimi i tij perpendikular me brinjën perëndimore të kështjellës përputhet në një farë mase me drejtimin nga lindja. Varri është mbuluar me pllaka prej guri ranor. Në pjesën e poshtme janë vendosur pllaka të mëdha rreth 1,00 x 1,50 m ndërsa mbi to pllaka më të vogla rreth 0,30 x 0,40 m të cilat pengonin rënien e dheut në varr. Në të u gjetën dy skelete edhe një vorbë prej qeramike.

Tipi i varrit në trajtë arke, me muraturë me llaç, ka një përhapje të gjerë në tërë territorin tonë, duke vazhduar deri në kohët e vona. Ky tip paraqitet mbizotërues dhe gjatë pushtimit romak. Në Apoloni nga 101 varret e zbuluar në nekropolin e dystë 55 i takojnë këtij tipi. Një përdorim të gjerë ai ka dhe në nekropolin e Dyrrahut[12].

Varret me konstruksion në formë çatie u zbuluan përbri kurtinave, si brenda, ashtu dhe jashtë. Duke u nisur nga vetullorja e llaçit, në kontaktin e murit me themelin, e cila përcakton qartë nivelin e tabanit, ose nga niveli i pragut dhe dyshemesë së kullave, kuptojmë se kulmi i varreve gjendej 0,20 – 0,30 m nën nivelin e tabanit, aq sa dhe varret me konstruksion në formë arke. Varre të tillë u zbuluan në anën e brendshme të gjysmës jugore të brinjës perëndimore (varret 3, 4, 5) dhe në anën e jashtme të kurtinave 14-1 dhe 9-10, ku u sondua nën nivelin e tabanit deri në shtresën sterile. Siç kuptohet varre të tillë gjenden gjatë tërë kurtinave të tjera.

Nga 14 varret e zbuluar, 12 janë varre fëmijësh të vegjël. Prej tyre 7 varre përbëhen nga dy tjegulla të mëdha (tegulae) që i mbështeten njera-tjetrës në formë çatie dy ujëse, me 45° ndaj tabanit (fig. 12), një përbëhet prej një tjegulle të vetme, e cila i mbështetet me 45° kurtinës (fig. 13), ndërsa dy varre përbëhen prej një rase të çrregullt ranori, të vendosur po me 45° ndaj murit. Një konstruksion të ndryshëm kanë varret ku mbulesa përbëhet prej 3 tjegullash, dy anësore të vendosur me vertikalitet ndaj truallit dhe një e tretë të vendosur horizontalisht mbi dy të parat. Varret e të rriturve, gjithsejt dy, përbëhen prej dy sërë tjegu-

10) N. Ceka, **Ndërtimet sepulkrale të qyteteve ilire,** Monumentet 9, 35-53.
11) A. Mano **Nekropoli i dystë i Apolonisë,** Iliria 3, Tiranë, 1974, 156. F. Tartari. **Arkitektura e disa varreve të shek. II-IV në Dyrrah,** Monumentet 15-16.
12) Shih shënimin 11.



Fig. 12



Fig. 13

DO NOT COPY

llash dhe mbyllen në ballë me copa tjegullash ose rrasa guri.

Në tjegullat e përdorura në varret dallojmë dy tipa kryesore. I pari që gjendet në pjesën më të vogël të varreve ka profil të harkuar uniformisht (fig. 14), buzë të prera drejt dhe një ngushtim të lehtë të bazës. Brumi i tij me kokriza shtufi ka ngjyrë okër të murme dhe fortësi mesatare. Përmasat e këtij tipi janë 0,70 – 0,72 x 0,42 (0,38 – 0,40) m. Tipi II (fig. 15) me përmasa 0,77 – 0,79 x 0,46 (0,44) m ka trajtën e një pllake të sheshtë, në të cilën rrallë herë janë hequr me gisht vija paralele ose shenja. Buzët e saja sipër kanë një rrumbullakim të lehtë, ndërsa poshtë zgjerohen duke fituar trajtën e një sqepi zogu. Tjegullat e këtij tipi kanë kryesisht ngjyrë të kuqe dhe brumë të përzier me grimca tulle.



Fig. 14

Varret me konstruksion në formë çatie që i përkasin kryesisht fëmijëve duket se e ndjekin në varg tërë perimetrin e kështjellës, pranë njeri-tjetrit, si nga brenda ashtu dhe nga ana e jashtme. Kjo dukuri tregon për vazhdimin e traditës së vjetër ndërtimore që haset në Gajtan mbrojtjes së fortifikimit nga shpirtërat e fëmijëve.[13] Rasti i Paleokastrës në këtë drejtim përbën një hallkë ndërmjetëse për përcjelljen e kësaj tradite në mesjetë, të dëshmuar nga legjenda e ndërtimit të kalasë së Rozafës, madje dhe në mesjetën e vonë siç e tregon murosja e një koke gruaje të gdhendur në dru në urën e Kurt Pashës në Berat.



Fig. 15

Një dukuri me mjaft interes është mbizotërimi i

13) **Historia e Shqipërisë** (maket) I, 1 Tiranë 1973.

simbolikës pagane mbi atë paleokristiane në kishën jashtë rrethimit. Kështu 15 pllakave të dyshemesë me simbolin e gjarpërit, u përgjigjen vetëm 9 pllaka me kryq. Simboli i gjarpërit i cili sipas studiuesve është «më i rëndësishmi dhe më Iliri» nga tërë simbolet dhe që gjendet dhe në qytetet e Epirit, ka qenë i huaj si për simbolikën Greke[14] ashtu dhe për ate paleokristiane. Mjafton të vemë në dukje se përfytyrimi i Shën Gjergjit paraqet pikërisht luftën midis kristianizmit dhe paganizmit të simbolizuar nga gjarpëri dragua. Dukuria e mësipërme nuk paraqet një shembull të izoluar për këtë zonë. Simboli kryesor i mozaikut të dyshemesë në kishën paleokristiane në Antigone, e një kohe me atë të Paleokastrës[15] paraqet një njeri — dragua i cili qarkohet prej gjarpërinjsh[16].

Kjo tregon për një qëndrueshmëri të bestytnisë vendase që arrin të thyejë kanonizmin e rreptë paleokristian. Kjo bestytni nuk mund të shihet kursesi si një divergjencë thjesht fetare, por si një divergjencë antagoniste midis elementit vendas dhe pushtuesit. Hasja e këtij simboli në trajtën e gjarpërit të shtëpisë ose vitores, thuajse në tërë krahinat e vendit tonë dëshmon nga ana tjetër për një qëndresë ideologjike dhe për vazhdimësinë etnike.

DO NOT COPY

14) A. Stipčević, **Simboličko značenje zmije na Iliro-Grčkom novcu,** Godisnjak XIII, Sarajevo, 1976, 245, 249.

15) Kollonetat e tryezës së alltarit në Antigone e Paleokastër, krejt të njejta me njera-tjetrën, i përkasin të njejtës punishte.

16) Dh. Budina, **Bazilika e Antigonesë,** Buletin Arkeologjik, 5, 117-123.

DO NOT COPY



1



A A

2

PRERJA A-A





A A

PRERJA A-A





A A

PRERJA A-A





4



5

0 5 10 15 20 CM



DO NOT COPY



DO NOT COPY

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

ARCHITECTURE DES DEUX EGLISES PALEOCHRETIENNES ET DES TOMBEAUX DE LA FORTERESSE DE PALEOKASTRA

RESUME

La forteresse de Paleokaster en forme d'un trapèze régulier, avec une surface de 0.917 ha, a une dimension qui la range parmi les ouvrages fortifiés destinés au stationnement d'une cohorte d'infanterie. Les dortoirs de caserne des soldats se trouvaient à l'intérieur de la forteresse. Après la destruction violente par le feu de ces dortoirs, et cela vers la deuxième moitié du IVe s. de notre ère, sur leurs ruines fut édifiée une basilique et hors des murs d'enceinte, sur le côté sud, une deuxième église, mais plus petite que la première (Fig. 1). C'est dans les années 1974 et 1975 respectivement que furent dégagées la basilique et l'église.

La basilique se situe sur le côté est de la forteresse.

L'axe principal de sa composition, traversant de part en part la nef centrale, se dirige en direction est-ouest. Symétriquement à cet axe s'alignent le naos, l'abside centrale et le narthex (Fig. 2). L'unité volumétrique créée de la sorte et où l'élément principal, réunissant tous les autres éléments les uns avec les autres et déterminant le volume extérieur, est représenté par le naos, et en particulier par la nef centrale, dont l'accentuation se reflétait aussi dans la silhouette de la basilique (Fig. 3). Cette symétrie est entamée, sans toutefois affecter le volume principal, par une abside dans la nef droite et par deux petites pièces s'appuyant sur le côté sud de l'église.

Les dimensions du naos de 11,43 x 13,85 m (un rapport de 1 : 1,22) sont telles d'une basilique avec le rapport normal de naos. Celui-ci se répartit en 3 nefs.

Face à la nef centrale se trouve l'abside en forme de cercle allongé, dont la charge qu'elle supportait était distribuée à travers un «arc de triomphe» d'un diamètre égal à celui de l'abside; quant à la sécurité statique, elle était renforcée par un diaphragme mural, à un niveau légèrement plus élevé de celui des fondations, ce qui le rendait plus léger et plus flexible. L'abside de la nef droite, elle aussi, se caractérise par une construction analogue.

Devant le naos, d'une largeur égale à celui-ci, se trouve le narthex. Tout contre ce dernier, du côté droit il y a une pièce, peut-être le protodiaconicon. A côté du mur méridional de la basilique se trouve une autre pièce, traversée en son milieu de l'extérieur par une entrée; à notre sens, il s'agit vraisemblablement à scevofilacion.

Les murs relativement étroits (0.60-0.75 m), travaillés avec des pierres fluviatiles, ne pouvaient pas affronter la poussée latérale d'une voûte éventuelle. Ce qui montre que la basilique de Paleokaster ne se range pas dans le groupe des basiliques à voûte, mais dans celui des basiliques couvertes de charpentes de bois. Il reste encore à résoudre le problème si nous avons affaire ici à une basilique dans le sens propre du mot, où la nef centrale se différencie en hauteur des nefs latérales, ou à une pseudobasilique couverte d'un toit à deux pentes, où les nefs ne se distinguent pas quant à leur hauteur. Partant de sa grande largeur, qui à l'extérieur est de 12,73 m d'un point à l'autre, nous estimons que cette basilique se différenciait en hauteur et que sa nef centrale avait une couverture distincte. Caractéristique de cette basilique est le fait qu'elle est pourvue de deux absides, un cas unique pour notre territoire et très rare pour les constructions paléochrétiennes en général.

A l'intérieur de la basilique on a trouvé une série de fragments architectoniques de marbre.

Selon toute vraisemblance, le fragment de corniche profilée (Tab. I, fig. 2), appartient à la mensa sacrae. Des pieds de la table on ne conserve actuellement qu'un fragment en forme de colonnette à section ovale, tout à fait identique aux fragments en parfait état de conservation de l'église se dressant hors de l'enceinte. Sur le troisième fragment figure la sculpture d'une colonnette à chapiteau allongé de l'ordre corinthien. (Tab. I, fig. 3).

Le schéma planimétrique de cette basilique, dont le narthex s'étend dans toute sa partie frontale, la range parmi le type de basiliques appellées helléniſtiques et datant le Ve siècle ou une date plus récente. Cette datation est étayée aussi par le fait que ce monument se dresse sur les ruines de dortoirs de caserne du IVe siècle, qui, comme en témoignent les monnaies récupérées, étaient utilisés pendant la première moitié de ce siècle. Logiquement, la construction de cette basilique aura dû être effectuée après une période de temps relativement longue. En témoigne aussi la trouvaille, dans une position renversée, sur

le côté droit du marthex, apparemment dans le rôle d'un seuil, d'une inscription votive portant les noms de Licinius et de Constant. De même, les éléments décoratifs architectoniques de l'intérieur appartiennent au Ve siècle. Cette basilique ressemble beaucoup à celle mise au jour à Mogorjelo datant la deuxième moitié du Ve siècle, à la basilique de Krumovo kala, à la bosilique de Serdik et à celle de Jatrus, toutes des constructions relevant du Ve s.

Quant à l'église hors de l'enceinte (Figs. 4, 5), elle se situe à environ 100 m au sud de la forteresse, presque au milieu des deux fleuves (Fig. 1). Sa partie centrale (4,60 x 6.40 m), sur la face antérieure de laquelle se trouve l'abside, est la mieux conservée. La pièce centrale de cette église est divisé en deux par un mur. Nous ne savons pas encore si ce mur limitait le presbytère de l'autre partie du naos ou s'il servait de limite entre le naos et la narthex. Le soubassement de la mensae sacrae se trouve sur l'axe de la pièce située devant le mur frontal. Le plancher de cette pièce est revêtu de tegulae mamatae. Jusqu'à une distance de 3 m de la face antérieure, le dallage comporte des plaques à ornement de dimensions 0.48 x 0.24 x 0.03 m (Fig. 6), puis viennent des plaques simples d'une dimension de 0,64 x x 0.38 x 0.03 m. L'ornementation de ces plaques est réalisée librement, en traçant avec le doigt différents motifs décoratifs. Des 40 exemplaires déchiffrables, la plupart est constituée par des ornements à lignes onduleuses (15) (Fig. 7) et à fossettes (14); le thème décoratif en croix (9) (Fig. 8) est de beaucoup inférieur en nombre et 2 exemplaires seulement se caractérisent par des motifs stylisés.

Le premier ornement est celui d'un serpent stylisé (Tab. II). Ce symbole figure en forme de deux lignes, tirées parallèlement avec les deux doigts et faisant plusieurs tours et détours en direction longitudinale. Dans certains exemplaires, le traitement initial se caractérise par une forme approximative à celle de la tête de serpent.

L'ornementation pointillée avec le bout des doigts figure des petites fosses rangées en lignes presque droites (Tab. II, 8, 9, 10). L'ornement à croix (Tab. III) comporte une croix latine, dont la branche verticale à deux enfonçures se prolongeant au milieu du champ de la plaque sur toute sa longueur. Plus haut, ces lignes se réunissent et en bas elles s'élargissent légèrement. Chacune des quatre parties du champ de la croix comporte divers motifs décoratifs: un petit cercle, des lignes courtes en zigzag ou des petites croix travaillées avec des entrelacs ou des lignes en zigzag. Deux autres exemplaires figurent schématiquement le poisson (Tab. III, 13, 11): Le premier, au moyen de lignes en zigzag traversant de part en part la plaque et d'une petite tête ovale sur son côté; le deuxième, au moyen de lignes en zigzag se terminant par une petite tête.

Sur le côté de la pièce centrale de l'église on relève les traces des murs des nefs latérales (Fig. 5). Leur séparation évidente de la pièce centrale, à travers des joints, indique que ces nefs ont été ajoutées pendant une seconde période de construction.

D'un petit fragment conservé dans la partie frontale intérieure S.-E., il ressort que l'église était peinte à fresque. Celle-ci comporte deux couches, ariccio et intonaco. On y distingue deux couleurs: le rouge, probablement préparé avec de l'oxyde de fer et le noir, en forme de bandes peintes avec du charbon de bois.

A l'intérieur de l'église, à proximité de l'autel, on a trouvé des fragments de marbre blanc cristallin. Six d'entre eux, avec des corniches larges, appartiennent vraisemblablement à l'iconostase. Il en est de même d'un autre fragment reproduisant un croisement de petits rameaux à section circulaire, ornés de jours.

En ce qui concerne la mensae sacrae on a trouvé in situ son socle de pierre gréseuse (Fig. 9) avec des trous pour y introduire les pieds de la table. De leur nombre l'élément le mieux conservé est la partie supérieure d'un pied. (Tab. III, 1). Au-dessus de la colonnette se trouve un torus et encore plus loin un chapiteau ciselé à 4 feuilles d'acanthe fortement dentelées. Leurs nervatures sont très fines et l'une près de l'autre afin de créer le contraste de lumière et d'ombre. Sans la partie supérieure se trouve l'abaque qui, à ce qu'il semble, supportait la plaque de la table.

Comme cela ressort des nombreux fragments de tegulae et d'imbricis, le toit de cette église, autrefois couvert de charpentes de bois, s'est écroulé verticalement en endommageant son plancher.

Les tombeaux. De leur nombre il y en a un qui est à voûte, 3 autres ont une construction en forme de coffre, 12 une construction en forme de toit à tegulae et 2 une construction en forme de toit couvert de plaques de pierre. A l'exception d'un tombeau ayant une construction en forme de coffre et se trouvant à proximité des murs de la forteresse, les autres à voûte ou en forme coffre ils ont été découverts à un distance de 80 à 85 m au sud de la forteresse. Les tombeaux à tegulae, par contre, furent mis au jour à côté des faces extérieures et intérieures des murs et disposés parallèlement à ceux-ci.

Dans les tombeaux ayant une construction en forme de toit l'inventaire manque entièrement, tandis que dans les tombeaux ayant une construction en forme de voûte ou de coffre il y est très pauvre. Il convient d'attirer l'attention sur le fait que ces derniers tombeaux s'orientent légèrement vers l'est, alors que les tombeaux à tegulae suivent la direction des côtés de la forteresse.

Le tombeau 2 (Fig. 10) (2,85 x 2,2 m) est couvert d'une voûte cylindique. Dans sa partie frontale vers l'ouest se trouve son entrée (0.60 x 0.65 m). Celle-ci, après l'inhumation, on la fermait de dehors avec des pierres. On y a trouvé trois squelettes avec leur visage vers l'est. Ce fait, outre celui de la fermeture non définitive de son entrée, montre que ce tombeau fut employé plus d'une fois. L'inventaire mis au jour comporte une seule chandelle de céramique.

Le type de tombeau à voûte en forme d'hypogée devient plus fréquent dans les Balkans, et cela à partir de la deuxième moitié du Ve siècle en Dalmatie: Salon, Lopud, Orebic, Sinje.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Chez nous, ce type nous le retrouvons à Peshtan (district de Berat), dans la basilique paléochrétienne de Tepe à Elbasan et dans l'église paléochrétienne de Suç. De leur nombre le tombeau de Peshtan comporte un vestibule, alors que les tombeaux des églises de Suç et d'Elbasan se rangent dans le type de tombeau à pozzetto. L'opinion prévalente est que ces tombeaux proviennent de Syrie et de Mésopotamie. Loin de vouloir nier cette influence, il convient de relever que le type de tombeau à voûte a connu une grande diffusion chez nous, étant en ce sens le type prévalent de tombe monumentale non seulement pendant l'antiquité mais aussi durant les premiers siècles de notre ère.

Le tombeau 1, en forme de coffre quadrangulaire (2.10 x x 0.60 x 0.70), se trouve à 0.35 m au-dessous du niveau du sol (Fig. 11). A l'intérieur on y relève un travail régulier, à l'extérieur le mur est d'une facture irrégulière et se trouve en contact avec face de terre creusée. Sur le plancher en terre battue de ce tombeau on a trouvé deux squelettes disposés de côté, avec leur tête vers l'est, et aucun inventaire.

A ce même type appartiennent aussi les tombeaux NN^{oo} 3 et 4.

Le type de tombeau en forme de coffre, en maçonnerie à mortier, a connu une diffusion large sur notre territoire et cela jusqu'à des périodes de temps avancées. Ce type prévaut aussi pendant l'occupation romaine; à Apollonie, des 101 tombeaux découverts dans la deuxième nécropole, 55 appartiennent à ce type. Il est largement utilisé dans la nécropole de Dyrrah.

Les tombeaux avec une construction en forme de toit furent mis au jour à côté des courtines, tant à l'intérieur qu'à l'extérieur de celles-ci. Le sommet de ces tombeaux se trouvait à 0.20-0.30 m au-dessous du niveau des assises, tout comme les tombeaux en forme de coffre. Des tombeaux semblables furent découverts dans la partie intérieure de la moitié méridionale du côté occidental et dans la partie extérieure des courtines 14-1 et 9-10, où des sondages furent effectués au-dessus du niveau des assises jusqu'à la couche stérile. A ce qu'il semble, des tombeaux similaires existent aussi dans les autres courtines.

Des 14 tombeaux mis au jour, 12 sont des tombeaux d'enfants. De leur nombre 7 comportent deux tegulae s'appuyant les unes sur les autres en forme d'un toit à deux pentes, un d'eux comporte une seule tegullae s'appuyant à la courtine en formant un angle de 45° (Fig. 13) et deux autres une seule pierre tombale, irrégulière et gréseuse, s'appuyant au mur en formant un angle de 45°. D'une construction différente sont les tombeaux comportant 2 tegulae bilatérales disposées plus verticalement par rapport au sol et une troisième tegullae placée horizontalement sur les deux autres. Les tombeaux des adultes, en tout deux, comportent deux séries de deux briques et sont fermés par devant par des morceaux de tuiles ou des plaques de pierre.

En ce qui concerne les tuiles employées dans la construction de ces tombeaux, nous en distinguons deux types principaux. Le premier représenté par des tuiles arquées de manière uniforme (Fig. 14). Le type II (Fig. 15) (0.77 – 0.79 x 0.46 (0.44) m) a la forme d'une plaque plate, dont la bordure supérieure est arrondie légèrement et la partie inférieure s'élargit en forme de bec d'oiseau.

Les tombeaux ayant une construction en forme de toit sont surtout des tombeaux d'enfants et entourent vraisemblablement le périmètre de la forteresse, à l'intérieur comme à l'extérieur de celle-ci. Ce phénomène indique la continuité de l'ancienne tradition de construction que l'on retrouve à Gajtan et qui se rattache à la protection de la fortification des esprits des enfants. Le cas de Paleokaster constitue en l'occurence un maillon intermédiaire de la chaîne à travers laquelle cette tradition fut transmise d'abord au moyen âge, comme le témoigne la légende de la construction de la forteresse de Rozafa, puis au bas moyen âge comme cela est attesté par le murage d'une tête de femme, travaillée sur bois, au pont de Berat et relevant du XVIII^{le} siècle.

Un phénomène de grand intérêt est la prévalence de la symbolique païenne sur celle paléochrétienne dans l'église située hors de l'enceinte. Ainsi donc, aux 15 plaques du plancher reproduisant le symbole du serpent correspondent seulement 9 plaques décorées d'une croix. Le symbole du serpent, le plus important et le plus illyrien de tous les autres symboles et que l'on retrouve même dans les villes de l'Epire, est étranger tant à la symbolique grecque qu'à celle paléochrétienne. Il suffit de relever le fait que l'image de Saint Georges figure précisément la lutte entre le christianisme et le paganisme symbolisé par un serpent dragon. Ce n'est pas là un exemplaire isolé pour cette zone. Le principal symbole de la mosaïque du plancher dans l'église paléochrétienne à Antigonée, contemporaine de celle de Paleokaster, figure un homme-dragon entouré de serpents.

Cela témoigne la stabilité de la superstition locale qui va jusqu'à violer les canons paléochrétiens. La présence de ce symbole en forme de totem, le serpent de la maison ou «vitore»; et cela dans presque toutes les régions du pays, est, d'autre part, un témoignage de la continuité ethnique de notre peuple.

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

KATEDRALJA «FJETJA E SHËN MËRISË» NË VOSKOPOJË

Duke ardhur nga rruga e Korçës, në të hyrë të Voskopojës, nga ana lindore e saj, pasi kalohet përroi i Zhombrit, ndodhet njera ndër dy bazilikat më të mëdha të këtij qyteti, Katedralja «Fjetja e Shën Mërisë». Ajo tani qëndron si e shkëputur midis rrënojave të lagjes së dikurshme me emrin Sharxa (më vonë emërtuar lagja e Shën Mërisë) (Fig. 1).

Nuk ka gjurmë me rëndësi të veçantë nga kodiku i vjetër i Katedrales, që përmendet edhe nga Martiniani[1] dhe që konsiderohet tashmë i humbur; aty duhej të kishte pasur të dhëna të shumta historike rreth këtij monumenti. Pra në shqyrtimin e vlerave historike, arkitektonike dhe artistike do të mbështetemi në vrojtimin direkt të vetë monumentit, në studimin e mbishkrimeve që ruhen në këtë faltore si edhe në literaturën egzistuese për këtë monument[2].



Fig. 1

1. Vështrim arkitektonik i monumentit

Kemi të bëjmë me një bazilikë të ndërtuar në vitin 1712. Kjo datë, siç del nga mbishkrimet dhe argumentat që do të sjellim më poshtë, duhet të përfaqësojë kohën e përfundimit të pikturimit të naosit; pra, si ndërtim duhet të jetë më i hershëm. Në literaturë përmendet si institucion i fundit të shek. XVII. Me përmasat e saj të mëdha (38 x 15,30 m) konsiderohet si një nga godinat më madhështore të tipit bazilikal të vendit tonë (Fig. 2). Muret e saj janë punuar prej gurësh të bardhë, ndërsa çatia është mbuluar me pllo-ça guri. Duke qenë se dyshemeja e saj është ndërtuar 1 m nën nivelin e tokës, në të zbritet nëpërmjet një shkallareje të ulët. Pjesa qendrore (naosi) përbëhet nga tri nefe të ndarë nga tetë shtylla rrethore (nga katër në të dy krahët)dhe dy pilastra. Si zakonisht nefi i mesit është më i gjerë se anësorët. Kalimi në kube është kryer me anë të pendativave, kurse nefet anësore mbulohen prej qemeresh me katër kalota nga lindja dhe dy nga perëndimi (Fig. 3). Mënyra e veshjes së brendëshme të mureve të saj dëshmon dhe për aftësitë e ndërtuesve në njohjen e teknikës së shpërndarjes së zërit.

1) I Martiniani: **Symbolai eis tin istorian tis Moshopoleos A' «I iera moni tou timiou Prodromou kata ton en auti kodika (1630-1875...)** Athinë 1939, f. 33, 36, 66, 172. Këtë faltore oparakët e Voskopojës e kanë thirur «Zonj' e madhe».

2) V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në shek. XVIII,** në BUSHT Nr. 1, 1957, f. 44-57.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

Absida e saj gjysëmrrethore, që sikurdoherë ndodhet nga ana lindore, është e madhe, e lartë dhe e trajtuar me elemente dekorative. Nga jashtë ajo zbukurohet nga shtatë harqe të verbëra dhe dy të tjera në të dy krahët e saj. Këto të fundit kurorëzojnë dy dritaret e vogla, të çelura në të dy anët e absidës, përveç dritares qendrore dhe dy të voglave ndënë të për të plotësuar ndriçimin e altarit me përmasa jo të zakonshme (Fig. 4, 5). Edhe në dyshemenë







Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6

e naosit të veshur me pllaka guri ndërtuesit kanë lënë gjurmë të shijeve të tyre estetike. Në nefin qendror janë formuar me pllaka guri tre rrathë me përmasa jo të njëjta, nga të cilët njeri me pllaka trekëndëshe, që dukat se simbolizon diellin, kurse dy të tjerët më të mëdhenj me rrathë koncentrikë.

Narteksi ka kohë që është rrëzuar. Nga nonjë përshkrim që trashëgojmë nga e kaluara dhe dëshmitë e më të moshuarve mësojmë se narteksi ka qenë ndërtuar me qemere mbi shtylla, i mbuluar dhe me lartësi më të madhe se nefi qendror. Ai është djegur nga nazistët gjermanë në tetor të vitit 1943. Edhe sot duken shënjat e pjesëve të drunjta të djegura. Në të dy anët e derës që lidhet me naosin, ku gjenden dy nike, edhe sot vërehen gjurmë të pikturave, kurse në të dy krahët duken ende nga dy dritare me qemere gjysëmrrethore.

Hajati i madh i kësaj bazilike, me përmasa 24 x 3 m, që shtrihet nga ana jugore në drejtimin gjatësor të saj, me portikun e vet dikur të zbukuruar nga jashtë me majolika, ka pas qenë mbuluar me shtatë kube gjysëmsferike të pikturuara, mbështetur mbi gjashtë shtylla prej guri, nga të cilat sot qëndron vetëm njera. Hajati është rrëzuar nga tërmeti i 21 Majit 1960, duke qëndruar ende më këmbë vetëm muri lindor i tij, ndërsa kubetë e këtij hajati, si edhe narteksi i tij, kishin rënë që kur nazistët gjermanë i vunë zjarrin (Fig. 2, 6). Pesë dritare të vendosura radhazi mbi hajat sigurojnë ndriçimin e naosit nga ana jugore.

Në vitin 1961, nga Ateljeja qendrore e ish Grupit të Kulturës materiale pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, u ndërmuarrën disa punime konservuese tek



Fig. 7

ky monument, duke iu bërë rishikimi i pjesshëm i çatisë. Me atë rast, për të mbrojtur pikturat mjaft të dëmtuara në murin lindor të hajatit, u rindërtua edhe streha pjesore e hajatit (Fig. 7).

Ngjitur me katedralen në drejtim verior duke filluar nga muri i cepit veriperëndimor është ndërtuar më vonë kishëza e Shën Marenës në drejtimin gjatësor të saj, me madhësi 10.58 x 3.88 m duke pasur si mur jugor murin verior të Katedrales (Fig. 3). Në murin jugor të kësaj kishëze njënefëshe ka dy dritare dhe një derë në mes, që lidhet me bazilikën, kurse nga ana veriore ka tri dritare dhe një nike në fund. Në



Fig. 8

DO NOT COPY



Fig. 9

faqen lindore ka një nike të hapur dhe dy të mbyllura. Në mes të kësaj faltoreje, nëpërmjet një shkallareje prej 10 këmbësh zbritet poshtë në një galeri të kriptës të mbuluar me gurë porozë në trajtë qemeri[3].

Siç tregojnë vendasit dhe siç vrojtohet në një fotografi të marrë para djegies së vitit 1916, (Fig. 9) brenda mureve të oborrit të Katedrales, nga ana jugore, ka qenë kishëza e Shën Anargjirëve, e Kozmait e Damianoit[4].

Nga ana jugore e oborrit të Katedrales mbi portën e jashtëme të hyrjes dhe ngjitur me muret rrethuese ngrihet në lartësi me katër hapësira drite një kambanore e lartë dhe mjaft e hijshme, punuar me gurë të gdhendur (Fig. 1, 10). Në mbishkrimin e gdhëndur mbi një pllakë guri mbi portën e kambanores thuhet se është ndërtuar më 1887, por, me sa duket, do të jetë fjala për një rindërtim të së vjetrës[5]. Në një pllakë tjetër, po mbi faqen jugore të kambanores, shënohen edhe emrat e mjeshtërve Niko Koli e Anastas Veria. Mjeshtrit ndërtues kanë ditur ta shfrytëzojnë edhe lartësinë e portës për ta ngriur mbi të edhe më në vertikalitet kambanoren (Fig. 10-11).

Pranë kishës, nga ana perëndimore dhe jugore, kanë qenë dikur kthinat e qëndrimit të përkohshëm

3) **«Vendasit edhe sot tregojnë një kthinë afër kishës ku kanë ruajtur të gjitha sendet me vlerë të trevës dhe të kishës dhe kjo kthinë mbyllej me gur të madh në rast rreziku, Hyrja e saj është shumë më e vogël se trupi i njeriut».** (V. Puzanova, vep. e cit., f. 50).

4) Ka dhe variant që kjo kishëzë të ishte e shën Pandelejmonit. Sidoqoftë, sot nuk i duken as themelet.

5) Përmbajtja e këtij mbishkrimi: **«Kjo kambanari është ndërtuar në kohën e kujdestarisë së Dhimitër E. Balaurit, ... më 1887, Korrik 15».**

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

të mitropolitëve (Fig. 9), kthina që pjesërisht u dogjën më 1916, teksa mbeturinat me kalimin e kohës, nga mos përkujdesja gjatë regjimit zogist, janë zhdukur krejt. Në atë kohë edhe kjo faltore pësoi djegie në konostas dhe jashtë në çati, por në vitin 1919, bashkë me ndreqjen e çatisë u rindërtua edhe ikonostasi.

2. Vlerësime artistike të monumentit

Përveç vlerave arkitektonike që përmendëm më sipër, ky monument dallohet edhe për vlerat artistike të tij, pikturat murale, ikonostasin e thadruar në dru dhe ikonat që e pajisin atë, disa prej të cilave me vlerë të padyshimtë.

Pikturat murale (Fig. 12), që kanë patur mbuluar krejt faqet e brendëshme të naosit (mbi lartësinë 1,50 m prej dyshemesë), absidën si dhe hajatin, duke përfshirë nike, qemere, harqe e kubera, në gjendjen e sotme paraqiten mjaft të dëmtuara. Ato kanë pësuar dëmtime qysh me djegien e çatisë së saj më 1916.

Nga piktura e absidës, që ka qenë e tëra e pikturuar, në niken e djathtë ruhen vetëm gjurmë të saj, sepse me kohë ka qenë dëmtuar. Në pjesën e poshtme të absidës ka një kornizë me motive gjeometrike.

Sipërfaqja e madhe e mureve të naosit, të absidës, të nikeve, të qemereve, të harqeve e të kubeve, u ka diktuar e lejuar piktorëve nga Agrafa, Theodhorit, Anagnostit dhe Sterianit, që në pikturat murale të trajtojnë një tematikë të pasur, duke mos respektuar krejt rregullat e rëndomta të kishës lindore. Këta piktorë, me sa dihet deri sot, nuk kanë punuar në ndonjë kishë

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

tjetër në Shqipëri. Temat e shumta të trajtuara dhe që mund të grupohen në disa cikle (liturgjik, dogmatik, i Krishtit, i Shën Mërisë, i Dhiatës së vjetër, i historisë së kishës, i shënjtorëve) ka kohë që janë analizuar hollësisht[6]. Shumica e skenave të cikleve të pikturuara në këtë katedrale, krahas vlerës artistike të pikturës, paraqesin interes edhe për tematikën e përfundimet që mund të nxirren rreth kultit të kohës; por nga mjeshtëria artistike nuk mund të krahasohen me pikturat murale të bazilikave të tjera të Voskopojës, ku më vonë kanë punuar piktorët vendas David Selenicasi, dhe Vëllezërit Korçarë. Pjesa perëndimore e kishës deri në shtyllën e dytë i ka skenat më të dobëta nga ana artistike se sa pjesët e tjera. Vetëm disa nga skenat e mëdha me shumë figura kanë më tepër vlerë artistike; kjo mund të shpjegohet edhe me aftësitë e ndryshme të të tre piktorëve agrafas. Në skenat e mëdha dallohen për vlera të arritura kompozicionale: «Zbritja e Krishtit në fer», «Parabulla e të zotit të vreshtës», «Rivendosja e ikonave», «Shën Mëria mbi thron të artë me Krishtin e vogël në prehër, me yllin mbi të, me ushtritë engjëllore, me magët dhe barinjtë përreth saj», etj. (Fig. 17--18). Seicila prej këtyre skenave mishërohet deri diku në një tërësi artistike më vete; por duhet thënë se një pjesë e mirë e pikturave të tyre vuajnë nga stereotipimi, shabllonizmi e skematizmi. Ngjyrat që kanë përdorur piktorët në punën e tyre janë: e arit, e kaltërta, e gjelbra, e kuqja, e bardha, e verdha.

Në krijimtarinë e këtyre piktorëve, ndërmjet medaljoneve me martirë dhe shënjtorë, bëjnë pjesë edhe zbukurime bimore, si hardhi me vile rrushi etj.

Pikturat murale të hajatit të Katedrales, prej të cilave kanë ngelur fare pak në faqen lindore dhe veriore (Fig. 20), nuk janë punë të agrafasve, por të një piktori të panjohur, mbase të së njëjtës shkollë të Athosit, që në art nuk solli veçse vazhdimin e ngurtësisë së traditave të Bizantit dhe që në atë kohë ishte vazhdimisht në rënie.

Përsa i përket gjendjes teknike të pikturës murale është për t'u nënvizuar lidhja mjaft e dobët e suvasë me murin tepër të lëmuar. Për të mënjanuar, pra, shkarjen e mëtejshme të pikturave murale ka qenë e domosdoshme ndërhyrja konservuese. Një ekspeditë e Institutit të Monumenteve të Kulturës gjatë verës së vitit 1978 filloi punimet e saj në këtë fushë[7].

Ikonostasi i kësaj bazilike (Fig. 13-14) është i përbërë nga pjesë ikonostasesh të ndryshme, të grumbulluar nga mbeturinat e ikonostaseve të kishave të tjera, pjesë të integruara në të nëpërmjet lidhjeve e copëve më të reja. Megjithatë, edhe pse vërehen pesë duar të ndryshme punimi, ikonostasi është me vlerë artistike, si një model thadrimi në dru arre. Nga djegia e vitit 1916 pësoi edhe ikonostasi. Pleqtë voskopojarë thonë se disa ikona dhe pjesë të ikonostasit në dru arre të latuar janë grabitur nga trupat ushtarake franceze gjatë Luftës së parë Botërore, gjë që përkon

7) Edhe në vitin 1961 kanë qenë kryer disa punime konservuese me karakter preventiv në pikturat murale në rrezik shembjeje të kësaj bazilike (shih art. e G. Strazimirit **«Një thesar që duhet të ruhet dhe mirëmbahet»**, «Zëri i Popullit», 26.X.1961.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

edhe me ndonjë burim të shkruar. Në gjendjen e sotme ikonostasi ndahet horizontalisht në dy pjesë kryesore (Fig. 14). Në dy rreshtat e pjesës së sipërme gjenden 22 ikona dhe 7 portrete të vegjël dhe mbi to kulmon kryqi i drunjtë që ka përbri në të dy anët dy figura simbolike kafshësh po prej druri. Pjesa e poshtme e ikonostasit përbëhet nga një rresht prej 9 ikonash të mëdha, kurse ndën to në nivele e trajta gjeometrike të ndryshme janë vendosur punime artistike të gdhendura në dru me motive të ndryshme floreale, zoomorfe etj. Si në këto punime (Fig. 14-15) ashtu edhe tek «dyert e bukura» (Fig. 16) apo shtyllat prej druri që ndajnë ikonat e mëdha, vërehet vende-vende përdorimi i teknikës së tejshpimit, por nuk mungojnë dhe pjesë të punuara rëndomtë. Prej amvonit të dikurshëm ka ngelur vetëm një pjesë e vogël.

Me vlerë janë edhe ikonat e punuara nga Jeromonak Kostandini më 1703, punime relativisht të mira prej dore të sigurtë, vepra me shije të hollë, me fytyra shprehëse dhe me teknikë punimi shumë të mirë, ndërsa ikonat e tjera, që janë sjellë për të pajisur ikonostasin e Katedrales, janë punuar nga piktorë të ndryshëm me aftësi më të pakta. Midis ikonave më të vogla, nga studiues të pikturës[8] është vërejtur se katër prej tyre ruajnë një stil e vlera artistike më të arrira; ato dallohen nga karakteri i përbashkët stilistik, përgatitja teknike dhe përmasat e njëjta. Duke u nisur nga ngjashmëria me dy ikona që ndodhen në bazilikën tjetër të Shën Kollit, ku ka pikturuar mjeshtri David, të cilat shquhen për kompozimin, të zgjidhur në disa raste jo në karakterin e zakonshëm të njohur në ikonografinë bizantine, mendohet që edhe këto të jenë vepra të David Selenicës, që siç dihet, deri tani ka qenë njohur vetëm si freskograf. Në të mirë të këtij përfundimi hedhin dritë trajtimi artistik, plasticiteti i veçantë, stili mjeshtëror i realizimit të këtyre ikonave, zbërthimi psikologjik i tipave, si dhe të gjitha ato cilësi që karakterizojnë krijimtarinë artistike të mjeshtrit tonë të madh të shek. XVIII.

3. Rreth datimit të ndërtimit e pikturimit dhe disa përfundime të tjera

Një nga mbishkrimet që na jep më tepër të dhëna është ai që gjendet mbi portën perëndimore të Kishës[9]. Prej tij ne mësojmë si kohën e përfundimit të ndërtimit e pikturimit (vitin 1712) dhe emrat e mjeshtërve që e pikturuan, ashtu edhe faktin që është ngritur me shpenzimet dhe kontributin e vetë popullit. Në

8) Hasan Nallbani, **Disa vepra të panjohura të piktorit David Selenicasi,** «Drita», Tiranë 15.X.1978.

9) Ja përkthimi i mbishkrimit greqisht (me shkurtime): **«Është ndërtuar dhe pikturuar ... me shpenzimet e arkondëve ... Adham Papadhimitër Prendit, Adham Dhimitrit, Gjergj Llazarit, Kostandin Zibus, Dhimitër Bretos, Gjergjit, Gjergj Ambarit, Gjergj Papadhanilit, Kristo Nikollë Flenxës. Në kohën e piskopimit të .... Danielit u përfundua me dorën tonë, të shërbëtorëve më të vegjël, Theodhorit, Anagnostit, Sterianit, nga Agrafa, në vitin 1712, në muajin Tetor 2».**

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16

një shënim me mjaft interes të kodikut të kësaj kishe që e gjejmë në literaturën e trashëguar është thënë: «Të bekuarat rufetëra (esnafë) muarrën përsipër që të mësojnë me harxhet e tyre seicili nga një djalë në mësimet helenistike, filozofike dhe teologjike, gjithnjë mot e nga mot[10]. Shohim, pra, se esnafët e zejtarëve dhe tregtarëve të Voskopojës, marrin përsipër edhe detyra për arsimimin e brezit të ri, fakt ky me domethënie të qartë për rolin që ata kanë lojtur në vështrim të zhvillimit ekonomik dhe kulturor të qytetit të tyre.

Në ikonën e Shën Gjergjit dhe të Shën Mitrit, një nga katër ikonat e mëdha më të vjetra (Fig. 14) që ndodhen në ikonostasin e Katedrales, piktori vendas Kostandin Jeromonaku ka lënë një mbishkrim të vitit 1703, kurse mbi ikonën e madhe të Krishtit figuron një mbishkrim tjetër i tij me tekstin e shkurtër: «Dora e Jeromonakut; 16-4» (shifra dhjetëshe është e prishur). Mendimi që ky piktor duhet të jetë shqiptar rrjeth jo vetëm nga teksti i mbishkrimit greqisht shkruar me gabime ortografike, por edhe nga një arsye me shumë rëndësi. Ai, ndryshe nga rregullat kishtare, rreshton krahas shenjtorëve kryesorë edhe shenjtorë lokalë të panjohur në mbarë kishën, të cilët populli ynë i ka pas konsideruar të vetët për shkak të veprimtarisë së tyre të zhvilluar në këto vende.

Nga këto mbishkrime, në dy ikona të pikturuara me dorën e Jeromonak Kostandinit në një kohë më të hershme se viti 1712, vit që na jepet si datim nga mbishkrimi kryesor, dalin këto dy përfundime: a) ikonat janë sjellë nga ndonjë kishë tjetër (ka të dhëna që janë sjellë mbas vitit 1916 nga kishat e tjera të pri-

10) F. C. Pouqueville, **Voyage dans la Grèce,** Paris 1820, f. 392 – 393.

DO NOT COPY



Fig. 19



Fig. 20

shura); b) vërtetohet teza e mësipërme që si ndërtim kjo Katedrale duhet t'i përkasë fundit të shek. XVII. Por megjithë qenien e disa mbishkrimeve mbetet i hapur problemi i datimit të saktë të ndërtimit të kësaj Katedraleje. K. Skënderi[11] dhe E. Kurilla[12] japin si datë të ndërtimit vitin 1715, duke u mbështetur në mbishkrimin tjetër të portës jugore jashtë kishës. Ata, si duket, nuk janë njohur me mbishkrimin kryesor të Katedrales mbi portën perëndimore nga brenda[13], i cili e ruan edhe sot datën 1712 me shifra greke dhe arabe. Megjithatë edhe kjo shifër nuk është bindëse, sepse nuk mund të jetë e pranueshme si vit i ndërtimit dhe njëkohësisht i pikturimit të kësaj kishte. Është jashtë mundësive, për kohën që bëhet fjalë, që brenda një viti të bëhet dhe ndërtimi edhe pikturimi i një bazilike kaq të madhe, siç është kjo. Përveç kësaj, shqyrtimi i burimeve arkivale përsa i përket periudhës që qëndronte si peshkop Danieli, gjatë së cilës sipas mbishkrimit duhet të jetë bërë ndërtimi i Katedrales dhe argumentimet e sjella nga autorë të mëparshëm na duken të drejta. Në këtë vështrim jemi të prirur të besojmë se ndërtimi i saj duhet të jetë

11) K. Skënderi, Istoria tis arhaias kai syghronou Moshopoleos. Athinë 1928, f. 47.

12) E. Kurilla, I. Moshopolis kai i nea Akadiemia autis. . . . Athinë 1935, f. 27; Grigoris O Argirokastritis . . . Epimetron i istoria tis Moshopoleos kai i politismos autis. Athinë 1935, f. 127. Nga ky autor thuhet se Kalimahos ka pasë grumbulluar rreth 150 mbishkrime të tempujve të Voskopojës.

13) Mbishkrimi për të cilin bëhet fjalë ka rënë kur u dogj çatia e hajatit dhe e narteksit nga nazistët. Sipas K. Skënderit (Istoria tis arhaias. . . . , Athinë 1906, f. 36) teksti i mbishkrimit ka qenë ky: «Nëqoftëse je mik i vakëfit hyrë duke u gëzuar, po në mos je i tillë ikë së këtejmi» 1715.

bërë para vitit 1712, që duhet konsideruar si viti i përfundimit të pikturimit të saj[14]. Por, ndërsa viti 1712 i përket pikturimit të brendësisë së kishës, viti 1715, për të cilin flet mbishkrimi, që ndodhej mbi portën jugore të kishës nga jashtë, duhet të ketë lidhje me pikturimin e hajatit, gjë që, për analogji, ndodh edhe me mbishkrimet e portave jugore të dy kishave të tjera të Voskopojës (Shën Kollit dhe Shën Thanasit). Në të vërtetë vërehen ndryshime midis pikturës së murit lindor të hajatit, që qëndron ende më këmbë, dhe pikturës në brendësi të kishës.

Nga një shqyrtim i imët i elementeve që na ofrohen nga monumenti siç janë mbishkrimet, punimet artistike, vëllimi i ndërtimit, periudha e kryerjes së punimeve, ndërtimore e artistike etj. mund të nxjerrim edhe disa përfundime të tjera, që mendojmë se nuk janë pa interes të vihen në pah dhe sadopak hedhin dritë për një studim sa më të plotë të kulturës materiale që ruajmë sot nga kjo qendër historike e mesjetës së vonë, siç është Voskopoja, me rëndësi të veçantë për shekullin e lulëzimit të saj.

a) Duke qenë si objekt i ndërtuar në fillimin e shek. XVIII dhe me shumë mundësi aty nga fundi i shek. XVII, kronologjikisht me këtë çelet seria e bazilikave të shumta që ndërtohen në gjysmën e parë të shek. XVIII, kur Voskopoja njohu zhvillimin më të lartë ekonomik e kulturor.

b) Katedralja «Fjetja e Shën Mërisë», si kishë e mitropolisë dhe e ndërtuar fill pas asaj të manastirit të Shën Prodhromit, duhet të ketë qenë vatra e dytë kulturore e Voskopojës. Do të kalonin edhe disa dekada që të ngriheshin institucionet e tjera kulturore-arsimore më të rëndësishme, si «Akademia e re», Shtypëshkronja, Biblioteka etj.

c) Ndërtimi i një bazilike me hapësirë kaq të madhe në këtë periudhë, ku mund të qëndrojnë rreth 1000 vetë, përforcon edhe një herë mendimin se Voskopoja të paktën qysh nga gjysma e dytë e shek. XVII ka filluar të zhvillohet si qytet jo pa rëndësi.

ç) Bashkë me bazilikën tjetër të Shën Kollit, ndërtuar më vonë (në dekadën e tretë të shek. XVIII) monumenti që shqyrtojmë zë vend të shquar midis ndërtimeve bazilikale të ngritura në atë periudhë jo vetëm në Voskopojë, por në mbarë vendin. Deri diku me të drejtë, por jo pa hiperbolë I.M. Qafëzezi[15] e ka pagëzuar këtë Katedrale si Shën Sofi e Shqipërisë, në analogji me atë të Stambollit, natyrisht duke ruajtur përpjesëtimet.

d) Me sa duket, nga fillimi i shek. XVIII nuk do të ketë pasur piktorë vendas më të mirë të pikturave murale, kështu që voskopojarët e asaj kohe janë detyruar të sjellin piktorë nga krahina të Greqisë me aftësi artistike relativisht jo të mëdha për të stolisur katedralen e tyre. Në të vërtetë tek ne piktorët që nga shek. XVII paraqitështin më të dobët në art se sa ata të një shekulli më parë. U deshën dhjetëra vjet pas pikturimit të kësaj Katedrale që të shfaqen piktorët e talentuar si David Selenicasi, Vëllezërit Korçarë etj, për ta ngritur në nivel më të lartë artin e pikturës murale në vendin tonë.

dh) Duke u nisur nga pozicioni i ndërtimit të kësaj bazilike mitropolitane, si edhe nga ai i dy të tjerave të mëvonëshme aty pranë, asaj të Shën Kollit dhe, më tej, të Shën Mëhillit, themi se pikërisht në truallin midis këtyre faltoreve shtrihej në atë kohë dhe u zhvillua qendra e qytetit, i cili me lulëzimin e mëtejshëm i shtriu lagjet e reja edhe matanë përrenjve të Strugut dhe Peltekut.

e) Me sa dimë ne është e para bazilikë që na përmendet me një kriptë me tipare të veçanta.

DOKTORATURA

14) Jani Mihalopullos në botimin e tij «**Moshopolis. Ai Athinai tis tourkokratias** 1500-1769, Athinë 1941, f. 50, shënon si datë të ndërtimit të kësaj kishe vitin 1699. Rreth kësaj date ose para saj shprehet edhe ndonjë autor tjetër.

15) I.M. Qafëzezi, **Voskopoja e vjetër edhe rrebeshimi i parë 1338-1769**», «Minerva» Nr. 16 d. 14.XII.1933 dhe N. 17 d. 16.I.1934, Tiranë.

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

LA CATHEDRALE «LE SOMMEIL DE SAINTE MARIE» A VOSKOPOJE

RESUME

En se fondant sur l'observation directe du monument lui-même, sur l'étude des inscriptions encore conservées ainsi que sur la littérature existante, l'auteur du présent article examine la valeur historique, architectonique et artistique de la cathédrale «le Sommeil de Sainte Marie», qui se trouve à l'entrée de la ville moyennâgeuse de Voskopoje. C'est là une des deux plus grandes basiliques de cette agglomération urbaine.

En raison de ses dimensions considérables (38 x 15.30 m), elle est considérée comme un des édifices plus imposants de type basilical du pays. Son naos comporte trois nefs séparées par huit colonnes circulaires et deux pilastres. Le passage à la petite coupole a lieu au moyen de pendantifs, alors que les nefs latérales sont couvertes par des voûtes à quatre calottes du côté E. et à deux calottes du côté O. Son abside semicirculaire est ornée d'éléments décoratifs. La partie inférieure de celle-ci est agrémentée de sept arcs aveugles et de deux autres sur ses deux côtés.

Le narthex comportait un voûte reposant sur des colonnes à un niveau supérieur à celui de la nef centrale. En octobre 1943 il a été incendié par les nazis allemands.

Le grand hayat de cette basilique, d'une dimension de 24 x x 3 m, s'étend longitudinalement du côté S. et son portique était autrefois orné extérieurement par de la maïolique; il était couvert par sept petites voûtes semi-sphériques peintes, s'appuyant sur sept colonnes de pierre, dont ne reste actuellement qu'une seule. Ce hayat s'est écroulé le 21 mai 1960 par suite du tremblement de terre qui a eu lieu à cette date.

En 1961, l'Atelier central de l'ex-Groupe de la culture matérielle près l'Université de Tirana s'est mise à la tâche pour y effectuer des travaux de restauration.

De façon contiguë à cette cathédrale en direction septentrionale, à partir du mur angulaire N.O. fut construite plus tard la petite église de Sainte Marie en direction longitudinale par rapport à la première, d'une dimension de 10.58 x 3.88 m, et en ayant comme mur méridional le mur septentrional de la cathédrale elle-même. Au milieu de ce temple, à travers un escalier de 10 gradins, on descend à la galerie de la crypte qui est couverte de pierres poreuses en forme de petite voûte.

Du côté méridional de la cour de la Cathédrale, au-dessus de la porte extérieure de l'entrée et à proximité des murs d'enceinte, se dresse un clocher attrayant. Sur deux plaques de pierre sont indiqués la date de sa construction et les noms de ses bâtisseurs et constructeurs.

A proximité de l'église il y avait autrefois les pièces destinées au séjour provisoire des métropolites, qui furent partiellement incendiées en 1916 et dont les vestiges ont disparu avec le temps par suite de l'insouciance montrée par les représentants du régime zoguiste.

Ce monument se distingue non seulement par ses valeurs architectoniques, mais encore par celles artistiques, par ses peintures murales, par son iconostase ciselée sur bois et les icônes relatives, dont quelques-unes sont d'un grand intérêt.

Les peintures murales, qui couvraient autrefois les parements intérieurs du naos, l'abside et le hayat, y compris la niche, les voûtes, les arcs et les petites voûtes, se présentent actuellement dans un état relativement détérioré. La grande surface à leur disposition a indiqué et permis aux divers peintres, depuis Agrafe, Theodhor, Anagnost, Sterian et autres, de traiter une thématique riche ne reflétant pas fidèlement les normes habituelles de l'église orientale. A l'état de nos connaissances, il ressort que ces peintres n'ont pas travaillé dans quelque autre église du pays. La majorité des cycles peints dans cette cathédrale, outre la valeur artistique de leur peinture, se distinguent aussi par leur thématique relative au culte de l'époque. Mais en ce qui concerne leur niveau artistique, ces peintures murales ne souffrent aucune comparaison avec les peintures des autres basiliques de Voskopoje, où plus tard ont oeuvré les peintres du pays David Selenicasi et les frères Korçare. Chacune des scènes peintes constitue plus ou moins une unité artistique bien distincte, mais certaines d'entre elles souffrent du défaut de lieu commun et de schématisme. En 1978, une expédition de l'Institut des Monuments de Culture entreprit des travaux pour la conservation de la peinture murale, afin d'éviter son détériorement ultérieur.

L'iconostase de cette basilique est un assemblage de pièces d'iconostases diverses appartenant à d'autres églises, aux-

quelles ont été ajoutées des pièces nouvelles. Malgré cela et malgré le fait qu'on y relève cinq mains différentes de peintre, cette iconostase présente un grand intérêt artistique en tant que modèle travaillé sur bois de noyer. Bien qu'elle ait été détériorée par l'incendie de l'an 1916, les personnes âgées du pays racontent qu'une partie des icônes et de l'iconostase ont été emportées par les troupes françaises pendant la Première Guerre mondiale, ce qui est confirmé aussi par les dires des sources écrites. Dans les travaux artistiques travaillés sur bois avec des motifs à fleurs, animaux et autres, par endroits l'on relève la technique de la perforation de part en part associée à la technique ordinaire.

En ce qui concerne la datation de cette cathédrale l'auteur du présent article, se fondant sur les inscriptions existantes et sur celles qui ont disparu, ainsi que sur les arguments avancés par les auteurs antérieurs, aboutit à la conclusion qu'elle doit avoir été construite avant 1712, date qui correspond à la conclusion des peintures murales de l'intérieur de l'église, tandis que l'an 1715, figurant sur l'inscription surmontant la porte méridionale de la cathédrale de dehors, se rattache vraisemblablement à la peinture du hayat, ce qui, par analogie, s'observe aussi sur les deux portes méridionales des deux autres églises de Voskopoja (Shen Koll e Shen Thanas). En fait l'on relève des différences entre la peinture du mur oriental du hayat, qui est encore debout et la peinture décorant l'intérieur de l'église.

D'un examen minutieux des éléments qu'offre ce monument, entre autres les inscriptions, les travaux artistiques, le volume de construction, la période d'exécution des travaux, de construction et d'art, etc., l'auteur du présent article aboutit aussi à d'autres conclusions qui ne sont pas sans intérêt pour une étude plus approfondie de la culture matérielle conservée de nos jours dans ce centre historique du bas moyen âge.

1) Etant un objet mis en place vers le début du XVIIIe siècle, et très probablement vers la fin du XVIIe, il ouvre chronologiquement la série des nombreuses basiliques qui furent construites dans la première moitié du XVIIIe siècle alors que Voskopoja connut son plus haut niveau de développement économique et culturel.

2) Cette cathédrale en tant que siège du métropolite, construite immédiatement après le monastère de Shen Prodhom, doit avoir été le deuxième foyer culturel de Voskopoja. Ce n'est qu'après quelques décennies que furent édifiés les importants établissements de caractère culturel et scolaire que sont la «Nouvelle Académie», l'imprimerie, la bibliothèque, etc.

3) La construction d'une basiliques si spacieuse à l'époque, avec une capacité d'environ 1 000 personnes, renforce notre conviction que Voskopoje, au moins depuis la deuxième moitié du XVIIe siècle, commence à se développer comme une ville d'importance.

4) Ce monument, avec la basilique de Shen Koll construite plus tard (dans la troisème décennie du XVIIIe siècle), occupe une place de relief parmi les édifices basilicaux mis en place à l'époque non seulement à Voskopoje, mais dans tout le pays.

5) Apparemment, dès le commencement du XVIIIe siècle se fait sentir chez nous l'absence de peintres de talent, aussi les voskopoyars furent contraints de faire venir de Grèce des artistes, en vérité fort peu doués, pour procéder à la décoration de leur cathédrale. En effet nos peintres, et cela depuis le XVIIe siècle, quant à leur niveau artistique sont de loin inférieurs à leurs collègues du siècle antérieur. Ce n'est qu'après avoir porté à terme la peinture de cette cathédralé que furent leur apparition les peintres de talent que sont David Selenicasi, les frères Korçar et autres, qui donnèrent un nouvel éclat à l'art de la peinture murale en Albanie.

6) Considérant la position de cette basilique siège du métropolite, ainsi que de celles plus récentes construites à sa proximité, l'église de Shen Koll et, un peu plus loin, l'église de Shen Mehill, nous pouvons affirmer que justement sur le terrain entre ces deux temples s'étendait à l'époque le centre de la ville, qui, par suite de son épanouissement ultérieur, s'est enrichie de quartiers nouveaux au-delà des torrents de Strugu et de Peltek.

DO NOT COPY

Sulejman DASHI

NJË XHAMI E VJETËR NË BERAT

DO NOT COPY

Qyteti muze i Beratit ruan shembuj të shumtë nga kultura jonë ndërtimore tradicionale.

Në tërësinë urbane të këtij qyteti, banesa popullore përcakton karakterin monumental, ajo shquhet për bukurinë kompozicionale, unitetin stilistik, dekorin e pasur, shumëllojshmërinë e tipave etj., por nëpërmjet banesës merren të dhëna vetëm për dy shekujt e fundit të mesjetës, ndonëse formimi i saj karakteristik u krye nëpër një proçesi të gjatë dialektik mbi bazën e traditës vendase dhe këmbimit të eksperiencave pozitive të ndërtuesave të ndryshëm.

Të dhëna me vlerë për traditën dhe nivelin e ndërtimeve mund të hetohen përveçse nga banesa edhe në objektet e tjera që ruhen në Berat, të epokave historike të njëpasnjëshme, që nga fortifikatat me taban ilir, ndërtesat social kulturore, krijimet inxhinjerike e hidrosanitare, faltoret etj. nga të cilat do të analizojmë xhaminë e Plumbit (fig. 1).

Ky monument ndodhet në qendër të qytetit. Është ndërtuar në vitet 1553-54 nga Skurajt e Beratit[1] Më i shquari nga kjo familje, Isa begu, në vitet 1440 kish arritur në ushtrinë osmane gradën e gjeneralit më pas të vezirit dhe më vonë ju ngarkua detyra e guvernatorit të Anadollit[2]. Si pohon Babinger, sulltan Mehmeti i dytë e shkarkoi Isanë nga ky post me «mospërfilljen më të ashpër»[3] dhe duket se nga ajo kohë Isa begu do jetë kthyer në vendlindje ku themeloi atë lagje e cila deri vonë njihej në dokumenta me emrin lagja e Iskurlijve (shqip Skurajve).

Që nga embrioni i saj i shek. 15, lagjia me kohë zmadhohet duke fituar fizionominë e plotë urbane. Xhamia e ndërtuar në qendër të lagjjes duhet të jetë ndërtuar nga bijtë ose nipat e tij që kishin funksione të rëndësishme qeveritare në Berat.

Evlija Çelebiu na jep një përshkrim me interes të kësaj lagjjeje[4] dhe veçanërisht të xhamisë që duhet marrë në konsideratë sepse sot nga ky kompleks urban kanë mbetur vetëm xhamia dhe gjurmët e një ujësjellësi.

Xhamia e plumbit, siç pohon tradita gojore, u ngrit në truallin e një manastiri të hershëm. Ajo ishte në Berat e para xhami e tipit të vogël monumental karakteristik për vendet e Ballkanit, me kupolë sferike dhe portik përpara hyrjes, ndryshe nga xhamitë e ndërtuara në Berat deri atëhere. Ajo hyn në një grup tipologjik me xhaminë e Mirahorit në Korçë, xhaminë e Muradies në Vlorë, të Gjin Aleksit në Delvinë, të Allajbegisë në Peshkopi etj. të gjitha në të njejtën periudhë (shek. XV-XVI)[5].

Volumin kryesor të xhamisë e zë salla e shërbesës (faltorja) me përmasa planimetrike 14 x 14 m dhe lartësi 15 m. Faltorja formohet prej muresh të gjerë

1) V. Buharaja, Mbishkrimet turko-arabe të vendit tonë si dëshmi historike, **Konferenca e II e studimeve albanologjike,** Tiranë, 1968, II, 81-85.
2) F. Babinger, **Moameto il conquistatore,** Milano, 1957; 401.
3) F. Babinger, **Vep. cit.** 78, 391.
4) E. Çelebi, Seyahatname, Istanbul, ... VII (Përkthim prej V. Samimit të cilin e falenderojmë për vënien në dispozicion të materialit.
5) Gj. Frashëri, S. Dashi, **Karakteristika arkitektonike të disa xhamive në vendin tonë,** Monumentet historike në vendin tonë, Tiranë, 1978, 41 — 45.
6) E. Çelebi, **Vep. cit.** po aty.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

guri. Në tri anët muret kanë të çelura nga pesë dritare. Më lart në qoshet janë formuar katër trompa sferike për mbështetjen e një tamburi tetëkëndësh dhe mbi tambur rëndon kupola e mbuluar me fletë plumbi (fig. 2). Kjo zgjidhje konstruktive krijon në brendi një hapsirë pa copzime, si kërkesë funksionale e zgjidhur drejt.

Ballin e xhamisë e prin hajati, dhe në të djathtë lartësohet minareja.

Në pamjen e jashtme xhamia ka një aspekt dekorativ të ndjeshëm, të realizuar nga vendosja e tullave të kuqe në dy reshta horizontale dhe nga kuadratet e bardha të gurëve që ndahen nga njeri-tjetri prej dy tullash vertikale të alternuara nga reshti në resht. Në të vërtetë ky kombinim piktoresk i përdorur edhe më parë në objekte të tjera kulti duket se përveç karakterit dekorativ ka për këtë ndërtesë edhe vlera teknologjike. Ai përcakton kompozimin e ndërtesës në çdo pamje të saj duke shërbyer si masë lartësimi për çdo kuotë dhe element arkitektonik të përdorur. Ai e ndjek këtë regullshmëri gjeometrike duke nisur nga niveli i tokës.

Xokolatura formohet vetëm prej guri duke qenë e patinuar. Në lartësinë 1 m kufizohet prej një reshti tulle i cili shënon njëkohësisht nivelin e dritareve të para (fig. 3). Këto dritare janë më të mëdha se të tjerat, kanë formë këndrejtë në bazë kurse sipër mbarojnë me hark. Deri në majën e harkut ka një numër të plotë reshta tullash. Mbi këtë nivel muratura ndërtohet e pandërprerë aq sa është lartësia e hapit duke patur reshtin pasardhës të tullave si kuotë fillimi për dritaret e dyta. Kjo teknikë përsëritet edhe për dritaren e fundit e cila është e vetme dhe e vendosur në aksin e simetrisë së fasadës.

Kemi vërejtur se në brendi niveli i bazës së dritares koincidon me fillimin e rakordimit të qosheve (trompave) kurse nga jashtë qoshet e murit janë në një nivel me fillimin e harkut të dritares. Qemeri i kësaj dritareje arrin lartësinë në nivelin ku formohet tamburi tetëkëndor dhe mbi tambur ngrihet kupola.

Kjo mënyrë që kemi shpjeguar gjen aplikim në tre fasada të xhamisë kurse nga fasada kryesore, trajtimi është i ndryshëm si pasojë e kërkesave funksionale.

Pamja kryesore, ka portën e hyrjes dhe vetëm dy dritare (të radhës së parë) për të cilat është kërkuar përkujdesje më e madhe dekorative. Faqja e murit është e suvatuar dhe ndërtuesit kanë kërkuar vlerat estetike, këtë herë jo nga kontrasti i tullave dhe gurit por nëpërmjet kornizave të profiluara në portën e dritaret dhe të rozetave të pikturuara në secilën sipërfaqe. Mbi portë është edhe sot vendi i vendosjes së pllakës së mbishkrimit (ekzistencën e tij do ta japin punimet pastruese të dekorit).

Është e kuptueshme që një trajtim i tillë i fasadës, presupozon ekzistencën e hajatit që në koncep-

DO NOT COPY



Fig.3 PAMJE ANSORE

Fig. 3

timin fillestar. Hajati i sotëm është i tipit të mbyllur dhe duket i ngjashëm teknikisht me ndërtimet e vona (shek. 19), megjithëse në planimetri ruan pjesërisht përmasat e vjetra. Lidhur me hajatin vjen në konsideratë edhe dëshmia e Çelebiut që e përshkruan atë të formuar nga një harkadë prej kollonash mermeri të bardha dhe të mbuluara me shtatë kube plumbi.

Mund të konkludohet se hajati që nga krijimi e këtej ka patur meremetime të rëndësishme, madje esenciale. Së pari, formën origjinale nuk mund ta riformulojmë sepse gjurmët janë shumë të pakta (vetëm shenjat e një çatie (fig. 4, 5). Portikun e përshkruar



Fig. 4



Fig. 5 PAMJE BALLORE (pas restaurimit) 0 1 2 3 M

Fig. 5



Fig. 6

nga Çelebiu do ta pranojmë si një rikonstruksion të parë dhe pas rënimit të tij kemi portikun ekzistues por edhe ky me ndryshime të pjesshme. (fig. 6).

Megjithatë ky rikompozim i fundit paraqet interes. I ndërtuar me mure guri, dritare me qemer të shtrirë, me kollona dhe harqe që mbajnë katër kupola, me një formim volumor të gjetur mirë, ai ballancon fal-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig.7 PREMJE GJATESORE



Fig.7 PLANIMETRIA

Fig. 7

DO NOT COPY



Fig. 8

toren duke krijuar së bashku me të një siluetë të bukur, ndërkohë, një shembull të veçantë në arkitekturën e xhamisë qytetare. Siluetën e xhamisë e plotëson minareja elegante e ndërtuar me të njëjtën teknikë si faltorja. Ky fakt dhe lidhja strukturore e muraturës pa fuga ndarje, tregojnë se minareja është origjinale, si dhe për kohën kur u ndërtua, një shembull i rrallë, i zgjidhur me sukses nga mjeshtrit shqiptarë.

Brendia e faltores siç kemi shprehur është racionale. Ka vetëm një hapsirë unike ku kanë qenë vendosur mafili dhe mimberi. Këto dy përbërës të brendisë nuk i kemi gjetur, por nëpërmjet gjurmëve të mbetura në muret mund të hedhim mendime mbi përmasat e tyre. Mafili ka qenë i drunjtë, ai mbështetej në tri muret dhe nga përpara mbahej mbi dy ose më shumë kollona. Për t'u ngjitur në mafil përdorej shkallarja e minares dhe një portë e çelur për këtë qëllim (fig. 7). Për mimberin të dhënat janë më të pakta. Dihet vetëm lartësia, gjerësia dhe gjatësia.

Mihrabi ruan konfiguracionin duke patur thellimin karakteristik dhe stalaktite në majë dhe një kornizë të profiluar anash tij.

Muratura në brendi ka qenë e suvatuar fillimisht me patinaturë gëlqereje e pluhur tulle me ngjyrë të kuqëremtë dhe të lëmuar. Të njejtën suva e gjejmë të përdorur edhe për formimin dekorativ të trompave anësore që të japin përshtypjen e guackave të detit dhe të stalaktiteve poshtë tyre. Suvatim të tillë ka patur edhe faqja ballore e xhamisë, për pjesën e zënë nga hajati, sepse në lartësinë e tamburit (nga jashtë) edhe për këtë faqe është ndjekur teknika e kombinuar e tullës dhe e gurit që e unifikon stilistikisht xhaminë në çdo pikë shikimi.

Sot nga suvatimi i hershëm ruhen pak sipërfaqe sepse në një kohë tjetër brendia është risuvatuar me gëlqere të bardhë përzjerë me lesh dhie duke patur edhe zbukurime pikturash dekorative me motive vegjetale anash mihrabit, në kupolë dhe në pamje nga hyrja.

Nuk mund të fiksojmë me ekzaktësi kohën e risuvatimit dhe të pikturës por data 1720 e shkruar mbi suvanë e hershme pranë hyrjes së minares na jep të drejtën të themi se meremetimi është kryer nga gjysma e dytë e shek. XVIII ose fillimi i shek. XIX. Dyshemeja është shtruar me tulla gjashtëkëndëshe prej argjile të pjekur mirë, në formën e hojeve të bletës. Në të njejtën mënyrë është shtruar edhe hajati.

Interesante kanë qenë dritaret të cilat nga jashtë kishin rjeta teli kurse nga brenda xhama shumëngjyrëshe, të kuqe, blu, jeshile, të bardha, të aplikuar në skelet gëlqereje me forma gjeometrike të ndryshme, siç rezultoi nga mbetjet e zbuluara gjatë studimit tonë dhe sondazheve.

Monumenti për moshën e tij të gjatë ka pësuar ndryshime, dëmtime e meremetime të ndryshme spontane. Përmendim rënimin dhe rikonstruimin e portikut, mbulimin me tjegulla të kupolave, dëmtime të minaresë (fig. 8), dëmtime në dysheme, ku janë zëvendësuar tullat gjashtëkëndëshe me rasa guri, prishje në kornizat, rënie suvatimesh si dhe dëmtime të tjera sidomos në kupolën qendrore e cila tregon çarje e plasaritje të rezikshme. Kjo gjendje e monumentit kushtëzon ndërhyrjen restauruese, konsoliduese.

Projekti i restaurimit i hartuar për këtë qëllim synonte t'i rikthente monumentit vlerat reale duke zëvendësuar ose plotësuar në masën e duhur elementet e humbur dhe në përfundim të bënte të përdorshëm monumentin me funksion muzeal, pa cënuar vlerat monumentale, konstruktive dhe arkitektonike. Gjithashtu do të kryheshin punime përreth objektit me

qëllim paraqitjeje sa më të kulturuar duke eliminuar disa ndërtesa pa vlera kulturore të bashkëngjitura atij. Punimet restauruese u kryen sipas një rradhe të caktuar. Së pari, u kryen punime çliruese, konsoliduese e restauruese jashtë ndërtesës. Së dyti, punimet përkatëse në brendi dhe të fundit punimet e ambjentit rrethues si dhe ato të pajisjes së brendisë me eksponate të ndryshme për kthimin e monumentit në muze të arkitekturës Beratase. Punimet më të rëndësishme ishin ato të kryera në vetë faltoren. Këto punime qenë çlirimi i dritareve nga mbushjet e vona që kishin zvogëluar hapësirën e dritës (Tab. I) duke i nxjerrë ato në dimensionin fillestar i cili ruhej plotësisht. Vendosja nga jashtë e rrjetave të telit dhe në brendi të xhamave me ngjyrë të aplikuar në skelet gipsi me formë kompozimi të krijuar sipas modeleve të gjetura në ndërtesa të tjera bashkëkohëse. U hoqën nga dritaret edhe kornizat prej druri të vendosura më vonë. Punime pati dhe në trajtimin e fasadave që konsistuan në suvatimin e blloqeve të gurëve me një përzjerje pluhur smërçi gëlqereje e cila afrohej mirë me suvanë origjinale. U pastruan tullat nga papastërtitë dhe monumenti fitoi edhe një herë pamjen e duhur. Ndërhyrje plotësuese u bënë në kornizat duke zevendësuar tullat e rëna dhe ato të dëmtuara. U vendosën disa pjesë kornizash guri në dritaret e reshtit të parë në vendet ku mungonin si dhe dritaret përkatëse me kapakë përbrenda sipas modelit të gjetur në vend.

Problem paraqiste konsolidimi i kupolës qendrore e cila siç kemi thënë ishte tepër e deformuar dhe plasaritur. U krye përforcimi i saj në themër me anë të një brezi unazor beton arme në vendin ku kishin qenë fillimisht brezat e drurit. Pas këtij procesi kupola u rimbulua me fletë plumbi.

Në portik u kryen suvatimet e mureve, u vendosën dyert dhe dritaret me gjithë kafaze dhe u mbuluan me plumb katër kupolat, mbulesë e cila kohët e vona qe realizuar me tjegulla. Heqja e tjegullave na zbuloi gjurmët e sakta se dikur kupolat mbuloheshin me fletë plumbi prandaj dhe u veprua në këtë mënyrë.

Në brendi u vlerësua si fazë e pranueshme suvatimi i hershëm prej pluhur tulle gëlqereje duke ruajtur të paprekura dekorimet në kornizën e kupolës dhe suvanë origjinale të trompave dhe në vendet ku ajo kish mbetur e pa cenuar. Minareja, maja e së cilës, qe restauruar më parë, u risuvatua gjithashtu si muratura me pluhur smërçi e gëlqereje mbi një shtresë llaçi çimentoje. Në aspektin urban monumenti fitoi pas eleminimit të disa ndërtesave të bashkëngjitura dhe largimit të dherave që deri atëhere arrinin lartësinë e dritareve të para. Me largimin e dherave u zbulua një varr që për dimensionet e tij na krijon përshtypjen se do të jetë i ndërtuesit të xhamisë.

Pas përfundimit të punimeve objekti do t'i nënshtrohet kompletimit muzeal. Eksponatet që do të vendosen brenda tij si foto dokumente, makete synojnë t'i japin vizitorëve një ide të plotë mbi vlerat kulturore që ruan Berati në sferën e ndërtimeve dhe të punës që bën Instituti i Monumenteve në drejtim të evidentimit, ruajtjes dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB I

PAMJE TE MONUMENTIT
(PARA RESTAURIMIT)











Sulejman DASHI

UNE ANCIENNE MOSQUEE A BERAT

RESUME

Dans la ville-musée de Berat sont conservés de nombreux exemplaires relevant de notre culture de construction traditionnelle. L'habitation populaire date la période allant du XVIIIe au XIXe siècles. Elle s'est développée sur les fondements de la solide tradition locale à travers un long processus dialectique.

De pair aux habitations caractéristiques à Berat sont conservés d'autres édifices de caractère monumental relevant d'époques historiques successives, entre autres des fortifications, des établissements de caractère social et culturel, des temples, etc., dont l'analyse nous permettra d'obtenir des données importantes sur l'art de la construction et sur les traditions qui sont les nôtres dans la sphère de la création populaire.

D'un intérêt particulier est la Mosquée e Plumbit qui se dresse au coeur de la ville. Elle fut construite dans les années 1553-54 par les Skuraj de Berat avec d'autres édifices à ses environs, qui constituèrent en ces années le noyau d'un quartier nouveau dénommé quartier des Skuraj (Iskurli). Celebi nous a laissé une description détaillée de ce quartier, mais de nos jours ne sont conservés de ce complexe urbain que la mosquée et les traces d'un aqueduc.

Selon la tradition orale, cette mosquée fut édifiée sur le terrain d'un ancien monastère. Ce fut pour Berat la première mosquée de type monumental de dimension réduite, caractéristique des pays balkaniques, dotée d'une coupole sphérique et d'un portique par devant l'entrée; toutefois, elle diffère des autres mosquées construites jusqu'alors en cette ville mais est de même type avec la mosquée de Mirahor à Korçe, avec la mosquée de Muradie à Vlore, de Gjin Aleks à Delvine, de Allajbegi à Peshkopi, toutes édifiées pendant la période de temps allant du XVe au XVIe siècles.

Le volume principal de cette mosquée est constitué par la salle des offices. Celle-ci a des murs de pierre épais. Sur les trois côtés des murs ont été pratiquées cinq fenêtres, tandis que du côté de l'entrée il n'y a que deux fenêtres. Aux angles de cette mosquée, au moyen de quatre trompes latérales, se dresse un tambour octaédrique supportant une coupole couverte de plaques de plomb.

La partie frontale de la mosquée est devancée par le hayat *et à droite se dresse le minaret.*

Cette mosquée a un aspect décoratif apparent, obtenu par la combinaison des briques en rangées horizontales et des pierres blanches entre elles; toutefois, cette technique ne poursuit pas seulement des buts esthétiques. Elle détermine la composition de l'édifice sous tous ses aspects en servant de module.

La régularité géométrique apparait clairement sur tous les plans.

L'actuel hayat *diffère sur le plan technique du temple, tandis que le minaret est d'une facture analogue.*

De nos études il ressort que le hayat *est une reconstruction plus récente (XVIIIe-XIXe s.), bien que sa conception présente intérêt. Par ses murs de pierre, ses colonnes et ses arcs supportant quatre coupoles, et se caractérisant par un espace volumétrique réussi, il contre-balance le temple et crée de la sorte une situation agréable, un exemplaire original dans l'architecture de la mosquée urbaine.*

L'intérieur de la mosquée est d'une conception rationnelle, le minber *et le* mafil *n'existent plus mais les traces découvertes nous indiquent leurs dimensions. Le* mafil *était de bois et la porte du minaret servait à y accéder. Le* minber, *lui aussi, était de bois.*

Le mihrat *conserve sa configuration, en créant la cavité prismatique caractéristique qui est fermée dans sa partie antérieure par des stalactites. Les parements des murs sont couverts d'une couche légère de patine, de coloration rougeâtre et consistant d'une mélange de chaux et de poudre de briques. On observe un crépissage analogue dans la coupole, dans les trompes latérales et le parement de l'entrée de la mosquée.*

Dans une deuxième phase la mosquée fut enduite de chaux mélangée à de la laine caprine. C'est à cette période que se rapportent les ornementations végétales de la coupole, de la partie latérale du mafil *et du parement de l'entrée.*

En raison de son ancienneté, cet édifice a subi maintes modifications, dégâts et réparations. Mentionnons de leur nombre l'écroulement du portique et sa reconstruction, la couverture avec des briques des coupoles endommagées du minaret, les parties abimées du plancher, la détérioration du crépissage, l'endommagement des corniches, etc. Il convient de relever aussi les fissures de la coupole centrale, qui ont nécessité sa consolidation de la part des restaurateurs.

La restauration tendait au but de redonner à ce monument son aspect initial, en le libérant des couches sans intérêt et en substituant ou remplaçant dans la mesure requise les éléments architectoniques qui manquaient, et cela pour en faire un musée de l'architecture moyennâgeuse à Berat.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ferid KOLA

RESTAURIMI I OBJEKTEVE PREJ DRURI NË BANESËN E PASHKO VASËS

Shtëpia e patriotit të shquar të rilindjes sonë kombëtare, Pashko Vasa, sot shtëpi muze e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për qytetin e Shkodrës, ndodhet në mes të lagjes që mban emrin e tij (fig. 1). Kjo shtëpi e tipit me çardak mban në vetvete një gërshetim harmonik të materialit dhe arkitekturës. Në banesat shkodrane të shek. XVIII-XIX dhe sidomos në banesën e Pashko Vasës vend të rëndësishëm zë trajtimi arkitektonik i fasadës, i ambienteve të brendshme si dhe ana konstruktive të cilat kanë marëdhënie harmonike ndërmjet tyre.

Materiali drusor në këto banesa zë vendin më të madh. Një nga ambientet më karakteristike në këtë banesë është çardaku. Ai është i trajtuar i gjithi në dru me përjashtim të ndarjeve të dhomave. Ai është i përbërë nga një radhë kolonash të daltuara të cilat përfundojnë në pjesën e sipërme me një jastëk të gdhendur që kryejnë funksion të dyfishtë: konstruktiv dhe dekorativ (fig. 2). Parmakët që vendosen në mes të kollonave krijojnë një ritëm transparent duke lidhur bukur dhe në mënyrë harmonike ambientin e jashtëm me atë të brendshëm. Në anë të çardakut, dy këmbë shkallë më lart dyshemesë ndodhet qoshku i tij, që zë një vend kryesor. Ai është konsideruar si vendi më i preferuar për kryetarin e familjes shkodrane, për ambientin e qetë plot ajër dhe dritë (fig. 2).

Në ambientin e dhomës së mirë vihet re tavani i tipit me kazan i cili ka pamje oktagonale me trekëndësha me daltim të cekët basoreliev (Fig. 3). Në këtë dhomë një vend të veçantë zë oxhaku në stukorelief me baldakin. Motivet e tija lidhen mjaft bukur me ato të drurit të sergjenit dhe elementeve të volumit trapazan-musandër (Fig. 4). Ambienti i dhomës së banimit tavanin e ka më të thjeshtë, pa kazan por me rozetë të cilën nuk e kish dhoma tjetër, me trekëndëshe të vendosur dy nga dy ortogonalisht; të njëjtë nga trajtimi dekorativ (Fig. 5). Ato kanë një daltim mjaft të bukur, dhe një kompozim origjinal. Në këtë dhomë kemi dhe trapazanin që bashkë me atë të dhomës së mirë ka diçka të përbashkët me motivin e parmakëve. Volumi trapazan-musandër i dhomës së mirë është punuar duke pasur parasysh lidhjen kompozicionale të dy açik-rafteve, kapaqeve të dyerve, arkës së nuses dhe dollapit musandër me daltime të thjeshta horizontale.



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 4



Fig. 3



Fig. 5

Në to janë harmonizuar motivet gjeometrike dhe floreale të gërshetuara në mes tyre. Në të dy anët e volumit trapazan-musandër dalin me vibrim të lehtë bordurat e sergjenit të cilat duket sikur vinë e lidhen me motivet e baldakinit të oxhakut. Në të dy anët e oxhakut ndodhen dy kamare duke ruajtur raportin me oxhakun dhe sipërfaqen e murit, pjesa e sipërme e së cilës ka të njëjtin motiv dhe trajtim që e shohim edhe tek sipërfaqet e dyerve, tek vendi i arkës së nuses dhe tek pjesët e harkuara të trapazanit.

Si kamaret ashtu edhe açik-raftet e plotësojnë bukur qenien e tyre jo vetëm në funksione dekorative por dhe funksionale. Në to vendoseshin gota bronxi, enë porcelani, qelqi, bakëri e të tjera. Motivet e gdhendura në açik-raftet ndryshojnë nga ato të banesave të tjera. Motivet trajtohen thjesht me gjethe në buzët, që rrethojnë hapësirën. Këtu gjendet dhe sergjeni i vendosur në të katër faqet e murit që shërbente për vendosjen e enëve të mëdha të bakërit etj.

Dhoma e fjetjes, megjithëse nuk ka musandër nuk e ndien mungesën e saj pasi dritaret dhe dollapi i murit e plotësojnë atë. Dollapi është një shembull i qartë i dorës prej mjeshtri dhe i bukurisë së



Fig. 6



Fig. 7

elementeve gjeometrike dhe florealë, rombi, trekëndëshe, lule dielli dhe gjethe urthi (fig. 6).

Bordura e sergjenit në këtë dhomë është trajtuar me delikatesë dhe intimitet. Ndryshe nga dy dhomat e tjera, e treta që ka shërbyer si dhomë zjarri, ndonëse nuk përmban elemente të daltuara, nga trajtimi arkitektonik me tymarin e thelluar në formë gjysmë harku në mur e që përfundon lart me majë, dhe që ka diçka origjinale.

Druri i pishës ka gjetur një përdorim të madh në banesën karakteristike shkodrane. Mjeshtri i kohës këtë lloj druri e ka përdorur mjaft. Të gjithë pjesën e ornamentikës ai e ka punuar thjesht me vegla dore. Banaku i tij, për aq sa na sygjeron mjeshtria dhe trajtimi i dekoreve, dukat se ka pasur sharrë dore, tryel, rolin e të cilës shpesh e ka lojtur hekuri i skuqur, sqepar, lloje të ndryshme të zdruktheve, me thika të ndryshme për fashaturat e dyerve dhe të doliapeve, për sheshet e tavanit etj. Daltat harkore, kordore rrallë herë janë përdorur me rrafje. Thikat e dorës me forma të ndryshme janë përdorur kryesisht në dekoret e sergjeneve, dollapeve etj. Këto thika kanë shërbyer si mjeti kryesor me të cilat, me anën e forcës së dorës janë kryer shumica e gdhendjeve.

Restaurimi i këtij objekti kërkonte një vëmendje të madhe për vetë gjendjen e tij mjaft të dëmtuar, si dhe për llojet e ndryshme të punimeve në to. Një pjesë e ornamentikës së tij mungonte, ndërsa pjesa tjetër ekziston, por dhe ajo e dëmtuar. Para se të vihej dorë në të u krijuan të gjitha dokumentet përkatëse, fotografitë dhe skicat e ndryshme, si dhe një sërë sondazhesh.

Disa pjesë që mungonin u plotësuan duke patur për bazë ekzistuesat, p.sh. në harqet e dyerve të cilat pasi u analizuan dhe u studiuan më parë për nga teknika dhe ornamentika e punimit u përpoqëm t'i rrimë sa më besnik origjinalit. Për objektet e daltuara, si syprina dyersh, kapakë dollapi, bordura sergjeni u kërkua dru pishe pa rrëshirë, i staxhionuar duke patur parasysh origjinalin. Njëri nga trekëndëshat e tavanit të dhomave është mjaft i dekompozuar. Druri në njërën anë ishte i kalbur dhe kish arritur një strukturë sfungjeroze. Duke patur gjithmonë si kriter mbajtjen e sa më shumë elementeve të origjinalit, në këtë rast u krye petrifikimi.

Druri pasi u tha dhe u injektua mirë u njom me një përzierie butil acetik dhe kaoline (në gjendje të ngurtë). Pasi u thërmua mirë dhe u fut në një enë me butilacetatum në raport 4 B. acetat, 1 kaolinë e thërmuar, u përzie duke siguruar një masë në formë vaji. Me këtë u lye pjesa e drurit të dekompozuar duke i dhënë mundësi të futet deri në poret më të vogla të tij. Ky proces u krye disa herë, mbas disa intervale kohe 1-2 orë, duke e shtuar dozën e kaolinës së thërmuar, deri sa druri u ngop mirë. Për mbylljen e vrimës së madhe që e përshkonte gadi krejt dërrasën e daltuar nga prapa, kësaj përzierjeje iu hodh allçi. Me këtë masë të trashë që u krijua me këtë përzierje,

DO NOT COPY

me anë të një spatule u mbush vrima duke i dhënë formën e dërrasë nga prapa. Mbasi u tha mirë, pas disa ditësh, pjesët e petrifikuara u lyen me bojë të zezë duke krijuar një ton të përafërt me të.

Pjesët e gjetura të dekorit, si të voglat ashtu dhe të mëdhatë u lanë mirë me sodë kaustike, u kontrolluan nga brejtësit e ndryshëm, u pastruan, u thanë, dhe vende-vende u plotësuan me pjesëza të reja që u ngjitën me vinovil. Të gjitha pjesët e reja, pas punimit u lyen me bronin kafe, duke krijuar një ton të përafërt me pjesët e origjinalit.

Mbas këtij procesi filluam lyerjen me vaj lini të të gjitha pjesëve të reja dhe pjesëve të vjetra të elementeve drusorë të banesës si të brendshme ashtu dhe të çardakut.

Kësaj pune iu kushtua një rëndësi e madhe pasi e gjithë vlera e saj origjinale duhej të kthehej përsëri në jetë duke ruajtur vërtetësinë e gdhendjes, por duke mbajtur njëkohësisht edhe vulën e ndërhyrjes restauruese.

Me përfundimin e punimeve restauruese monumenti mori një pamje më estetike si nga jashtë ashtu edhe nga brenda.

Problem tjetër që edhe ambienti i jashtëm i këtij monumenti. Elementet e gurta si pusi, govata, dhe rrasa e gurtë dhe havanet u vendosën në oborrin e banesës tashmë në aspekt dekorativ (Fig. 7). Ato rrinë mjaft bukur në vendin e tyre si rrelike të banesës, duke ruajtur kështu karakterin e vet banesës shkodrane të asaj kohe.

DO NOT COPY

Ferid KOLA

DO NOT COPY

RESTAURATION DES OBJETS DE BOIS SE TROUVANT DANS LA MAISON DE PASHKO VASA

RESUME

La maison de l'illustre patriote de notre Renaissance nationale P. Vasa, aujourd'hui maison-musée de la filiale de la Ligue de Prizren pour la ville de Shkodër, se situe dans le coeur du quartier de même nom.

Dans les habitations shkodrane des XVII.e-XIXe siècles et en particulier dans celle de P. Vasa, une place de relief revient au traitement architectonique de la façade, aux pièces intérieures ainsi qu'à l'aspect de la construction, qui entretiennent entre eux des rapports harmonieux.

La décoration occupe dans ces habitations la place principale. Une de leurs pièces plus caractéristiques est le tchardak *ouvert, travaillé entièrement en bois, exception faite des parois séparant les chambres. Il est constitué par une rangée de colonnes ciselées, dont le fût est couronné par des caussins sculptés exerçant une double fonction: de construction et de décoration. La balustrade à jour disposée entre les colonnes relie bien et de façon harmonieuse le milieu extérieur à celui intérieur.*

Du côté du tchardak, *à quelques degrés d'escalier arqué au-dessus du niveau du plancher, se trouve le* qoshk *qui occupe une place importante dans le champ de vision du côté de la cour.*

Une autre caractéristique de ces habitations concerne la classification de leurs chambres, en chambres destinées aux amis et en chambres destinées à l'habitation. Cette classification s'exprime aussi dans le traitement décoratif que les maîtres batisseurs consacrent à ces pièces. Dans la chambre des amis, le plafond de type à chaudière crée un aspect octagonal avec des bas-reliefs. Une place importante y est réservée au foyer qui a des décorations de forme cylindrique en stuc. Ses motifs s'harmonisent à la percetion avec les motifs ciselés sur bois du dressoir et les éléments du volume trapazan-placard. Par contre la chambre destinée à l'habitation a un plafond plus simple, elle n'est pas du type à chaudière mais avec des rosettes, élément qui manque dans la pièce précédente. Les triangles disposés en couple se distinguent par un traitement décoratif finement ciselé. Ce plafond constitue en soi une composition originale. Dans ces pièces, comme dans la chambre des amis, le trapazan *a quelque chose en commun avec les motifs des rampes. Le volume* trapazan-placard *de la chambre des amis est finement orné de bas-reliefs, en tenant compte de la liaison de composition existant entre les étagères ouvertes, les arcs des portes, la malle de la mariée et l'armoire-placard.*

Les niches, tout comme les étagères ouvertes justifient leur présence en tant qu'objets de caractère décoratif et fonctionnel. En effet ici sont dressés et luisent des verres de bronze, des plats de porcelaine, de verre, de cuivre, etc. Les motifs agrémentant les dressoirs diffèrent d'une habitation à l'autre. Dans notre cas ils sont traités simplement par des feuilles à la bordure cernant l'espace. En plus il y a des dressoirs sur les quatre murs de la chambre. Ils constituent en soi un élément caractéristique servant à l'exposition des grands récipients de cuivre.

La chambre destinée à l'habitation, malgré l'absence du placard, n'en éprouve pas les effets du fait de la présence des fenêtres et de l'armoire à mur. Cet armoire est un exemple illustrant le talent de son auteur, et cela par la beauté des éléments géométriques et floraux (rhombes, triangles, fleurs de tournesol et feuilles de lierre) qu'il a su finement ciseler.

La bordure de l'étagère, dans cette chambre, est traitée avec grande délicatesse et beaucoup d'intimité. A la différence des deux autres chambres, la troisième, qui a servi comme chambre du feu, bien que ne comportant pas des éléments ciselés, se caractérise par un traitement architectonique quelque peu original. La cheminée, percée dans le mur en demi-arc et se terminant en haut en forme de cône, est un élément caractéristique de la maison shkodrane du XVIIIe siècle.

Les maîtres de l'époque ont oeuvré avec talent le bois de pin, en ne se servant à cette fin que de simples outils, entre autres la scie de menuisier, l'erminette, différents types de rabots avec des lames diverses pour travailler les corniches des portes et des armoires, ainsi que les plafonds; quant au vilebrequin, ils l'ont remplacé par une tige de fer rougie. Ils se sont servis rarement de ciseaux pour le battage des métaux. Les

couteaux de menuisier furent employés exclusivement pour la décoration des étagères, des armoires, etc., et, en général, pour ciseler les éléments de bois de la maison shkodrane. Certes, la véritable école où se sont formés les menuisiers d'art furent leurs ateliers et l'expérience qu'ils ont acquise pour faire face aux exigences élevées de l'époque. Une attention toute particulière fut consacrée à la restauration de la maison de cet illustre patriote, et cela en raison de l'état lamentable dans lequel elle se trouvait et des différents types d'intervention qu'il y fallait effectuer. Une part de l'ornementation des éléments de bois manquaient et celle existante était durement détériorée. Avant d'entamer les travaux, on procéda à la préparation de la documentation requise: photographies, croquis, sondages, etc. Le plan de travail fut élaboré à la suite de l'analyse scientifique de la situation de fait. Certains éléments qui manquaient furent remplacés en nous fondant sur ceux existants; exemple les arcs des portes, les corniches des armoires, etc. Quant autres éléments faisont défaut, après avoir procéder à leur analyse et les avoir étudiés sur le plan technique et de l'ornementation, ils furen consolidés pour en conserver l'originalité. Quant aux objets ciselés qui étaient absents, entre autres des panneaux de porte, des couvercles d'armoire, des bordures d'étagère, etc. ils furent reconstruits avec du bois de pins sans résine et étuvé, d'une qualité le plus proche possible de l'original. Un des triangles du plafond des chambres se trouvait en état de décomposition. Son bois pourri avait une structure spongieuse. En suivant le critère de conserver le plus grand nombre possible d'éléments originaux, dans ce cas nous avons procédé à sa pétrification de la manière suivante:

Après le séchage du bois, il lui fut injecté une solution de butyle-acétate et de kaolin (solide). A cette fin le kaolin fu broyé finement, puis versé dans un récipient contenant du butyle-acétate dans un raport de 1 : 4. C'est avec cette masse huileuse que furent enduites les parties du bois en décomposition, de manière à obtenir une imprégnation complète. Cette opération fut répétée à plusieurs reprises, avec des intervalles de temps d'une à deux heures, en y augmentant la dose de kaolin broyé jusqu'à la saturation du bois traité. Puis pour boucher la cavité traversant presque toute la partie postérieure du bois ciselé, à cette solution fut ajouté du plâtre. C'est avec cette masse épaisse et en se servant d'un spatule que fut remplie la cavité se trouvant dans la partie postérieure. Au bout de quelques jours, les parties pétrifiées furent peintes en créant de la sorte un ton semblable à la couleur du bois.

Tous les éléments de cette habitation, même les plus insignifiants, furent nettoyés avec de la soude caustique. Les différents rongeurs furent éliminés. Par endroits, des petits détails de bois furent substitués et collés avec du chlorure de polyvinyle.

Enfin, toutes les pièces préparées à nouveau avec du bois de pin sans résine furent enduites avec bronin de coloration brune, afin de créer un ton proche à celui de l'original.

Une fois ce processus terminé, toutes les pièces nouvelles et anciennes des éléments de bois de l'intérieur et du tchardak furent enduites avec de l'huile de lin.

Une grande importance fut consacrée à ces travaux, et cela pour redonner à cette habitation sa valeur originale, mais à condition de conserver et de ne pas affecter l'originalité des éléments ciselés, tant sur le plan architectonique que décoratif, et de mettre en vue, dans le même temps, le sceau de la restauration effectuée.

Ainsi, l'extérieur comme l'intérieur de ce monument ont acquis un aspect plus jovial et plus sain.

Un autre problème d'importance était celui de l'environnement de cette habitation. Les éléments de pierre, entre autres le puits, le cuvier, les plaques de pierre, les grands mortiers, furent remis à leur place dans la cour désormais à des fins purement décoratifs, mais aussi pour conserver le caractère propre à l'habitation shkodrane.

L'Institut des monuments de culture et son atelier de Shkodër sont appelés à effectuer un travail considérable en ce sens, car la ville de Shkodër abonde en monuments de ce genre. Par leurs efforts, ils seront en mesure de rétablir les valeurs spirituelles, et matérielles que notre peuple à crée avec passion et sincérité. Ce sera là un trésor d'une valeur inestimable pour les générations futures, pour leur éducation patriotique et idéologique dans l'esprit de nos traditions nationales.

DO NOT COPY

Emin RIZA

ANSAMBLET NDËRTIMORE TË PAZAREVE DHE RESTAURIMI I TYRE

DO NOT COPY

Ansamblet ndërtimore të pazareve, zënë një vend të rëndësishëm në jetën e qytetit shqiptar gjatë shekujve XVI deri në fillim të shekullit XX. Kjo periudhë lidhet me sundimin e formës feudale të ekonomisë në qytetet tona, deri aty rreth mesit të shekullit XIX, kohë rreth së cilës fillojnë të lindin e zhvillohen marëdhëniet kapitaliste. Forma e ekonomisë feudale u shpreh me sistemin e esnafëve, i cili ndeshet në kushtet e reja të sundimit osman në fazën embrionale, aty nga gjysma e dytë e shek. XVI, në qytetin e Elbasanit. Më vonë nga shek. XVII, ky sistem bëhet forma mbizotëruese në jetën shoqërore-ekonomike të zejtarëve dhe tregtarëve të vendit tonë[1]. Ritmi i ulët i zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste, bëri që kjo formë e re e marrëdhënieve ekonomike të mos pasqyrorej ndjeshëm në karakterin urbanistiko-arkitektonik të ansambleve të pazareve, të cilët ruajnë karakterin e tyre mesjetar dhe për disa dekada të shek. XX.

Materiali bazë, mbi të cilin mbështetet artikulli, janë pjesët e ansambleve të pazareve, që të vënë në mbrojtje shtetërore ruhen ende sot, të dhënat përshkrimore, grafike dhe fotografike, si dhe njoftimet e udhëtarëve dhe studijuesve të ndryshëm, që tërthorazi kanë dhënë njoftime mbi këto njësi ndërtimore. Veçanërisht të vlefshme janë të dhënat e udhëtarit turk Evlija Çelebiu[2], për shek. XVII, natyrisht të marra me rezervat e duhura, veçanërisht përsa i përket shifrave.

Pazari, si qendra ekonomike e qytetit, në të cilaurën, ku kryhej prodhimi dhe shitja e mallit, përbën një nga njësitë kryesore të këtyre qendrave të banuara. Është pikërisht kjo pjesë e qendrës së banuar, që duke përfshirë në gjirin e saj shtresën e zejtarit-tregtar dhe më vonë dhe të shtresave të tjera, përcakton karakterin e vendbanimit. Shtresat e popullsisë që merreshin me prodhimin dhe shitjen e mallrave, përbënin përherë e më tepër një forcë të rëndësishme, jo vetëm ekonomike por dhe politike në jetën e qytetit të kohës, i cili shkallë-shkallë theksonte karakterin e qendrës së banuar si qendër prodhimi e shkëmbimi, duke përfshirë përherë e më shumë banorët, në sferën prodhuese të mallrave.

Pushtimi osman në shek. XV, pruri shkatërrimin e sistemit të koorporatave, së bashku me atë të qyteteve shqiptare, që kishin arritur në një shkallë të rëndësishme zhvillimi për kohën. Në ato pak qendra ku ky sistem duket se vazhdoi, ai u shkri, me sistemin korporativ turko-arab, të njohur me emrin esnaf, i cili rilind në vendin tonë një shekull më vonë[3]. Shekulli XVI, lidhet me një rigjallërim të përgjithshëm të qendrave qytetare, të cilat ripërtërihen me banorë të rinj të ardhur nga fshatrat. Rilindja e pazareve në kushtet e reja të pushtimit osman i përket pikërisht fillimit të këtij shekulli. Shekulli XVII, shënon një rritje të ndjeshme të qytetit si qendër prodhimi dhe shkëmbimi. Shekulli i XVIII është periudha e lulëzimit të ekono-

1) Zija Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** Tiranë, 1973, 10.
2) Evlia Çelebi, **Shqipnia para dy shekujsh** (Përkthim shqip), Tiranë 1930.
3) Z. Shkodra, **Vep. cit.** 9.

misë feudale, që shprehej në sistemin e esnafëve. Ansamblet e pazareve rriten mjaft, veçanërisht në disa qytete, që po viheshin në rolin e tregjeve me karakter ndërkrahinor. Gjatë shekullit XIX, vërehet rritja e mëtejshme e qytetit shqiptar, dhe rënia e sistemit mesjetar të esnafëve, për t'i hapur rrugë, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, lindjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste. Pikërisht në këtë periudhë fillon procesi i formimit të tregut kombëtar. Në veprimtarinë ndërtimore mënyra e re e prodhimit fillon të pasqyrohet me ndërtimin e një sërë punishteve shpesh larg pazareve, si dhe me një proces rindërtimi të këtyre të fundit. Zakonisht nxitje për këto rindërtime qenë rrethana të tilla si zjarre, apo tërmete, veçanërisht në qendrat më të zhvilluara të kohës.

Pazaret e qyteteve tanë, gjatë periudhës në shqyrtim, kanë një ecuri në planin tipologjik, veçanërisht përsa i përket trajtimit të pjesës ballore. Të dhënat e pakta që disponohen tregojnë se deri aty rreth mesit të shek. XIX, pazaret kanë pasur një unitet të dalluar urbanistiko-arkitektonik, ndërsa gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, e më tej, vërehen ndryshime të rëndësishme në planin urbanistik dhe në mënyrë më të ndjeshme në atë arkitektonik.

Zhvillimi i qyteteve tanë, në periudhën e sundimit të marëdhënieve ekonomike feudale dhe më vonë me fillimin e marëdhënieve kapitaliste, është i lidhur ngushtë me zhvillimin e qendrës ekonomike të qytetit, pazarit. Çdo qytet, në të kaluarën, kishte qendrën e tij zejtaro-tregtare, gjithmonë një e vetme. Të përmendur, veçanërisht gjatë shekujve XVIII-XIX, kanë qenë pazaret e Shkodrës, Beratit, Korçës, Elbasanit, Gjirokastrës, Krujës, Tiranës, Kavajës etj. Zhvillimi i këtyre pazareve është në lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik të qytetit shqiptar të kohës, me rimëkëmbjen e tij në shekullin XVI, konsolidimin në shekullin XVII, lulëzimin e tij në shekullin XVIII dhe zhvillimin e mëtejshëm gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX, gjithnjë brenda kuadrit të ekonomisë feudale. Zhvillimi i pazareve, përgjithësisht është një proces i gjatë, gjatë të cilit ata shtohen e zgjerohen me blloqe e ndërtime të reja, zakonisht në të njëjtën zonë dhe rrallë duke u rindërtuar në troje të reja. Degradimi nga koha, zjarret e shpeshtë, që shkaktonin dëme të mëdha për shkak të kompaktësisë së ndërtimeve dhe përdorimit të gjerë të drurit, dhe nga gjysma e dytë e shekullit XIX prirja për rindërtime në frymën e kohës, qenë shkaqet kryesore të ndryshimit të pamjeve të këtyre ansambleve.

Pazaret përfshinin ndërtime me funksione të ndryshme, brenda një kompleksi pak a shumë të njëjtë. Përbërësit kryesor të pazarit, në të kaluarën ishin çarshia, e cila ishte pjesa kryesore që përfshinte tërësinë e dyqaneve-punishte dhe atyre të tregtarëve. Një vend me rëndësi, zinte dhe pazari i hapur, një shesh i caktuar, shpesh i ndarë në zona për shitjen e produkteve të ndryshme bujqësore e blegtorale, si dhe të bagëtive dhe kafshëve të ngarkesës. Veçanërisht e gjallë ishte kjo pjesë e pazarit në ditë të caktuara të javës, jo të njëllojta për qendra të ndryshme, gjatë të cilave fshatarët vinin për të shitur prodhimet e tyre dhe njëkohësisht për të blerë prodhimet artizanale të qytetit. Një vend me rëndësi në pazaret, zinin hanet, jo të rrallë ishin bezistenet (pazaret e mbyllura), ndërsa duke filluar nga shekulli XVII fillojnë të ndërtohen kullat e sahatit[4], së pari me këmbanë, dhe pastaj me fushë. Veçanërisht gjatë shekujve XVIII-XIX, kjo veprimtari dendësohet në mbarë qytetet tona.

Ansamblet e pazareve, në të gjithë qytetet, formojnë njësi më vete, qartësisht të dalluara nga qendra e banuar. Pazaret, që me lindjen e tyre, në qytetet e fortifikuar ndërtohen jashtë mureve rrethuese. Zgjerimi i qytetit të hapur nuk e prek qendrën zejtaro-tregtare, e cila gjendet e vendosur në zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të hapur, në raporte të ndryshme me qendrën e banuar. Përgjithësisht, pazari ngrihet në pjesën qendrore të qytetit si në Berat, Elbasan, Gjirokastër, Krujë, Tiranë, Kavajë etj. ndërsa më rrallë ai i largohet qendrës, duke qenë disi i mënjanuar si në Shkodër dhe Korçë.

Nga ana urbanistike, pazaret formonin zakonisht vargje të gjata, në të cilët dyqanet të vendosur përngjitur dhe karshi njeri-tjetrit, linin në mes rrugën, ku lëviznin blerësit. Zhvillimi urbanistik në përgjithësi nuk i nënshtrohej planifikimit. Rritja e pazarit bëhej shkallë-shkallë, duke shtuar dyqane dhe ndërtime të reja, kështu formoheshin blloqe të rinj dhe zgjeroheshin ata ekzistuesit. Një karakteristikë e rëndësishme e këtyre pazareve ishte se në ta pjesa më e madhe e zejtarëve ishin rreshtuar sipas zejeve, duke qenë kjo një traditë shumë e vjetër, e trashëguar ndofta nga periudha bizantine[5].

I pari pazar i rindërtuar sipas një plani, është ai i Korçës, pas zjarrit shkatërrues të vitit 1879, ndërsa pazaret e tjerë deri vonë vazhduan të ripërtrihen duke ruajtur skemat e vjetra urbanistike.

Në pazaret ngritur mbi troje të rrafshët, dyqanet në formë vargu, kishin dy muret anësore të përbashkë-

4) Z. Shkodra, **Vep. cit.** 45.
S. Dashi, **Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë,** «Monumentet», 12/1976.
5) Z. Shkodra, **vep. cit.** 67.

DOKTORATURA

ta, dhe në përgjithësi ishin të një lartësie. Ndërsa në terrenet e pjerrëta, ata zhvilloheshin në vargje të shkallëzuara, duke formuar blloqe prej disa dyqanesh. Rruga ndërmjet dy blloqeve, përkundrejt njeri tjetrit përbënte një element të rëndësishëm të pazarit. Ajo e shtruar gjithmonë me kalldrëm në pazaret e lashtë, kishte në mes një kunetë për kullimin e ujërave, mbi të cilën arrinin strehët e gjera të dyqaneve, siç ruhen në pazarin e Krujës (fig. 1). Më vonë, siç e shohim në pazarin e Gjirokastrës dhe Korçës, rruga zgjerohet dhe pajiset me trotuare (fig. 2) duke pasur një ngritje në qendër, e cila krijon dy kunetat anësore përbri trotuarëve. Ky zhvillim është i lidhur me vetë zhvillimin e ballit të dyqanit, siç do të shohim më tej.

Dyqanet përgjithësisht ishin pronë e institucioneve fetare, gjithashtu dhe feudalët e mëdhenj si dhe funksionarët e lartë zotëronin një pjesë të mirë të dyqaneve, duke i gjetur këto investime me leverdi. Një pjesë e vogël e dyqaneve i përkiste zejtarëve apo tregtarëve.[6]

Njësia kompozicionale bazë, formuese e ansambleve të pazareve është dyqani. Tërësia e një numri dyqanesh të një zeje, vendosur përngjitur njeri-tjetrit anash një rruge qendrore, formonte rruginën e një zeje të caktuar. Në elementet e tij themelore kompozicionale dhe në trajtimin arkitektonik të tyre, dyqanet deri aty rreth mesit të shekullit XIX, kanë një unitet të dalluar. Më vonë me fillimin e lindjes së marëdhënieve kapitaliste dhe gjallërimin përherë më të madh të tregut, vërehet një prirje divergjente në trajtimin e dyqaneve, ndërsa kompozimi, pasi merr disa tipare të reja, mbetet një element i qëndrueshëm njësie.

Karakteristika thelbësore funksionale e dyqanit është se ai është dyqan-punishte, pra në të prodhohet dhe njëkohësisht shitet prodhimi zejtar. Mjeshtri zejtar prodhon dhe shet mallin.

Nga ana funksionale, brenda njësisë së dyqanit, dallohen tre përbërës: vendi i punës, pjesa e ekspozimit të mallit dhe pjesa e depozitimit të lëndëve të para, apo prodhimeve të gatshme. Të dy njësitë e para për një kohë të gjatë kanë qenë shkrirë në një volum të vetëm. Në dyqanet e thjeshtë dhe njësia e tretë qëndronte bashkë, por më shpesh ajo përbënte një volum më vete. Në kompozimin e dyqaneve ndikonte dhe lloji i zejes që ushtrohej në të. Kështu ndërsa dyqanet e rrobaqepësve, qeleshepunuesve, opingarëve etj, kishin trajtim të njejtë, ato të kovaçëve, bakërpunuesve etj, kishin disa veçanti që lidheshin me



Fig. 1

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

natyrën e punës që kryhej. Në përgjithësi deri nga mesi i shekullit XIX, dyqanet kanë qenë njëkatëshe, të ngritura nga niveli i rrugës rreth 50 cm, por mjaft më herët në vendin tonë janë ndërtuar dhe dyqanet dykatëshe[7] si në pazarin e Gjirokastrës. Nga gjysma e dytë e shekullit XIX, dyqani dykatësh bëhet një ndërtim i zakonshëm, madje ndërtohen dhe të tillë trekatësh. Pjesa më interesante nga ana e trajtimit arkitektonik të dyqaneve është padyshim balli i tyre. Ai njëkohësisht përbën dhe pjesën që ka pësuar një zhvillim të dalluar në kohë. Balli i dyqanit, për një kohë të gjatë, madje në pazarin e Krujës deri vonë, luante një rol të rëndësishëm funksional, si pjesa ku bëhej ekspozimi i mallit, dhe në shumë raste qëndronte mjeshtri zejtar. Vetëkuptohet se ai për të kryer këtë funksion, ishte i hapur, kurse sigurimi i dyqanit, dmth mbyllja e ballit, së pari realizohej me një sistem portativ i cili quhej me taraba (fig. 3). Balli i dyqanit kishte fikse vetëm derën e hyrjes njëflegërshe në njerën anë të ballit. Pjesa tjetër, sigurohej nëpërmjet vendosjes njëra pas tjetrës, të disa dërrasave, tarabave, të cilat të guiduara në dy trarë me kanal, gjatësor, në qendër të seksionit, siguronin mbylljen e dyqanit. Pasi hiqeshin kur hapej dyqani, ato vendoseshin ose mbi zgjatimin e trarëve të tavanit, që dilnin për të siguruar strehën e gjerë, ose vendoseshin mbi sofanë. Sofaja përbën një element të rëndësishëm në dyqanet me ballë të hapur. Ajo ndërtohet prej guri, kur dyshemeja e dyqanit është përdhese, ndërsa, kur ajo është prej dërrasash, nga trarët e dyshemesë dalin disa bishta në formë konsoli (fig. 1). Sofatet prej dërrase të dyqaneve përmenden që në shekullin e XVII[8]. Tarabat vazhduan të qëndrojnë në disa pazare, si ai i Krujës, deri vonë në shekullin tonë. Pasiguria që binte sistemi me taraba, kushtëzoi shkallë-shkallë zëvendësimin e tyre me një sistem më të përparuar, atë me qepena. Qepenat (fig. 1) janë panele druri, të cilat me anë të menteshave, lëvizin karshi një boshti horizontal. Tipet më të lashtë të mbylljes me këtë sistem, formohen nga dy qepenët e sipërm dhe një i poshtëm me gjerësi sa të dy të sipërmit. Qepenet e sipërme janë mjaft të gjerë, ndërsa i poshtmi, e ka gjerësinë sa dalja e sofasë, mbi të cilin ai mbështetet në pozicion horizontal, kur hapet dyqani. Qepenet e sipërme ngrihen dhe ato në pozicion horizontal, duke u siguruar në këtë pozicion me anë të disa ganxhave metalike të mbërthyera në konstruksionin e strehëve. Në disa raste, për të lehtësuar hapjen dhe mbylljen, qepenat e sipërme (fig. 4) bëhen dyfish në gjerësi, duke u palosur njeri mbi tjetrin dhe

6) Z. Shkodra, **vep. cit.** 72.
7) E. Çelebi, **vep. cit.** 35, 36.
8) E. Çelebi, **Vep. cit.** 66.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

duke u siguruar në pozicionin horizontal gjithashtu me çengela. Një element me rëndësi funksionale dhe arkitektonike në dyqanet që sigurohen në ballët e tyre me taraba dhe qepena druri janë strehët e gjera dyfishe. Ato janë të zhveshura dhe zgjaten përtej ballit deri në 1,6 m, duke siguruar kështu thuajse mbulimin e plotë të rrugës, ndërmjet dy vargjeve të dyqaneve, ku blerësit lëvizin të pashqetësuar nga shiu apo dielli i fortë. Përveç këtij funksioni streha shërbente dhe për ekspozimin e mallit, i cili i varur në elementet e drunjta të saj krijonte mundësi për të vrojtuar e zgjedhur me kujdes. Pra, funksionalisht dyqani përfshinte dhe pjesën e hapësirës së rrugës nën strehë. Aty nga çereku i tretë i shekullit të XIX, së pari në qendrat më të zhvilluara, ballët e dyqaneve fillojnë të sigurohen me qepena dhe rrulo metalike. Qepenët metalikë (fig. 5) të formuara nga pano të gjata, të lidhura në formë fizarmonike, rrotulloheshin duke u palosur rreth aksesh vertikale, gjatë hapjes dhe mbylljes së dyqanit. Ndërsa rrulotë metalike (fig. 2) mbështilleshin rreth një aksi horizontal në pjesën e sipërme të dyqanit. Futja e kësaj mënyre të re sigurimi, pruri zhdukjen e strehëve karakteristike dhe në përgjithësi lidhet me pazaret që po rindërtoheshin për arsye të ndryshme, në kushtet e fuqizimit të shtresave zejtaro-tregtare. Lindja e formave të reja për trajtimin e ballit dhe lidhur me të, për sigurimin e dyqanit, nuk donte të thoshte se tipi apo tipat e vjetër, nuk ndërtoheshin më. Ashtu si në shumicën e kategorive të ndryshme arkitektonike dhe në këtë rast format më të vjetra bashkëjetojnë deri vonë me të rejat, madje këto të fundit thuajse nuk zënë vend fare në disa pazare, si p.sh. në pazarin e Krujës. Kjo shpjegohet me shkallët e ndryshme të zhvillimit ekonomik të qendrave qytetare, si dhe me diferencimin brenda shtresave të ndryshme zejtaro-tregtare.

Muratura e dyqaneve ndërtohej zakonisht me gurë. Ndarjet me parete dërrasash si dhe ballët prej elementesh druri, kishin një përhapje shumë të gjerë, ndërsa konstruksioni i çative ishte krejt prej druri.

Në pazaret e gjysmës së dytë të shekullit të XIX, lënda e drurit po largohej përherë e më tepër duke u zevendësuar me pjesë metalike dhe në disa raste me përdorimin e qemereve. Në përgjithësi vërehet një prirje e theksuar drejt përdorimit të materialeve më solide dhe të padjegshëm. Rreziku i zjarreve, ka përherë një problem të përhershëm për komplekset e pazareve. Kompaktësia e madhe e ndërtimeve, përdorimi i gjerë i drurit, numri i madh i njerëzve si dhe shërbimi i pamjaftueshëm dhe shpesh krejt i mangët i zjarrfiksave, në rrjedhje të kohëve, thuajse nuk ka kursyer asnjë ansambël, madje dhe për disa radhë rresht. Këto fatkeqësi, shpesh bëheshin nxitëse për ritrajtime të rrënojave sipas arritjeve të kohës, ndërsa pjesët e padëmtuara të pazarit qëndronin siç ishin. Kjo rrethanë, binte shpesh një larmi të dalluar formash arkitektonike, në të njëjtin pazar, i cili, siç jemi shprehur më sipër, kishte dhe arsye të tjera.

Për ruajtjen, sigurimin nga zjarret dhe shitjen e mallrave të kushtueshme[9]), në disa qytete, përfshirë në

9) Z. Shkodra, Vep. cit. 74, marrë nga A. Mehlam, **Die Tuerken und der** Balkanhandel ... 14-15.

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

ansamblet e pazareve, ndërtohen pazaret e mbyllura (bezistenet).

Bezistene me një numur të madh dyqanesh dhe kthinash nga shekulli i XVIII e këtej filluan të ndërtohen në Kavajë, Berat e Shkodër[10]. Nga të gjithë këta, bezisteni i Shkodrës[11], ndërtuar në qendër të pazarit, që sipas të dhënave të pakonfirmuara i përket Bushatllinjve, pra shekullit XVIII, përbën shembullin më tipik edhe më të arritur të kësaj gjinie në vendin tonë. Në plan ndërtimi i afrohet një katërkëndëshi të përzgjatur (Tab. 1), duke pasur një thyerje të madhe në murin gjatësor nga verilindja. Dyqanet ngrihen brenda sipërfaqes së rrethuar nga muret e larta të bezistenit (fig. 6), në formën e dy rreshtave përkundrejt rrugës që përshkon ndërtimi në drejtim gjatësor. Dyqanet të bashkëngjitur njeri me tjetrin, ndahen në mes tyre nga mure guri, të cilët ngrihen deri lart në rrafshin e mbulesës, për të mënjanuar përhapjen eventuale të zjarrit. Ashtu si dhe në pazarin e Krujës, muret tërthorë rrugës, që formojnë hapësirat e dyqaneve, nuk vazhdojnë deri në ballin e dyqanit, por ndërpriten rreth 2,5 m më brenda. Gjerësia e dyqaneve dykatëshe, luhat rreth 2,5 m. Bezisteni kishte katër porta, dy kryesoret në qendër të ballëve anësorë, prej nga hyhej dhe dilej nga bezisteni, ndërsa dy të tjerat, të dorës së dytë, afërsisht në meset e mureve gjatësorë. Në ballin juglindor, disa dyqane shërbehen nga jashtë, megjithëse janë pjesë e bezistenit. Të gjithë dyqanet janë dykatëshe. Kati përdhe shërbente për ekspozimin dhe shitjen e mallit, ndërsa i sipërmi për depo. Në disa ambiente të katit të sipërm kishte dhe oxhak. Ndërlidhja për në katin e sipërm sigurohej me shkallë të brendshme.

Nga jashtë dy ballët gjatësorë ishin thuajse të

10) Z. Shkodra, **Vep. cit.** 74.

11) Rilevimi i bezistenit është i Ark. Xh. Kroqit, i cili e ka botuar në broshurën **«Nga thesari i arkitekturës sonë» 6/77.** Lidhur me ndërtimin nga Bushatllinjtë na njofton R. Dizdari në artikullin **«Pazari i vjetër i Shkodrës»,** Monumentet, 5-6/1973, 207. Trajtimi arkitektonik i katit të dytë të dyqaneve të bezistenit, dëshmon për një kohë më të vonë, ose për një ritrajtim të dyqaneve apo vetëm të ballit të tyre.

patrajtuar dhe të shurdhër, për vetë përkujdesjen e sigurimit të bezistenit nga dhunimet eventuale. Përkundrazi dy ballët e ngushtë janë më të përpunuar. Në qendër të tyre, janë ndërtuar respektivisht nga një portë e lartë monumentale, mbuluar me hark dhe qemer rrethor, flegrat e rënda, dy të tilla për çdo portë, siguronin pazarin me mbylljen e tyre, në mbrëmje. Pamja nga jugëlindja, ishte më e përpunuar, sepse në të ishin ndërtuar një sërë dyqanesh që shërbeheshin nga jashtë. Monumentalitetit dhe lakonizmit të formave arkitektonike të pamjes së jashtme i kundërvihet brendësia e bezistenit, ku vargjet paralele të dyqaneve, trajtuar me të njëjtën mënyrë, shquajnë për gjallërinë piktoreske dhe kompaktësinë e njësive uniforme.

Një kategori tjetër ndërtimesh që ndërtohej në ansamblet e pazareve shpesh dhe në numur jo të vogël, qenë dhe hanet.

Zhvillimi i tregtisë, binte si pasojë dhe nevojën për lokale, ku klientë apo shitës produkesh të ndryshme, kryesisht fshatarë, të qëndronin për një apo disa ditë në qytet, shpesh së bashku me kafshët e ngarkesës. Ndërtimi i haneve, duket se ka filluar së bashku me atë të pazareve. Në shekullin XVII[12], ndërtimi i haneve në pazaret e qyteteve tanë ishte një dukuri mjaft e përhapur. Në kompozimin e tyre, hanet përgjithësisht zhvilloheshin sipas një konturi të mbyllur, brenda të cilit shtrihej një oborr i gjerë, në të cilin hapej pamja e balleve të ndërtimeve dykatëshe. Përgjithësisht kati përdhe shërbente për stalla, ku strehoheshin kafshët e ngarkesës së klientave. Ndërsa në katin e sipërm ndërtoheshin kthinat e klientave, në formë vargu. Zakonisht përpara tyre zhvillohej një lloj çardaku i ngushtë me funksione ndërlidhjeje.

Sot ruhet një numër mjaft i vogël hanesh. Ai më me vlerë është hani i «Elbasanit» në qytetin e Korçës (fig. 7). Në skemën planimetrike, ai paraqet një kontur të mbyllur pesëkëndësh rreth një oborri të gjerë, në qendër të të cilit është ndërtuar pusi. Hani ka disa faza ndërtimi. Ai ngrihet dykatësh në lartësi, duke qenë ambientet e katit përdhe kryesisht stalla, ndërsa disa prej tyre depo. Në katin e sipërm zhvillohen ambientet e fjetjes, përpara të cilëve shtrihet një galeri e gjerë, ndërlidhëse, në formë çardaku. Ai është ndërtuar brenda kompleksit të pazarit, duke dalë hyrja e tij në njërën nga rrugët kryesore. Të dhëna të tërthorta tregojnë se faza e parë e ndërtimit i përket fillimit të shekullit XIX[13], ndërsa faza e fundit gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Krahas bezistenëve dhe haneve, në komplekset e pazareve, përfshiheshin dhe një sërë ndërtimesh të tjera, si kafenetë, magazinat, etj. Këto të fundit ishin veçanërisht të shumta e të mëdha, në qendrat që kryenin rolin e kryetregjeve për zona të gjera, duke qenë kështu dhe me funksionin e qendrave tranzite për shpërndarjen e mallrave. Për t'u përmendur janë magazinat e mëdha në pazarin e Shkodrës.

* *

Ansamblet ndërtimore të pazareve, ashtu si mbarë monumentet e arkitekturës, ruajnë vlera të rëndësishme historiko-arkitektonike. Ata përbëjnë dëshmi të prekshme të nivelit të zhvillimit ekonomik të qendrave të ndryshme qytetare, sepse janë pikërisht pazaret ata ku kryhej procesi i prodhimit zejtar, që në analizë të fundit përcaktonte dhe shkallën e natyrës qytetare të qendrës së banuar. Duke pasur parasysh vlerat e mëdha të këtyre ansambleve, me vendim të Këshillit të Ministrave, në vitin 1961, së bashku me shpalljen e qyteteve-muze të Gjirokastrës dhe të Beratit, u vu në mbrojtje shtetërore pazari i vjetër i qytetit të Krujës. Më vonë e njejta gjë u bë për pazaret e Gjirokastrës dhe të Korçës. Vënia në mbrojtje shtetërore e këtyre kompleksëve, diktonte rrjedhimisht dhe ndërmarrjen e punimeve restauruese duke qenë se veçanërisht disa prej këtyre pazareve, vinin në gjendje mjaft të degraduar.

Kriteret e restaurimit lidhur me këta komplekse, gjithë duke qëndruar brenda parimeve të përgjithshme, paraqisnin disa veçanti dhe probleme që lidheshin me karakteristikat e veçanta të këtyre ansambleve në tërësinë e trashëgimisë arkitektonike. Parimet themelore të restaurimit si ruajtja me rigorozitet i vlerave autentike të monumentit si në kompozim ashtu dhe në trajtimin e elementeve përbërës arkitektonikë, respektimi i fazave të ndryshme të ndërtimit, konsolidimi i pjesëve apo elementeve të dëmtuara ose zëvendësimi i atyre krejtësisht të dëmtuar, përbëjnë bazën udhëheqëse dhe në këtë gjini arkitektonike. Veçantitë dhe problemet përbëjnë dukuri të dorës së dytë. Ndër to, së pari, vjen në konsideratë ai i raportit të këtyre ansambleve me qytetin në zhvillim e sipër, sepse në pazaret e qyteteve muze ky problem është i zgjidhur në kuadrin e rregulloreve të këtyre qendrave. Për të arritur në një vlerësim sa më të mirë të këtyre ansambleve, rreth tyre në qendrat e pashpallura qytet-muze është vendosur një zonë e tillë, në të cilën,

12) E. Çelebi, **Vep. cit.** 23, 35, 66, 91, 95.

13) B. Strazimiri, **Hanet e qytetit të Korçës,** në «Mjeshtrat dhe arkitektura popullore». Autori i këtij artikulli, ka hartuar edhe projektin e restaurimit për këtë monument.

Botim

sipas rastit, ose zhvillohet gjelbërimi, ose ndërtimet e reja respektojnë ansamblin-monument, kryesisht nëpërmjet trajtimit të volumeve, atij arkitektonik dhe ngjyrave.

Karakteristikë e veçantë në restaurimin e pazareve duhet mbajtur dhe respektimi i të gjithë përbërësve urbanistikë dhe ambientalë të pazarit, të cilët kanë vlerat dhe rëndësinë e tyre si pjesë e këtyre ansambleve. Së dyti vinte në konsideratë funksionin që do të kishin këto komplekse në jetën e përditshme. Zgjidhja e këtij problemi do të ndikonte në një farë mase në kriteret e restaurimit dhe në masën e ndërhyrjes. Lidhur me këtë çështje u ndoq parimi që këto komplekse të ruajnë funksionin e tyre origjinal, atje ku është e mundur, duke ushtruar në ta zejtari që ende nuk e kanë humbur vlerën ose që janë në funksion të prodhimeve artizanale artistike. Një vend të rëndësishëm dhe madje kryesorin, në shfrytëzimin e këtyre kompleksëve do të zinin dyqanet për shitjen e prodhimeve të sotme, zgjidhje kjo veçanërisht e frytshme në qytetet-muze. Lidhur me këtë destinacion të fundit, pa cënuar pamjen e jashtme, vetëm duke prishur muret ndarës, ndërmjet dyqaneve, në disa raste u lejua bashkimi i dy apo më shumë dyqaneve, për të lehtësuar shfrytëzimin sipas kërkesave të kohës. Lidhur me parandalimin e rrezikut të zjarrit, është gjetur e përshtatshme që në disa raste dyshemetë prej druri të zëvendësohen me konstruksione b-arme, të cilat shpesh janë të veshura me materialet origjinale.

Së fundi, si veçanti, lidhur me kriteret e restaurimit të këtyre ansambleve, duhet mbajtur dhe kalimi në disa raste i punimeve restauruese thuajse në rindërtimin tërësor të një njësie ndërtimore, të cilat përndryshe do të humbisnin njëherë e përgjithmonë. Madje në raste të rralla, mund të lejohen dhe rindërtime të kufizuara, për të mbushur boshllëqet eventuale të kompleksëve, që dëmtojnë rëndë unitetin dhe vlerat e ansamblit. Njësia e dalluar në trajtimin arkitektonik të këtyre ansambleve e bën këtë zgjidhje të pranueshme, gjithnjë duke pasur parasysh anët negative që ajo bart.

Çështja e qëndrimit karshi zhvillimit në kohë të këtyre ansambleve është zgjidhur gjithmonë sipas parimeve të njohura të respektimit të kontributit ndërtimor të çdo epoke. Kështu, restaurimi i pazareve ka synuar të ruajë përbërësit e ansambleve, pavarësisht nga koha e ndërtimit, duke vlerësuar kështu gjurmët e zhvillimit në kohë të tyre.

Restaurimi i ansambleve të pazareve në vendin tonë, filloi menjëherë me krijimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në vitin 1965. Së pari u restaurua pazari i Krujës, fill pas tij ai i Gjirokastrës, ndërsa më vonë filluan punimet e restaurimit në pazarin e Korçës, të cilat janë në vazhdim. Për të krijuar një panoramë të karakteristikave të pazareve tona, në të kaluarën dhe të punimeve të restaurimit të kryer në to, po japim një vështrim të shkurtër mbi ansamblet më të rëndësishëm të kësaj gjinie.

Pazari i Krujës. Kruja, si qendër banimi, në të kaluarën kishte një natyrë të dyfishtë ekonomike, që shprehej në sigurimin e mjeteve të jetesës së një pjese të popullsisë nëpërmjet prodhimit zejtar, ndërsa të pjesës tjetër nëpërmjet blegtorisë dhe rritjes së ullirit. Pozita dhe traditat e këtij vendbanimi, bën që ai gjatë shekujve të jetë dhe qendra ekonomike e malësisë përreth. Për këto arsye, Kruja ka pasur një ansambël relativisht të madh ndërtimor, ku prodhoheshin e shiteshin prodhime të zejtarisë. Koha e fillimit të ndërtimit të këtij ansambli nuk dihet me saktësi. Sipas regjistrit fiskal të vitit 1431-2, Kruja kishte 125 banesa ndërsa në fillim të shekullit XVI, numri i tyre kishte arritur në 154[14]. Kjo rritje e vogël shënon fillimin e zhvillimit të mëtejshëm të kësaj qendre, e cila lidhet dhe me ndërtimin e pazarit[15]. Sigurisht kjo nuk do të thotë se pjesët e ansambleve të këtij pazari, që kanë arritur deri në ditët tona, janë të kësaj kohe. Tipologjikisht dyqanet e pazarit të Krujës janë më të hershmit. Zhvillimi relativisht i ngadalshëm i kësaj qendre, ka bërë që dyqanet e vjetër dhe në përgjithësi format e lashta të ruhen për një kohë të gjatë. Sipas mendimit tonë, pjesa më e madhe e këtij ansambli, duhet t'i përkasë shekujve XVIII-XIX.

Pazari i Krujës, formonte dhe qendrën e qytetit në të kaluarën. Ai, në periudhën e zhvillimit më të madh, shihej gjatë rrugës që fillonte, aty ku sot është qendra e qytetit, deri pranë hyrjes kryesore të kalasë. Ai kishte një shtrirje tepër të gjatë, sipas një vije të lakuar. Rruga, e shtruar me kalldrëm me kunetën karakteristike në aksin e saj, kufizohej nga të dy anët prej vargjeve të dyqaneve bashkangjitur dhe kundrejt njeri-tjetrit. Terreni i pjerrët ka kushtëzuar në mjaft zona të pazarit, ndërtimet në formë blloqesh prej dy e më shumë dyqanesh me shkallëzime (Tab. II, III). Terreni i pjerrët mbi të cilin ngrihet ansambli i pazarit, ka kushtëzuar gjithashtu karakterin e ndryshëm të ndërtimeve të vargut të sipërm me atë të poshtmin. Vargu i sipërm i vishet pjerrësisë së terrenit, duke u mbështetur pjesa e prapme e tij në të. Kjo rrethanë ka detyruar dhe ndërtimin e mbulesës me një kullim uji. Vargu i poshtëm e ka pjesën e prapme të lirë, ndërsa çatinë me dy kullime. Forma e terrenit ka ndikuar dhe në kompozimin vëllimor të ambien-

14) Z. Shkodra, **Vep. cit.** 26, sipas H. Inalçik në Encyclopedia of Islam... Vol. 1, 655.
15) Z. Shkodra, **Vep. cit.** 35.

DO NOT COPY

teve e të formës së dyqaneve duke mbetur numri dhe funksioni i tyre i njëllojtë për të dy vargjet.

Dyqani, njësia formuese kompozicionale e ansamblit, përbëhej prej ambientit kryesor, ku kryhej prodhimi dhe shitja e mallit, si dhe prej një ambienti ndihmës dhe prej depos. Të dy vargjet e dyqaneve në përgjithësi i kanë të tri këto ambiente. Mjaft rrallë në disa dyqane të vargut të sipërm, ngrihet një kat i dytë, i cili në disa raste shërbehet nga rruga prapa pazarit. Kështu dyqanet në kompozimet e tyre volumore janë përdhes, me gjysmëkat dhe me kat. Përdhes janë dyqanet e vargut të sipërm, ndërsa me gjysmëkat, ata të vargut të poshtëm. Në dyqanet përdhes të vargut të sipërm, si dhe në ato me gjysmëkat të vargut të poshtëm, formohen nga dy njësi, dyqani me ballë dhe ambienti ndihmës në pjesën e prapme, të cilët zakonisht ndahen në mes tyre me një perde, në të cilën shpesh ndërtohen etazhere si dhe dera për ndërlidhje. Zakonisht të dy ambientet janë në një kuotë, por ka dhe raste, kur ambienti i pasmë është më i ngritur. Ambienti i depos në dyqanet e vargut të sipërm, sajohet në pjesën e nënçatisë, ku të çojnë shkallë të lehta druri.

Në dyqanet e vargut të poshtëm, depoja ndërtohet nën ambientin ndihmës, ku të çojnë shkallët e drurit, mbuluar me qepen. Ambienti kryesor i dyqanit ka në ballin e tij, sipas rastit, sigurimin me taraba, apo qepena, me flegrën e poshtme dhe të sipërmen, e cila në disa raste paloset duke pasur dy pjesë. Strehët e gjera 1,ó – 1,8 m., dyfishe, që përfundojnë mbi kunetën qendrore të rrugës, krijojnë një mbrojtje të mirë për blerësit dhe shfrytëzohen për ekspozimin e mallit. Qoshku i sajuar mbi sofanë prej murature guri, apo zgjatimi i trarëve të dyshemesë, mbi të cilët vendosen tarabatë ose qepeni i poshtëm, është një pjesë e rëndësishme e dyqanit, ku ekspozohet malli, apo punon mjeshtri. Hyrja, një e vetme, në dyqanet që sigurohen me taraba, është zakonisht anash, ndërsa në ato me qepene gjendet dhe në qendër. Dyshemeja e dyqanit është e ngritur nga rruga 2 – 3 këmbë shkalle.

Karakteristika konstruktive e këtij ansambli është ndërtimi me muraturë guri vetëm i pjesës fundore të dyqaneve. Muret ndarës prej guri të këtyre pjesëve shkojnë deri në drejtimin e perdes ndarëse të dyqanit me ambientin ndihmës, kurse konstruksioni i mureve të dyqanit është me skelet druri veshur me dërrasë në vazhdim të mureve ndarëse prej guri. Pra, konstruktivisht, muret kanë një dallim të qartë në të dy volumet, ato të dyqanit dhe ambientit ndihmës. Siç dukët arsyet për këtë zgjidhje duhen kërkuar në krijimin e mundësisë për të zotëruar më shumë se një dyqan, duke hequr ndarjen e lehtë ndërmjetëse. Konstruksioni i çatisë është me sistem vendi. Streha e parë



Fig. 8



Fig. 9

formohet nga zgjatimi i trarëve të tavanit, ndërsa e dyta, nga zgjatimi i binarëve nën shtresën e petavrave. Dyqanet, sipas rastit, janë përdhes, apo me dysheme druri.

Në momentin e vënies në mbrojtje shtetërore të këtij ansambli ai ishte në një gjendje mjaft të keqe teknike dhe praktikisht thuajse tërësisht ishte braktisur (fig. 8, 9). Të gjitha strukturat mbajtëse si dhe elementet e ndryshme, si taraba, qepena, dyer, etj. ishin në degradim të plotë. Shtojmë se nga ansambli i këtij pazari, kishin mbetur vetëm tri grupe, ndërsa

Poor COPY



Fig. 10

pjesa tjetër e tij ishte rrafshuar deri në themelet. Në këto kushte, u vendos restaurimi i këtyre tri pjesëve, të cilat krijonin një ide të qartë të natyrës dhe karakteristikave të këtij ansambli.

Pas dokumentimit të imtë, grafik, përshkrimor, fotografik e kinematografik si dhe studimit të imtë të karakterit dhe të zhvillimit në kohë të këtij ansambli, u hartua projekti i restaurimit[16]. Gjendja në prag të rrënimit të këtij ansambli, diktoi rindërtimin thuajse tërësor të tij. Ky vendim rridhte nga kushtet në të cilat ndodhej monumenti të cilat qenë të tilla që praktikisht bënin të pamundur ruajtjen e elementeve origjinalë. Në hartimin e projektit të restaurimit u udhëhoqëm nga këto kritere: të rindërtohej ansambli duke respektuar kompozimin vëllimor dhe planimetrik të tij, formulimin arkitektonik të elementeve, teknikën dhe materialet origjinale. I vetmi ndryshim në skemën planimetrike qe bashkimi në disa raste i dy apo tri dyqaneve në një njësi të vetme volumore dhe mosndërtimi i perdeve ndarëse ndërmjet ambientit të dyqani dhe atij ndihmës. Kjo u diktua nga funksioni që do të merrte ansambli pas restaurimit të tij. Punimet e restaurimit (fig. 10) u zbatuan gjatë dy vjetëve 1965-1966. Në Janarin e vitit 1967, me rastin e pesëqindvjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ky kompleks së bashku me shumë punime restauruese në Kalanë e Krujës, gjallëruar mjaft qytetit. Një problem i vështirë për t'u zgjidhur ishte dhe ai i funksionit që do të merrte ky ansambël. Për këtë u vendos që ai të ruante funksionin e qendrës zejtaro-tregtare. Kështu mjaft dyqane shërbejnë për ushtrimin e disa zejeve tradicionale, ndërsa pjesa më e madhe e tyre shfrytëzohet për tregtimin e mallrave. Një njësi prej tri dyqanesh është kthyer në një kafene karakteristike. Ky funksion jo vetëm nuk dëmton vlerat e ansamblit të restauruar, por përkundrazi krijon kushtet që masa e vizitorëve të njihet së afërmi me vlerat e këtij monumenti.

Pazari i vjetër i Krujës, pas restaurimit të tij (fig. 1, 3, 4) përbën një vlerë të rëndësishme për historinë e arkitekturës sonë, duke qenë tipologjikisht i formave më të lashta të kësaj kategorie ndërtimesh.

Pazari i Gjirokastrës. Si një rast i rrallë, në Gjirokastër, qendra ekonomike e qytetit, pazari, është zhvendosur nga një truall, në një tjetër. Njoftimin e parë mbi qenien e pazarit dhe njëkohësisht mbi zhvendosjen e tij, na e jep E. Çelebiu[17]. Ai shkruan: «Në veri të fortesës, ndër muret e saj, është tregu i vjetër, që quhet Pazari i Kalasë, me dyzet dyqanka. Ky treg në të dy anët, ka dy porta druri që u përngjajnë atyre të bezistenit[18]. Më poshtë, po ky autor, shkruan: «Gjirokastra ka dyqind dyqane të rinj, në dy kate. Ky treg në të dy anët ka nga një portë të bukur, që e bëjnë si një bezisten[19]. Këto të dhëna me rëndësi, tregojnë se rreth mesit të shekullit XVII, krahas pazarit të vjetër, atje ku sot ende ruhet toponimi «pazar i vjetër», për një lagje të banuar, kishte filluar ndërtimi i pazarit të ri, atje ku ai shtrihet sot. Me rëndësi është gjithashtu e dhëna e Çelebiut se dyqanet e rinj ishin dykatëshe. Me kalimin e kohës pazari i vjetër u shkatërrua, duke u ndërtuar në vendin e tij një lagje e banuar, ndërsa pazari i ri mori një zhvillim të madh.

Pazari i Gjirokastrës (fig. 11) përbën një njësi më vete nga ana urbanistike, gjithnjë duke qenë së ba-

16) Hartimi i projektit dhe drejtimi i punimeve u krye nga autori i këtij artikulli. Punimet u kryen nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës së Tiranës. Ato filluan në vitin 1965 dhe përfunduan në muajin dhjetor të vitit 1966.

17) E. Çelebi, **Vep. cit.** 32, 35, 36.

18) E. Çelebi, **Vep. cit.** 32.

19) E. Çelebi, **Vep. cit.** 35, 36. Nga këto pasazhe, kuptohet mungesa e saktësisë në numrin e dyqaneve, pasi numri prej 200 dyqanesh për të cilat flet autori, nuk përputhet me dy të dhënat e tjera.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11

shku me kalanë qendra e qytetit. Pazari, në gjendjen e sotme i përket një rindërtimi tërësor, rreth çerekut të tretë të shekullit XIX. Shkak për këtë u bë një zjarr i madh shkatërrues i cili bëri që ai të rindërtohet tërësisht, duke ruajtur akset e vjetra të rrugëve, por duke i zgjeruar ato. Formulimi arkitektonik thuajse uniform i dyqaneve, ndërtimet solide, shpesh trekatëshe dhe përdorimi i gjerë i profileve prej hekuri në formë arkitrarësh, flasin qartë për rindërtimin tërësor të tij.

Nga ana e vendosjes urbanistike, Pazari i Gjirokastrës, ndjek skemën klasike të këtyre kompleksëve, duke krijuar me ndërtimin e vargjeve paralele të dyqaneve blloqe ndërtimesh. Vetë dyqanet janë dykatëshe, por nuk mungojnë dhe ata trekatësh. Terreni i pjerrët, mbi të cilin shtrihet pazari, ka kushtëzuar zhvillimin e tij gjatë rrugës, me shkallëzime blloqesh prej disa njësish, duke i dhënë kështu një lëvizje të madhe volumeve.

Fillimisht, kati përdhes i dyqanit, ishte ambienti ku punonte zejtari, apo shiste tregtari, ndërsa ambientet e tjera, kishin funksione ndihmëse. Ndërlidhja me katet e sipërme sigurohej nga kati përdhe, por shpesh, kur e lejonte terreni, ai kishte dhe hyrje nga prapa.

Formulimi arkitektonik i pamjeve të jashtme, në përgjithësi është unik (fig. 12) dëshmi bindëse e kohës së njëjtë të ndërtimit. Ballët sigurohesin me qepene metalike, me palosje rreth aksesh vertikalë, por sot prej tyre kanë mbetur pak elemente. Në pamjet e jashtme të bie në sy përdorimi i gjerë i gurit të latuar, që veshin kollona e pilastra, formojnë kornizat karakteristike, apo konturojnë hapësirat e dritareve, relativisht të mëdha të kateve të parë dhe të dytë (fig. 13). Guri i përpunuar shkëputet nga sipërfaqja e suvatuar, si nga faktura, ashtu dhe nga dhëmbëzimi që krijon me të.

Në këto ndërtime, mbisundon linja e drejtë, e cila në hapësirat e mëdha të katit përdhe, arrihet me përdorimin e shinave të hekurit, si arkitra. Por nuk mungojnë dhe zgjidhje me harqe. Çatia, realizohet me konstruksion druri dhe si të gjitha ndërtimet e qytetit

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 14

mbulohet me rrasa guri. Rrallë dyqanet janë trajtuar në ballë me frontone.

Në formulimin e tij arkitektonik, Pazari i Gjirokastrës, ka mjaft elemente të përbashkëta me banesën gjirokastrite, duke bërë që ai, të përfshihet mjaft mirë në tërësinë e qytetit.



Fig. 13

Në përgjithësi, gjendja teknike e këtij ansambli në momentin e vënies në mbrojtje shtetërore ishte e mirë. Konstruksionet e mureve dhe pjesërisht të çative qenë solide. Pjesa më e dëmtuar që kërkonte një trajtim tërësor ishte ajo e pamjeve të jashtme (fig. 14). Me kalimin e kohës, vitrinat, dyert dhe suvatimet ishin dëmtuar rëndë, ndërsa një pjesë e mirë e gurëve të punuar ishin mbuluar me shtresa gëlqereje. Kështu i gjithë ansambli kërkonte punime restauruese. Këto punime u kryen gjatë viteve 1967-1968[20]. Punimet prekën të gjitha pamjet e jashtme të kompleksit të pazarit, duke ribërë suvatimet, rindërtuar vitrinat dhe dyert si dhe duke prekur dhe elemente të brendësisë së dyqaneve, si shtresa, tavane, suvatime etj. Një volum i madh pune përfshiu restaurimin e trotuarëve, të cilët u shtruan me pllaka guri.

Gjatë viteve 1976-1977, u krye, me të njëjtat kritere, dhe restaurimi i një pjese të ansamblit të pazarit, rreth obeliskut kushtuar pionierëve të arsimit dhe të shkollës shqipe. Kështu sot i gjithë ansambli është i restauruar. Megjithëkëtë vazhdojnë punime të ndryshme konsolidimi.

Pazari i Gjirokastrës, i përfshirë brenda qendrës historike të qytetit-muze të Gjirokastrës, bën pjesë në zonën muze. Duke qenë se rregullorja e qytetit-muze të Gjirokastrës[21] nuk lejon ndërtime të reja në zonën-muze, Pazari i Gjirokastrës funksionon, ashtu si dhe më parë, duke përfshirë pjesën më të madhe të

20) Projekti u hartua nga E. Riza dhe Th. Kamberi. Ky i fundit drejtoi punimet e restaurimit, që u kryen nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës së Gjirokastrës.

21) **Rregullore mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qytetit-muze të Gjirokastrës,** Monumentet, 5-6/1973.

lokaleve për shitje, si dhe një pjesë të mirë të institucioneve shtetërore të qytetit. Gjendja e tij e mirë dhe përgjithësisht kompozimi dhe trajtimi i arritur, që i reziston ende kohës kanë bërë që ky ansambël të plotësojë më së miri kërkesat e qëndrës historike të qytetit-muze të Gjirokastrës.

Pazari i Korçës. Ky ansambël zë një vend të posaçëm në trashëgiminë arkitektonike të kësaj gjinie ndërtimesh në vendin tonë. Së pari këtu vjen në konsideratë madhësia dhe gjallëria e këtij ansambli, i cili mund të krahasohet në këtë drejtim vetëm me pazarin e Shkodrës. Së dyti, zhvillimi i vrullshëm i kësaj qendre të rëndësishme zejtaro-tregtare, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, lidhur me fuqizimin e shtresave të ndryshme të borgjezisë, bëri që Pazari i Korçës të pësojë rritje dhe rindërtime të shumta, të cilat pasqyrohen qartë në karakterin urbanistiko-arkitektonik të tij.

Ashtu si mbarë ansamblet e pazareve dhe ai i Korçës, ka vuajtur shumë nga zjarret e shpeshtë dhe në mjaft raste shkatërruese. Veçanërisht me rëndësi për këtë ansambël është zjarri i vitit 1879, i cili thuajse rrafshoi plotësisht kompleksin e pazarit. Kjo rrethanë i dha shkas një ritrajtimi tërësor të ansamblit, si në planin arkitektonik, ashtu dhe në atë urbanistik[22]. Kështu, pazari pas kësaj katastrofe, merr një drejtim të ri. Rrjeti rrugor, që ndërpritet sipas këndesh të drejtë, formon parcela katërkëndëshe kënddrejta, ku shpinë më shpinë ndërtohen vargje dyqanesh, kryesisht dykatëshe dhe më rrallë dhe disa trekatëshe. Rrugët janë të gjera dhe të pajisura me trotuare. Ato janë të shtruara me kalldrëm. Ky kriter urbanistik i përparuar për kohën, të kujton menjëherë atë të lagjeve të reja të qytetit[23].

Pazari i Korçës, ashtu si dhe ansamblet e tjera të këtij lloji në të kaluarën përfshinte pazarin e hapur, ansamblin e dyqaneve-punishte dhe atyre për tregtim (çarshia) dhe hanet. Pazari i Korçës ishte veçanërisht i përmendur për gjallërinë e pazarit të hapur javor. Në sheshin e këtij pazari kishte një ndarje të dalluar të zonave për shitjen e produkteve të ndryshme bujqësore e blegtorale.

Ansambli i dyqaneve, në dallim nga ata të qendrave të tjera, shquhet për realizimet arkitektonike më të arritura. Konstruksionet janë mjaft të qëndrueshme të punuara me gurë apo tulla. Shpesh për mbulimin e hapësirave të katit përdhe janë përdorur dhe qemeret. Dyqanet janë, në shumicën e tyre dykatëshe (fig. 2, 5) por nuk mungojnë dhe ata trekatëshit. Mjaft e përpunuar është pamja e jashtme e këtyre dyqaneve, ku krahas gurit të punuar, një vend të rëndësishëm zenë zbukurimet në suva, ku parapëlqehen motivet neoklasike, ashtu si në banesën korçare të kësaj periudhe.

Sigurimi i dyqaneve bëhej kryesisht me taraba hekuri (fig. 5), por krahas tyre, pas vitit 1879, hyjnë edhe rrulotë metalikë (fig. 2).

Trajtimi arkitektonik i pamjeve kryesore të dyqaneve nuk është unik, zhvillimi i vrullshëm ekonomik i qyteteve dhe konkurenca ndërmjet shtresave të prodhuesve, kushtëzuan këtë larmi trajtimesh, të cilat nuk cënojnë unitetin kompozicional të këtij ansambli. Pazari i Korçës dallohej dhe për numrin e shumtë të haneve, gjatë periudhës së lulëzimit të tij. Këto ishin të ndërtuara zakonisht në periferi të pazarit, duke pasur deri diku një klientelë të përcaktuar sipas zonave.

Ashtu si pazaret e tjera dhe ai i Korçës vinte në gjendje të keqe teknike nga e kaluara. Për këtë arsye që prej vitit 1974, në këtë ansambël kanë filluar punimet e restaurimit, të cilat vazhdojnë edhe sot e kësaj dite[24]. Punimet e restaurimit kanë prekur kryesisht konstruksionet e çative, ritrajtimin e pamjeve kryesore si dhe trotuarët. Krahas këtyre punimeve janë prekur dhe brendësitë e dyqaneve.

Punimet kanë respektuar si format origjinale arkitektonike, ashtu dhe materialet e ndërtimit. Krahas restaurimit, pazari po rimerr kryesisht funksionet e qendrës tregtare. Njëkohësisht në njësi të ndryshme ndërtimore të tij do të vendosen lokale të shërbimit komunal dhe eventualisht në katet e sipërme zyra të institucioneve të ndryshme, funksione këto që nuk cënojnë vlerat historiko-arkitektonike të këtij ansambli.

Krahas pazareve të Krujës, Gjirokastrës dhe

22) P. Pepo, **Kontribut për historinë e tregut të Korçës e të Voskopojës gjatë sundimit otoman,** «Korça e Re», 5/1964.
P. Thomo, **Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës** «Monumentet historike», Tiranë, 1978.
Mendimi i shfaqur nga E. Riza dhe B. Strazimiri, në artikullin **«Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës»,** «Monumentet», 3/1972, zjarri i vitit 1879, nuk duhet të ketë ndikuar në urbanistikën e pazarit, nuk është i bazuar.

23) E. Riza, B. Strazimiri, **«Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës»,** «Monumentet» 3/1972. P. Thomo, **«Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës»,** «Monumentet historike», Tiranë, 1978.

24) Projekti i restaurimit është hartuar nga P. Thomo, ndërsa punimet zbatohen nga Ateljeja e Korçës, nën drejtimin e autorit të projektit.

Shkodrës, në të kaluarën çdo qytet kishte pazarin e tij. Ndërmjet tyre vlejnë të përmenden Pazari i Shkodrës, Elbasanit, Beratit, Tiranës, Kavajës, Përmetit, Peqinit, Vlorës, Lezhës etj.

Pazari i Shkodrës, në të kaluarën, një nga më të mëdhenjtë e vendit, prej të cilit sot nuk ruhen gjurmë, shtrihej në jug të qytetit të sotëm[25]. Ai përfshinte një zonë të rrafshtë që arrinte deri në brigjet e liqenit.

Së pari ai përmendet që në vitin 1509[26]. Në rrjedhje të shekujve, ai u rrit, duke arritur në shekullin XIX, për të cilin të dhënat janë të plota, në një nga qendrat më të zhvilluara zejtaro-tregtare të vendit. Kjo lidhej me rolin e rëndësishëm që mori Shkodra, si kryeqendra e zonave të gjera të Shqipërisë së Veriut. Pazari ishte i ndarë në rrugë të ndryshme sipas zejeve. Pothuaj në qendër të tij, ngrihej bezisteni (fig. 6). Në dallim nga pazaret e tjera, për vetë funksionin e Shkodrës si qendër tranziti i mallrave, ishin ndërtuar dhe një sërë magazinash[27]. Aty nga fillimi i shekullit XX, ato ndërtohen me kritere të tjera, më të përparuara dhe në disa raste trekatëshe. Pazarit nuk i mungonin hanet, madje dhe ndërtesa e doganës, lidhur me marrëdhëniet me tregjet e huaja, duke kaluar nëpërmjet Bunës në det.

Dyqanet në përgjithësi paraqisnin karakteristikat e njohura të këtyre ndërtimeve në qendrat e tjera.

Pazar të rëndësishëm ka pasur dhe qyteti i Elbasanit, i cili në shekullin XVIII qe kryetregu i Shqipërisë së Mesme[28]. Pazari i Elbasanit përmendet në shekullin XVII si një qendër e zhvilluar[29]. Për këtë dëshmon dhe e dhëna se në kushtet e sundimit otoman, esnafët ndeshen në formën embrionale në Elbasan, që në gjysmën e dytë të shekullit XVI[30]. Pazari i Elbasanit shtrihej në zonën qendrore të qytetit, në jug të kalasë. Si nga formulimi urbanistik, ashtu dhe nga karakteristikat arkitektonike të dyqaneve, ai paraqet të njejtat zgjidhje me pazaret e tjera të vendit tonë.

Një pazar të madh ka pasur dhe qyteti i Beratit, në të kaluarën. Ai zinte pjesën qendrore të qytetit me një shtrirje mjaft të madhe. Gjatë shekullit XVII, pazari, kishte një gjallëri të madhe, në të qenë ndërtuar dhe hane e bujtina, madje dhe një kullë sahati me çangë[31]. Më vonë, në Berat, ndërtohet dhe një bezisten. Balli i dyqaneve në këtë pazar ka pësuar zhvillimin e njohur në kohë, nga sigurimi me taraba deri te qepenet dhe rulotë metalike.

Krahas këtyre pazareve kryesorë dhe qendrat e tjera qytetare të vendit, kanë pasur ansamble pazaresh, madhësia e të cilëve ishte në përputhje me shkallën e zhvillimit ekonomik të tyre.

POOR COPY

25) R. Dizdari, **Pazari i vjetër i Shkodrës,** Monumentet, 5-6/1973.
26) Z. Shkodra, **Vep. cit.** 37.
27) R. Dizdari, **Art. cit,** 206.
28) Z. Shkodra, **Problemi i tregut shqiptar në sh. XVIII,** B.SH.SH. 3/1966, 70.
29) E. Çelebi, **Vep. cit.** 107, 108.
30) Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** Tiranë, 1973, 10.
31) E. Çelebi, **Vep. cit.** 59, 60, 65, 66.

Bezisteni Shkodër



PLANIMETRIA



PAMJE JUG-PERENDIMORE



PAMJE NGA VERI-LINDJA



PAMJE NGA VERIU



PAMJE NGA JUGU

0 2 4 6 m.

DO NOT COPY

PAZARI I KRUJES
GRUP DYQANESH (PAS RESTAURIMIT)



PAMJE KRYESORE



PAMJE NGA MBRAPA



PRERJA DIAGONALE B-B.



PLANIMETRIA KATIT

0 1 2m.



PAMJE E FAQES A.

DO NOT COPY

PAZARI I Krujës

DETAJE DYÇANESH (PAS RESTAURIMIT)

DERE DYÇANI ME TARABA





PAMJE KRYESORE

0 1 2 3 M



DETAJ I MBYLLJES



DETAJ I VENDOSJES SE TARABAS



DERE DYÇANI



0 1 2 3 M

PRERJE TERTHORE E DYÇANEVE

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

LES ENSEMBLES DES MARCHES ET LEUR RESTAURATION

RESUME

Les ensembles des marchés occupent une place importante, dans la vie de la ville albanaise, pendant la période allant du XVIe siècle au commencement du XXe. Cette période se rattache à la prévalence de la forme féodale de l'économie des centres urbains du pays, et cela jusqu'à presque la première moitié du XIXe siècle, période durant laquelle commencent à naître et à se développer les rapports capitalistes. La forme de l'économie féodale s'est exprimée à travers le système des corporations d'artisans dit esnafs, *système qui fit son apparition pendant le deuxième moitié du XVIe siècle à Elbasan, quoique en forme embryonnaire, dans les nouvelles conditions créées par suite de l'occupation ottomane. Plus tard, à partir du XVIIe siècle, il devient la forme prédominante dans la vie sociale et économique des artisans et commerçants du pays.*

Dans le passé, le marché, en tant que centre économique de la ville, où se réalisaient la production et le commerce des marchandises, en en constituait une des principales unités. C'est justement cette partie du centre de la ville, où exercent leur activité la couche des artisans et commerçants et plus tard d'autres couches, qui détermine le caractère de l'agglomération urbaine. Les couches de la population, s'occupant de la production et du commerce des marchandises, représentaient à l'époque une importante force en croissance non seulement économique, mais aussi politique, dans la vie de la ville, laquelle, petit à petit, revêt le caractère toujours plus marqué d'une agglomération urbaine, d'un centre de production et d'échange, en incluant constamment de nouveaux habitants dans la sphère de production des marchandises.

L'occupation ottomane, au XVe siècle entraîna la liquidation du système des corporations et, en même temps, la destruction des villes albanaises qui avaient atteint un important degré de développement à l'époque. Dans le peu de centres où ce système continua vraisemblablement à exister, il fusionna avec le système corporatif turco-arabe, connu par le nom d'esnaf, en se manifestant toutefois à nouveau chez nous un siècle plus tard. Le XVIe siècle se rattache à la renaissance générale des centres urbains, et cela grâce au concours de nouveaux habitants venus des villages avoisinants. L'apparition à nouveau des marchés, dans les nouvelles conditions de l'occupation ottomane, a eu lieu justement au cours même de ce siècle. Le XVIIe siècle marque l'accroissement sensible de la ville en tant que centre de production et d'échange. Le XVIIIe siècle est la période d'épanouissement de l'économie féodale, et cela à travers le système des esnafs. *Les ensembles de marchés gagnent en ampleur, notamment dans les villes en train de se convertir en marchés de caractère interrégional. Pendant le XIXe siècle, on relève un accroissement encore plus grand de la ville albanaise et le déclin du système moyennâgeux des* esnafs, *ce qui fraya la voie, surtout pendant la deuxième moitié du XIXe siècle à la naissance et au développement des rapports capitalistes. C'est justement au cours de cette période que fut entamé le processus de formation du marché national. Dans l'activité d'édification, le nouveau mode de production entraîna la construction d'une série d'ateliers, souvent loin des marchés, ainsi que le processus de reconstruction de ceux-ci. Ces reconstructions sont en général une conséquence des incedies ou des tremblements de terre, et cela notamment dans les centres les plus en essor de l'époque.*

Les marchés de nos villes, pendant la période que nous sommes en train d'examiner, se caractérisent sur le plan typologique surtout par le traitement de leur partie frontale. Le peu de données que nous disposons indiquent que, jusque vers la moitié du XIXe siècle, nos marchés se distinguaient par une unité urbanistique et architectonique bien nette, tandis que pendant la deuxième moitié de ce même siècle et plus tard ils subissent des modifications importantes sur le plan urbanistique et de beaucoup plus profondes sur le plan architectonique.

Le développement de nos villes, pendant la période de prévalence des rapports de l'économie féodale et plus tard des rapports capitalistes, se relie étroitement au développement du centre économique de la ville: le marché. Dans le passé, chaque ville avait un centre à lui destiné aux artisans et aux commerçants, mais toujours un seul. Mentionnons notamment de leur nombre, surtout pendant les XVIIIe-XIXe siècles, les marchés de Shkoder, Berat, Korçe, Elbasan, Gjirokastra, Kruja, Tirana, Kavaja, etc. Leur développement se rattache directement à l'essor économique de la ville albanaise dans le temps, par suite de son renouvellement au XVIe siècle, de sa consolidation au XVIIe,

de son épanouissement au XVIIIe et de son développement encore plus marqué pendant la première moitié du XIXe siècle, mais toujours dans le cadre de l'économie féodale. Le développement des marchés est en général un processus long, au cours duquel ceux-ci croissent en nombre et s'enrichissent de nouveaux blocs et de nouvelles constructions, d'habitude dans la même zone et rarement en d'autres endroits. La dégradation provoquée par les temps, les incendies fréquents qui causaient des dégâts considérables en raison de la densité des constructions et le large usage du bois d'oeuvre, et puis, depuis la deuxième moitié du XIXe siècle, la tendance à procéder à des reconstructions dans l'esprit de l'époque, sont parmi les principaux motifs qui ont entraîné la modification de l'aspect de ces ensembles.

Les marchés comportaient des constructions exerçant différentes fonctions, et cela à l'intérieur d'un complexe plus ou moins unique. Dans le passé une des principales composantes du marché est le çarshi, qui englobait tous les ateliers-boutiques des artisans et les magasins des commerçants. Une place importante y revient aussi au marché, à ciel ouvert, souvent divisé en différentes zones pour la vente des productions végétales et animales, ainsi que du bétail et des bêtes de somme. Cette partie du marché se caractérisait par une vivacité particulière notamment en des jours fixes de la semaine, et cela de façon non analogue dans tous les centres, durant lesquels les paysans y venaient vendre leurs productions et acheter des produits de l'artisanat citadin. Une place importante occupent aussi dans les marchés les auberges (han), les bezisten (marché couvert), etc.; depuis le XVIIe siècle font leur apparition les tours d'horloge, d'abord à clocher puis à cadran. Cette activité a connu une intensité particulière dans toutes nos villes pendant les XVIIIe-XIXe siècles.

Les ensembles de marchés, et cela dans toutes les villes, constituent des unités se distinguant nettement du centre urbain. Dès leur apparition, ils ont été édifiés hors les murs des centres fortifiés. L'extension de la ville ouverte n'affecte en rien le centre artisanal-commercial, qui se situe dans le développement ultérieur de la ville ouverte et en différents rapports avec le centre habité.

Du point de vue urbanistique, les marchés constituaient à l'époque une file longue de boutiques contiguës, disposées les unes face aux autres et laissant libre le milieu de la rue pour le mouvement des acheteurs. L'extension du marché a eu lieu petit à petit, par étapes, en y ajoutant de nouvelles boutiques et constructions, ce qui entraînait la création de nouveaux blocs ou l'élargissement des blocs existants. Une caractéristique de ces marchés consiste dans le fait que la grande majorité des artisans, suivant une ancienne tradition, avaient leurs boutiques rangées les unes à côté des autres.

Le premier marché, qui fut reconstruit suivant un projet, est celui de Korçe et cela par suite de l'incendie destructeur de l'an 1879. En ce qui concerne les autres marchés, ils furent renouvellés en y conservant les anciens schémas urbanistiques.

Dans les marchés édifiés sur un terrain plat, les boutiques disposées en file ont les deux murs latéraux mitoyens et ont en général la même hauteur. Dans les terrains escarpés, par contre, elles se déploient les unes après les autres en gradins, constituant de la sorte des blocs de quelques boutiques. La rue entre deux blocs, disposés vis-à-vis, constituait à l'époque un élément important du marché. Elle était toujours pavée dans les anciens marchés, ayant en son milieu un égout servant à l'éloignement des eaux de pluies et étant surmonté par les auvents larges des boutiques. Plus tard, comme cela se voit dans les marchés de Kruje, de Gjirokaster et de Korçe, la rue devient plus large et on y aménage des trottoirs, son milieu est plus élevée pour créer deux égouts latéraux à côté des trottoirs. Ce développement est une conséquence du developpement même de la façade de la boutique.

En général les boutiques sont propriété des établissements religieux, mais les grands féodaux et les hauts fonctionnaires aussi en possèdent une bonne part, vu l'avantage que présente un tel investissement. Une partie infime seulement des boutiques sont propriété des artisans et des commerçants.

La boutique est l'unité de composition base des ensembles de marchés. L'ensemble des boutiques d'un métier, disposées de façon contiguë les unes après les autres sur les côtés d'une rue centrale, constituait la ruelle portant le nom d'un métier donné. En ce qui concerne leurs principaux éléments de composition et leur traitement architectonique, jusque vers la première moitié du XIXe siècle les boutiques se caractérisent par une unité bien distincte. Plus tard, à la suite de la naissance des rapports capitalistes et l'activité toujours plus accrue du marché, on relève une tendance diversifiée dans le traitement des boutiques, alors que leur composition, après avoir acquise certains traits nouveaux, reste un élément d'unité stable.

Une caractéristique fondamentale de la fonction de la boutique est le fait que celle-ci est une boutique-atelier, donc un lieu où à la fois l'artisan produit et vend sa marchandise.

Du point de vue fonctionnel, on relève dans la boutique trois éléments constitutifs: le lieu de travail, la partie destinée à l'exposition de la marchandise et la partie destinée à la conservation des matières premières ou des produits finis. Pendant un certain temps, les deux premières unités ne constituaient qu'un seul volume. Les choses se passaient de la même manière dans les boutiques simples en ce qui concerne sa troisième composante, mais souvent celle-ci constituait un volume à part. Naturellement, le métier qui y était exercé a influé aussi sur le caractère de la composition des boutiques. En général, dans la première moitié du XIXe siècle, celles-ci sont à un étage et à envíron 50 cm. du niveau de la rue, mais il y avait aussi des boutiques à deux étages bien avant cette période de temps. A partir de la deuxième moitié du XIXe siècle, la boutique à deux étages devient un phénomène habituel, on construit même des magasins à trois étages. Sur le pln du traitement architectonique, la partie de la boutique présentant le plus d'intérêt est sans doute sa devanture. Elle en constitue en même l'élément qui a subi une évolution remarquable dans le temps. La partie

PUBLIKOHET

DO NOT COPY

frontale de la boutique, pendant une longue période de temps, et cela au bazar de Kruje jusqu'à récemment encore, a rempli un important rôle fonctionnel, comme lieu destiné à l'exposition de la marchandise et où restait souvent le maître artisan. Il va de soi que pour remplir cette fonction le devant de la boutique devait être ouvert; quant à la sécurité de celle-ci, soit la fermeture de la devanture, elle était assurée par un système portatif appelé «taraba». Le devant de la boutique n'avait de fixe que sa porte d'entrée à un battant amménagée sur un de ses côtés. Quant à l'autre partie, elle était assurée en plaçant successivement des planches de bois, les «taraba», qui glissaient sur deux poutrelles à canal longitudinal au centre de la section. Quant la boutique était ouverte, ces planches étaient placées ou sur l'allongement des poutres du plafond, faisant saillie pour former l'auvent large, ou sur le sofa. Celui-ci constitue un élément important des boutiques à devanture ouverte. Il est construit de pierres, quant le plancher de la boutique est à même le sol; mais quant le plancher est de bois, certaines de ses poutres font saillie en forme de console. Dès le XVIIe siècle les boutiques du pays sont pourvus d'un sofa en planches de bois. Les tarabas continuèrent à être employés dans certains marchés, comme celui de Kruje, jusqu'à ces derniers temps. L'insécurité entraînée par le système des tarabas fit en sorte qu'il fut remplacé petit à petit par un système plus avancé, celui des qepena (une sorte de tabliers de bois). Il est question de panneaux de bois qui se meuvent, au moyen de charnières, face à un axe horizontal. Les plus anciens types de ce système, assurant la fermeture de la devanture de la boutique, comportent deux qepena supérieurs et un inférieur, d'une largeur égale aux deux premières. Les deux qepena supérieurs sont relativement larges, celui inférieur ayant une largeur égalant la saillie du sofa, sur laquelle il est appuyé quand la boutique est ouverte. Les qepena supérieurs, eux aussi, s'ouvrent horizontalement et sont fixés dans cette position au moyen de certains crochets métalliques cloués aux auvents. En vue de faciliter l'opération de fermeture et d'ouverture, parfois les qepena supérieurs ont une largeur double ce qui permet de les enrouler l'un sur l'autre et les fixer horizontalement à travers les crochets mentionnés plus haut. Un important élément fonctionnel et architectonique des boutiques, dont la devanture est assurée par des taraba et des qepena de bois, sont les double auvents larges. Ceux-ci, dégarnis et faisant saillie jusqu'à 1.6 m de la devanture, couvrent de la sorte complètement la rue, entre les deux files de boutiques, où les clients se meuvent tranquillement sans craindre la pluie ni le soleil très fort. Par ailleurs, les auvents servaient aussi à l'exposition des marchandises, qui, accrochées à des éléments de bois, donnaient la possibilité au client de les observer et de les choisir soigneusement avant de les acheter. Donc, du point de vue fonctionnel, la boutique englobait aussi l'espace de la rue couverte par l'auvent. Vers la fin du XIXe siècle, tout d'abord dans les centres plus avancés, les devantures des boutiques sont assurées par des tabliers et des stores métalliques. Les tabliers métalliques, constitués par des panneaux longs et fixés en forme d'accordéon, s'enroulaient autour de certains axes verticaux au moment de l'ouverture ou de la fermeture de la boutique. Entre-temps, les stores métalliques s'enroulaient autour d'un axe horizontal dans la partie supérieure du magasin. L'introduction de cette nouvelle méthode de sécurité entraîna la disparition des auvents caractéristiques; et cela, en général, dans les marchés en reconstruction pour divers motifs et en une époque caractérisée par le renforcement de la couche des artisans et des commerçants. L'adoption de nouvelles formes dans le traitement des devantures à des fins de sécurité ne signifie aucunement qu'on avait renoncé à construire les anciens types de boutique. Dans notre cas aussi, comme dans la plupart des différentes catégories architectoniques, les anciennes formes ont continué d'exister à côté des formes plus modernes, voir même ces dernières manquent absolument dans certains marchés, par exemple au bazar de Kruje. Cela s'explique par le différent degré de développement économique des centres urbains, ainsi que par la différentiation qui s'était produite parmi les diverses couches d'artisans et de commerçants.

Pendant la deuxième moitié du XIXe siècle, le bois d'oeuvre est remplacé de plus en plus par des éléments métalliques et parfois par des voûtes. En général, on relève la tendance marquée à l'usage de matériaux de construction plus solides et incombustibles. Le danger d'incendies a constitué toujours un problème important pour les complexes de marché. La grande compacité des édifices, le large emploi du bois d'oeuvre, l'accroissement de la population et le service insuffisant des pompiers ou le manque absolu de ce service dans certains cas, ont fait en sorte que les incendies n'ont épargné aucun marché, en réduisant parfois en cendres des files entières de boutiques. Ce sont par ces fléaux que s'explique souvent la reconstruction des boutiques incendiées selon les acquisitions de l'époque, en ne touchant pas toutefois aux parties épargnées du marché par le feu. Ce sont par ces mêmes circonstances que s'explique, entre autres, la variété des formes architectoniques caractérisant le même marché.

Afin de préserver la sauvegarde des marchandises de valeur à l'encontre des incendies et des vols, dans certaines villes on commença à construire des marchés couverts (bezisten), en les incluant dans l'ensemble du bazar.

Le bezisten, en tant que complexe comportant un grand nombre de boutiques à plusieurs pièces, fait son apparition dès le XVIIIe siècle à Kavaje, Berat et Shkoder. De leur nombre, celui de Shkoder, édifié en plein centre du marché, en constitue l'exemplaire le plus typique et le plus réussi de ce genre chez nous. Cette construction de forme quadrangulaire allongée, comporte une brisure marquée sur son mur longitudinal du côté N.-E. C'est à l'intérieur de l'espace entourée de hauts murs du bezisten, en forme de deux rangées face à la rue que la construction traverse en direction longitudinale, que se dressent les boutiques.

Le bezisten de Shkoder avait quatre portes, dont les deux principales amménagées au milieu des façades latérales, pour y accéder et en sortir, et deux autres, d'une importance secondaire, presque au milieu des murs longitudinaux.

Une autre catégorie de constructions faisant part souvent et en grand nombre des ensembles de marchés sont les auberges (han).

Le développement du commerce avait entraîné la nécessité de construire des locaux afin d'héberger les clients ou les vendeurs de divers produits, notamment les paysans, qui venaient souvent en ville avec leurs bêtes de somme. La construction des han, selon toute vraisemblance, est contemporaine de celles des marchés. Au XVIIe siècle, c'est là un phénomène habituel dans les villes du pays. Quant à leur composition, en général elles se caractérisent par un contour fermé, à l'intérieur duquel s'étend une cour ample où regardent les façades des constructions à deux étages. En général, l'étage au rez-de-chaussée servait d'étable aux bêtes de somme des clients. Ces derniers logeaient au premier étage de l'immeuble, où il y avait plusieurs chambres alignées les unes après les autres. Par devant celles-ci s'étendait une espèce de tchardak étroit assurant la communication entre les diverses pièces de l'étage.

Actuellement, il ne reste plus chez nous qu'un petit nombre de han. Le plus en vue est celui de Korçe, portant le nom d'«Elbasan». Son schéma planimétrique reproduit un contour fermé pentagonal circonscrivant une cour vaste, au milieu de laquelle se trouve un puits. Cette auberge montre diverses phases de construction. Elle est à deux étages, les pièces se trouvant au rez-de-chaussée faisant fonction d'étable et d'entrepôt. Au premier étage s'alignent les unes après les autres les chambres à coucher, par devant lesquelles se développe une galerie large, en forme de tchardak, faisant fonction de liaison. Cet édifice se dresse à l'intérieur du complexe du marché et sa porte principale donne sur une des rues la plus importante.

De pair aux bezisten et han, dans les complexes de marchés on trouve une série d'autres constructions comme cafés, magasins, etc. Ceux-ci sont en grand nombre et spacieux surtout dans les centres exerçant le rôle de marchés importants pour des zones vastes et de lieu de transit et de distribution des marchandises.

o
o o

Comme tous les monuments architecturaux, les ensembles de construction des marchés comportent des éléments d'un grand intérêt historique et architectonique. Ce sont des témoignages tangibles du niveau de développement atteint par les différents centres urbains, parce que c'est justement dans les marchés que s'accomplissait le processus de la production artisanale, qui déterminait, en dernière analyse, le degré d'urbanisation du centre habité. Vue la grande valeur de ces ensembles, en 1961 par décision du Conseil des Ministres, outre la proclamation de Gjirokaster et de Berat comme villes-musée, le vieux bazar de la ville de Kruje fut pris en protection par l'Etat. Successivement, des décisions analogues furent adoptées pour les marchés de Gjirokastër et de Korçe. La mise de ces ensembles sous la protection de l'Etat entraîna, naturellement, la réalisation de travaux de restauration, d'autant plus que certains de ces marchés se trouvaient dans un état de dégradation qui ne faisait qu'empirer de jour en jour. Les critères de restauration de ces complexes, quoique se conformant aux principes généraux régissant la matière, présentaient quand même des problèmes particuliers en raison de leurs caractéristiques distinctes dans l'ensemble de notre héritage architectonique. Les principes fondamentaux de la restauration, tels la conservation avec rigueur des valeurs authentiques du monument tant sur le plan de la composition que sur celui du traitement des différents composants architectoniques, le respect des diverses phases de construction, la consolidation des pièces ou des éléments détériorés ou la substitution de ceux endommagés entièrement, conservent toute leur valeur même pour ce qui est ce genre architectonique. Quant aux problèmes particuliers, ce ne sont que des phénomènes d'importance secondaire. De leur nombre il convient tout d'abord de mentionner le rapport existant entre ces ensembles et la ville en développement, du fait que dans les marchés des villes-musée ce problème a été résolu dans le cadre des règlements disciplinant la matière. Afin de faire ressortir mieux la valeur de ces ensembles, dans les centres non proclamés encore villes-musée il a été décidé de créer aux environs des ancien marchés des zones vertes ou bien de faire en sorte que les nouvelles constructions soient ralisées dans le plus grand respect de l'ensemble-monument, surtout pour ce qui concerne le traitement des volumes, le traitement architectonique et les couleurs.

Une autre caractéristique de la restauration des marchés consiste dans le fait de respecter tous les composants urbanistiques et de l'environnement, en tant qu'éléments de grand intérêt et de valeur de ces ensembles. Il fallait ensuite aborder le problème de savoir la fonction qu'allait remplir ces complexes dans la vie quotidienne. La solution apportée à ce problème ne pouvait ne pas influer sur la mesure de l'intervention et sur les critères de la restauration. En cette matière, nous nous sommes guidés sur le principe de conserver à ces complexes leur fonction originale, et cela dans la limite du possible.

La question du comportement à l'égard de l'évolution dans le temps de ces ensembles a toujours été résolue selon les principes connus du respect de la contribution apportée par chaque époque sur le plan de la construction. Ainsi, la restauration des marchés s'est guidée sur le principe de conserver leurs éléments constitutifs, indépendamment de la période de leur édification, en mettant de la sorte l'accent sur les traces de leur évolution dans le temps.

La restauration des ensembles de marché fut entamée chez nous en 1965, immédiatement après la création de l'Institut des monuments de la culture. Tout d'abord fut restauré le bazar de Kruje, puis celui de Gjirokaster, alors que les travaux pour la restauration du marché de Korçe sont en cours.

Lorsque le bazar de Kruje fut placé sous la protection de l'Etat, il se trouvait dans un mauvais état technique et il avait

DOKTORI

été presque abandonné. Toutes ses structures portantes, ainsi que divers autres éléments de cet ensemble: taraba, qepena, portes, etc, se trouvaient dans un état de dégradation totale. En plus il ne restait de cet ensemble que trois groupes, ses autres parties ayant été rasées. Dans ces conditions, il fut décidé d'entamer la restauration de ces trois groupes, ce qui nous aurait permis de nous faire une idée claire de la nature et des caractéristiques de cet ensemble.

Ce n'est qu'après avoir complété la documentation graphique, descriptive, photographique et cinématographique et porté à terme l'étude minutieuse du caractère et de l'évolution de cet ensemble dans le temps, que fut dressé le projet de sa restauration. Le fait qu'il était en train de tomber en ruine, dicta la nécessité de le reconstruire totalement. Cette décision découlait des conditions de fait rendant impossible la conservation de ses éléments originaux. Dans l'élaboration du projet de restauration nous nous sommes guidés sur le critère suivant: procéder à la reconstruction de cet ensemble en en respectant la composition volumétrique et planimétrique, la formulation architectonique de ses éléments, sa technique de construction et les matériaux de construction qui y avaient été employés. La seule modification apportée au schéma planimétrique consiste dans le fait d'avoir réuni parfois deux ou trois boutiques en une seule unité volumétrique et de ne pas avoir mis en place les cloisons séparant la boutique elle-même de son annexe. Ce fut là une nécessité dictée par la fonction qu'allait exercer cet ensemble après sa restauration. Les travaux de restauration furent poursuivis pendant les années 1965-1966.

En général l'état technique dans lequel se trouvait le marché de Gjirokaster, au moment de sa prise en protection par l'Etat, était satisfaisant. Les constructions des murs, et en partie celles du toit, étaient solides. Les parties les plus détériorées exigeant un traitement radical étaient les vues extérieures. Avec le temps, les vitrines, les portes et le crépissage avaient été gravement endommagés et une bonne part des pierres travaillées étaient couvertes de chaux. En conséquence, il fallait intervenir dans tout l'ensemble. Les travaux furent menés à bonne fin dans les années 1967-1968. Ils concernèrent toutes les vues extérieures du complexe du marché, entre autres le crépissage des murs, la reconstruction des vitrines et des portes, ainsi que des éléments se trouvant à l'intérieur des boutiques comme plancher, plafond, crépissage, etc. En plus, les trottoirs des rues furent revêtus de dalles de pierre.

Pendant les années 1976-77, on a effectué aussi, suivant les mêmes critères, la restauration d'une partie du marché, aux environs de l'obélisque dédié aux pionniers de l'enseignement et de l'école albanaise. Ainsi, aujourd'hui ce complexe est restauré dans son ensemble. Malgré cela, les travaux se poursuivent pour la consolidation surtout des structures des tois.

Le marché de Gjirokaster, qui rentre dans le centre historique de la ville-musée de Gjirokaster, fait part de la zone-musée. Vu que le règlement en vigueur pour la ville-musée de Gjirokaster n'autorise pas la mise en place de nouvelles constructions dans la zone-musée, le marché de cette ville fonctionne, comme auparavant, en incluant en son sein la plus grande part des magasins de vente et certains édifices gouvernementaux de la ville. Son état actuel satisfaisant, et en général sa restauration réussie sur le plan de la composition et du traitement, font en sorte que cet ensemble est en mesure de satisfaire au mieux les exigences que sont celles du centre historique de la ville-musée de Gjirokaster.

Le marché de Korçe, comme les autres marchés du pays, se trouvait dans un mauvais état technique. C'est pourquoi, depuis 1974 furent entamés des travaux encore en cours pour la restauration de cet ensemble. Ils concernent surtout les structures des toits, le traitement à nouveau des principales vues extérieures et les trottoirs, ainsi que l'intérieur des boutiques.

Ses travaux se poursuivent dans le respect des formes architectoniques originales et en y employant les matériaux de construction de l'époque. De pair à la restauration, ce marché est en train de regagner principalement sa fonction de centre commercial. Dans le même temps, dans certaines de ses unités, et cela à leurs étages supérieurs, seront installés les locaux des services communaux et éventuellement les bureaux de différentes institutions, ce qui n'affectera aucunement les valeurs historiques et architectoniques de cet ensemble.

DO NOT COPY

Genc SAMIMI

DO NOT COPY

TË DHËNA MBI ARKITEKTURËN E BANESËS POPULLORE NË KRAHINËN E SKRAPARIT

Rrethi i Skraparit shtrihet në pjesën jugore të vendit tonë. Në këtë krahinë mundet të shkohet duke ndjekur rrugën automobilistike gjatë rrjedhjes së kundërt të lumit Osum i cili në thellësi të zonës ka çarë formacionet shkëmbore në formë shtresash duke krijuar një pamje madhështore dhe piktoreske në anët e tij. Përveç lumit Osum krahina e Skraparit[1] përshkohet dhe nga lumi i Tomoricës që rrjedh në pjesën lindore të malit të Tomorit. Luginat e krijuara nga lumenjtë dhe përenjtë që derdhen në to kanë favorizuar dhe mundësinë e vendosjes së popullsisë dhe banesave në këto zona. Pjesa më e madhe e fshatrave shtrihet në anën e dy lumenjve por ka edhe fshatra të veçuara në zonat e thella malore. Terreni i kësaj krahine megjithëse përshkohet nga dy lumenjt është mjaft i thyer, me kodra të thepisura dhe brigje shkëmbore, klima është kontinentale dhe me bimësi të dobët. Kjo krahinë nuk mbyll në vetvete një unitet etnografik mbrenda saj, karakteristikat etnografike të saj gjinden edhe në krahinën fqinje[2]. Në të kaluarën popullsia ka qenë marrë me blegtori dhe me bujqësi. Produktet blegtorale tregtoheshin në rrethet fqinj të Skraparit si në Korçë — Berat dhe Këlcyrë. Duke qenë një vend i varfër në të kaluarën një pjesë e popullsisë emigronte për të gjetur punë ose merrej edhe me zejtari[3]. Deri tani ekzistojnë të dhëna të përgjithshme gjeografike etnografike dhe historike për zonën e Skraparit, por njohuritë tona mbi banesën karakteristike, mbi zhvillimin e arkitekturës së saj na mungojnë. Duke pasur parasysh këto mungesa u planifikua eksplorimi dhe studimi i kësaj zone.

Krahina e Skraparit në vitin 1431 përfshinte 24 Timare që përmbledhin gjithsej 66 fshatra[4] (fig. 1). dhe në vitin 1672[5] rrethi i Skraparit përfshinte gjithsej 47 fshatra; ndërsa vetë qyteti i Skraparit kishte një kështjellë, brenda së cilës gjendeshin gjithsej 45 banesa dhe një varosh poshtë me gjithsej 100 shtëpi të mbuluara me tjegulla. Në vitin 1833-1834 Skrapari varej nga mytesarifi i Beratit dhe përfshinte 60 fshatra të gjitha myslimane me gjithsej 2300 shtëpi dhe rreth 13000 banorë.

Gjatë Luftës së parë Botërore Skrapari pësoi mjaft dëmtime, shumë banesa u shkatërruan[6]. Pas luftës shumica e këtyre banesave u rindërtuan mbi the-

1) J. Gjinari **E folmja e Skraparit** B.U.SH.T. Nr. 1 1958, fq. 86-87. «Në këtë pjesë në veri të Skraparit shtrihet lugina e vogël e lumit Tomoricë. Kjo luginë përbën në vetvehte një krahinë të veçantë që mer emërin e lumit, por duhet thënë këtu se banorët e kësaj ane e inkuadrojnë krahinën e tyre të vogël në krahinën e madhe të Skraparit dhe e quajnë vehten Skraparllinj. Gjatë hetimeve nuk vërejtëm ndonjë diferencë etnografike dhe gjuhësore midis Tomoricës dhe pjesës tjetër të Skraparit nuk kemi të bëjmë aty me dy rrethe të veçantë».

2) **Historia e Shqipërisë** I, Tiranë 1959 fq. 326. Me mijra fshatarë u shpërngulën nga bregdeti i Himarës e u vendosën në malësitë e Kurveleshit, nga Myzeqeja e në malësinë e Beratit dhe Skraparit.

3) Të dhëna gojore të mbledhura nga fshatarë të moçëm nëpër fshatra.

4) H. Inalçik **Suret-i defter-i sancak-i Arvanid.** Ankara 1954.

5) E. Çelebi **Sejahatname,** Istambul, 1902, VIII.

6) Nga të dhënat në muzeun historik të Çorovodës rezulton se gjatë luftës së I-rë botërore janë djegur rreth 1000 banesa në zonën e Skraparit.



Fig. 1

melet e vjetra si dhe në truall të ri por duke pasur parasysh edhe tipet e vjetra të banesave.

Nga të dhënat e mësipërme rezultoi se kjo krahinë ka pasur mjaft fshatra në të cilat urbanistika dhe arkitektura e banesës ka pasur zhvillimin e saj, por gjithmonë duhet patur parasysh që kategoria e banesave nga ana konstruktive dhe e shumë faktorëve të tjerë nuk i rezistoi vazhdimësisë së jetesës, kohës, prandaj shumica e tyre u shkatërruan ose transformuan. Banesat origjinale të shek. XVII dhe të gjysmës së parë të shek. XVIII neve sot nuk i trashëgojmë.

Materialin e mëposhtëm mbi të cilin është kryer studimi e kemi mbledhur nga banesat ekzistuese duke mbajtur qëndrim kritik relativ mbi lashtësinë e objektit. Me gjithëse shumë banesa janë zhdukur kjo nuk do të thotë që tipet e tyre kanë ndryshuar aqë më tepër që zhvillimi ekonomik e shoqëror përpara çlirimit për këtë zonë kishte mbetur siç ishte nën Perandorinë otomane.

Gjatë vitit 1974, 1975 dhe 1978 u kryen dhe tri ekspedita në këtë krahinë, për të mbledhur të dhëna mbi arkitekturën e banesës popullore, tipin e saj, evolucionin në kohë dhe karakteristikat në planin arkitektonik dhe konstruktiv. Në këto ekspedita kemi gjurmuar dhe mbledhur material mbi banesën që shtrihet në dy anët e lumit Osum. Në krahun e majtë të tij kemi gjurmuar (fig. 2) fshatrat Therepel, Cerovë, Veleshnjë, Munushter, Çepan kurse në krahun e djathtë fshatrat Dobrushe, Verzhezhë, Radesh, Veseshte, Gradec, si dhe fshatrat e zonës së thellë Potom, Straveck, Helmas, Backë. Në ekspeditat e tjera gjurmuam fshatrat në dy anët e lumit Tomoricë, Çorofet, Zhepë, Greve që ndodhen në krahun e djathtë dhe Ujanik, Gjerbës, Zaloshnjë, Milovë, që ndodhen në krahun e majtë të tij.

Banesa është një ndërtim që trashëgohet brez pas brezi, si e tillë ajo pëson shpesh transformime lidhur me ndryshimin e kushteve social ekonomike të jetës dhe ritjes së familjes prandaj shumë prej banesave që kemi dokumentuar nuk paraqesin në tërësi pjesën e tyre fillestare, megjithatë ruajnë strukturën bazë të vjetër. Shumica e banesave të dokumentuara si më tipiket janë rindërtuar apo ndërtuar pas vitit 1914. Nga sa kemi vrejtuar dhe siç është e kuptueshme fill mbas Luftës së I-rë Botërore për kushtet e vështira një përhapje të gjerë mori banesa përdhese dhe më vonë me rimëkëmbjen ekonomike filloi ndërtimi i banesave në kat.

* * *

Të dhënat e mbledhura lidhur me arkitekturën e banesës së krahinës së Skraparit mundet t'i ndajmë në dy grupe: banesa përdhese dhe banesa në kat. Në grupin e dytë do të përfshijmë dhe banesën me gjysëm kat. Po japim më poshtë një paraqitje të shembujve që mendojmë se janë tipike nga të dy grupet duke rrjeshtuar së pari banesat më të thjeshta dhe duke arritur tek ato më të zhvilluarat.

Banesa në fshatin Valas (fig. 3) është një ndërtim i thjeshtë me një ambient. Ajo ka oxhak dhe është e shtruar me dhe. Banesa me një ambient nuk kemi takuar përveç këtij rasti. Ky shembull mendojmë që paraqet banesën më të thjeshtë të krahinës në kohërat e mëparme. Një zhvillim më të madh paraqet banesa me dy ambiente (fig. 4). Në secilën prej tyre kemi nga një oxhak. Ndërtimi ngrihet në xokël dhe ka një parahyrje të vogël. Kjo banesë me këtë kompozim arkitektonik kohët e fundit është përhapur shumë dhe ka marrë një zhvillim të madh, por natyrisht në trajtimin e saj i përshtatet kushteve të sotme të banimit.

Në tab. I jepet një kompleks në fshatin Helmës me një zgjidhje me interes nga ana arkitektonike dhe urbanistike. Përveç vlerave të sipërme ky kompleks gjatë Luftës Nacional Çlirimtare qe vendi ku jetoi e punoi udhëheqësi i popullit tonë Shoku Enver Hoxha. Në këtë drejtim ato morën vlera historike e muzeale të veçanta. Kompleksi përbëhet nga dy ndërtime njëkatëshe të veçanta të cilat janë vendosur kundrejt njeri-tjetrit. Sipërfaqja ndërmjet tyre formon oborrin të shtruar në formë të çrregullt me pllaka guri, që kufizohet nga perëndimi me mure rrethuese ndërsa nga lindja me portën kryesore të oborrit (Tab. II) e cila është e mbuluar me hark guri e çati me rrasa guri.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESË NË FSHATIN VALAS
SKRAPAR





BANESË NË FSHATIN VALAS
SKRAPAR

Fig. 3







Fig 2

Fig. 2, 3, 4

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

Kjo portë e këtij kompleksi me elementet e saj formon një aspekt mjaft të bukur dekorativ, dimensionet e saj janë racionale dhe harmonike, e pajisur me dy sofa prej guri majtas e djathtas ku banuesit dhe miqtë kanë vend për t'u ulur.

Të dy ndërtimet janë të një kohe, një katëshe, por ndërtimi i sipërm ngrihet mbi një xokol rreth 0,80 – 0,90 m, ndërsa i poshtëmi është përdhes. Banesa e sipërme formohet nga dy ambiente që lidhen në qendër me një korridor të vogël nga hyrja për në banesë, i cili del mbi një verandë të rrethuar me parmakë të thjeshtë druri që mbrohen nga zgjatimi i flegrës së çatisë. Ndërtimi i poshtëm përbëhet nga dy pjesë, shtëpisë së zjarrit në të djathtë dhe ahrit në të majtë. Ahri komunikon me oborrin, drejt për drejt me rrugën dhe gjithashtu lidhet me shtëpinë e zjarrit nëpërmjet dyerve të veçanta. Sipërfaqja e tij është e ndarë me perde gardhi për të veçuar bagëtitë e imta dhe të trasha. Shtëpia e zjarrit e pajisur me oxhak ruan gjurmët e një furre. Vetë ajo është përdhese dhe pa tavan. Kjo zgjidhje arkitektonike e këtij kompleksi tregon se kemi një ndarje të qartë funksionale ndërmjet shtëpisë së zjarrit, ahrit, ambienteve të pritjes së miqve dhe ndejtjes, fenomen mjaft i përhapur në zonën e thellë të krahinës së Skraparit.

Një karakteristikë tjetër e këtij kompleksi lidhur me ruajtjen e pastërtisë në oborr është kanali që mbledh ujërat e shiut dhe që zgjatet gjatë gjithë gjatësisë së oborrit dhe shtëpisë së zjarrit. Ambienti sanitar është ndërtim i veçantë jashtë oborrit, po kështu kasollja e kashtës dhe koteci i pulave janë ndërtuar pranë kompleksit të banesës.

Po kalojmë tani në paraqitjen e shembujve më tipikë të banesave me kate. Së pari po paraqesim një banesë me kat buzë lumit Osum (fig. 5) sot e pa banuar. Banesa është një ndërtim kompakt prej dy ambientesh të vendosura nën njeri-tjetrin (Tab. III a) të cilat ndërlidhen me shkallë të mbrendshme guri ndërtuar në pjesën fundore të banesës. Konfiguracionin katërkëndësh kënddrejtë të planimetrisë e thyen një dalje në formë kulle në cepin e banesës në të cilën është ndërtuar ambienti sanitar. Kati përdhes duket qartë se është ndërtuar në funksionin e ahurit ndërsa kati i sipërm përdoret nga kthina e vetme e banimit. Në të gjejmë të ndërtuar oxhakun, ndërsa përpara hyrjes për në ambientin sanitar është ndërtuar avdesana. Banesa mbulohet me çati katërujëshe.

Banesa tjetër (Tab. III b) (fig. 6) është një ndërtim me kat me dy ambiente nga një për çdo kat por me dallim nga banesa e parë. Në vendosjen e saj lidhur me terrenin një anë e muraturës së katit përdhe është e bashkangjitur me të kështu që lejon që në pjesën e mprapme të katit të sipërm të hyet direkt nga jashtë nëpërmjet një dere të hapur. Ambienti sanitar është i bashkangjitur me pjesën kryesore të banesës. Në dhomën e sipërme është ndërtuar oxhaku (fig. 7), i cili ka pësuar ndryshime në kohë. Si në të gjithë banesat fshatare oxhaku ka qenë i hapur gjatë gjithë pjesës së lartësisë së tij mbrenda në dhomë, mbyllja e tij fillonte në pjesën e sipërme rreth 20-40 cm nën nivelin e strehës së çatisë vetëkuptohet për të mbrojtur konstruksionin prej druri të çatisë. Oxhaku nuk ruan fazën fillestare të ndërtimit të tij, në të duket qartë ndryshimi që ka pasur në kohë. Gjatë mbylljes ai është ulur, ka marë formën e oxhaqeve të zakonshëm. Anash oxhakut janë dy kamare, elemente të

DO NOT COPY

përhershëm të kompozimit, të cilat shërbejnë për vendosjen e objekteve të ndryshme të shërbimit. Dhoma ka dy dritare dhe një derë të zënë në drejtim të fasadës. Simbas të dhënave gojore kjo derë është hapur më vonë dhe ka qenë e pajisur përpara me shkallë druri për t'u ngjitur në katin e sipërm. Mbulesa e derës është trajtuar me hark guri. Shtresa e dyshemesë e katit të sipërm është me dhe. Një kapak i hapur në pjesën anësore të dyshemesë prej dheu mbi të cilën kalohej në ambientin sanitar, lejonte ndërlidhjen me katin e poshtëm nëpërmjet një palë shkallëve prej guri që për mendimin tonë janë shkallët origjinale të banesës. Kati i poshtëm përdorej vetëm për mbajtjen e bagëtisë. Në këtë kat gjenden tre frengji, dy në murin e fasadës dhe njeri anash, që kanë shërbyer për ajërimin dhe ndriçimin e ambientit të kafshëve. Dera nga hynte bagëtia, ruan akoma sistemin e vjetër të mbylljes nga brenda me katarah. Nga të dhënat rezulton se kjo është banesa më e vjetër e fshatit se ajo nuk ishte djegur gjatë Luftës së I-rë dhe ruante fazën fillestare. Sot ajo thirret Ahur dhe në të prej kohësh nuk banonte njeri.

Banesa e tretë (tab. III fig. c) është një ndërtim me kat me dy ambiente, por në dallim nga dy rastet e parë (tab. III). Këtij ndërtimi (fig. 8) i mungon katoi, kështu që të dy ambientet janë për banim. Nga të dhënat gojore rezulton se kjo shtëpi ka qenë banesa e miqëve e një kompleksi më të madh banimi. Për vetë funksionin e saj në këtë banesë kemi një trajtim më të përpunuar të paretit që ndan hapësirën e kafazit të shkallës nga të dy ambientet e banimit. Ambienti sanitar, në dallim me rastet e mëparshme përfshihet brenda kontureve të planimetrisë. Ndërlidhja midis kateve bëhet me shkallë dërrase.

Banesa dy katëshe e ndërtuar në fshatin Çepan në vitin 1930 (Tab. III fig. d) sipas dëshmive gojore përsërit për nga kompozimi një tip të lashtë (fig. 9). Karakteristikë e kësaj banese në dallim nga rastet e mësipërme është se ndërlidhja midis dy kateve sigurohet nga shkallë guri të jashtëme që përfundojnë në një verandë, dyshemeja e së cilës ngrihet mbi kollona guri. Të dy ambientet janë të banuara por për mendimin tonë kjo lloj banese më parë ambientin e katit përdhe nuk e ka pasur për funksion banimi. Kthimi i tij në ambient banimi duket se është fenomen i këtij shekulli.

Një shembull interesant në grupin e banesave me kate paraqet një banesë në fshatin Veleshnjë (fig. 10; Tab. IV). Kompozimi i saj volumor është me gjysëm kat duke pasur në katin përdhe katoin dhe sipër tij dhomat e zjarrit dhe të miqëve. Katoi është i pajisur me frengji ndriçimi që shërbenin edhe për ajrimin e ambientit ndërsa në katin e sipërm dhoma e miqëve ka tri dritare, dy në fasadën kryesore dhe



Fig. 7



Fig. 8

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 11

një në atë anësore, si dhe oxhakun. Dhoma e zjarrit ka pësuar disa ndryshime, si hapje dritaresh. Në Tab. IV) paraqitet nj variant tjetër i banesës me gjysëm kat më e zhvilluar nga ana kompozicionale. Banesa është e variantit gjysëm kat por me funksionin e katit përdhe për banim (kjo duket nga lënia e dritareve në katin përdhe) dhe dy ambiente në katin e sipërm që ndërlidhen me katin e poshtëm me një palë shkallë të jashtme prej guri. Ambientet e sipërme ndahen nga një paret i hollë prej gardhi. Kjo banesë është ndërtuar kohët e vona për arsye se këtu kemi eliminimin e katit përdhe që është ambient për strehim të bagëtisë dhe kalimin në një variant të ri të tipit të banesës me gjysëm kat në atë të shfrytëzimit të katit përdhe për banim.

Në tab. V, paraqitet një banesë në fshatin Çerovë. Anash banesës kryesore dy katëshe është vendosur lëmi i cili është rreth 40 cm më e ulët nga niveli i shtresave të pllakave prej guri në anën e sipërme të



Fig. 10



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 15

oborrit. Anash lëmit ndodhet një ambient për depozitimin e kashtës. Banesa në anën veriperëndimore ka një pus. Sipas thënieve të pronarit, banesa është e ndërtuar në themelet e banesës së vjetër e cila është shkatërruar. Sot kati i poshtëm nuk përdoret më si përpara për bagëti por për banim. Qarkullimi nëpër banesë është zgjidhur mjaft mirë, ajo ka dy hyrje një nga (fig. 11) ana e sipërme nëpërmjet disa këmbë shkallësh që shërben për miqtë dhe një nga ana e poshtëme për njerëzit e familjes. Kompozimi i ambienteve është i njejtë për të dy katet, ku ndodhen shkallët në pjesën qendrore dhe anash saj dy dhoma të paisura me oxhakë.

Në fshatin Greve banesa (Tab. VI) paraqet interes nga ana kompozicionale (fig. 12). Ajo është dy katëshe. Kati i parë formohet nga dy katoj dhe një koridor ku janë vendosur shkallët për në katin e dytë. Në të kemi dy ambiente banimi, pranë secilit kemi të ndërtuar ambientet sanitare që dalin jashtë konturit të planimetrisë. Dhoma e mirë përveç ambientit sanitar ka dhe sqollin, ndërsa tjetra është e ndarë me një perde druri të suvatuar me të cilën janë ndërtuar musandra. Kjo banesë në katin e sipërm ka një çardak të vogël sa zë gjerësia e korridorit.

Gjatë eksplorimit në fshatin malor të Veseshtës u rilevuan dy banesa, më të vjetrat në fshat, që kishin



Fig. 14



Fig. 16

DO NOT COPY



Fig. 17

shpëtuar dhe nga djegia gjatë Luftës së I-rë. E para paraqitet në fasadë si banesa e fshatit Grece, (Tab. VI; fig. 14) por me një ndryshim që ajo në pjesën e sipërme nuk ka çardak. Banesa ka si elemente të kompleksit të saj lëmin përpara hyrjes, depo për kashtë të vendosur larg godinës kryesore dhe kopshtet pranë shtëpisë. Banesa kryesore është dy katëshe pak e futur në pjesën qendrore me nga një ambient në çdo kat: Kati parë është përdorur për strehimin e bagëtisë ndërsa kati i dytë ka dy ambiente nga të cilat njera dhomën e mirë dhe tjetra dhomën e zjarrit. Secili i pajisur me nyjen sanitare. Nga vrojtimi me kujdes i banesës rezultoi se në fazën fillestare ndërtimi ishte dy katësh por me nga një ambient në çdo kat. Më vonë ai ishte shtuar dhe kishte marrë konfiguracion, zgjidhjen planimetrike të sotme në bazë të shtimit të nevojave për strehim të familjes fshatare. Konkluzioni i shtesave është i qartë. Po të shikohet muratura e vjetër është me breza druri të dukshme që banesa e re nuk i ka, trajtimi i dritareve është më kanate dhe kapakë, banesa e re ka ndryshuar në nivelin e çatisë ndërsa dhoma e re e ka oxhakun të mbyliur.

Rëndësi ka fakti se në këtë ndërtim zhvillohen tipat e vjetër të banesave në këtë krahinë, si marrin ato zgjidhje të re planimetrike në drejtim të kërkesave për shtesë të ambienteve të banimit, dhe si më vonë ato përdoren si tipe të veçanta.

Në Tab. VII b fig. 15 jepet një banim me dy kate me shumë interes nga zgjidhja planimetrike. Banesa ndodhet në fshatin Zhepe. Nëse do t'i referohemi planimetrisë do të kuptojmë se zgjidhja kompozicionale e kësaj banese ka lindur nga bashkimi i banesave në kat me një ambient banimi dhe i banesës me kat në dy ambiente banimi. Siç shikohet kjo banesë në të dy katet është e banueshme. Kompozimi i saj nga mjeshtri popullor në një bashkim të frytshëm të dy varianteve të njohura ka zgjidhur mjaft mirë lëvizjen e miqëve në banesë, të cilët kanë hyrje dhe ambiente sanitare të veçanta.

Në Tab. VII a, fig. 16 jepet një ekzemplar i rrallë banese e kësaj krahine, banesa me kullë. Nga zgjidhja planimetrike kuptohet që kulla është e futur brenda konturave katërkëndëshe të banesës. Ajo është e vendosur në skajin e planimetrisë në drejtim të lindjes. Dy mure të saj që intersektohen duke dhënë qoshen, japin njëkohësisht dhe qoshen e banesës. Këto mure lartësohen sa sipërfaqja e kullës dhe japin volumin e saj. Kulla është tri kate. Në katin përdhe ka një herë e cila ka shërbyer për futjen e bagëtisë, kati i dytë ka shërbyer për ndejtje, ka oxhak, derë, kamare, në katin e tretë ngjitesh nëpërmjet një palë shkallëve (sot të prishura, ekzistojnë gjurmët në mur) të cilat janë vendosur jashtë sipërfaqes së mbrendshme të kullës për në dhomën e mirë të banesës. Edhe ky kat ka oxhak dhe dy dritare të vogla. Kjo banesë përveç kullës ka dy ambiente në katin përdhe të bashkangjitur njeri me tjetrin ku në të parin janë vendosur shkallët prej guri për në katin e sipërm, ndërsa sipër po prapë kemi dy ambiente. Ambienti sanitar është krijuar në sheshpushimin e shkallëve dhe shërben për të dy dhomat.

Në tab. VIII jepet një kompleks interesant në të cilin banesa paraqet një variant të zhvilluar me kate. Ky kompleks përbëhet nga dy banesa që siç thamë është një ndërtim dy katësh, pranë saj gjejmë të ndërtuar shtëpinë e zjarrit dhe ambientin sanitar. Jashtë oborrit të brendshëm të rrethuar me mure gjejmë të ndërtuar lëmin dhe pranë tij kasollen e kashtës. Më larg tyre është ndërtuar një lëm i dytë dhe stalla e bagëtive. Kompleksit nuk i mungon dhe koteci i pulave. Me interes është të shënojmë se në anën verilindore është ndërtuar pusi. Banesa është e veçuar nga shtëpia e zjarrit dhe formohet nga katër ambiente banimi dy në çdo kat, që ndërlidhen respektivisht me dy sallone, në njerin prej të cilëve janë ndërtuar shkallët prej druri.

Në tab. IX fig. 17 jepet faza më e zhvilluar e një kompleksi. Banimi në zonën e thellë të krahinës, siç shikohet edhe nga planimetria; kompleksi përbëhet nga dy ndërtime të vendosura kundrejt njeri-tjetrit të bashkuara me muraturë rrethuese prej guri në mënyrë që të krijohet një oborr i brendshëm. Ndërtimi kryesor është dy katësh me ambient banimi si në katin

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

e poshtëm ashtu edhe në atë të sipërm. Parahyrja në katin e poshtëm është krijuar nëpërmjet dy kollonave prej guri të bashkuara sipër me harqe guri. Ky ndërtim përdoret vetëm për pritje dhe fjetje. Kjo banesë sot është e ndarë për dy familje me dy palë shkallë. Edhe ndërtimet ndihmëse janë bërë për dy familje. Nga planimetria rezulton se kemi dy dhoma zjarri të vendosura në skaje dhe ndërmjet tyre dy ambientet për strehimin e bagëtisë. Duhet të theksojmë se mjaft me interes janë trajtuar dyert e hyrjes për në oborr për të dy familjet dhe se pranë një hyrje ndodhet pusi.

Së fundi po japim një banesë të ndërtuar në fshatin Dobrushë Tab. X fig. 18. Për nga kompozimi ajo duket se është një ndërtim për një familje të madhe patriarkale. Në afërsi të ndërtimit ndodhen të gjitha objektet e nevojshme për ekonominë fshatare, si lëmi, depo kashte, stalla bagëtie, pusi, e objekte të tjerë. Ky ndërtim është ngritur pasi është rënuar ndërtimi i vjetër, por në bazë të kërkesave të reja të jetesës.

Ekzemplarët e banesave që trajtuam dhe karakteristikat e tyre mendojmë se ishin më tipike për këtë krahinë.

Mjeshtrat popullorë që kanë ndërtuar këto banesa në këtë zonë nuk kanë qenë vendas, por ata vinin çdo vit në periudha të caktuara nga krahina e Oparit dhe e Përmetit. Sipas profesionit këto mjeshtra ndaheshin në muratorë të cilit ishin nga Opari dhe marangozë nga Përmeti. Të parët ndërtonin muret, hidhnin çatinë dhe e mbulonin atë, kurse të dytët kryenin suvatimet dhe punimet e drurit. Muratorët nxirrnin dhe transportonin me kafshët e tyre gurin, ndërsa porositësi i cili ndihmohej nga i gjithë farefisi siguronte gëlqeren dhe lëndën njëkohësisht, merrte përsipër ushqimin dhe duhanin për mjeshtrit. I gjithë materiali sigurohej nga kavot dhe pyjet pranë fshatit. Në të gjithë krahinën ndërtimi kryhet me gurë dhe mbulohet me rasa guri, muratura lidhet me breza druri kurse si material lidhës përdoret balta e punuar dhe ndonjëherë llaç gëlqereje.

Ambientet më përpara kanë qenë shtruar me dhe sipër binarëve që mbështeteshin në trarët e dyshemesë, por ka dhe shumë raste që ato janë shtruar me dërrasa. Dritaret në përgjithësi mbulohen me arkitrarë prej guri por nuk mungon dhe përdorimi i harkut, gjysëm rrethor (Tab. 11). Interesante është përdorimi i shpeshtë në dritare i një kafazi prej druri. Nëpër çatitë përdoret konstruksioni me baballëk duke krijuar çati me konstruksion të dyfishtë në mënyrë që të shfrytëzohen sa më shumë elemente druri të hollë.

Fshatrat e krahinës së Skraparit janë të grumbulluara, grupimet e lagjeve janë në bazë të lidhjes së gjakut (fig. 19). Siç shikohet dhe nga materiali i dhënë një përhapje të gjerë në këtë krahinë ka pasur banesa me kate kryesisht me një apo dy ambiente banimi, krahas kësaj është ndërtuar dhe banesa përdhese me një apo dy ambiente banimi duke shprehur qartë diferencimin klasor të popullsisë së kësaj krahine. Duke krahasuar banesën përdhese të krahinës së Skraparit me atë të Kurveleshit të sipër, vërejmë ngjashmëri vetëm se në këtë krahinë banesa përdhese me dy ambiente banimi me hyrje të veçantë si ato të Kurveleshit të sipërm nuk ka. Në banesat me kate me një ambient banimi, në

katin e sipërm dhe me katua në katin e poshtëm, koncepti i vjetër i ndërtimit ka qenë me shkallë të brendshme guri, ndërsa më vonë ky koncept ndërtimi ndryshon dhe me shndërrimin e ambientit të poshtëm në ambient banimi shkallët vendosen jashtë prej guri ose bëhen dhe të brendshme po prej druri. Mungesa e datave të ndërtimit e bën të vështirë një vendosje të saktë në kohë të këtyre banesave, por nga sa thonë dëshmitë gojore mundet të pohohet që banesa me kate është ndërtuar nga fillimi i shekullit 19. Në banesat me kate ka ekzistuar një ndarje e qartë funksionale ndërmjet katit përdhe që shërbente si strehë për kafshët dhe katit të sipërm. Mbas Luftës së I-rë Botërore në periudhën e rindërtimeve mbas shkatërrimeve nga Lufta fillon gjerësisht kthimi i katit përdhe në kat të banuar.

Në bazë të shtimit të kërkesave për strehim të familjes, tipi i banesës me kat me një ambient banimi në katin e sipërm ka marrë formën e banesave me kate me dy ambiente banimi në katin e sipërm. Shumë mirë duket ky evolucion nëpërmjet shtesës së ndërtimit (fig. 13; Tab. VI b). Më vonë kjo lloj banese ka marrë formën e një tipi të veçantë duke u zhvilluar pozitivisht në bazë të kërkesave të reja. Në zonat e thella të krahinës së Skraparit kanë një përhapje të gjerë komplekset e mbyllura të banimit që formohen nga dy ndërtime të veçanta kundrejt njeri-tjetrit dhe mureve anësore që mbyllin oborrin. Karakteristikë kryesore e këtyre kompleksëve të mbyllura është ndarje e qartë funksionale midis ambienteve të ndejtjes dhe të shërbimit.

Tipet e vjetra të banesave të krahinës mendojmë se kanë pasur në zgjidhjen planimetrike të tyre edhe ambientin e kullës[7]. Mendimi ynë është që kulla si element përbërës i banesës shumë të vjetër duke humbur interesin e saj dhe prakticitetin (kemi parasysh që banesat nuk ndërtoheshin të veçuara por në lagje në bazë të lidhjes së gjakut) është eleminuar. Kulla (fig. 16) ka humbur tiparet e veta mbrojtëse, për arsye se ajo është mjaft e ulët nga terreni mbrapa dhe ka dritare të një madhësie të konsiderueshme. Banesa me kullë është gjetur edhe në një fshat të Tomoricës[8] vetëm se kulla është bashkëngjitur në konturin e planimetrisë, nuk është si në rastin tonë.

Në përgjithësi të gjitha tipet e banesave sidomos ato më të zhvilluarat janë të shoqëruara me elementet dhe ambientet ndihmëse të një ekonomie bujqësore blegtorale fshatare si lemi, stallën e bagëtisë, depoja e kashtës, koteci i pulave dhe gjithmonë pusi ose janë të vendosura pranë burimit. Ekonomia bujqësore pra ka luajtur një rol me rëndësi në kompozimin e shumë kompleksëve në anekset që kërkon ushtrimi i bujqësisë.

Banesa e Skraparit është një banesë e mbyllur tek e cila nuk gjejmë asnjëherë ambientin karakteristik të çardakut dhe për mendimin tonë ajo ka tipare mbrojtëse. Banesa me kate e kësaj krahine ka afrime të dallueshme me banesat e fshatrave të Shqipërisë së Jugut në përgjithësi me ndryshimin kryesor që shkallët në pjesën dërmuese të tyre janë vendosur në pjesën e brendshme të banesës.

7) Nga të dhënat gojore rezulton se banesa me kullë ka pasur edhe në fshatrat Munushti, Ujanik, Gradec, Shpataj, Koçaj po ato janë prishur. Në fshatin Munushfar u gjetën edhe gjurmët e kullës.

8) K. Zheku «Shtëpitë e banimit në krahinën e Tomoricës» Monumentet 10/1975.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN HELMES SKRAPAR



PAMJE NGA MBRAPA E AMBJENTEVE NDIHMESE



PLANIMETRIA



PAMJE ANESORE





PAMJE E SHTEPISE SE BANIMIT



TAB II

BANESE NË FSHATIN HELMES

SKRAPAR













DO NOT COPY

DO NOT COPY

a)



b)



c)



d)





KATI I



KATI I



KATI PERDHE



KATI I



KATI PERDHE



KATI PERDHE



KATI I



KATI PERDHE

0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN VELESHNJE
SKRAPAR



BANESE NE FSHATIN RADHESH
SKRAPAR









KATI I



KATI I



KATI PERDHE

0 2 4 6m.



KATI PERDHE

0 2 4 6m.

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN CEROVE
SKRAPAR







KATI I



KATI PERDHE



GEN-PLAN





DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN [illegible]
SKRAPAR



KATI PERDHE



KATI I

0 2 4 m

BANESE NE FSHATIN VESESHTE
SKRAPAR



KATI PERDHE



KATI I



GEN PLANI
BANESE NE FSHATIN VESESHTE



PRERJE TERTHORE

0 2 4 m

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN VESESHTE
SKRAPAR

a)



PAMJE KRYESORE



KATI I



PAMJE ANESORE



KATI PERDHE



PRERJE



0 2 4m

BANESE NE FSHATIN ZHEPE
SKRAPAR

b)



PAMJE KRYESORE

KATI PERDHE



0 2 4m

KATI I

DO NOT COPY

BANESA NE FSHATIN STRAVECKË

SKRAPAR



GEN–PLANI



KATI I



KATI PERDHE







BANESE NE FSHATIN STARAVECKE
SKRAPAR



KATI I

GEN PLANI



AMBJENTE NDIHMËSE

0 2 4m

DO NOT COPY

TAB X

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN DOBRUSHE
SKRAPAR.



BANESE NE FSHATIN VERZHEZHE
SKRAPAR.











DETAJE TE NDRYSHME BANESASH NE KRAHINEN E SKRAPARIT.

DO NOT COPY















Genc SAMIMI

DO NOT COPY

DONNEES SUR L'ARCHITECTURE DE L'HABITATION POPULAIRE DANS LA REGION DE SKRAPAR

RESUME

La région de Skrapar se situe dans la partie méridionale du Pays. Pour y accéder il faut suivre la route nationale en aval du fleuve Osum, dont les eaux pénètrent en profondeur dans cette zone, en traversant de part en part les formations de roches stratifiées pour y créer un panorama grandiose et pittoresque sur ses deux berges. A part le fleuve Osum, la région de Skrapar est baignée par le fleuve Tomorica dont les eaux parcourent la partie orientale du mont Tomor. Les vallées créées par le fait de ces fleuves et des torrents qui s'y jettent ont favorisé le peuplement et la construction d'habitations dans ces zones. La majorité des villages s'étend le long de ces deux fleuves, mais il y a aussi des villages isolés dans les zones reculées de montagne. Le terrain de cette région, quoique traversé par deux fleuves, est relativement accidenté, avec des collines escarpées et mamelonnées, avec un climat continental et une végétation peu abondonte. Cette région ne constitue pas une unité ethnographique à soi, du fait que ses traits ethnographiques on les retrouve aussi dans les régions avoisinantes. Dans le passé, la population du pays s'occupait d'élevage et d'agriculture. Le commerce des productions animales se faisait avec les districts voisins de Korçe, de Berat et de Kelcyre. Avant la libération du pays une partie de la population, ne pouvant subvenir à ses besoins, était contrainte d'emprunter le chemin de l'émigration pour trouver du travail ou s'adonner à un métier.

Au cours de la Première Guerre mondiale, la région de Skrapar fut gravement endommagée et nombre de ses maisons furent détruites. Une fois la guerre finie, une part de ces habitations furent reconstruites sur les anciennes fondations, mais aussi sur d'autres terrains en ayant en vue aussi les anciens types d'habitation.

Dans cette région il y avait plusieurs villages, où l'urbanistique et l'architecture de l'habitation ont connu une évolution particulière, mais il importe d'avoir en vue le fait que la catégorie de l'habitation, au point de vue de la construction et de nombre d'autres facteurs, n'a pu résister à la continuité de la vie, du temps, aussi nombre de ces maisons n'existent plus ou ont été détruites. De ce fait, nous n'avons pas hérité des habitations originales se rapportant à la période allant du XVIIe à la moitié du XVIIIe siècle.

Le matériel sur lequel se fondent les travaux que nous avons effectués se rapporte aux habitations existantes, en adoptant évidemment une attitude critique à l'égard de l'ancienneté de l'objet examiné.

Etant donné que la maison est une construction qui est transmise d'une génération à l'autre, de ce fait elle subit souvent des transformations par suite du changement des conditions sociales et économiques et de l'accroissement de la famille, aussi nombre d'habitations que nous avons documenté ne reprouisent pas intégralement leur état initial, bien qu'elles conservent leur ancienne structure base qui s'appuie sur les traditions locales dans le domaine de la construction.

Les maîtres bâtisseurs populaires qui ont construit ces maisons dans la région de Skrapar n'étaient des gens du pays, ils y venaient chaque année dans des périodes de temps établis des régions de Opar et de Permet. Il y avait parmi eux des maçons, en général originaires d'Opar, et des menuisiers originaires de Permet. Les premiers s'occupaient de la construction des murs, de la mise en place du toit et de sa couverture, tandis que les autres s'adonnaient au crépissage et au travail du bois. Les maçons s'occupaient eux-mêmes de l'extraction de la pierre et de son transport avec leurs bêtes de somme, tandis que le futur propriétaire de la maison, aidé aussi par ses parents les plus proches était tenu d'assurer aux maîtres batisseurs la chaux et le bois d'oeuvre, la nourriture et le tabac. Les matériaux de construction étaient prélevés des carrières et des forêts se trouvant à proximité du village. Dans toute la région de Skrapar les murs des maisons sont en pierre et leurs toits couverts de plaques de pierre, la maçonnerie est renforcée par des bandes de bois; en tant que liants, on employait de la terre argileuse et parfois du mortier de chaux.

Au début les poutrelles reposant sur les poutres du plancher étaient couvertes de terre, mais souvent on y disposait aussi des planches. En général les fenêtres sont surmontées d'architraves de pierre, mais on employait aussi l'arc semi-circulaire

(Tab. II). Il est intéressant de relever l'usage fréquent de fenêtres comportant un grillage de bois. Les toits se caractérisent par une double construction de manière à pouvoir utiliser le plus grand nombre possible d'éléments de bois léger.

Les villages de la région de Skrapar ne sont pas dispersés, le groupement des quartiers se fait sur la base des liens de sang (Fig. 19). Des matériaux recueillis il ressort qu'une plus grande diffusion ont connu les maisons à étages, notamment celles à une ou deux pièces, mais il y a aussi des habitations à rez-de-chaussée à une ou deux pièces destinées à l'habitation, ce qui exprime clairement la différenciation de classe parmi la population de cette région. De la comparaison de la maison à rez-de-chaussée de la région de Skrapar avec celle du Haut Kurvelesh, on relève la seule ressemblance qu'ici on ne trouve pas des habitations à rez-de-chaussée à deux pièces et avec une entrée particulière comme au Haut Kurvelesh. Dans les habitations à étages ayant une seule pièce destinée au logement au premier étage et une étable à l'étage inférieur, l'ancienne conception prévoyait un escalier de pierre intérieur mais plus tard cette conception de construction s'est modifiée et, par suite de la modification de la pièce inférieure en pièce d'habitation, elle a cédé la place à un escalier de pierre extérieur ou à un escalier de bois intérieur. L'absence de la date de construction rend difficile la détermination exacte dans le temps de ces habitations, mais selon les dires des gens du pays il apparaît que la maison à étages remonte au début du XIXe siècle. Les maisons à étages se caractérisent par une division fonctionnelle nette entre l'étage au rez-de-chaussée destiné à abriter les animaux et l'étage supérieur. Après la Première Guerre mondiale, pendant la période de reconstruction des dégâts causés, l'étage au rez-de-chaussée fut transformé et destiné principalement à l'habitation.

En vue de faire face aux nécessités croissantes de la famille pour un logement plus ample, le type de l'habitation à étages comportant une seule pièce à l'étage supérieur céda la place à celui avec deux pièces à l'étage supérieur. Plus tard ce genre d'habitation a évolué positivement, afin de mieux satisfaire les exigences de l'époque. Dans les zones reculées de la région de Skrapar connaissent une plus grande diffusion les vastes complexes fermés, comportant deux édifices particuliers disposés vis-à-vis et en face des murs latéraux cernant la cour. Ces complexes fermés se caractérisent par le fait d'une séparation nette sur le plan fonctionnel des pièces destinées au séjour de celles destinées aux services.

A notre sens, la planimétrie des anciens types d'habitation comportait aussi une tour. Avec le temps, la tour cette composante de l'habitation très ancienne, est éliminée par suite du fait que les maisons sont désormais construites en groupe dans des quartiers sur la base des liens de sang.

En général tous les types d'habitation, notamment ceux plus évolués, comportent les éléments et les pièces auxiliaires si nécessaires à une économie agricole pastorale comme le sont l'aire, l'étable des bêtes, le hangar de la paille, le poulailler de la volaille et immanquablement le puits, sauf quand ces habitations sont construites à proximité d'une source. Il en découle donc que l'économie agricole a joué un rôle important dans la composition de plusieurs complexes et annexes si nécessaires à l'exercice du métier d'agriculteur.

L'habitation de Skrapar est une maison fermée qui ne comporte jamais la pièce caractéristique dite tchardak. A notre avis, il s'agit d'un type de maison de caractère défensif. La maison à étages de cette région offre en général des ressemblances évidentes avec celle des villages de l'Albanie méridionale, à la seule exception que dans la majorité des cas l'escalier est aménagé dans la partie intérieure de l'habitation.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

DO NOT COPY

BANESA FSHATARE NË FSHATRAT KODRINORE PËRRETH QYTETIT TË TIRANËS

Në fshatrat kodrinore përreth qytetit të Tiranës ka qenë në përdorim në kohën e kaluar një lloj banese e cila për tiparet e saj karakteristike në formën e planimetrisë, konstruksionin, teknikën e ndërtimit dhe në përgjithësi në formulimin arkitektonik të saj paraqet një interes me vlerë në fushën e studimit të arkitekturës popullore të vendit tonë.

Banesat fshatare që kemi parasysh në këtë punim janë ndërtuar rreth fundit të shekullit XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XX. Kjo kronologji është nxjerrë nga bashkëbisedimet me fshatarët, pronarë të banesave, mbasi data ndërtimi nuk kemi gjetur në asnjë rast.

Zhvillimin arkitektonik të banesave në fshatrat kodrinore përreth qytetit të Tiranës mendojmë se mund ta ndjekim nëpërmjet renditjes të disa varianteve të zgjedhura ndërmjet banesave të ndryshme më karakteristike që kemi gjetur në fshatra të ndryshme. Shtojmë se renditja e këtij zhvillimi nuk mund të përfshihet në diapazonin kohor që kemi dhënë për ndërtimin e banesave, për vetë faktin se ndër to siç do të shohim riprodhohen variante në forma planimetrike të cilat paraqesin analogji tipologjike me banesat të periudhave shumë më të hershme.

Materiali i botuar deri më sot mbi banesat e këtyre fshatrave[1] përbën bazën kryesore në përpjekjen tonë për të dhënë një panoramë arkitektonike dhe tiparet konstruktive të këtyre banesave. Për ta bërë më të kuptueshme banesën fshatare Tiranase po japim së pari shkurtimisht një përshkrim të ambientit gjeografik dhe të kushteve ekonomike-shoqërore të vetë popullsisë fshatare që banonte në këto banesa para çlirimit të Shqipërisë.

Ambienti natyror që rrethon fshatrat e krahinës së Tiranës ka një klimë të butë bregdetare dhe një vegjetacion natyror ku mbizotëronin në të kaluarën shkurre dhe pyje të vogla me lisa të përzier me shkozë e mare. Fshatrat në përgjithësi kanë qenë vendosur në mes të ullishtave në brigjet e kodrave që rrethojnë fushën e Tiranës. Toka e bukës në kohën e kaluar ishte shumë e kufizuar, vetëm për rreth banesave fshatare, ndërsa fusha e Tiranës, në sipërfaqen e saj më të madhe ishte mbuluar me pyje të dendur shekullor. Pjesa tjetër e fushës së shpyllëzuar nuk mund të mbillej veçse me misër mbasi gjatë kohës më të madhe të vitit ishte e përmbytur për mungesë të kanaleve kullues.

Në përbërjen gjeologjike të kodrave të fshatrave kodrinore të Tiranës predominojnë formacione shkëmbore ranore, burimi kryesor për nxjerrjen e gurëve për ndërtimin e banesave fshatare. Vendbanimi fshati në këtë krahinë quhet «katun» dhe banuesi «katunar». Ata përbëheshin në përgjithësi nga tre-katër lagje të

1) K. Zheku: Shtëpia e banimit në fshatin Mullet dhe zhvillimi i saj. Etnografia shqiptare Nr. I, 1962 fq. 65-103. K. Zheku: Tiparet karakteristike në arkitekturën e banesave të fshatit Linxë (Tiranë), Etnografia Shqiptare Nr. II fq. 110-142. K. Zheku: Disa shtëpi banimi karakteristike në fshatrat Farkë e Lundër (në rrethin e Tiranës. Etnografia Shqiptare Nr. IV, 1972, fq. 242-259. E. Riza, K. Zheku: Banesa Tiranase Monumentet 1971, Nr. 2 fq. 113-126.

formuara nga grupe shtëpiash të banuara zakonisht nga familje me të njëjtën origjinë fisnore.

Përbërja e popullsisë i përket një grupi të vogël, me tipare të përbashkëta etnografike e gjuhësore që sipas ndarjes krahinore të popullit shqiptar, bën pjesë në grupin e Gegënisë[2].

Popullsia fshatare në të kaluarën merrej me olivikulturë dhe përpunimin e prodhimit të kësaj kulture, si edhe me bujqësi e blegtori. Toka punohej me mjete primitive, parmendë druri, me plug hekuri e cila tërhiqej me qe ose buaj.

Prodhimi kryesor i bujqësisë ka qenë misri, i cili përdorej kryesisht për gatimin e bukës. Drithërat e tjera ishin më pak të kultivuara në këtë rreth. Në fshatrat e Rrëzës së Dajtit, duke pasur në sfond malin me kullota verore dallohej një zhvillim më i theksuar i blegtorisë dhe prodhimeve prej saj si gjalpë, djathtë, lëkura dhe lesh.

Të gjitha këto prodhime përpunoheshin në banesë nga gratë fshatare në masën aq sa të plotësonin nevojat më të domosdoshme të ushqimit dhe veshjes-mbathjes së pjesëtarëve të familjes fshatare. Kulturat bujqësore dhe blegtoria përfaqësohen me një numër ambientesh ndihmëse të cilët i gjejmë të ndërtuar në oborrin e shtëpisë, siç janë kosheret e misrit dhe ambientet e strehimit të bagëtisë së imët, dhen e dhi dhe kafshët e punës, qe dhe buaj.

Në shumicën e rasteve këta ambiente kanë qenë ndërtuar me një skelet druri të thurur me gardh thupra sh dhe të mbuluara gjithmonë me kashtë misri dhe gruri.

Secili fshatar ka pasur si pronë të tij tokën e oborrit të shtëpisë dhe pak tokë buke për rreth saj ndërsa ullinjtë në shumicën e rasteve kanë qenë prona të agallarëve Tiranas dhe fshatarët i kultivonin duke ndarë në natyrë për gjysëm prodhimin vjetor me pronarin. Edhe kjo kulturë përfaqësohet thuajse në çdo banesë fshatare me një ambient të posaçëm atë të mullirit të bluarjes së ullinjve ku përfshihen veglat e shtrydhjes dhe vendi i kullimit të vajit si edhe qypat që përdoreshin për depozimin e tij. (Tab. VII). Në kompleksin e banesës fshatare që kemi parasysh nuk kemi gjetur në ndonjë rast lëmin për shirjen e prodhimeve bujqësore, si edhe plevicën për depozitimin e kashtës ose barit të thatë. Ky i fundit ruhej për dimër jashtë, në ambient të hapur i vendosur qipi përreth ndonjë trupi lisi në afërsi të banesës.

1. **Ambientet që përbëjnë banesën tiranase.** Për plotësimin e nevojave më të domosdoshme të jetesës familjare në banesa të ndryshme fshatare kemi gjetur një numër ambientesh të vendosura brenda dhe përreth banesës nga të cilët kryesoret përdoren për strehimin e pjesëtarëve të familjes dhe të tjerë për përpunimin e depozitimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale e kulturave të tjera si edhe për strehimin e bagëtisë dhe shpendëve shtëpiake.

Këto ambiente siç do të shohim në vazhdim i janë shtuar banesës me radhë, sipas nevojës së përdorimit të tyre.

Ambientet kryesore që përfshihen në banesën fshatare tiranase janë: 1) «Shpia e zjermit» ose «shpia e bukës», 2) «të ramet» siç i quajnë dhomat e fjetjes 3) Hajati, 4) quri, 5) konaku i miqve, 6) Çardhaku, 7) Nyjet sanitare.

Këto ambiente i kemi gjetur të vendosur në mënyra të ndryshme, simbas kushteve të terrenit, të disponimit të sipërfaqes së banuar, dhe mundësive ekonomike.

Me vendosjen në mënyra të ndryshme të këtyre ambienteve janë krijuar në periudha të ndryshme dhe variante të shumëllojshëm në kompozimin arkitektonik të këtyre banesave.

Varianti me një kthinë banimi «Shpia e zjermit». Banesat fshatare në format më primitive përfaqësohen me banesën njëkthinëshe e cila përbëhet nga një ambient i vetëm banimi. Ky ambient quhet nga vetë fshatarët «shpi zjermi» ose «shpi buke» në këtë ambient zhvillohej jeta e përditshme familjare dhe priteshin miqtë. Në fazën fillestare shtëpia e zjarrit kishte afërsisht formë katrore dhe më vonë merr formën drejtkëndëshe. Sipërfaqja e banimit në këtë ambient luhat 20-60 m^2.

Në shtëpinë e zjarrit, gjejmë gjithmonë vatrën e zjarrit, të vendosur zakonisht në mes të ambientit.

Vatra e zjarrit ndërtohet mbi truallin e dyshemesë në formën e një drejtkëndëshi, i cili ndahet me një shkallëzim në mes në dy sipërfaqe katrore, në njerën ndizet zjarri ndërsa në tjetrën vendosen për së gjati drutë e zjarrit. Në të dy anët e vatrës vendosen dy gurë prizmatik, të futur në tokë, të cilët quhen «Carunj» që shërbejnë për të mos lejuar shpërndarjen e druve të zjarrit. Vatra është pa oxhak dhe tymi del nëpër hatlla siç i thonë fshatarët d.m.th. nëpër tjegullat e çatisë. Në vatër gatuhej ushqimi, piqej bukë dhe ngroheshin pjesëtarët e familjes. Zjarri në këtë ambient qëndronte kurdoherë i ndezur dhe mbi të ishte i varur në kamostër[3] një gjym me ujë të ngrohtë.

Në vendin tonë janë përdorur deri në ditët tona shprehje popullore që i japin vatrës një rëndësi të veçantë në jetën familjare. Vetë emërtimi «shpi zjarri»

2) Rr. Zojzi. Ndarja krahinore e popullit shqiptar. Etnografia Shqiptare. Nr. 1, 1962, fq. 27-30.

3) Kamostër quhet zinxhiri që varet mbi vatrën e zjarrit.

FOTOKOPJE

siç e quajnë në shumë fshatra, ambientin kryesor të banesës së tyre të shtyn të mendosh se shtëpia i takon zjarrit dhe është ndërtuar qëllimisht për të mbajtur zjarrin dhe pjesëtarët e familjes të mbledhur përreth tij. Shpesh dëgjon në popull, kur duan të tregojnë se dy persona janë të një familje, shprehjen «janë ndarë nga një vatër» ose «kanë ndarë vatrën e zjarrit».

Edhe vendosja e vatrës së zjarrit siç e kemi gjetur në shumë raste, në mesin e shtëpisë së zjarrit, në banesat fshatare të Tiranës dhe në raste të rralla edhe në fshatra të tjera, tregon qartë për një tradite shumë të lashtë që trashëgohet që nga periudha shumë të largëta pra që nga zanafilla e banesës fshatare.

«Shpia e zjermit» ka hyrje kryesore, ndriçimi i saj bëhet me anën e dy baxheve (vrima) të hapura në çati në formë të rrumbullakët ose katrore. Këto janë të hapura në dy flegra të çatisë dhe drita e tyre projektohet mbi vatrën e zjarrit.

Në shtëpinë e zjarrit ndodhej sqolli, një vend i posaçëm që shërben për larjen e enëve si edhe sergjeni, tri dërrasa të fiksuara në mur në drejtimin horizontal, ku vendoseshin të gjitha enët e ngrënies dhe ato të gatimit. Enët e ujit zinin vend në afërsi të hyrjes mbi një vend të ngritur disa centimetra nga dysheneja, ndërtuar me gurë të lyer me baltë. Në çdo shtëpi zjarri kishte edhe dy hambarë njeri përdorej për depozitimin e drithit dhe tjetri më i vogli, për mbajtjen e miellit dhe bukës. Në fshatrat e krahinës së Tiranës përfshi edhe qytetin, buka piqej zakonisht me «çerjep» prej balte në formë të rrumbullaktë.

Shtëpia e zjarrit ndërtohej gjithmonë pa tavan dhe me dysheme prej dheu të ngjeshur, si shtresë për t'u ulur pranë zjarrit përdoreshin rrogozat dhe mbi të postiqet (lëkura prej delesh) për t'u ulur afër zjarrit ishin në përdorim gjithashtu edhe «shkamit» (frone të vegjël prej dërrase ose thjesht trupa pemësh.).

Në faqet e brendshme të mureve anësore të shtëpisë së zjarrit vërehen shpeshherë dollapa të futur në mur, në afërsi të vatrës së zjarrit, këto dollapa janë më të vegjël dhe të harkuar në pjesën e sipërme dhe përdoreshin për vendosjen e kandilave dhe për filxhanet e kafesë.

Banesën fshatare me një kthinë banimi e kemi gjetur në përdorim, në shumë fshatra të cilat kanë qenë përdorur nga familje të shtresës së varfër fshatare.

Këto banesa të para nga ana e formulimit arkitektonik paraqesin fazat më të hershme të banesës fshatare me një kthinë banimi.

Në fshatin Mullet kemi gjetur një variant të banesës me kthinë banimi fig. 1 e cila ka një planimetri në formë katrore me përmasa 5 x 5 m; ka një hyrje dhe vatrën e zjarrit të vendosur në mes të ambientit të banimit.

Zhvillimi i mëtejshëm i këtij varianti në drejtim të shtimit të sipërfaqes së banuar është arritur nëpërmjet kalimit nga planimetria në formë katrore në atë me formë drejtkëndore. Në këtë mënyrë sipërfaqja e banimit arrin të shtohet deri në rreth 40 m^2, thuajse dyfishi i asaj që kish në variantin fillestar njëkthinësh, me planimetri katrore. Në banesën fig. 2 (Mullet) shihen përpjekjet e para për shtimin e sipërfaqes së banimit edhe në drejtimin vertikal. Në banesën që kemi marrë si shembull ishte ndërtuar në gjithë gjerësinë e shtëpisë së zjarrit një konstruksion druri me përmasa 5 x 2 m. i shtruar me dysheme dërrasash në lartësinë rreth 0,80 m nga trualli i banesës. Këtu kemi të bëjmë me fazën fillestare të krijimit të një ambienti të ri brenda shtëpisë së zjarrit, i cili quhet nga fshatarët «mafil» dhe përdoret për fjetjen e pjesëtarëve të familjes. Në shtrojen e mafilit kur lartësia është relativisht e vogël, ngjitja bëhet me anën e tre-katër këmbëve shkallësh prej druri.

Mafili në formën e tij më të plotë në variantin e banesës njëkthinëshe e kemi gjetur në Prezë fig. 3. Banesa ka planimetri drejtkëndore me vatër zjarri të vendosur në afërsi të murit në të djathtë të hyrjes së saj. Mafili në këtë banesë është ngritur deri në gjysmë lartësinë e banesës, 2 m. nga trualli i saj, rrjedhimisht ka edhe një konstruksion më të avancuar. Dyshemeja e tij është mbështetur mbi trarë të futur në mur dhe të dalë jashtë tyre 1,5 m. Mafili është i mbrojtur me anën e një parmakllëku me lartësi 1 m. i cili është i lidhur me anën e shtyllave të holla prej druri të vendosura vertikalisht dhe të mbërthyera me trarët e çatisë. Ngjitja për mafil bëhet me anën e shkallëve prej druri të cilat zakonisht vendosen për bri murit. Siç do të shohim më poshtë mafili në banesa të tjera vjen duke u transformuar dhe në disa raste ndërron edhe funksionin e tij fillestar.

Ngritja e mafilit në lartësi ishte me të vërtetë një hap përpara, siç e thamë në drejtim të shtimit të sipërfaqes së banuar, brenda shtëpisë së zjarrit, por jo i fundit. Në këtë drejtim ne vërejmë se fshatari në mënyrë racionale dhe me këmbëngulje shfrytëzon përfundimet konstruktive dhe njohuritë teknike gjithnjë në favor të përmirësimit të konditave të jetesës brenda caqeve më të ngushta të mundësive ekonomike që ai dispononte. Banesa fig. 4 që e kemi gjetur në Mullet na tregon se me dyfishimin e sipërfaqes së dysheneses së mafilit dhe thurjen me gardh të parmakllëkut të tij është krijuar një ambient i veçantë për fjetje. Ky ambient quhet e «rame» dhe përdoret për fjetjen e një çifti të ri që i shtohet familjes fshatare. Mafili në këtë shembull ekziston akoma, por i zvogëluar dhe shërben si element ndërlidhës i ambientit të

Do not copy

ri me shtëpinë e zjarrit. Dhoma e fjetjes, ndriçohet nga një derë e cila të nxjerr në një nënstrehë, ballkon i hapur dhe nëpërmjet tij shkohet në hamam.

Ballkoni është një element i ri që takohet shumë rrallë në banesat e fshatrave kodrinor të Tiranës. Ai është i ndërtuar mbi trarë që dalin jashtë mureve perimetral rreth 1.20 m. dhe i rrethuar me parmakllëk druri të lidhur me shtylla vertikale. Ballkoni është ndërtuar në gjithë gjerësinë e ballit të banesës dhe mbulohet me zgjatjen e strehës së çatisë. Në një qoshe të ballkonit është ndërtuar hamami që është një nyje sanitare e cila ndërtohet, me skelet druri thurur me thupra, zakonisht si shtesë nga jashtë banesës dhe gjithmonë afër dhomave të fjetjes[4].

Në banesën tiranase, e cila siç do të shohim, karakterizohet në pamjen e saj të jashtme nga hajati dhe në variantet më të zhvilluara nga çardaku, ballkoni i hapur nuk gjen vend për një lidhje organike prandaj edhe shfaqjet e tij janë shumë të rralla.

Këto ishin variante me anën e të cilëve ne mundëm të ndjekim rrugën e zhvillimit sipërfaqësor e vëllimor, krijimin dhe vendosjen e ambienteve të ndryshme, brenda shtëpisë së zjarrit, në banesës njëkthinëshe.

Më poshtë do të shikojmë disa banesa të tjera për të ndjekur në një rrugë tjetër zhvillimin e mëtejshëm të banesës tiranase njëkthinëshe. Në banesat që kemi parasysh, shtëpia e zjarrit si ambienti kryesor, përfaqësohet tërësisht me përmasat e mëdha sipërfaqësore e volumore dhe elementet karakteristike të saj tani, të përcaktuara më mirë. Hapi i parë në drejtim të këtij zhvillimi bëhet duke krijuar në ball të shtëpisë së zjarrit një ambient të mbrojtur, i cili quhet nga fshatarët hajat. Ky ambient lindi nga nevoja për të mbrojtur hyrjen e banesës nga agjentët atmosferikë dhe për të pasur një vend rezervë për depozitimin provizor të prodhimeve bujqësore dhe veglave të punës si edhe për një sërë funksionesh të tjerë që dalin në jetën e përditshme të familjes fshatare. Në këtë mënyrë hajati zë vendin e dytë, pas shtëpisë së zjarrit, në radhën e ambienteve kryesore të banesës. Në variantet më të zhvilluara në stinën e verës, hajati përdoret për fjetje dhe për punimin e tekstileve në avlëmend, etj. Hajati është i mbyllur anash me zgjatimin e mureve gjatësore të banesës, dhe i mbuluar nga çatia e saj e cila mbështetet mbi shtylla druri që vendosen në gjithë gjatësinë e ballit të hajatit.

Në këtë mënyrë hajati është shumë i favorshëm edhe si vend rezervë për ndërtimin e ambienteve të rinj, simbas nevojave që i paraqiten familjes fshatare.

Në banesën fshatare tiranase hajatin e gjejmë gjithmonë si shoqërues të shtëpisë së zjarrit deri sa ai arrin të bëhet një nga elementet më karakteristike të kësaj banese.

Formën fillestare të hajatit që paraqitet në rikonstruksionin në fig. 5 e kemi nxjerrë nga të dhënat e fshatarëve dhe gjurmët që kemi gjetur në banesat njëkthinëshe me dy kate. Në variantin e tij fillestar hajati ka një sipërfaqe afërsisht sa 1/3 e sipërfaqes së shtëpisë së zjarrit, e cila në këto raste na paraqitet akoma me formën fillestare të saj.

Një zhvillim deri diku të plotë, të banesës njëkthinëshe me hajat e kemi gjetur në fshatin Linxë fig. 6.

Në këtë variant vemë re se shtëpisë së zjarrit i është shtuar një e ndarë e vogël për kundrejt hajatit me sipërfaqe të barabartë me këtë të fundit. Ky ambient merr emrin «qur» dhe ze vend të përhershëm në banesën fshatare. Zakonisht këtu depozitoheshin prodhimet blegtorale e bujqësore dhe vendosen orenditë shtëpiake që nuk kanë përdorim të përditshëm. Si një zhvillim të mëtejshëm duhet të marrim edhe ekzistencën e dhomës së gjumit «të rames» e cila është vendosur në kat të parë sipër qurit e ndarë me mur nga shtëpia e zjarrit dhe në komunikim me të nëpërmjet qurit.

Në përfundim të këtij zhvillimi ne vërejmë se banesa një kthinëshe me hajat, ka marrë në planimetri formën e një drejtkëndëshi të zgjatur të ndarë në drejtim të tërthortë me gjatësinë e tij në tre ambiente: parahyrje ose hajati, shtëpia e zjarrit dhe quri. Ne mendojmë se në këtë mënyrë është krijuar varianti më i përkryer i banesës fshatare tiranase, një kthinëshe me hajat.

Përdorimin e këtij varianti deri në ditët tona duhet ta shpjegojmë me faktin se kjo banesë ka qenë gjithmonë e preferuar nga shtresat e varfra të popullsisë fshatare, sepse ajo u përshtatej kondita-ve dhe plotësonte mjaft mirë nevojat më të domosdoshme të jetës familjare.

Karakteristika kryesore e kësaj banese është vendosja e ambienteve në radhë dhe komunikimi njeri pas tjetrit. Një vendosje e tillë ka qenë në përdorim që në kohët e lashta.

Varianti me dy kthina banimi (Shtëpia e zjarrit me konak»). Konaku i miqve është një ambient që ka hyrë relativisht vonë në banesën fshatare tiranase, kjo gjë vërtetohet edhe nga vetë fakti që këtë ambient në disa raste e kemi gjetur të ndërtuar më vete, në oborrin e banesës, por edhe kur ai është brenda banesës ka

4) Ballkoni i hapur në banesën tiranase mendojmë se është i huazuar nga banesa e malësisë në lindje të Tiranës ku ka patur një përdorim shumë të gjerë aqë sa ishte bërë një element karakteristik i këtyre banesave».

Fotokopje

gjithmonë hyrje të veçantë. Konaku i miqve sikurse del edhe nga vetë emëri që ka marrë, shërben kryesisht për pritjen e miqve të familjes. Këtë funksion përpara ndërtimit të tij e kryente shtëpia e zjarrit sepse shqiptari e ka pasur gjithmonë zakon që mikun e priste në gjirin e familjes së tij dhe në kohë më të vona si rezultat i zhvillimit ekonomiko-shoqërore duket se ka dalë nevoja e krijimit të një ambienti të veçantë në banesën fshatare. Ky ambient në përgjithësi ka formën e një drejtkëndëshi me gjerësi 4-5 m., dhe gjatësi 5-7 m., është i pajisur me vatër zjarri e cila shpesh është edhe me oxhak. Ndriçimi i konakut bëhet në të shumtën e rasteve me anën e dy-tri dritareve të hapura në ballkonin e tij. Kur konaku është në katin e parë ka dysheme të shtruar, me dërrasa, ndonjëherë ka edhe tavan dhe mure të suvatuar e të lyer me shërbet gëlqere.

Konakun e miqve në raste të rralla e kemi gjetur të pajisur me një ballkon të mbyllur, i cili edhe ky dallohet si një element i huaj i ardhur me sa duket së bashku me konakun e miqve. Ballkoni vendoset në anën ku mund të soditet ambienti përreth banesës.

Ballkoni është i ndërtuar mbi trarët e dyshemesë së konakut të cilët dalin jashtë mureve 1.50 – 1.70 m. Në tri anët e jashtme ballkoni është i mbyllur me bylme ose skelet druri veshur brenda e jashtë me dërrasa të holla. Dyshemeja e ballkonit është shtruar 10-20 cm më lart nga ajo e konakut. Në anën e brendshme ballkoni është i hapur tërësisht mbasi muret perimetral të banesës ndërpriten aq sa zë vend ballkoni. Dritaret e këtij ambienti janë me hark të dhëmbëzuar dhe të mbyllur me kafaz druri të thurur me binarë të hollë të kryqëzuar horizontalisht dhe vertikalisht çdo 10 cm. largësi. Në këtë ballkon gjejmë elemente të cilët na duken se janë të huaj për banesën fshatare, në ekzekutimin e punimeve të drurit, vihet re një teknikë e kualifikuar ku janë përdorur një numër veglash speciale, gjurmët e të cilëve nuk i gjejmë në punimet e drurit që janë bërë në ambiente të tjerë të banesave fshatare që kemi parasysh. Këto fakte përforcojnë bindjen për një influencë të huaj nga krahinat fqinje. Një konak të përafërt e ka gjetur edhe A. Muka në fshatrat e Çermenikës[5].

Në variantet e para konaku i miqve ndërtohej ngjitur me shtëpinë e zjarrit në të majtë ose në të djathtë të saj. Po të marrim parasysh planimetrinë e banesës fig. 7[6] shohim se sipërfaqja e shtëpisë së zjarrit është reduktuar në përmasat fillestare të saj për të lëshuar sipërfaqen e nevojshme për ndërtimin e konakut të miqve.

Në këtë rast mund të themi se në formën e përgjithshme të planimetrisë të kësaj banese ne shikojmë se përsëritet dy herë njësia planimetrike e banesës një kthinëshe me trajtën e saj më të hershme sikurse e kemi parë në fig. 5.

Në dy banesa të tjera që i kemi takuar në fshatin Mullet fig. 8-9 të cilat janë përafërsisht të një varianti, konaku i miqve në të dy rastet, i favorizuar nga pjerrësia e terrenit del në kat të parë dhe përpara tij gjejmë çardakun e hapur. Shtëpia e zjarrit në variantin fig. 8 ka formë katrore, ka dhe mafilin që komunikon me konakun, kurse në variantin e dytë fig. 9 në vendin e mafilit ka zënë vend dhoma e gjumit dhe poshtë saj quri. Në këtë banesë komunikimi i shtëpisë së zjarrit me konakun bëhet nëpërmjet hajatit. Në të dy variantet është vendosur brenda banesës dhe konkretisht nën konakun e miqve «burgu i gjasë» ambient ky ndihmës që përdorej për strehimin e bagëtisë.

Këtë lloj banese ne mendojmë se mund ta quajmë edhe banesa gjysmë përdhese, duke menduar se ato paraqesin variantet fillestar të zhvillimit të banesës me dy kthina banimi, në drejtimin vertikal. Në këto raste shohim të konkretizuara përpjekjet e para të këtij zhvillimi që zënë fill siç e pamë në ngritjen në lartësi apo krijimin e dhomës së gjumit brenda shtëpisë së zjarrit.

Në fshatin Prezë kemi hasur edhe një banesë tjetër fig. 10 të ngjashme me dy të parat, përsa i përket shtëpisë së zjarrit e cila ruan në vetvete të gjitha karakteristikat e saj. Në këtë banesë, konaku i miqve është i vendosur në krahun e djathtë të shtëpisë së zjarrit dhe këtu çardaku zgjatet në gjithë gjatësinë e banesës duke ruajtur përmasat e hajatit që ndodhet poshtë tij. Në këtë variant duken qartë fazat e ndryshme të zhvillimit të banesës si rezultat i vendosjes së konakut të miqve në lartësinë e katit të parë.

Banesa fig. 11 (Farkë) është e një varianti më të zhvilluar. Në planimetrinë e katit përdhe duket qartë se krijimi i këtij varianti është arritur duke përsëritur dy herë planimetrinë e banesës me shtëpi zjarri e hajat përpara. Ky variant duke përfshirë në vetvete ambientet kryesore të banesës fshtatare, shtëpinë e zjarrit, konakun e miqve i cili përdoret edhe për fjetje, hajatin, çardakun dhe një burg gjaje, arrin të bëhet një nga tipet më karakteristike të banesës fsha-

5) A. Muka. Banesa popullore e Çermenikës, Studime historike Nr. 1, 1974, fq. 135.
6) Ky variant është rikonstruksion i një banese që është gjetur në fshatin Linxë shif fig. 6 në artikullin e botuar për banesat e këtij fshati, cituar në fillim.

DOKTORI

tare tiranase dhe i kalon përtej kufijt e vendlindjes së tij. Në banesën fig. 12 (Farkë) shohim gjithashtu se zhvillimi i mëtejshëm i banesës fshatare është i vazhdueshëm gjithmonë në kërkim të krijimit të varianteve më të përshtatshëm. Kështu që në periudha të vështira, ku pasiguria ekziston për kohë të gjatë, fshatari kërkon ti sigurojë familjen dhe bagëtinë e tij. Hapi i parë në këtë drejtim bëhet në mbylljen me mur të hajatit duke krijuar kështu një banesë me një hyrje qendrore, dhe shkallë brenda saj. Hajati në këto banesa përdoret edhe si stallë bagëtish, kurse çardaku ruan akoma formën dhe funksionin që ka pasur.

Konaku i miqve veç banesës

Thamë se konaku i miqve ndërtohet më vete i shkëputur nga banesa, por gjithnjë në oborrin e saj. Në fshatin e Linxës kemi dy raste të tilla të cilat janë të ndryshme për nga planimetria dhe formulimi arkitektonik. Varianti i parë fig. 13 na paraqitet me një planimetri të njëllojtë për nga forma dhe përmasa sikurse edhe bërthama fillestare e shtëpisë së zjarrit me hajat përpara shiko fig. 5. E njëjta planimetri përsëritet edhe në katin e parë ku zë vënd konaku i miqve, përpara tij kemi çardakun të mbrojtur në ballë me një parmakllëk. Konaku ka nyjen sanitare më vete të ndërtuar me skelet druri thurur me gardh. Ky konstruksion mbështetet në trarët e dyshemesë që dalin 1 m. jashtë murit gjatësor të ndërtesës. Ngjitja për në çardak bëhet me anën e një palë shkallëve prej druri të vendosur në hajat bri murit në krahun e majtë. Në katin përdhe nën konak është një stallë bagëtish dhe pranë saj një hajat që përdoret për veglat bujqësore. Sikurse duket qartë përsa i përket, ndërtimit, planimetrisë dhe elementeve arkitektonike që përmban ky variant ka lidhje të ngushtë gjenetike me banesën fshatare vendase, megjithëse ky është një ambient i cili siç thamë i është shtuar më vonë banesës.

Krejt e kundërta ndodh me variantin e dytë fig. 14 ku konaku i vendosur në katin e parë ka formë drejtkëndëshe me përmasa të brendshme 7.50 x 5.00 m. Brenda konakut gjejmë dy vatra zjarri të vendosura kundrejt njera-tjetrës, në murat e ngushtë, dhe në mes të tyre ballkonin e mbyllur karakteristik të cilin e përshkruam më parë. Ngjitja për në këtë konak bëhet nëpërmjet një palë shkallësh prej guri të vendosura bri murit nën strehën e çatisë. Shkallët përfundojnë në një ballkon të hapur të ngushtë i cili qarkullon gati gjysmën e gjatësisë të mureve perimetral të konakut. Në këtë ballkon është vendosur edhe nyja sanitare që i shërben konakut.

Varianti me tri kthina banimi. Ambienti që delte i nevojshëm t'i shtohej banesës ka qenë kthina e tretë e cila përdorej si dhomë gjumi për kurorën e parë që lind në gjirin e familjes fshatare. Shtojmë se në banesën me dy kthina banimi ku paraqitej nevoja e një ambienti të tillë zakonisht ndërtohej si shtesë, me materiale rrethanore, në hajatin ose çardakun e këtyre banesave. Një variant të banesës me tri kthina banimi e kemi gjetur në fshatin Linxë fig. 15. Këtë banesë po e përshkruajmë shkurtimisht me qenë se ajo paraqet një ekzemplar të rrallë thuajse të pandryshuar nga faza fillestare e ndërtimit të saj. Duhet të përmendim se shumë të rralla janë banesat fshatare të cilat ruajnë formën origjinale të tyre, në përgjithësi ato i gjejmë krejtësisht të ndryshuara gjatë jetës së tyre. Ndarjet apo shtesat e ndryshme në shumicën e rasteve janë ekzekutuar me material shumë të thjeshtë nga vetë familja fshatare. Arsyet kryesore të ndryshimeve janë: ndarja e familjes dhe shtimi i kurorëve të reja brenda saj.

Kjo banesë është ndërtuar mbi një breg të vogël shkëmbor, me terren pak të pjerrët në anën veriore të vendosjes së saj. Në këtë pozicion ajo ka një pamje mjaft piktoreske dhe lidhet shumë bukur me ambientin që e rrethon.

Në kompozimin e ambienteve të ndryshme të kësaj banese na duket se është arritur një zgjidhje shumë e goditur. Me vendosjen në mënyrë krijuese, të varianteve të banesave të ndryshme paraardhëse është arritur një variant i ri ku përfaqësohen të gjithë ambientet që ka patur nevojë një familje fshatare e madhe.

Planimetria e kësaj banese ka përafërsisht formën e një katrori me përmasa të jashtme 17.80 x 14.60 m. është e ndërtuar me mur-guri lidhur me breza druri edhe baltë.

Po të shikojmë me kujdes edhe në këtë rast kompozimin planimetrik të kësaj banese, dallohet menjëherë vendosja së bashku e dy varianteve të ndryshme, që përfaqësojnë dy tipet kryesore, gjerësisht të përdorur në banesat fshatare. Varianti i parë i vendosur në krahun e djathtë paraqet tipin më të zhvilluar të shtëpisë së zjarrit me hajat në ballin e ngushtë të saj dhe varianti i dytë i vendosur në krahun e majtë paraqet tipin e banesës me dy kthina banimi dhe hajat të vendosur në ballin e gjerë të banesës.

Në këtë banesë shtëpia e zjarrit ruan përmasat

7) Një banesë të këtij varianti e kemi parë edhe në fshatin Drisht të rrethit të Shkodrës.

DO NOT COPY

sipërfaqësore e vëllimore të fazës origjinale, «e ramja», oda e gjumit, megjithëse me sipërfaqe të kufizuar, tregon se ka zënë vend të pandryshuar brenda shtëpisë së zjarrit. Mafili në këtë shembull është mjaft i zhvilluar dhe shërben kryesisht si element ndërlidhës i shtëpisë së zjarrit me gjithë ambientet e tjerë të banesës që janë vendosur në kat të parë. Në rastin konkret në shtëpinë e zjarrit gjenden edhe dy ambiente të tjerë që lidhen direkt me të, çardaku i ndërtuar sipër hajatit dhe i dyti quri i cili zë vend nën kthinën e fjetjes. Shtëpia e zjarrit ka një sipërfaqe banimi rreth 40 m^2, vatrën e ka të vendosur në të djathtë të hyrjes në afërsi të murit anësor të ndërtesës, ndërmjet vatrës dhe këtij muri është ndërtuar një mur tjetër me lartësi 0.80 m. dhe 0.60 m. gjerësi i cili zgjatet në gjithë gjatësinë e shtëpisë së zjarrit. Ky mur quhet nga fshatarët qerm dhe shërben për radhitjen e sahaneve në kohën kur gratë ndajnë gjellën. Në vendin ku vatra bashkohet me qermin është një kamare e vogël në formë qemeri që shërben për të futur drutë e gjata të zjarrit. Në pjesën tjetër të kësaj banese ku siç thamë përfaqësohet plotësisht shtëpia me çardak, në katin përdhe janë vendosur dy stalla bagëtish dhe hajati përpara tyre. Në këtë shembull ky hajat për mendimin tonë nuk na duket se është i domosdoshëm, ai edhe mund të mungonte. Ekzistenca e tij lidhet direkt me tipin e banesës që përfaqësohet në këtë rast. Në katin e parë është vendosur konaku i miqve, një dhomë gjumi dhe çardaku përpara këtyre dy ambienteve.

Me interes është të përmendim këtu se pamja kryesore e kësaj banese është vendosur në krahun ku është edhe hyrja e shtëpisë së zjarrit, ndonëse balli përpara konakut të miqve, me hajat dhe çardak në gjithë gjatësinë e tij, do të ishte më i goditur. Ky fakt na shtyn gjithnjë të mendojmë se shtëpia e zjarrit vazhdon të zërë vendin kryesor në banesën fshatare. Nga ana tjetër mund të themi se varianti që paraqitet në këtë banesë ka arritur fazën e tij mjaft të zhvilluar. Banesat e tjera të Linxës, të përafërta me variantin që po trajtojmë, tregojnë përpjekjet e vazhdueshme që bëhen në këtë drejtim për të arritur në zgjidhje të tjera më të përsosura.

Një tjetër variant i banesës me tri kthina tanimë e kemi gjetur në fshatin Lundër. Në këtë banesë, sikurse vërehet në fig. 16 përfshihen tre ambjente kryesore. Shtëpia e zjarrit, oda e gjumit dhe konaku i miqve. Në këtë variant shohim të konkretizuara, mbjen tërësisht të funksioneve të hajatit dhe kthimin e tij në një burg gjaje.

Banesa që kemi parasysh ka një planimetri në formë dhe ndarje të brendshme të përafërt me banesën që përmenden në fig. 12 megjithëkëtë duken të qarta ndryshimet e mëdha që bëhen sidomos në pamjen e saj kryesore për shkak të shtimit të një ambienti të tretë.

Në këtë variant shtëpia e zjarrit gjithnjë zë vend në katin përdhe, ka hyrje të veçantë, komunikon nga brenda me burgun e gjasë, dhe me anën e një palë shkallëve prej druri lidhet me dhomën e gjumit dhe nëpërmjet saj me çardakun e konakun e miqve.

Dy ambientet e tjerë të banimit janë vendosur në katin e parë, oda e gjumit mbi burgun e gjasë në një drejtim me shtëpinë e zjarrit, kurse konaku i miqve në gjysmën e sipërfaqes së çardakut. Një vendosje e tillë e ambienteve kryesore dhe kthimi i hajatit në «burg e gjaje» bëri të domosdoshme që banesa të ketë tri hyrje kryesore, një për pjesëtarët e familjes të cilët hyjnë së pari në shtëpinë e zjarrit, një për miqtë e familjes dhe e treta për bagëtinë. Sikurse vërehet edhe në fasadën e kësaj banese gjysma e çardakut që ka mbetur në këtë rast është e mbyllur me gardh dhe me perde dërrasash. Në këtë variant duket qartë gjithashtu se mbas sigurimit që u arrit në katin përdhe, bëhen përpjekje për të siguruar edhe katin e parë të saj.

Me zhdukjen e hajatit shkallët vendosen bri murit ballor duke përfunduar në një sheshpushim të vogël, një element tjetër karakteristik që së bashku me shkallët del jashtë banesës fshatare. Në variantin e banesës së Lundrës përfaqësohen përpjekjet fillestare për mbylljen graduale edhe të çardakut të banesës fshatare. Këtu ne shohim gjithashtu se fshatari çdo ndërhyrje që bën në banesën e tij lidhur me përmirësimin e konditave të jetesës së familjes së tij e bën gjithmonë të pjesshme dhe e provon për një kohë të gjatë deri sa krijon bindjen për zgjidhjen e drejtë.

Variante me shumë kthina banimi. Shtimi i kurorëve në familje dhe zakoni i bashkëjetesës në gjirin e familjes mëmë në një banesë të vetme, ka ndikuar në krijimin e varianteve të ndryshme të banesave me shumë kthina. Ekzemplarë të këtyre varianteve janë ruajtur në banesat e vjetra të qytetit të Tiranës[8], ku përfaqësohen edhe variantet më të thjeshtë të banesës fshatare.

Në banesat e zhvilluara të qytetit të Tiranës fig. 17 pasqyrohet më i qartë koncepti funksional i shprehur në vendosjen e dhomave të gjumit përreth një bërthame qendrore, shtëpisë së zjarrit. Në kompozimin planimetrik të kësaj banese sipërfaqen qendrore e zë shtëpia e zjarrit e cila ruan të gjitha karakteristikat

8) E. Riza, K. Zheku, vep. cit.

Botim

e saj sikurse e kemi gjetur në variantin që përfaqësohet në banesat fshatare me një kthinë banimi.

Në një banesë tjetër fig. 18 në qendër të kompozimit janë vendosur ngjitur njeri me tjetrin dy variante të njëllojtë të shtëpisë së zjarrit gjë që na shtyn të mendojmë se kjo banesë që në fillim ka qenë e programuar të banohej nga dy familje të një vëllazërie.

Ndërtimi i banesave

Banesat në fshatrat përreth Tiranës kanë qenë ndërtuar me muratorë të ardhur nga krahina e Gollobordës me materiale të cilat në shumicën e rasteve i grumbullonte vetë familja fshatare. Lënda e drurit pregatitej nga fshatarët një ose dy vjet para fillimit të banesës së re. Përpunimi i kësaj lënde dhe përgatitja e dyerve, dritareve, dyshemeve bëhej nga sharrëxhinj dhe marangozë të ardhur nga krahina e Korçës dhe e Dibrës. Tjegullat për mbulimin e çatisë kanë qenë pjekur nga vetë fshatarët. Themelet dhe muret kryesore të banesave kanë qenë ndërtuar në përgjithësi me gurë ranorë ose gurë lumi të lidhur me llaç e baltë. Qerpiçi përdorej mbi brezat e fundit të mureve kryesor të banesave fshatare ndërsa në qytetin e Tiranës banesat e vjetra kanë qenë ndërtuar me qerpiç mbi themele me mur guri.

Ndarjet e bëra përbrenda banesave ndërtoheshin me bylme, skelet druri të mbushura me qerpiç ose të thurura me gardh. Në këto raste suvatohen me një shtresë llaç balte të përzier me kashtë. Banesat kanë çati të përzier me kashtë. Banesat kanë çati katërujëshe të mbuluar me tjegulla në formë lugu.

Konstruksioni i rëndë i çatisë ndërtohet me lëndë lisi, shtresa nën tjegulla bëhej me thupra të lyera me baltë ose me dërrasa të holla të çara me sopatë.

Për të mbrojtur muret prej qerpiçi çatia del me një strehë të gjerë rreth 0.60 — 1.20 m. Pjesa e çatisë që mbulon hajatin ose çardhakun në ballin e banesës mbështetej mbi shtylla druri.

Shtëpia e zjarrit kishte gjithmonë për dysheme truallin të shtruar me baltë. Nga brenda zakonisht muret suvatohen me llaç balte dhe lyhen herë pas here me shërbet po prej balte.

Banesat fshatare duke qenë të ndërtuara me mure guri të lidhura me breza druri e llaç balte, materiale këto që siç dihet kanë një qëndrueshmëri relativisht të shkurtër kundrejt agjentëve atmosferikë, kanë bërë që banesat të kenë pasur një jetë relativisht të shkurtër.

Si përfundim mund të themi se në pellgun e vogël që përkufizohet nga fshatrat kodrinore përreth qytetit të Tiranës janë ruajtur deri në ditët tona banesa të vjetra, nëpërmjet të cilave ne mendojmë se mund të arrihet të përcaktohen tiparet karakteristike të banesës tiranase si tip i veçantë në kuadrin e banesës shqiptare, e cila dallohet në kompozim, teknikën e ndërtimit si dhe në drejtimet kryesore të rrugëve të zhvillimit të saj.

Materiali i mbledhur dhe parashtruar duke filluar me banesën më të thjeshtë, njëkthinëshe, deri në variantet më të zhvilluara mendojmë se argumenton në mënyrë bindëse karakterin dhe zhvillimin e kësaj banese, në tre drejtime kryesore.

Së pari, siç duket edhe në variantet e banesës një kthinëshe zhvillimi fillestar është arritur brenda volumit të ambientit kryesor, shtëpisë së zjarrit. Banesat që kemi parasysh në fig. 1-4 pasqyrojnë qartë fazat më të rëndësishme të përpjekjeve fillestare për shtimin e sipërfaqes së banuar dhe krijimin e ambienteve të rinj, brenda shtëpisë së zjarrit. tab. X.

Në fazën e parë të këtij zhvillimi vërejmë se është arritur të krijohet një vend i ngritur me lartësi të vogël nga trualli i shtëpisë së zjarrit, i cili kryesisht përdorej për fjetje. Në një variant tjetër këtë e gjejmë pak më të zhvilluar e të ngritur në gjysmë lartësinë e shtëpisë së zjarrit duke krijuar një ambient që fshatarët, tanimë e emërtojnë «mafil».

Sikurse e kemi theksuar, nevoja e strehimit të kurorës së parë, që i shtohej familjes, bëri që mafili të rriste sipërfaqen e tij duke u krijuar brenda këtij një ambient tjetër i posaçëm, i ndarë nga shtëpia e zjarrit. Gjatë këtyre fazave banesa fshatare nuk duket se bën ndonjë ndryshim të madh në pamjen e saj të jashtme, përveç zmadhimit të sipërfaqes dhe vëllimit të saj.

Në rrugën e dytë përpjekja fillestare duket se është krijimi i hajatit para hyrjes së shtëpisë së zjarrit dhe më vonë të dhomës së fjetjes, të ndarë me mur nga shtëpia e zjarrit, por me hyrje gjithnjë nëpërmjet saj. tab. X.

Në fazën përfundimtare të kësaj rruge arrihet kristalizimi i banesës tiranase si tip e cila merr karakteristika të veçanta, si në zgjidhjen planimetrike ashtu edhe në pamjen e saj të jashtme.

Vërejmë se varianti i kristalizuar i banesës tiranase, ka afërsi të qarta kompozicionale me banesën e tipit «Megaron», gjë që të shtyn të mendosh për formimin e lashtë në kohë të banesës tiranase.

Në rrugën e tretë të zhvillimit të kësaj banese duke gjykuar gjithmonë në bazë të atyre banesave që kemi gjetur në këmbë vërejmë se në mënyrë të vazhdueshme si modul kryesor në kompozimin e planimetrisë së banesës qëndron shtëpia e zjarrit me të gjitha karakteristikat që përfaqësohet në fazën e kristalizuar të banesës tiranase, ndonëse bri saj vendosen variante të ndryshme më të zhvilluara të këtij tipi.

DO NOT COPY

Përsëritja e tipit fillestar karakteristik të banesës tiranase e varianteve të ndryshme të tij dhe arritja e tyre deri në ditët tona nuk duhet të na shtyjë të mendojmë se fshatari tiranas nuk ka bërë përpjekje për të përmirësuar konditat e jetesës dhe banimit të tij. Theksojmë se zhvillimi i banesës fshatare është bërë gjithmonë kur janë krijuar kushtet ekonomike e shoqërore të vetë familjes fshatare. Ky zhvillim është bërë gjithmonë me hapa të matura e në mënyrë racionale duke përfaqësuar kurdoherë në mënyrë krijuese elementet karakteristike të banesës origjinale.

Shpesh fshatari tiranas është rikthyer në variantet e banesave të vjetra dhe disa herë në format më primitive atëhere kur për arsye të ndryshme ai është gjetur në kondita ekonomiko-shoqërore të njëllojta apo të përafërta me ata që i krijuan këto banesa.

Për lashtësinë e banesës fshatare tiranase, na tregon shumë qartë edhe vetë fakti se në këtë banesë ruhet shtëpia e zjarrit si ambienti kryesor i saj. Në këtë ambient ruhesh deri në kohët e vona vendosja e vatrës së zjarrit në mes të truallit të tij dhe në formën e saj më primitive.

Banesat fshatare që trajtuam në këtë punim bartin në vetvete forma planimetrike, materiale dhe teknike ndërtimi që siç dihet kanë qenë në përdorim që në kohët më të lashta. Rrjedhimisht ne mendojmë se banesat fshatare përreth Tiranës përfshirë këtu edhe banesat vëndase të këtij qyteti duhet të shikohen si replike të banesave më të vjetra të vendit tonë.

Ekzistenca dhe përdorimi deri në ditët tona të formave fillestare dhe i atyre më të zhvilluara në fshatrat e rrethit të Tiranës tregon për një banesë autoktone, lindur dhe zhvilluar në të njëjtin territor. Në këtë mënyrë studimi dhe botimi i këtyre banesave është me një interes të veçantë sepse me rrugën retrospektive ne mund të ndjekim edhe zhvillimin në përgjithësi të banesës shqiptare.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



FIG 1



FIG 2





FIG 3



FIG 4

DO NOT COPY



0 2 4 m



0 1 2 m

FIG. 5



0 2 4 m



FIG. 6

DO NOT COPY



FIG. 7



FIG. 8

DO NOT COPY



FIG. 9





FIG 10

DO NOT COPY



FIG 11



FIG 13



FIG 12



FIG 14





FIG 15





FIG. 16





DO NOT COPY

DO NOT COPY



FIG 1.a

DO NOT COPY



PAMJE KRYESORE



PREMJE TERTHORE

0 2 4m



KATI PERDHES



0 2 4m

KATI I I

FIG. 17



PAMJE KRYESORE

0 2 4 6m



PAMJE KRYESORE

0 1 2m



PLANIMETRIA

0 2 4 6m



KATI PERDHES



KATI I Ī rë

0 2 4m

FIG 18

DO NOT COPY

DO NOT COPY



ZHVILLIMI I BANESES TIRANASE BRENDA SHTEPISE SE ZJARRIT



ZHVILLIMI I BANESES TIRANASE ME HAJAT

Koço ZHEKU

DO NOT COPY

L'HABITATION RURALE DANS LES VILLAGES S'ETENDANT SUR LES COLLINES AUX ENVIRONS DE TIRANA

RESUME

Dans les villages de la zone mamelonnée s'étendant aux environs de Tirana on a employé dans le passé un type d'habitation dont les traits caractéristiques quant à la forme de la planimétrie, de la construction, de la technique de construction et en général de la formule architectonique, présentent un intérêt de grande valeur pour l'étude de l'architecture populaire albanaise.

Les maisons paysannes objet de cette étude furent construites dans la période s'étendant de la fin du XVIIIe siècle jusqu'à la première moitié du XXe. Cette chronologie a été établie à la suite des conversations que nous avons eues avec les paysans propriétaires de ces maisons, car nous n'avons pu repérer des dates de construction en aucune occasion.

L'évolution architectonique des habitations situées dans les villages de la zone mamelonnée s'étendant aux environs de Tirana peut être suivie, à notre sens, à travers certaines variantes que nous avons choisies parmi les différents types de maison plus caractéristiques identifiés dans divers villages. Evidemment cette évolution outrepasse les limites de la période de temps indiquée pour la construction de ces maisons, du fait même que parmi celles-ci, comme on va le voir, il y a des variantes qui se reproduisent et dont la forme planimétrique présente des analogies typologiques avec les habitations appartenant à des périodes beaucoup plus anciennes.

Les écrits publiés à ce jour sur les habitations de ces villages constituent la seule base pour brosser le panorama architectonique et les traits relatifs à la construction de ces maisons. Afin de rendre plus compréhensible l'habitation rurale tiranoise, il serait utile de faire brièvement une description du milieu géographique et des conditions économiques et sociales de la population rurale qui habitaient dans ces maisons avant la libération de l'Albanie.

Le milieu environnant des villages de la région de Tirana se caractérise par un climat tempéré maritime et par une végétation naturelle à nette prédominance, dans le passé, de buissons et de petites forêts peuples de chênes et de bruyères. Généralement les villages se trouvaient au milieu des olivaies s'étendant sur les flancs des collines qui entourent la plaine de Tirana. La surface de terre destinée aux cultures céréalicoles était très limitée et s'étendait aux environs des habitations paysannes, tandis que la plaine de Tirana était couverte dans sa plus grande partie par des forêts denses, séculaires. Quant au reste de cette plaine, sa partie déboisée, elle n'était destinée qu'à la culture du maïs du fait qu'en l'absence de canaux d'écoulement elle était inondée pendant presque toute l'année.

Quant à la composition géologique des collines sur lesquelles se dressent les villages de Tirana, on relève une nette prévalence des formations gréseuses qui constituent la principale source d'où sont extraites les pierres pour la construction des habitations rurales. L'agglomération rurale, le village, s'appelle dans cette région «katun» et ses habitants «katunar». Chaque village comportait en général de trois à quatre quartiers, composés par des groupes de maisons habitées d'ordinaire par des familles dérivant de la même souche.

La composition de la population se rattache à un petit groupe, ayant des traits ethnographiques et linguistiques communs et appartenant au groupe de la Gegëri selon la division régionale du peuple albanais.

La population paysanne de cette région s'occupait dans le passé de la culture de l'olive et de son traitement, sans délaisser les autres cultures agricoles et l'élevage. La terre était travaillée avec des instruments primitifs, une charrue de bois ayant un soc de fer trainée par des boeufs et des bufles.

Le maïs en tant que principale production végétale, était employé surtout pour la préparation du pain. Les autres céréales panifiables étaient moins cultivés dans ce district. Les villages de la zone dite Rrëzë e Dajtit, où sur le fond de la montagne de même nom s'étendent des pâturages d'été, se distinguaient par un développement plus intense de l'élevage et de ses produits comme le beurre, le fromage, les peaux et la laine.

Tous ces produits étaient traités par les femmes paysannes-

à l'intérieur de leur logis dans la mesure pour satisfaire les besoins indispensables en nourriture et vestiaire des membres de la famille. Les productions animales et végétales sont représentées par plusieurs pièces auxiliaires construites dans la cour de la maison, comme le sont les granges ouvertes du maïs et les locaux destinés à l'abri du menu bétail, des bêtes de travail et des bufles.

Dans la majorité des cas la construction de ces pièces consiste en un squelette de bois tressé de verges et couvert toujours avec de la paille de maïs ou de blé.

Chaque paysan ne possédait que le terrain de la cour de sa maison et une petite surface de terre destinée à la culture des céréales et s'étendant à ses alentours; les olivaies étaient dans la plupart des cas propriété des agas de la ville et les paysans ne recevaient en nature que la moitié de la production annuelle pour les façons culturales effectuées. Cette culture aussi est représentée presque dans toutes les habitations rurales par un moulin à huile équipé des instruments nécessaires comme pressoir, réservoir de décantation et jarres. Dans le type d'habitation que nous sommes en train d'examiner nous n'avons jamais rencontré l'aire de battage et le hangar destiné à abriter les animaux et la volaille.

Ces pièces, comme on le verra plus loin, furent ajoutées successivement à l'habitation paysanne selon les exigences du cas.

Les principales pièces de la maison rurale tiranoise sont: 1) La «maison du feu» ou «maison du pain»; 2) les chambres à coucher ou «të rramët»; 3) la veranda ou «hayat»; 4) le «qur» 5) la chambre des amis; 6) le «tchardak» et 7) les installations sanitaires.

Quant à l'emplacement de ces pièces, cela dépend des conditions du terrain, de la disposition de la surface destinée à l'habitation et des possibilités économiques du propriétaire de la maison.

L'habitation à une seule pièce nous l'avons rencontrée dans plusieurs villages de cette région et elle abritait les familles appartenant aux couches plus pauvres paysannes.

Ces premières habitations représentent du point de vue de la formulation architectonique les phases plus anciennes de la maison paysanne à une pièce.

Dans le village de Mullet nous avons trouvé une variante de la maison à une pièce (Fig. 1) avec une planimétrie de forme carrée aux dimensions 5 x 5 m., une entrée et l'âtre du feu disposé au milieu de la chambre.

L'évolution de cette variante en direction de l'accroissement de la surface destinée à l'habitation a eu lieu par le passage de la planimétrie de forme carrée à celle de forme à angle droit. De la sorte la surface destinée à l'habitation s'est accrue de près de 40 m^2, presque le double de la surface caractérisant la variante initiale à une pièce et à planimétrie carrée. La maison de la Fig. 2 (Mullet) indique les premiers efforts entrepris pour l'accroissement de la surface destinée à l'habitation même en direction verticale. Dans la maison que nous avons choisi comme exemple, il y avait sur toute la largeur de la «maison du feu» une construction de bois aux dimensions 5 x 2 m. et dont le plancher se trouvant à 0.80 cm. au-dessus du niveau du sol était revêtu d'un assemblage de planches. Ici nous avons affaire à la première tentative de créer une nouvelle pièce à l'intérieur de la «maison du feu», que les gens du pays appellent «mafil» et qui est employé comme chambre à coucher. L'accès au plancher du «mafil», lorsque celui-ci est relativement peu haut, se fait à travers les trois ou quatre marches d'un escalier de bois.

En ce qui concerne la forme intégrale du «mafil», dans la variante de l'habitation à une pièce, nous l'avons retrouvée dans le village de Prezë (Fig. 3). Cette habitation montre une planimétrie à angle droit et l'âtre du feu est aménagé à proximité du mur situé à droite de l'entrée de la maison. Ici le «mafil» se trouve à 2 m. au-dessus du niveau du sol, soit à la moitié de la hauteur de la maison, aussi se caractérise-t-il par une construction en saillie.

Dans le petit bassin circonscrit par les villages s'étendant sur les collines environnant la ville de Tirana, il y a encore d'anciennes maisons à partir desquelles il est possible de définir, à notre avis, les traits caractéristiques de l'habitation tiranoise en tant que type particulier dans le cadre de la maison albanaise du fait que celle-ci se distingue quant à sa composition, la technique de construction et les directions principales de son évolution.

Le matériel recueilli et exposé, depuis l'habitation plus simple à une pièce jusqu'aux variantes plus évoluées, montre on ne peut mieux le caractère et l'évolution de ce type de maison en trois directions principales.

Premièrement, comme cela apparaît aussi dans les variantes à une pièce, l'évolution initiale de ce type d'habitation a eu lieu dans le volume même de la pièce principale: la «maison du feu». Les habitations des Figs. 1 – 4 reflètent clairement les phases plus importantes des efforts entrepris au commencement pour accroître la surface destinée à l'habitation, en créant des pièces nouvelles à l'intérieur même de la «maison du feu» (Tab. X).

Au cours de la première phase de cette évolution, dans la «maison du feu» a été aménagé un endroit peu élevé du niveau du sol qui faisait les fonctions d'une chambre à coucher. Dans une variante plus évoluée, cet emplacement s'élève jusqu'à la moitié de la hauteur de la «maison du feu» en créant de la sorte une pièce appelée par les paysans «mafil».

Comme nous l'avons souligné, le besoin d'abriter le premier couple qui venait s'ajouter à la famille a entraîné l'accroissement de la surface du «mafil», en créant de la sorte dans son volume une pièce nouvelle, particulière, séparée de la «maison du feu». Au cours de ces phases l'extérieur de la maison paysanne ne subit pas des modifications importantes, si ce n'est l'accroissement de sa surface et de son volume.

Au cours de la deuxième phase de son évolution, les principaux efforts sont tendu au commencement à créer une espèce de véranda («hajat») par devant l'entrée de la «maison du feu» et plus tard de la chambre à coucher; le «hajat» est séparé

ZONOTOPOY

de la «maison du feu» par un mur et l'on ne peut y accéder que par l'entrée de celle-ci (Tab. X).

A la fin de cette phase l'habitation tiranoise se cristallise en tant que type particulier, du fait qu'il se distingue tant par la solution apportée à sa planimétrie que par la modification de son extérieur.

Il convient de relever que la variante définitive de l'habitation tiranoise, dans sa forme cristallisée, présente des analogies évidentes avec le type d'habitation «Megaron»; donc nous avons affaire à une habitation dont les origines sont très anciennes.

Au cours de la troisième phase de son évolution, en nous fondant toujours sur les habitations existantes que nous avons pu observer, la composition planimétrique de la maison tiranoise se développe ayant comme module principal la «maison du feu» avec tous les traits qui la distinguent pendant la phase de cristallisation de ce type d'habitation. Toutefois, nous avons eu l'occasion d'observer des variantes encore plus évoluées en ce sens.

La répétition du type initial, caractéristique, de l'habitation tiranoise, ses différentes variantes et le fait que celles-ci soient parvenues jusqu'à nos jours, ne doivent pas nous induire à penser que les paysans de cette zone n'ont pas fourni des efforts pour améliorer leurs conditions de vie et d'habitation. Il convient de souligner que l'évolution de l'habitation rurale a toujours coïncidé avec l'existence de conditions économiques et sociales favorables pour la famille paysanne elle-même. Cette évolution s'est accomplie à pas sûrs et judicieusement, en suivant de près de façon créatrice les éléments caractéristiques de la maison originale.

Souvent le paysan de la zone de Tirana est revenu aux variantes des anciennes maisons, voir même aux formes plus primitives de celle-ci, quant il s'est trouvé dans des conditions économiques et sociales analogues ou proches à celles qui ont donné le jour à ces maisons.

En ce qui concerne l'ancienneté de la maison paysanne de la zone de Tirana, en témoigne très clairement le fait que dans cette habitation la «maison du feu» a été conservée en tant que pièce principale. Il y a quelque temps encore on pouvait voir l'âtre du feu au milieu du plancher à même le sol et dans sa forme plus primitive.

Les maisons paysannes que nous venons d'examiner se caractérisent par des formes planimétriques, des matériaux et une technique de construction qui ont été employés, comme on sait, depuis les temps plus antiques. En conséquence, les maisons paysannes de la zone de Tirana, y compris les plus anciennes habitations de la ville même, représentent à notre avis une réplique des plus anciennes habitations du pays.

L'existence et l'emploi jusqu'à nos jours des formes initiales et de celles plus évoluées de ce type de maison dans les villages de la zone de Tirana montrent que nous sommes en présence d'une habitation autochtone, qui est née et s'est développée sur le même territoire. Ainsi l'étude de ces habitations et la publication des résultats obtenus sont d'un grand intérêt du fait que même par un examen rétrospectif l'on peut suivre l'évolution générale de l'habitation albanaise.

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

BANESA POPULLORE NË FSHATRAT E RRETHIT TË VLORËS *)

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve fshatare, gjatë viteve 1975-1977 krahas ekspeditave në rrethe të ndryshme të vendit janë kryer dhe tri ekspedita gjurmimi në fshatrat e rrethit të Vlorës (Fig. 1). Ekspedita e parë përfshiu zonën e Mesaplikut dhe Kurveleshit të poshtëm, e dyta zonën ndërmjet, rrjedhjes së Vjosës dhe pjesërisht lumit të Shushicës dhe rrugës Vlorë-Tepelenë nga perëndimi e jugu. Ekspedita e tretë u krye në zonën e ulët, në rjedhën e poshtëme të Vjosës[1]. Zonat e gjurmuara bëjnë pjesë në grupin e madh etnografik të Labërisë. Ndërsa zona e Mesaplikut e Kurveleshit të poshtëm dhe ajo kodrinorja, në jug të rrjedhjes së poshtme të Vjosës kanë karakteristika të njëjta ekonomiko-shoqërore, të cilat pasqyrohen dhe në tipologjinë e njejtë të banesës, Zona e ulët në jug të rrjedhjes së poshtme të Vjosës ka qënë në të kaluarën në kushte krejt të tjera. Pikërisht për këtë arsye banesa në zonën e fundit shkëputet qartë nga tipologjia e banesës së dy zonave të përmendura. Këto rrethana qenë shkaku që në parashtrimin e materialit, zona në jug të rrjedhjes së poshtme të Vjosës do të trajtohet si njësi më vete. Të dy zonat e tjera do të paraqiten së bashku, duke qëndruar në bazën e trajtimit kriteri tipologjik, pa lënë mënjanë karakteristikat e tjera në planin arkitektonik dhe konstruktiv. Një vend me rëndësi do të zënë dhe zgjidhjet e veçanta, ndërsa disa qendra do të trajtohen veças, sepse paraqesin tipare të dalluara nga vendbanimet e tjera.

Zona e ulët, në jug të rrjedhjes së poshtme të Vjosës

Në këtë zonë përfshihet ultësira në jug të derdhjes së Vjosës dhe kënetës së Nartës, gjithashtu dhe ajo rreth një lartësie të ulët kodrinore, në të majtë të rrjedhjes së poshtme të Shushicës, e cila është mjaft e dendur me vendbanime fshatare.

Kjo zonë në të kaluarën ka qenë e përfshirë pothuajse e gjitha në sistemin e çiflikut, pra ka qenë pronë e feudalëve të mëdhenj, shumica e të cilëve qëndronte në Vlorë. Pikërisht për këtë arsye ajo për nga karakteri i marëdhënieve ekonomiko-shoqërore duhet mbajtur e njëllojtë me krahinën e Myzeqesë, ku sistemi i çifligut kishte gjetur përhapje shumë të madhe. Të dhënat për banesën e kësaj zone thuajse

*) Banesat e fshatrave të zonës së Bregut të Detit do të trajtohen në një artikull të veçantë.

1) Gjatë ekspeditës së parë u gjurmuan fshatrat: Gjorm, Bashaj, Matohasanaj, Ramicë, Velçe, Lepenicë, Brataj, Tërbaç, Vranisht, Kallara, Bolenë, Kuç, Çorraj dhe Fterë. Gjatë ekspeditës së dytë fshatrat: Mavrovë, Gumenicë, Rexhepaj, Mërtiraj, Haderaj, Armen, Sevaster, Golimbas, Shkozë, Dushkarak, Vajzë, Peshkopi, Selenicë, Romës, Karbunarë, Picar, Lubonjë, Penkovë, Vezhdenisht, Treblovë, Kacul, Gërnec, Mallkeq, Hysoverdhë, Amonicë, Zvërnec, Nartë dhe Kaninë. Në ekspeditën e fundit u gjurmuan fshatrat: Radhimë, Drashovicë, Qishbardhë, Babicë, Xhyherine, Risili, Cebrat, Bunavijë, Bestrovë, Grabian, Llakatund, Mëkat, Beshisht, Trevllezër, Dellënjë, Zhyk, Grykpishë, Poro, Bishan, Novoselë, Aliban, Mifol, Skrofotinë, Cerkovinë, Pana dhe Hoshtimë. Ekspeditat u drejtuan nga autori i këtij artikulli me pjesëmarrjen e B. Penxhës, A. Qyshkës, H. Savos dhe A. Drazhi.



DO NOT COPY

Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3

mungojnë, me përjashtim të përmendjes anësore në pak botime[1]. Me interes është një punim mbi banesat e fshatit Pojan të Myzeqesë, ndër të cilat ato të vjetrat, janë të njëjta me zonën në shqyrtim[2].

Gjatë ekspeditës në fshatrat e shumta të kësaj zone, nga banesat e vjetra, ruhej një numër tepër i vogël, dhe këto më shumë të braktisura. Arsyet janë dy, së pari, fakti i njohur i ndryshimit rrënjësor të kushteve të jetesës në këto krahina ku shtypja dhe padrejtësia shoqërore qenë veçanërisht të spikatura në të kaluarën. Rendi i ri socialist, ashtu si për mbarë vendin dhe për këto zona krijoi kushtet për një rilindje të vërtetë, e cila u pasqyrua shpejt në një veprimtari të vrullshme ndërtimore, duke lënë banesat e vjetra, tashmë të papërshtatshme dhe duke ndërtuar banesa të reja. Së dyti, banesat e vjetra, duke qenë të ndërtuara me materiale të dobëta ndërtimore, nuk i kalonin të 20 vjetët. Megjithëkëtë, gjurmët e pakëta që ende ruhen, ndërtimet e reja ndihmëse, që siç dihet shpesh përsërisin format e mëparshme të banesës si dhe të dhënat gojore, lejojnë të krijohet një kuadër i mirë i tipave të banesës së vjetër. Tipologjia jo tepër e larme e kësaj banese, gjithashtu lehtëson mjaft këtë paraqitje.

Zona e ulët, në jug të rrjedhjes së poshtme të Vjosës, në të kaluarën ka qenë thuajse e gjitha pronë e çifligarëve. Toka i përkiste atyre, ndërsa vetëm pak fshatra ishin jashtë sistemit të çifligut. Fshatarët çifçinj punonin tokën e çifligarit. Nëse fshatari punonte tokën me pendën e tij të qeve, ai i detyronte çifligarit një të tretën e prodhimit, me përjashtim të taksave të shumta që i detyrohej shtetit. Kur qetë, ishin të çifligarit prodhimi ndahej përgjysëm. Zakonisht dhe banesa ishte pronë e beut, duke qenë kështu çifçiu ishte praktikisht i zhveshur nga çdo pronësi, dhe si i tillë i ekspozuar karshi shfrytëzimit më të thellë, me shpërblimin e plotësimit të kushteve minimale jetësore, sa për të siguruar mundësinë fizike për të punuar tokën e tjetërkujt. Vetëkuptohet se këto kushtet jetësore, kanë përcaktuar dhe karakterin e banesës, e cila nuk mund të ishte tjetër, veçse një strehë e thjeshtë. Çifligari duke dashur të shfrytëzonte sa më mirë fshatarin çifçi, i ndërtonte banesat pranë ngastrave të tokës. Kështu që fshati merr një karakter tepër të shpërndarë, banesat e vogla, mezi spikasin, ndërsa diku, zakonisht mbi një lartësi që sundon fushën përreth, ngrihej kulla e çifligarit, në të cilën ai, apo qehajaj nuk mungojnë asnjëherë në kohën e vjeljes së prodhimeve.

Banesa e çifçiut është gjithmonë përdhese. Kompleksi i banimit formohet përveç kësaj dhe nga stalla, hambari, furra, shpesh pusi, dhe ambienti sanitar, të gjitha këto mjaft të thjeshta me materiale rrethanore. I gjithë kompleksi i banimit rrethohet me gardh të ulët. Në oborr mungojnë pemët, sepse çifçiu në çdo moment mund të detyrohej të largohej, apo të ndërronte vendbanimin. Banesa përdhese sipas përbërjes familjare të çifçiut ishte një, dy apo dhe trikthinëshe. Banesa dykthinëshe, ishte ajo më e përhapura.

1) G.V. Hahn, **Albanesische Studien,** Jena, 1854, 73 V. Rosatti, **Relazione dela commissione per lo studio dell'Albania,** Roma 1915. **M. Urban. Die siedlungen Sudalbaniens.**

2) K. Zheku, **shtëpitë e banimit në fshatin Pojan (Myzeqe),** Etnografia Shqiptare, 3/1966.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY

Banesa njëkthinëshe, ishte në plan në formë katërkëndëshi këndrejtë. Katër muret anësore, në njerin prej të cilëve ndërtohej dera, konturonin një hapësirë, që shpesh ndriçohej nga baxhaja, apo një dritare e vogël, siguruar me kapak druri. Ndërtimi mbyllej me çati, me katër kullime, e cila mbulohej zakonisht me kashtë dhe rrallë me tjegulla. Elementi kryesor i ambientit të vetëm të banesës ishte vatra, pak larg nga njeri prej mureve perimetral. Ambienti ishte përdhes dhe pa tavan. Në banesën dykthinëshe (fig. 2) me dy hyrje të veçanta për secilën ambient, ambienti kryesor ishte shtëpia e zjarrit, ndërsa ambienti tjetër, oda, po aq e varfër dhe pa asnjë përpunim si dhe shtëpia e zjarrit. Në familjet me shumë pjesëtarë ndërtohej dhe banesa trikthinëshe, gjithmonë me kompozim në formë vargu. Stalla është një ndërtim i thjeshtë, pranë banesës, ashtu si dhe hambari me materiale provizore. Furra, e cila ndërtohej nga gratë në oborr, mbulohej me një lloj kupole. Mungesa e ujit kishte përhapur mjaft ndërtimin e puseve. Banesa kish larg saj dhe ambientin sanitar.

Këto banesa të thjeshta, që më shumë i afrohen kasolles, për shkak të materialeve të brishta të ndërtimit dhe trajtimit të tyre, ndërtohen me dy materiale kryesore, me drurin dhe baltën, rrallë konstruksioni i çatisë mbulohej me tjegulla, ndërsa zakonisht mbi të vendosej kashtë. Pyjet nuk kanë munguar në këto zona, kallami rritej, ndërsa balta mund të gatuhej kudo. Muratura e këtyre ndërtimeve ishte me skelet druri. Ky skelet vishej me dy mënyra; duke u mbërthyer jashtë e brenda kallamat të cilët pastaj suvatoheshin me baltë, ose duke u mbushur (Fig. 3) hapësira ndërmjet dy faqeve të kallamave me baltë dhe pastaj mbi këta të fundit kalonte shtresa e baltës së punuar. Vetëkuptohet se teknika e dytë siguronte qëndrueshmëri më të lartë termike të mureve. Shtyllat kryesore të skeletit nguleshin në dhe, ose vendoseshin mbi gurë. Konstruksioni i çatisë ishte me sistem vendi, me strehë të zhveshura. Banesat e ndërtuara me këtë teknikë kishin një jetë relativisht të shkurtër 15-20 vjeçare, pas së cilës ato degradoheshin plotësisht. Karakteri i tyre thjesht utilitar, për plotësimin e kushteve minimale jetësore i zhvishte ato vetiu nga çdo përkujdesje për trajtimin e elementeve të ndryshme arkitektonike.

Siç përmendëm, në zonën në shqyrtim, krahas fshatrave çifliqe, kishte dhe fshatra që nuk ishin pronë e çifligarëve në të cilat, në dallim nga të parat, banesa kishte tipare të ndryshme të njëjta me ato të zonave të tjera të Labërisë.

Banesa e këtyre fshatrave, është banesë guri, përgjithësisht dykatëshe. Me interes janë banesat e fshatit Llakatund dhe Trevëllezër. Në këto fshatra ndeshet dhe banesa e njohur me gjysmëkat. Një shembull me interes i këtij lloji është banesa Nr. 1 (Fig. 4, tab. I) në fshatin Llakatund. Ajo është e zgjidhjes së njohur me dy ambiente sipër, dhe katoin poshtë, nën odën e miqve. Të dy ambientet e banimit, shtëpia e zjarrit dhe oda e miqve kanë ambiente sanitare të veçanta. Banesa e ndërtuar rreth mesit të shekullit të kaluar (sipas të dhënave gojore) dallohet për një trajtim të kujdeshëm të mbulesave të dyerve e dritareve. Të dy ambientet e banimit janë pa tavan, shtëpia e zjarrit përdhese ndërsa oda me dysheme druri. Oda ndërlidhej me katin me shkallë të brendshme që mbylle-



Fig. 6



Fig. 7

shin me qepen[3]. Banesa ka pësuar një shtesë të mëvonshme, e cila nuk lejon të përcaktohet qartë nëse fillimisht përbrl odës së miqve ka qënë ndërtuar një lloj çardaku, siç tregojnë disa gjurmë.

Por siç përmendëm përhapje të gjerë në këto fshatra (Fig. 5) ka banesa me kat. Zakonisht, ndërtohet banesa me dy ambiente në katin e sipërm, me shkallë të jashtme ose të brendshme; por të përhapura janë dhe zgjidhjet asimetrike. Gurët përpunohen me kujdes kur mbulojnë hapësirat e dyerve dhe dritareve. Nuk mungojnë as portat e jashtme mbuluar me faqen e jashtme me hark rrethor. Interes paraqiste dhe një kompleks i zhvilluar banimi në fshatin Mëkat[4], prej të cilit, nuk kanë mbetur veçse pak gjurmë.

Diferencimi kaq i spikatur i banesës brenda një rualli shumë të vogël, siç e shohim në rastin e paraqitur, është një dëshmi bindëse e faktit të pamohueshëm të përcaktimit të fenomeneve arkitektonike në përgjithësi dhe të banesës popullore në veçanti, nga faktorët ekonomiko shoqërorë.

Banesa e Mesaplikut, Kurveleshit të Poshtëm dhe zonës ndërmjet rrjedhjes së poshtme të Vjosës dhe Shushicës. Njësitë e mësipërme, në përgjithësi nuk dallojnë nga pjesët e tjera të krahinës së Labërisë, sepse kushtet ekonomiko-shoqërore kanë qenë po ato. Megjithatë në raportin ndërmjet dy degëve kryesore të ekonomisë, blegtorisë dhe bujqësisë, ndërmjet zonave të ndryshme ka dallime që përcaktohen kryesisht nga kushtet natyrore. Kurse zhvillimi i shoqërisë fshatare në këto zona, gjatë shek. XIX, të cilit i përkasin kryesisht banesat që janë bërë objekt i këtij punimi, kishte arritur në një shkallë të konsiderueshme të diferencimit klasor. Ky diferencim i cili, kishte krijuar dy pole, në njerën anë fshatarët e varfër që robëtoheshin me pak bagëti, dhe në anën tjetër fshatarët e pasur që zotëronin kope, toka dhe kullota[5]. Ndërmjet këtyre poleve, akoma qëndronte një shtresë e mirë e fshatarëve të mesëm, që ende i qëndronin synimeve të shtresës së pasur për t'i dobësuar ekonomikisht. Këto dukuri kishin cenuar tashmë rëndë organizimin e vjetër, kur diferencimi klasor nuk ishte aq i spikatur dhe kur prona e përbashkët e kullotave zinte një vend me rëndësi në ekonominë e fshatit.

Zona e Mesaplikut dhe e Kurveleshit të poshtëm, ashtu si edhe Kurveleshi i sipërm, ka pasur në bazën e ekonomisë, blegtorinë. Trojet e pakta për zhvillimin

3) Dera e katoit sigurohet me katarah, i cili bllokohej pas mbylljes me një binar vertikal, i cili duke lëvizur në një fole me seksion katror, komandohej nga oda e miqve. Zakonisht siguruesi, që në Gjirokastër emërtohet: «pingël», ndërsa në këtë zonë sirt i derës, vendoset normal katarahut në të njejtin nivel me të.

4) C. Patch. Das Sandschak Berat in Albanien, Wien 1904.

5) F. Haxhiu. **Ekonomia blegtorale në Kurvelesh gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX,** Etnografia Shqiptare, V. 1974.

DO NOT COPY

e bujqësisë, i dhanë rrugë zhvillimit të blegtorisë, e cila favorizohej nga kullotat e pasura verore, në malësitë pranë, në dy anët e luginës së Shushicës, si dhe nga kullotat dimërore në zonat e ulëta përreth. Por në krahasim me Kurveleshin e sipërm, bujqësia në zonat rreth rrjedhjes së sipërme dhe të mesme të Shushicës, ka qenë deri diku e zhvilluar.

Tipare disi të ndryshme ekonomike, paraqet zona ndërmjet rrjedhjes së poshtme të Vjosës në veri, dhe rrjedhjes së poshtme të Shushicës, në perëndim dhe jug, e cila megjithëse një masiv kodrinor, ka mjaft troje buke, ku bujqësia është zhvilluar mirë. Në këtë zonë bujqësia dhe blegtoria janë dy degë me një zhvillim të ekuilibruar. Kjo zonë është e hapur karshi detit, prandaj në pjesën perëndimore të saj kultivohet ulliri. Vendbanimet, përgjatë rrjedhjes së sipërme e të mesme të Shushicës, kufizohen anash nga masive malore të larta, malet e Lungares dhe Çikës nga perëndimi dhe mali i Gribës nga lindja. Një luginë e ngushtë në jug, të rrjedhjes të sipërme të Shushicës, i lidh vendbanimet e kësaj zone me ato të Bregut të detit. Kjo mbyllje natyrore, ka ashpërsuar klimën e kësaj zone.

Vendbanimet përgjithësisht ngrihen në lartësi, dhe rallë në ultësira. Si fshatra të ndërtuara në ultësira mund të përmenden: Gjormi, Lepenica, Brataj, Vranishti etj. Të paktë janë dhe fshatrat që ngrihen në troje me lartësi deri në 300 m. ndërsa një pjesë e mirë janë ngritur në lartësitë 300-600 m si: Velça, Ramica, Matogjini, Bashaj, Tërbaçi, Kuçi dhe shumë fshatra të zonës në jug të derdhjes së poshtme të Vjosës.

Fshati i zonave në trajtim është fshat i mbledhur. Ai formohet nga disa lagje, zakonisht në bazë fisi. Dëndësia e ndërtimeve është relativisht e madhe. Banesat rrethohen zakonisht me mure, portat e jashtme shpesh punohen me kujdes, duke u mbuluar me hark gjysëm rrethor (fig. 6). Rrjeti rrugor ka një zhvillim spontan, dhe në mjaft raste rrugët janë të shtruara me kalldrëm. Banesa, përgjithësisht nuk del në rrugë me pamjen e saj kryesore, por nuk mungojnë dhe zgjidhje të tilla, kur hyrja del drejtpërdrejt në rrugë.

Zhvillimi i madh i blegtorisë, në këto zona, në të kaluarën, ka bërë që gjatë shinëve të ngrohta, një pjesë e mirë e familjeve blegtore, të shpërnguleshin pjesërisht në vendqëndrime provizore, në stanet. Këta të fundit (fig. 7) ngriheshin në afërsi të kullotave verore duke u formuar nga vatha dhe ngrehinat provizore për strehimin e bagëtive që së bashku formonin një rreth të mbyllur dhe pranë saj ndërtonin zakonisht dy kasolle, njera për qëndrimin e barinjve (fig. 8) ndërsa tjetra për përpunim dhe ruajtjen e përkohshme të prodhimeve të qumështit, që përpunohej në stan.

Siç përmendëm, banesa e kësaj zone rrethohet



Fig. 8



Fig. 9

BOOST COPY

me një oborr, gjerësia e të cilit është relativisht e kufizuar në trojet shkëmbore ndërsa më e madhe në zonat e rrafshta, ku krahas oborrit qëndron dhe kopshti. Ndërtimi kryesor, brenda oborrit është banesa, por krahas saj ngrihen dhe ndërtime ndihmëse, vendin e të cilave e zinte kasollja ku qëndronin pak bagëti, që mbaheshin larg tufës, për të plotësuar nevojat e domosdoshme të familjes. Në disa raste, muret rrethuese të banesës, shfrytëzoheshin dhe për ndërtimin në to të disa kamareve (fig. 9) me një dalje në formë frengjie nga jashtë, në të cilat në mënyrë të thjeshtë sajoheshin zgjoje bletësh. Rrallë pranë banesës ndërtohej një ndërtim i dytë, më i vogël, i cili shërbente si shtëpi-miqsh, natyrisht në shtresat e pasura të fshatarësisë. Këto ndërtime, përsërisin skemat e thjeshta të banesës së zonës dhe përgjithësisht ishin të kompozuara në volum me gjysmëkat apo me kat. Një shembull me interes i kësaj zgjidhjeje është banesa Nr. 2 (fig. 10, Tab. I) në fshatin Mavrovë. Ajo është e kompozimit të njohur me gjysmëkat. Katoi në katin përdhe dhe ambienti i odës në katin e banuar, përpara të cilit ndodhet një parahyrje me ambientin sanitar, përbëjnë të gjithë ambientet formuese të kësaj shtëpie miqsh.

Një zgjidhje tjetër paraqet banesa e miqve Nr. 3 (Tab. I) në fshatin Lepenicë. Ajo është një ndërtim me kat, me shkallë të brendshme. Kati përdhe përbën një hapësirë të vetme. Shkallët e brendshme në fund të volumit të çojnë në një parahyrje të vogël dhe prej saj kalohet në odën e miqve. Të dy këto ndërtime janë ngritur pranë hyrjes për në banesë të shkëputura nga banesa e familjes. Siç kuptohet nga të dy shembujt e përshkruar, banesa e miqve nuk paraqet veçanti tipologjike në krahasim me banesën e mirëfilltë të zonës.

Siç kemi përmendur, diferencimi klasor i shtresave të popullsisë së kësaj zone gjatë shek. XIX, dhe më parë kishte arritur një shkallë të konsiderueshme. Lidhur me këtë flet qartë përhapja e kasolleve në funksionin e banesës. Në gjendjen e sotme ruhen në të gjithë krahinën vetëm dy kasolle të tilla në fshatin Amonicë. Të dyja ato (fig. 11, 12, Tab. II) i përkisnin një familje të vetme, duke qenë më e madhja, shtëpia e zjarrit, ndërsa tjetra, më e vogla oda e miqve.

Kasollet në plan kanë formën e një elipsi (kasollja e vogël ka diametrat 350-295 cm, ndërsa e madhja 600-400 cm). Ato janë ngritur mbi një truall me pjerrësi të lehtë, me aksin gjatësor normal të terrenit. Kasollja ka një hyrje të vetme. Në brendësinë e saj shquan pjesa ballore e kasolles, në të cilën duke shfrytëzuar rënien e terrenit është sajuar një podium rreth 40 cm i lartë, me gjerësi maksimale 100 cm, e cila quhet «policë». Në ballin e policës, në qendër të saj është ndërtuar vatra (fig. 13) përbri së



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

PO2101 COPY



Fig. 13



Fig. 14

cilës, në trupin e policës është formuar një lloj kamareje rreth 10-12 cm e thellë. Vatra është rreth 100 x 100 cm. Ndriçimi i kasolles sigurohet nga dera, nga një dritare e vogël, si dhe nga një baxhë me shumë vrima në kulm, prej të cilave njëkohësisht del dhe një pjesë e mirë e tymit. Interes paraqet teknika dhe mënyra e ndërtimit të këtyre kasolleve, që ngriheshin nga vet fshatarët. Ndërtimi kryhet në këtë mënyrë, mbasi bëhet rrafshimi dhe pastrimi i truallit, vendosen furkat kryesore, në largësi 1-1,5 m. Ato ngulen në tokë rreth 40 cm. Mbi këto vendoset brezi. Pastaj ngulen dy furkat e mëdha, brenda sipërfaqes së kasolles. Mbi to hidhet kulmi, pastaj mbërthehen qeprat rreth çdo 35 cm, e mbi to shufrat çdo 15-20 cm. Mbi këto të fundit pastaj bëhet mbulimi me kashtë, e cila përforcohet me thupra nga sipër. Pasi është ngritur karkasi, fillon thurja e gardhit, i cili lyhet nga brenda me baltë, në të cilën hidhet dhe kashtë. Lyerja bëhet me 3-4 duar, duke u shtrirë dhe rreth 40 cm nën strukturën e mbulesës, për të penguar depërtimin e erës. Pjesa e kamares punohet me gurë dhe pastaj lyhet me baltë. Vatrat shtroheshin me një lloj rëre të hollë (savur) mbi të cilën shtrohej pastaj baltë. Nga jashtë me baltë zakonisht lyhet vetëm balli në të cilin ishte ndërtuar dera. Për të mënjanuar vërshimin e ujërave në pjesën e prapme të kasolles, ndërtohet një kanal i vogël i cili largon ujrat që vinë nga sipër. Ndërsa konstruksionin e ndërtonin burrat, gratë bënin lyerjen e saj. Lënda më e preferuar ishte lisi. Një kasolle e tillë qëndronte 10-15 vjet, duke iu ndërruar mbulesa me kashtë çdo vit.

Kasolle me planimetri elipsoidale me konstruksione pak a shumë të ndryshme nga shembujt e Amonicës, takohen pothuaj në të gjithë vendin tonë[6], të cilat në të kaluarën kanë shërbyer dhe për banim nga shtresat e varfëra të fshatarësisë.

Banesa në zonat në shqyrtim karakterizohen nga një tipologji e larme e cila përmbledh një numër të madh realizimesh, që dallohen nga numri i kateve, kompozimi, trajtimi arkitektonik dhe tipare të tjera të dorës së dytë. Megjithë këto ndryshime të gjitha banesat e kësaj zone dallohen për unitetin e theksuar në idenë kompozicionale. Banesat nuk kanë tipare të veçanta nënkrahinore apo njësish më të vogla, por janë të barasshpërndara tipologjikisht në të gjithë trevën. Për një pasqyrim të përshtatshëm të tipologjisë së banesës së kësaj zone e kemi ndarë atë në tre kategori: banesën përdhese, atë me gjysmëkat si dhe banesën me kat, krahas tyre një vend jo pa rëndësi do të zërë trajtimi i zgjidhjeve të veçanta, të cilat megjithëse në tiparet thelbësore ndjekin karakteristikat e përgjithshme të banesës së zonës, dallojnë për karakteristika të veçanta.

Banesa përdhese. Kjo lloj banese, kronologjikisht më e lashta, gjatë shekullit XIX, ashtu si dhe në Kurveleshin e sipërm[7] nuk gjeti përhapje të gjerë në fshatrat e zonës që trajtojmë. Shembujt që takohen sot janë mjaft të rrallë, ata kryesisht janë njëkhinëshe e më rrallë dykhinëshe të ndërtuara të tilla që në krye, ose të sajuara me shtesën e një ambienti të dytë më vonë. Nga banesat që ruhen

6) K. Zheku, **Të dhëna mbi kasollet fshatare të vendit tonë dhe gjurmët e tyre në lashtësi,** Monumentet 5 – 6, 1973.

7) E. Riza, **Banesa popullore në Kurveleshin e sipërm,** Monumentet 9/1975.

DO NOT COPY

me interes të veçantë është banesa Nr. 4 (Tab. II) në fshatin Vranisht. Banesa formohet nga një kontur katërkëndësh kënddrejtë, mbuluar me çati katërujëshe. Ajo ka një hyrje të vetme, në skajin e njerës prej faqeve ballore, në të cilën është ndërtuar dhe dritarja e vetme, mjaft e vogël. Pothuaj në qendër të banesës që ndërtuara vatra (sot e prishur). Brendësia e ambientit është krejt e varfër, një kamare dhe një dollap muri janë të vetmet elemente që bien në sy. Si zakonisht ambienti është shtruar me baltë dhe nuk ka tavan. Të bie në sy sipërfaqja e madhe e ambientit të vetëm të banesës prej 36.6 m^2 (7.8 x 4,7). Banesa njëkthinëshe më e zhvilluar është dhe ajo Nr. 5. Në dallim nga banesa Nr. 4, banesa në fshatin Mallkeq (fig. 14, Tab. II) ka një lloj portiku përpara hyrjes, i cili është i mbyllur me zgjatimin e murit tërthor të banesës. Në brendësi, në mes të faqes ballore është ndërtuar oxhaku, ndërsa anash dy dritare, një e tretë, është simetrike me portën. Në disa raste portiku, mbahet nga dy shtylla druri, apo guri.

Banesa Nr. 4 ka një dallim të rëndësishëm nga ajo Nr. 5. Është fjala për trajtimin e ballit të banesës, i cili në banesën e parë është krejt i patrajtuar, ndërsa në banesën e dytë, ai është i dalluar qartë, duke pasur dhe oxhakun. Kështu ndërsa në banesën e Vranishtit, vendi kryesor i qëndrimit është ai në qendër të ambientit, rreth vatrës, në banesën e Mallkeqit, qëndrimi është zhvendosur në ballin e ambientit, pranë oxhakut, duke qenë kjo pjesë e ambientit me ndriçim të bollshëm. Ky ndryshim i rëndësishëm ndërmjet të dy banesave, lidhet me dukurinë e rëndësishme të zhvendosjes së vatrës, pranë murit ballor të banesës, duke marrë kjo pjesë e dhomës dallueshëm funksionet e qëndrimit.

Banesat dykthinëshe në këtë zonë janë mjaft të rralla, dhe nuk paraqesin të njëjtën zgjidhje me banesat e këtij lloji në Kurveleshin e sipërm[8]. Një shembull në fshatin Haderaj është kompozuar me thyerje, duke u vendosur të dy ambientet me akset gjatësore normal njëri-tjetrit.

Banesa me gjysmëkat. Kjo banesë e njohur në mbarë vendin është mjaft e përhapur dhe në zonën që trajtojmë. Atë e ndesh thuajse në çdo fshat, duke qenë veçanërisht të përhapura variantet me dy kthina banimi sipër, njëra prej të cilave është magjeria përdhese. Përhapja e gjerë e kësaj banese dhe familjarizimi me të, na detyrojnë të shohim disi më ndryshe shkaqet e këtij kompozimi interesant me thyerjen karakteristike në volum, e cila bën që ambienti i sipërm fundor të jetë përdhes, megjithëse është në të njëjtin plan me odën. Materiali i kësaj zone na shtyn të saktësojmë se kompozimi me gjysmë kat padyshim është diktuar nga terreni i pjerrët shpesh shkëmbor mbi të cilin ngrihej banesa[9], por në disa raste banesa ngrihej posaçërisht në troje të pjerrëta për të mundësuar krijimin e shtresës përdhese për magjerinë, në të cilën vatra në mes, apo më vonë dhe pranë murit fundor, nuk kërkonte pranë dysheme druri, e cila në çdo çast mund të shkaktonte zjarrin. Disa banesa në zonën e Bregut të Detit, dukefilluar që në fshatin Tragjas, në të cilat, për magjerinë krijohet një platformë mbi një apo dy qemere paralele, tregojnë qartë sa më sipër. Pra përfundimisht, mund të themi se banesa me gjysmëkat perpendikulare në formimin e saj u diktua nga terreni i pjerrët, por pas familjarizimit me të, ajo u gjet tepër praktike për shkak të magjerisë përdhese dhe si e tillë në mjaft raste banesa u vendos enkas, në troje të pjerrët, ose në rastin më të skajmë trualli i padjegshëm dhe praktik, për magjerinë, u sajua artificialisht. Me interes është të shënojmë se në këto zona kjo lloj banesa emërtohet: «e ngulur në bisht» ndërsa për magjerinë përdoret dhe sinonimi «dollma» (nga turqishtja që do të thotë e mbushur)[10].

Nga shembujt e shumtë të kësaj lloj banese, vlen të përmendet së pari banesa Nr. 6 (Tab. II) në fshatin Fterrë. Banesa paraqet në volum thyerjen e njohur, e cila nuk shtrihet shumë, por bën përdhese thuajse vetëm gjysmën e sipërfaqes së magjerisë. Në katin përdhe është ndërtuar katoi. Një palë shkallë guri, dyrampëshe, e dyta mbi qemer cilindrik, me zhvillim të thyer planimetrik, të çojnë në derën e vetme të katit të sipërm, prej nga shkohet nëpër odë, kalohet me magjeri[11]. Kjo zgjidhje është e pazakontë, që ndofta tregon se më vonë është bërë ndarja prej skeleti thuprash. Në ambientin e magjerisë përveç oxhakut dhe sqollit, të bie në sy furra në njerin kënd fundor, Ajo është e tipit të njohur me kësulë sferike.

Një zgjidhje klasike të këtij tipi paraqesin rrënojat e një banese në Vranisht, e cila pranë vatrës së magjerisë ka një kamare, që të kujton atë të vendit të zjarrit në kasollet e Amonicës Banesa Nr. 7 (fig. 15; Tab. III) në fshatin Çorraj, paraqet një zgjidhje më të arritur të kësaj banese. Në planin e kom-

8) E. Riza. **Banesa popullore në Kurveleshin e sipërm,** Monumentet 9/1975.
9) E. Riza, **Banesa me gjysmëkat – perpendikulare,** Monumentet, 7-8/1974.
10) Kolegu F. Zarshati ka gjetur në Malësinë e Lezhës, për të njëjtën banesë emërtimin: «me jerevi përkjetë» pra me shtëpinë përdhese sipër.
11) Përveç emërtimit magjeri, për shtëpinë e zjarrit, në këtë zonë përdoren dhe sinonimet «shtëpi e fëmijës» «shtëpi e punës» dhe «shtëpi e madhe».

DOKTORI

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16



Fig. 17

pozimit volumor, ajo përsërit banesën e Vranishtit me dallimin se muri ndarës ndërmjet të dy ambienteve është mur mbajtës. Dy hyrjet e veçanta për çdo ambient dhe ajo që ndërlidh së brendshmi ata, janë të grupuara pranë. Shkallët janë zhvilluar me një rampë normalë rënies së terrenit, zgjidhje kjo e rrallë. Me interes të veçantë në këtë banesë është portiku relativisht i gjerë, përpara hyrjeve, i cili merr karakterin e një çardaku të vogël, zgjidhje kjo që ndeshet në disa banesa të kësaj zone. Magjeria ka furrën, oxhakun dhe sqollin. Oxhaku fillimisht ka qenë pa tambur. Me interes në odë është një instalim fiks, në fundin e saj, që shërben poshtë si hambar, ndërsa sipër si musandër.

Banesa me kat. Kjo lloj banese ka pasur përhapje mjaft të gjerë në zonën tonë. Atë e gjejmë në zgjidhje të ndryshme, të cilat krahas ndryshimeve sasiore, dmth numrit të ndryshëm të ambienteve, kanë dhe ndryshime konceptesh kompozicionale, duke provuar kështu se banesa me kat, realizimi më i arritur në këtë gjini, ka pasur një rrugë të qartë zhvillimi, duke ruajtur disa njësi bazë kompozicionale dhe disa parime të përgjithshme arkitektonike dhe konstruktive. Në përgjithësi tipet më të zhvilluara janë më të përhapur në zonën që kufizohet nga rrjedhja e poshtme e Vjosës dhe Shushicës. Për këtë siç duket ka ndikuar dhe bujqësia më e zhvilluar e kësaj zone, madje në disa raste dhe afëria me qytetin e Vlorës, siç tregojnë disa banesa në fshatin Armen. Përkundrazi zona që shtrihet në dy anët e rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të Shushicës karakterizohet nga një tipologji më e thjeshtë, në të cilën mbisundon banesa me dy kthina të banuara në katin e sipërm.

Një prej shembujve më të thjeshtë të banesës me kat është banesa Nr. 8 (fig. 16, Tab. III) në fshatin Gjorm. Në gjendjen e sotme, në saje të shtesave të mëvonshme banesa ka pasur një rritje të madhe, duke e dyfishuar volumin e saj, me ndërtimin e një blloku të ri thuajse të njëjtë me origjinalin në pjesën perëndimore, normal me banesën fillestare. Banesa e vjetër është një zgjidhje tipike e banesës me kat me katoin poshtë, magjërinë sipër, dhe ambientin sanitar anash, jashtë konturit katërkëndësh kënddrejtë të banesës. Ndërlidhja me magjerinë si zakonisht me shkallë të



Fig. 23

Nr. 13 (fig. 21, Tab. V) në fshatin Mavrovë është një shembull tipik i kësaj zgjidhjeje. Banesa del në rrugë me të dy faqet e saj, duke përfshirë dhe pamjen kryesore. Banesa ka një kompozim të thjeshtë, me qendër hajatin poshtë dhe një lloj divani sipër, ndërsa anash, respektivisht poshtë, katojtë e sipër dy ambiente banimi. Shkallët e brendshme prej guri përfundojnë pranë hyrjes, së odës së majtë të katit. Ambientet sanitare, një për çdo odë, zhvillohen prapa. Një derë që ndodhet në faqen e prapme, siguron kalimin në oborr nga divani. Magjeria, në të djathtë të divanit ndërlidhet me shkallë shërbimi me katoin. Në hajat është ndërtuar një harkadë me dy harqe për të zvogëluar hapësirën e dritës të trarëve të dyshemesë së divanit. Porta kryesore e banesës si dhe dyert e katit, sigurohen me katarah. Të dy dyert e ambienteve të banimit në kat nga jashtë mbulohen me harkun e gurtë, me thellimin karakteristik nga niveli i suvasë. Banesa në pamjen e jashtme, ka të diferencuar të tri blloqet formuese të kompozimit me një thyerje të vogël të muraturës në kufijt e takimit të bllokut qendror me anësorët. Kuptohet se kjo thyerje minimale ka arsye thjeshtë estetike. Rreptësinë e kompozimit simetrik e prishin pak, vetëm dritaret e divanit. Banesa në të dy njësitë anësore të kujton mjaft qartë banesën e thjeshtë dykthinëshe me kat, e cila në kompozimin e dhënë gjithë duke ruajtur karakteristikat e njohura, është kompozuar mjaft organikisht me bllokun qendror, duke shënuar një moment të rëndësishëm rritjeje në banesën e Labërisë. Dy shembujt, në fshatin Armen, banesa Nr. 14, 15 (fig. 22, Tab. V, VI) janë të së njëjtës zgjidhje kompozicionale. Por krahas afërive me banesën e Mavrovës, shembujt e Armenit dallohen për dy ndryshime me rëndësi; së pari, pjesa qendrore relativisht e vogël, ka vetëm funksione ndërlidhëse dhe së dyti, më e rëndësishmja qëndron në qenien në katin përdhe të një ambienti banimi, që thirret sobë. Ky ambient kryen funksionet e shtëpisë së zjarrit. Zbritja e tij në katin përdhe përgjithësisht të pabanuar shënon një karakteristikë me rëndësi, e cila duhet mbajtur si një ndikim nga banesa qytetare. Të dy banesat e Armenit kanë disa dallime të vogla ndërmjet tyre. Banesa Nr. 14 ka hyrje të veçanta nga jashtë për sobën dhe i mungon muri i djathtë tërthor.

Një shkallë më të përparuar në kompozim paraqet banesa Nr. 16 (fig. 23, Tab. VI) në fshatin Amo-



Fig. 24



Fig. 25

DO NOT COPY



Fig. 26

nicë. Karakteristike e saj është zhvillimi i theksuar i bllokut qendror përpara. Në të dy krahët e tij me sipërfaqe më të vogla, ndërtohen dy blloqet anësore (sot, i majti i shkatërruar në katin e sipërm). Në bllokun e djathtë poshtë është soba, si në shembujt e Armenit, ndërsa sipër oda e miqve që ka dhe një hyrje të dytë të veçantë drejtpërdrejt nga jashtë. Zgjidhja e veçantë e pjesës fundore të ambienteve të hajatit dhe divanit duket se është diktuar nga pamundësia për të zhvilluar volumin e ambienteve sanitare përtej rrugës. Divani është trajtuar në ballin e tij si ambient i zakonshëm banimi me oxhakun dhe dy dritaret anash tij. Banesa është ndërtuar në vitin 1936 (sipas mbishkrimit), duke përbërë një zgjidhje më të përparuar në krahasim me ato të ngjashme me të.

Për t'u përmendur janë dhe disa banesa me kompozim rreptësisht simetrik që përbëjnë dy njësi më vete të trajtuara barazisht. Ato janë banesat e njohura për dy vëllezër si në fshat ashtu dhe në shumë qytete të vendit tonë. Banesa Nr. 17 (fig. 24, Tab. VII) në fshatin Amonicë, është një shembull i goditur i kësaj zgjidhje, e cila formohet nga dy njësi binjake. Pjesa qëndrore e këtij çifti është më e zhvilluar se një shembull i ngjashëm në fshatin Salari të Kurveleshit të sipërm.[12]

Krahas tipologjisë së parashtruar më sipër, e cila përfshin pjesën më të madhe të banesave të kësaj zone, në të ndeshen dhe zgjidhje të veçanta, që dallohen prej të tjerave nga kompozimi, ndërsa kanë të përbashkët llojin dhe trajtimin e ambienteve.

Së pari, duhet përmendur banesa Nr. 18 (fig. 25, Tab. VII) në fshatin Bashaj. Të dhënat gojore e çojnë këtë banesë në fillim të shek. XIX. Ajo ngrihet në krye të fshatit, mbi një shkëmb i cili është shfrytëzuar për mbështetjen në të të një pjese të muraturës. Banesa është dykatëshe. Kati përdhe ka dy hyrje, njëra prej të cilave kalon pjesërisht nën një qemer. Në këtë katin nuk ka asnjë ambient përveç hajatit. Shkallët



Fig. 27



Fig. 28

12) E. Riza. **Banesa popullore në Kurveleshin e sipërm,** Monumentet 9/1975; Banesa Nr. 12.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 29



Fig. 31

e gurta të çojnë në kat i cili ka një shtrirje më të gjerë. Në një zhvillim planimetrik të përthyer ky kat përfshin dy ambiente banimi dhe një nyje sanitare. Dalja e shkallëve pranë hyrjes për në ambientin e shtëpisë së zjarrit dhe kalimin nga një ambient në tjetrin janë një zgjidhje e rrallë.

Një zgjidhje të përparuar paraqet banesa Nr. 19 (fig. 26, Tab. VII) në fshatin Shkozë. Ajo nuk përfshin në volumin e saj katoin. Një vend të rëndësishëm në kompozim zenë dy ambientet ndërlidhëse të hajatit dhe divanit, në hapësirën e të cilëve zhvillohen shkallët. Ambienti sanitar del jashtë konturit të planimetrisë. Te kjo banesë duken qartë ndikimet e banesës qytetare.



Fig. 30

Interes paraqet banesa Nr. 20 në fshatin Kaninë (fig. 27, Tab. VIII) e cila është mjaft e zhvilluar dhe ka një kompozim të goditur. Ambientet e banesës, një katua dhe një ambient ndihmës në katin përdhes ndoshta qilari i zahiresë, ndërsa shtëpia e zjarrit dhe dy ambiente banimi në katin e sipërm, zhvillohen rreth hajatit dhe divanit të gjerë njeri mbi tjetrin. Shkallët zhvilloheshin në dy faqe të volumit të hajatit. Në të dy odat e katit të sipërm kalohet nëpërmjet një parahyrjeje, në fundin e së cilës janë nyjet sanitare. Krijimi i kësaj parahyrjeje ka ndikuar në shtrirjen e njerës odë përtej ambienteve qëndrore. Banesa, që kishte përngjitur dhe një ambient për mulli vaji, duket se i përkiste ndonjë fshatari të pasur.

Një zgjidhje shumë të rallë paraqet dhe banesa Nr. 21 (fig. 28, Tab. VIII) në fshatin Drashovicë, e cila është tri katëshe. Në katin përdhe një parahyrje me një aneks anash të çon në qilarin e zahiresë. Në katin e parë janë ndërtuar dy ambiente me ndërlidhje në mes të tyre, i djathti më i vogël në funksionin e ambientit të gatimit. Kati i tretë më i lartë 40 cm, ka të njëjtin kompozim planimetrik. Ngjitja në të bëhet me shkallë të brendshme, që zhvillohen në ambientin e vendit të gatimit, mbi të cilin është një i dytë thuajse identik. Përpara kalimit në odën e miqve të katit të dytë, kalohet në kompleksin e musandrës, nga i cili kalohet në ambientin sanitar, që del në formë kulle. Oda e miqve, si rast i veçantë është mjaft e përpunuar me tavan të punuar në dru, në qendër të të cilit është punuar një rozetë në formën e yllit 6 cepash. Trajtimi i musandrës me harkun me tri



Fig. 32



Fig. 34

qendra, e çon ndërtimin e kësaj banese rreth fundit të shek. XIX.

Ashtu si në krahina të tjera dhe në zonën në shqyrtim nuk janë të pakta rastet kur pranë një banese fillestare, me kalimin e kohës, ndërtohen banesa të tjera, si pasojë e shtimit të familjes. Këto shtesa ndërtohen përngjitur ndërtimit fillestar, duke krijuar në disa raste komplekse relativisht të mëdhenj. Një rast tipik i kësaj dukurie duhet konsideruar kompleksi i banesave Nr. 22 (fig. 29, Tab. IX) në fshatin Amonicë. Ndërtimet, të vendosura në formën e shkronjës L, njëra pas tjetrës, së bashku me një banesë përdhese përkundrejt formojnë thuajse një oborr të mbyllur. Kompleksi është ndërtuar në fillim të shek. XX, së pari banesa I, pastaj me radhë II, III dhe IV. Porta kryesore e kompleksit, që ngrihej bre-

nda volumit të banesës I, shënonte datën 1915, ndërsa kompleksi III është ndërtuar më 1920. Ky grup banesash ka pësuar mjaft ndryshime, banesa I është ulur një kat, ndërsa II dhe III kanë pësuar ndryshime të mëdha. I pa cënuar ruhet vetëm ndërtimi i fundit, i katërti, i cili kryente funksionin e shtëpisë së mia ve. Ai në dallim nga banesat e tjera, ka shkallë brendshme, dhe një zgjidhje të pazakontë të haj dhe divanit të vogël respektivisht në të dy katet fundin e hajatit është sajuar një lloj depoje, n sipër saj, në volumin e divanit dy ambiente sar Oda e miqve ka në fundin e saj një musandë i së cilës shkon deri sipër. Këto komplekse së bashku me lagjet në bazë fisi, flasin për a shmërinë e madhe të lidhjes së fortë të gjak to zona.

Një vend të veçantë në arkitekturën fshatare të kësaj zone zenë dhe disa gjurmë në numër të banesave me kullë dhe kull timin e ndërtimeve me karakter thellësi Qenja e banesave me kullë konfirmoh kujtesa popullore në këto zona, por rre dha që ka kaluar krahina e Labërisë shumta për pavarësi dhe drejtësi sh shkatërruar shumicën e këtyre ndër mbull mjaft me interes i banesës m gjendje rrënojë në fshatin Drashovic djegur gjatë Luftës Nacionalçlirimto sotme ruhen (fig. 30, Tab. X) vetë të majtë, ndërsa krahut të djathtë seja e mureve. Krahu i majtë fo përparme që përmban hajatin sipër, të mbyllur anash. Pas



Fig. 33

DO NOT COPY



Fig. 35



Fig. 36

është ndërtuar katoi në pjesën fundore të të cilit ngrihen dy qemere cilindrike paralele, që formojnë platformën e padjegshme për vendin e zjarrit të ambientit të banimit sipër. Ky i fundit ndërlidhet në pjesën e prapme të tij me ambientin sanitar dhe kullën, në nivel më të lartë se dyshemeja. Kulla ne planimetri është e pajisur me frëngji, të tilla janë ndërtuar dhe në faqen ballore dhe anësore të odës. Madje frëngjitë janë ndërtuar dhe në katua, nën njerin nga qemeret. Frëngjitë janë dy llojesh, njëshe dhe dyshe. Për të gjykuar për funksionin dhe karakterin e kullës, duhet së pari të kemi parasysh pozicionin e vetë banesës në këtë vendbanim. Ajo është ndërtuar në pjesën më të lartë të fshatit, prapa së cilës nuk ka asnjë mbrojtje. Pikërisht ky duket se ka qenë shkaku i ndërtimit të kësaj kulle, vrojtimi dhe mbrojtje, e cila nuk mund të ketë pasur funksione të tjera, po të kemi parasysh se, vetë banesa ka pasur një çardak të gjerë (ky është mbyllur më vonë, duke u ndërtuar në të një ambient banimi).

Një ndërtim mbrojtës i veçuar, është dhe kulla Nr. 24 (fig. 31, Tab. X) në fshatin Gumenicë. Kujtesa popullore e vendos kohën e ndërtimit të saj nga fundi i shek. XVIII. Kulla, është një ndërtim dykatësh, në katin e sipërm është ambienti i vetëm i qëndrimit. Nyja sanitare zhvillohet përtej vëllimit prizmatik të kullës. Frëngjitë e shumta në faqen jugore, flasin qartë për funksionin e këtij ndërtimi, si kullë mbrojtëse për fshatin. Kulla ka pasur oborr në pjesën veriore. Porta e oborrit ka pasur frëngji, ajo sigurohej gjithashtu dhe nga frëngjitë e vetë kullës që drejtoheshin nga ajo.

Krahas ndërtimeve në fshatrat e përmendura të kësaj zone, vlejnë të përmenden rrënojat e fshatit Kallarat si dhe qendra e banuar e Nartës. Kallarati (fig. 32) një fshat i zhvilluar mbi një pllajë të bukur pranë Shushicës, u dogj gjatë Luftës së Parë Botërore nga ushtritë greke, ndërsa Narta, mund të konsiderohet, si një qendër e ndërmjeme ndërmjet fshatit dhe qytetit.

Rrënojat e Kallaratit, që i përkasin shek. XIX në një pjesë të mirë, lejojnë të lexohet kompozimi i tyre. Shumicën e banesave të Kallaratit e përbëjnë ato me gjysmëkat me një ose dy ambiente në kat dhe me shkallë të jashtme guri. Krahas tyre ruhen dhe rrënojat e disa banesave më të mëdha, disa gjurmë të të cilave tregojnë për qenjen e volumeve të hapura. Banesat prej guri ruajnë elementet e zakonshëm arkitektonikë të zonës. Për t'u shënuar është ndërtimi relativisht i dendur i frengjive të luftimit (fig. 33) në muret e banesave, disa prej të cilave madje treshe.

Narta, qendër relativisht e madhe, në veri të qytetit të Vlorës, shtrihet mbi një terren të rrafshët, pranë detit, i cili në të kaluarën formonte njerin prej

DO NOT COPY



Fig. 36

burimeve kryesore të jetesës. Prej banesave të vjetra, sot thuajse nuk ka mbetur asnjë e pandryshuar, kështu që është vështirë të arrish në përfundime të plota e të sakta. Megjithëkëtë mund të thuhet se në Nartë nuk ndeshet ndonjë tip i parapëlqyer në mënyrë të veçantë. Në këtë qendër, mbisundon banesa dykatëshe (fig. 34), përgjithësisht e mbyllur, por shënjat tregojnë se njiheshin dhe tremat e hapura. Krahas banesave me kat, ndërtoheshin dhe banesat përdhese (fig. 35). Banesat janë të vendosura ngjeshur në formë vargu duke formuar rrugë të ngushta (fig. 36), në të dy anët e të cilave qëndrojnë ballët kryesore apo anësore të banesave. Dyert e oborreve apo banesave, shpesh mbuluar me hark, kati i sipërm, jo rrallë në formë konsoli me dritare të mëdha e të shumta, gjallërojnë mjaft rrugët e Nartës. Krahas gurit si material kryesor ndërtimor, është përdorur dhe teknika me skelet druri, ndërsa më vonë dhe tulla. Përhapje të gjerë në Nartë ka banesa dykatëshe, me ambientin ndërlidhës në qendër dhe me dy ambiente anash. Karakteri i banesave në Nartë, tregon qartë për tiparet mjaft të afërta të kësaj qendre me qytetin.

Zona që shqyrtojmë, siç kemi përmendur bën pjesë në krahinën e Labërisë, ashtu si dhe Kurveleshi i sipërm dhe njësi të tjera nënkrahinore. Përsa i përket teknikës së ndërtimit, e cila për vetë natyrën e saj përbën një karakteristikë relativisht të qëndrueshme dhe me shtrirje të gjerë, banesa e zonës që trajtohet përsërit atë të Kurveleshit të sipërm[13]. Një element i rëndësishëm i banesës, vendi i zjarrit me shembujt e zonës në shqyrtim, shfaqet qartë në zhvillimin e tij nga vatra, diku rreth mesit të shtëpisë së zjarrit, deri te vatra me oxhak. Në gjendjen e sotme nuk ruhet asnjë shtëpi zjarri që të ketë ruajtur vatrën në mes, por në kujtesën e banorëve ruhet shumë mirë kujtimi i kësaj vendosjeje, e cila ka qenë zgjidhja e zakonshme jo vetëm gjatë shek. XIX, e natyrisht dhe më parë, por deri vonë në vitet e para të pasçlirimit. Krahas kësaj vendosje të vatrës të paktën që në shek. XIV, siç dëshmojnë rrënojat e qendrës së banuar pranë kalasë së Borshit dhe ato të Kamenicës[14] është njohur dhe vendosja e vatrës, përngjitur murit fundor të shtëpisë së zjarrit, pikërisht në mesin e saj. Pranë vatrës ndërtohej një thellim në formë kamareje, mbuluar me një gur në formë arkitrau, ose me qemer rrethor. Në plan thellimi kishte formë apsidoidale ose thjeshtë katërkëndëshi këndrejtë. Baza e kamares së zjarrit është disa centimetra më e ngritur se niveli i vatrës. Një zgjidhje të rallë, paraqet vendi i zjarrit të këtij lloji në një banesë të vjetër, në fshatin Shkozë. Në shtëpinë e zjarrit, përngjitur vatrës, ngrihen dy kamare njëra mbi tjetrën. (fig. 37). E poshtmja katërkëndëshe këndrejtë në ballë, ndërsa e sipërmja mbuluar me qemer. Ndarja ndërmjet tyre nuk është e plotë, guri ndarës lë në pjesën e brendshme një rrip hapësire ndërlidhëse për të dy këto volume. Kjo zgjidhje të kujton ato të vendeve të zjarrit në disa banesa shkodrane, megjithse këto të fundit janë tashmë në volumin e tymarit[15]. Po në banesën e Shkozës, në odën e miqve vatra ka pranë një kamare të vetme. Kuptohet se dhe në vatrat me kamare, tymi mbushte volumin e shtëpisë së zjarrit dhe gjente rrugë kalimi, nëpërmjet tjegullave apo rrasave. Në zhvillimin e tij të mëtejshëm vendi i zjarrit, pajiset me një kamare më të lartë, mbuluar zakonisht

13) E. Riza, **Banesa popullore në Kurveleshin e sipërm,** Monumentet 9/1975.

14) E. Riza, **Banesa e hershme fshatare në Shqipërinë e Jugut. «Tradita në arkitekturë dhe art.»** Tiranë 1978. A. Meksi–E. Riza, **Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës.** Monumentet 7-8/1974.

15) E. Riza **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** Monumentet 4/1972, fig. 11, 12, 13, 14.

DO NOT COPY

me një lloj kulmi në formë samari, duke pasur sipër, në faqen e jashtme një vrimë për daljen e tymit, dhe jo tymarin deri në çati dhe oxhakun sipër saj. Zgjidhje të tilla ndeshen rrallë dhe në Gjirokastër[16]. Pajisja e thellimit tashmë të zgjeruar me kanal tymi, që ndodhet në kullën Nr. 1 të Kamenicës[17], dhe në mjaft banesa të Kardhiqit[18] përbën hapin e fundit drejt vendit të zjarrit, me oxhak, të cilit tashmë i mungon vetëm tamburi. Ky i fundit duket se fillon të përhapet shkallë-shkallë që prej fillimit të shek. XX, në banesat e reja të kësaj zone, ndërsa në banesat e lashta ai fillon të zëvendësojë me shpejtësi vatrën në mes të shtëpisë së zjarrit.

Në zonën e trajtuar gjatë shek. XIX, mbisundonte banesa me kat, me një dhe me më shumë se dy kthina banimi. Kati përdhe ishte gjithmonë me funksionin e strehimit të bagëtive që qëndronin gjithë vitin pranë familjes, si dhe eventualisht të kafshëve të ngarkesës. Krahas tyre, për arsye të diferencimit, tashmë të spikatur klasor, vazhdonin të ndërtoheshin kasollet për banim, si dhe banesat përdhese një dhe dy kthinëshe. Shtresat e pasura, ndërtojnë banesa më të zhvilluara dhe në disa raste dhe një ndërtim të veçantë si banesë për miqtë. Banesat në përgjithësi janë të thjeshta, me tipare mbrojtëse dhe me formulimin modest arkitektonik. Në pamjen e jashtme përpunohen vetëm qoshet, kornizohen dyert dhe dritaret me gurë të punuar, ndërsa rrallë korniza trajtohet me përkujdesje. Brendësia është e varfër, rrallë oda e miqve ka tavan, ndërsa akoma më rrallë musandër. Në dallim nga Kurveleshi i sipërm, në zonën në shqyrtim ndeshen, megjithëse rrallë, disa volume të hapur në formën e një çardaku të vogël. Zona rreth rrjedhjes së sipërme dhe të mesme të Shushicës ka afëri të qarta tipologjike me banesën e Kurveleshit të sipërm, ndërsa zona në të djathtë të rrjedhjes së poshtme të saj, dallohet për realizime më të përparuara, që shpjegohen kryesisht me vendin e rëndësishëm që zinte krahas blegtorisë bujqësia në ekonominë e fshatit, si dhe me diferencimin më të thellë klasor në krahasim me zonën e parë.

Në mbarë zonën në trajtim, duke përfshirë dhe Kurveleshin e Sipërm, vërehet qartë, vazhdimësia dhe fryma e njëjtë tipologjike, si dhe qëndrueshmëria relativisht e gjatë e mjaft formave arkitektonike, që pasqyrojnë atë realitet historik në të cilin për kushtet e njohura procesi i zhvillimit kishte një ecuri relativisht të ngadaltë.

16) E. Riza, **Qyteti–muze i Gjirokastrës,** monografi, ruhet në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

17) A. Meksi, E. Riza, **Ndërtimet në fshatin–rrënojë të Kamenicës,** Monumentet 7-8/1974, f. 143-144.

18) E. Riza, **Arkitektura e fshatit–rrënojë të Kardhiqit,** gazeta lokale «Pararoja», 12, 19, 26, VII, 1978.

DO NOT COPY

TAB. I



BANESE Nr 1 -LLAKATUND-



BANESE Nr 2 -MAVROVE-



BANESE Nr 3 -LEPENICE-

0 1 2M



KATI PERDHE





KATI PERDHE



KATI I PARE



KATI I PARE

0 2 4M



KATI I PARE

0 2 4M



KATI PERDHE

0 2 4M

DO NOT COPY

TAB. II

KASOLLET NE FSHATIN - AMONICE -



GDA E MIQVE



PRERJE A-A



BANESE Nr 4 - VRANISHT -





SHTEPI E ZJARRIT



PLANIMETRIA

0 2 4M

BANESE Nr 5 — MALLKEQ —





KATI PERDHE

0 1 2M

KATI PERDHE

KATI I PARE

BANESE Nr 6 - FTERRE -







0 2 4M.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. III



BANESA Nr 7 - ÇORRAJ-





BANESE Nr 6 - GJORM.-



KATI I PARE



BANESE Nr 9 - MERTIRAJ-







TAB. IV

BANESE NR. 10 -SEVASTER-



KATI PERDHE



KATI I PARE



BANESE NR. 11 -LEPENICE-



KATI PERDHE



KATI I PARE



DO NOT COPY

TAB. V



BANESE Nr. 12 - GUMENICE -



BANESE Nr. 13



KATI PERDHE



KATI PERDHE





KATI I PARE 0 2 4M.



BANESE Nr. 14 - ARMEN -



KATI I PARE 0 2 4M.

DO NOT COPY

TAB. VI



BANESE Nr. 15 - *ARMEN*-



BANESE Nr 16 - *AMONICE* -



KATI PERDHE





KATI I PARE

0 2 4M.

KATI PERDHE



0 2 4M

KATI I PARE



DO NOT COPY

TAB. VII



BANESE Nr. 17 - AMONICE -

BANESE Nr. 19 - SHKOZE -



KATI PERDHE



KATI PERDHE



KATI I PARE

0 2 4M



KATI I PARE

0 2 4M



KATI I PARE



KATI PERDHE



BANESE Nr. 18 - BASHAJ -

0 2 4M.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. VIII



BANESE Nr. 20 - KANINE -



BANESE Nr 21 - DRASHOVIC



KATI PERDHE



KATI I PARE



KATI I DYTE



KATI I PARE

0 2 4M.



KATI TRETË

0 2 4M

TAB. IX

BANESE Nr 22 AMONICE



KATI PERDHE



KATI I PARE





0 2 4M.

DO NOT COPY

TAB. X

BANESA Nr 23 DRASHOVICE



PREMJE A-A





KULLA Nr 24 GUMENICË







KATI PERDHE



KATI I PARE

0 2 4M

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

L'HABITATION POPULAIRE DANS LES VILLAGES DU DISTRICT DE VLORE

RESUME

Afin de mettre en oeuvre la Décision du Conseil des Ministres relative au dépistage et à la protection des constructions paysannes, pendant la période allant de 1955 à 1977, outre les autres expéditions, ont été effectuées trois expéditions de dépistage dans les villages du district de Vlore (Fig. 1). La première de celles-ci concernait la zone de Mesaplik et du Bas Kurvelesh, la deuxième la zone comprise entre le cours de la Vjose et en partie du fleuve Shushice et la route nationale Vlore-Tepelene du côté O. et S. et la troisième la zone basse du cours inférieur de la Vjose. Ces zones sont comprises dans le grand groupe ethnographique de la Laberi. Alors que la zone de Mesaplik, du Bas Kurvelesh et la zone de colline, au sud du cours inférieur de la Vjose, se caractérise par des traits économiques et sociaux identiques se reflétant aussi dans la typologie analogue des habitations, la zone basse située au sud du cours inférieur de la Vjose se caractérisait dans le passé par des conditions tout à fait différentes. C'est justement pour cette raison que l'habitation de cette dernière zone se détache nettement de la typologie de l'habitation des deux zones susmentionnées. Ces circonstances expliquent aussi le fait que dans l'exposition du matériel la zone située au sud du cours inférieur de la Vjose a été traitée en tant qu'unité distincte. Les deux autres zones seront exposées ensemble, en mettant à la base du traitement le critère typologique, tout en ne négligeant pas toutefois les autres caractéristiques architectoniques et de construction. Une place de relief sera consacrée aussi aux solutions particulières, tandis que certains centres seront traités séparément, en considération du fait qu'ils présentent des traits distinctifs par rapport aux autres agglomérations urbaines.

La zone basse, au sud du cours inférieur de la Vjose

Cette zone comporte la dépression située au sud de l'embouchure de la Vjose et du marais de Narta, ainsi que la zone de colline peu élevée, située sur la gauche du cours inférieur de la Shushice, où se dresse un grand nombre d'agglomérations rurales.

Dans le passé cette zone faisait part presque totalement du système du tchiflik, *elle appartenait donc aux grands féodaux dont la majorité avait leur résidence à Vlore. C'est justement pour ces motifs que sur le plan des rapports économiques et sociaux nous avons affaire à une zone analogue à celle de la région de Myzeqe, où le système du* tchiflik *était largement diffusé.*

Au cours de l'expédition effectuée dans les nombreux villages de cette zone il a été relevé que la plupart des anciennes habitations n'existent plus, et celles qui y sont ont été abandonnées par leurs propriétaires. Et cela pour deux raisons: premièrement, par suite des transformations radicales survenues dans les conditions de vie après la libération dans ces régions, où l'oppression et l'injustice sociale étaient des plus durs. Deuxièmement, les anciennes habitations, étant édifiées avec des matériaux de construction peu solides, ne résistaient pas aux intempéries plus de 20 ans. Malgré ce fait, les traces encore conservées, les nouvelles constructions auxiliaires, qui souvent reproduisent par la forme les habitations plus anciennes, ainsi que les données orales, nous permettent de dresser un tableau satisfaisant du type de l'ancienne habitation. La typologie pauvre de cette habitation, par ailleurs, nous facilite la tâche en ce sens.

La zone plate, au sud du cours inférieur de la Vjose, appartenait dans le passé quasi exclusivement aux grands propriétaires terriens. Un nombre infime de villages seulement ne rentrait pas dans le système du tchiflik. *En général, la maison aussi était propriété du bey, le métayer étant de la sorte dépourvu pratiquement de toute propriété et en tant que tel exposé à une exploitation impitoyable, le bey ne le rémunérant que dans la mesure lui permettant de garantir les conditions minimales d'existence et de travailler la terre d'autrui. Il va de soi que ces conditions de vie ont déterminé aussi le caractère de l'habitation, qui ne pouvait être en l'occurence qu'un abri. Le propriétaire du* tchiflik, *afin d'exploiter au mieux le paysan* tchiftchi,

construisait les habitations à proximité des lopins de terre. C'est pourquoi le village de l'époque était parsemé, avec de petites maisons que l'on pouvait à peine distinguer, alors que sur une hauteur dominant la plaine environnante se dressait le manoir du bey, où lui-même on son intendant (le qeyaha) ne manquaient jamais pendant les moissons.

L'habitation du tchiftchi est toujours à même le sol. A proximité de celle-ci se trouvent l'étable, la grange, le four, l'annexe sanitaire et souvent le puits, le tout construit avec des matériaux d'occasion. Dans son ensemble cette habitation est ceinte d'une haie peu élevée. Dans la cour il n'y a pas d'arbres fruitiers, car le tchiftchi pouvait être contraint à n'importe quel moment d'abandonner son logis et s'installer ailleurs. Cette habitation à même le sol comportait, selon la composition numérique de la famille du tchiftchi, une, deux ou trois pièces. La maison à deux pièces était la plus diffuse. L'habitation à une pièce est de forme rectangulaire. Les quatre murs latéraux, sur l'un desquels est aménagée la porte, cernent un espace illuminé par une lucarne, ou par une petite fenêtre, ayant un couvercle de bois. La construction est couronnée par un toit à quatre pentes, couvert généralement avec de la paille et, rarement, avec des tuiles. L'élément principal de la seule pièce de la maison est le foyer, un peu à l'écart de l'un des murs délimitant l'habitation. Cette pièce est à même le sol et n'a pas de plafond. Dans l'habitation à deux pièces (Fig. 2), ayant deux entrées particulières pour chacune d'elles, la pièce principale est la maison du feu; tandis que l'autre pièce, l'oda, est tout aussi dénuée et manque de n'importe quel traitement comme la maison du feu. Pour les familles nombreuses, on construisait des habitations à trois pièces dont la composition est toujours en forme de chapelet.

Comme nous l'avons mentionné plus haut, dans cette zone, outre les villages tchiflik, il y en avait d'autres ne rentrant pas dans ce système et dans lesquels, en distinction des premiers, la maison se caractérise par des traits différents, analogues à ceux des autres zones de la Laberi.

L'habitation de ces villages est de pierre et généralement à deux étages. D'un plus grand intérêt sont les maisons des villages Llakatund et Trevëllez. De leur nombre il convient d'attirer l'attention sur l'habitation N° 1 (Fig. 4, Tab.) au village Llakatund.

Comme nous venons de le dire, dans ces villages (Fig. 5) connaissent une plus grande diffusion les maisons à étage. En général celles-ci ont deux pièces à l'étage supérieur, un escalier extérieur ou intérieur, mais on relève aussi des solutions asymétriques.

Une différenciation tellement prononcée de l'habitation sur un territoire si peu étendu témoigne on ne peut mieux du fait indiscutable que les phénomènes architectoniques en général et l'habitation populaire en particulier sont fonction des facteurs économiques et sociaux.

L'habitation de Mesaplik, du Bas Kurvelesh et de la zone située entre le cours inférieur de la Vjose et du fleuve Shushice. Les unités susmentionnées, en général, ne se distinguent pas des autres contrées de la région de la Laberi du fait qu'elles se caractérisent par des conditions sociales et économiques analogues. Toutefois, dans le rapport entre les deux principales branches de l'économie, l'élevage et l'agriculture, on relève entre les différentes zones des particularités qui sont surtout le fait des conditions naturelles. Le développement de la société rurale dans ces zones, pendant le XIXe siècle, auquel se rapportent principalement les habitations que nous sommes en train d'examiner, avait atteint un degré considérable pour ce qui est la différentiation de classe. Cette différentiation avait créé deux pôles, d'une part les paysans pauvres qui peinaient pour s'assurer l'existence avec quelques bestiaux et de l'autre les paysans riches possédant des troupeaux, de la terre et des pâturages. Entre ces deux pôles se situait une couche consistante de paysans moyens continuant de s'opposer aux visées de la couche riche en vue de l'affaiblir économiquement.

Dans la zone de Mesaplik et du Bas Kurvelesh, tout comme dans le Haut Kurvelesh, l'élevage constituait la base de l'économie. Le manque de terre, empêchant le développement de l'agriculture, ouvrit la voie au développement de l'élevage, qui était favorisée par l'abondance des pâturages d'été, dans la zone montagneuse s'étirant sur les deux flancs de la vallée de la Shushica, ainsi que par les pâturage d'hiver situés dans les zones plates environnantes. Par rapport au Haut Kurvelesh, dans les zones situées aux alentours du cours supérieur et moyen de la Shushica l'agriculture connaissait un niveau de développement supérieur.

En général les agglomérations rurales se dressent dans les zones hautes et, rarement, dans celles plates. Ces dernières nous les retrouvons à Gjorm, Lepenice, Brataj, Vranisht, etc. Peu nombreux sont les villages édifiés dans des zones hautes ayant une altitude allant jusqu'à 300 m et de beaucoup supérieur est le nombre des villages s'élevant sur des hauteurs de 300 à 600 m. Exemple Velça, Romica, Motogjini, Boshaj, Kuçi et plusieurs autres situés au sud du cours inférieur de la Vjose.

Le village des zones dont il est question n'a pas un caractère parsemé. Il est constitué de plusieurs quartiers, en général sur la base des liens de sang. La densité des habitations est relativement grande. Celles-ci sont ceintes de murs, souvent leur porte extérieure, oeuvrée avec soin, est couverte d'un arc semi-circulaire (Fig. 6). Le réseau des rues se caractérise par un développement spontané, souvent celles-ci sont pavées. En général la façade principale de la maison ne donne pas sur la rue, toutefois on retrouve aussi des solutions semblables quand l'entrée regarde directement la rue.

L'essor considérable de l'élevage dans le passé a fait en sorte que, pendant la saison chaude, une bonne part des familles d'éleveurs se transféraient provisoirement dans les parcs à moutons. Ces parcs (Fig. 7) se trouvent à proximité des pâturages d'été; leur composition comporte la bergerie et des constructions provisoires pour abriter les bestiaux, constituant dans leur ensemble un espace ceint, à proximité duquel se dressent généralement deux cabanes, dont l'une servant d'abri aux ber-

DOWNLOAD

DO NOT COPY

gers (Fig. 8) et l'autre destiné au traitement et à la conservation provisoire des produits laitiers.

Comme nous l'avons mentionné plus haut, l'habitation de cette zone était ceinte par une cour de surface limité dans les terrains rocheux et plus ample dans les zones plates, où à côté de la cour s'étend un jardin. La construction principale de la cour est la maison elle-même, mais à sa proximité se dressent des annexes auxiliaires, dont la cabane destinée aux animaux qui servaient à satisfaire les besoins de la famille.

Rarement, à proximité de la maison, il y avait un autre édifice plus petit destiné aux amis; cela se passait naturellement parmi les couches aisées de la paysannerie. Ces constructions ne faisaient que répéter les schémas simples de l'habitation caractéristique de la zone et, en général, leur composition volumétrique était à demi-étage ou à étage.

Comme nous l'avons déjà mentionné, la différentiation de classe des différentes couches de la population de cette zone avait atteint au XIXe siècle, et même avant, un degré considérable. En témoigne clairement la diffusion des chaumières faisant fonction d'habitation. A l'heure actuelle il n'y a dans toute la région que deux chaumières de ce type, et celles-ci se trouvent dans le village d'Amonice. Toutes les deux (Figs. 11, 12, Tab. II) appartiennent à la même famille; une de celles-ci, qui est aussi la plus grande, faisait fonction de maison du feu et l'autre, plus petite, représentait la chambre des amis.

Des chaumières à planimétrie éllipsoïdale, avec des constructions plus ou moins différentes des exemplaires d'Amonice, on en trouve presque dans tout le pays; dans le passé elles servaient aussi comme habitation pour les couches pauvres de la paysannerie.

Les habitations de cette zone se caractérisent par une typologie variée, qui comprend un grand nombre de réalisations se distinguant les unes des autres par le nombre des étages, la composition, le traitement architectonique et d'autres traits d'importance secondaire. Malgré ces différences, toutes les habitations de cette zone se distinguent par l'unité marquée caractérisant l'idée de composition. Ces habitations n'ont pas des traits sous-régionaux ou se rapportant à des unités plus petites, mais sont réparties de la même manière dans toute la contrée. Pour une meilleure représentation de la typologie de ce type d'habitation dans la dite zone, nous l'avons répartie en trois catégories: l'habitation à rez-de-chaussée, l'habitation à demi-étage et celle à étage. De pair à ces catégories, une place non moins importante revient au traitement des solutions particulières, qui quoi que dans leurs grandes lignes reflètent les caractéristiques générales de la maison type de cette zone, se distinguent quand même par des traits propres.

L'habitation à rez-de-chaussée. Ce type de maison, le plus ancien chronologiquement pendant le XIXe siècle, n'a pas connu une diffusion aussi large dans les villages de notre zone comme dans les villages du Haut Kurvelesh. Actuellement ses exemplaires sont rares, ils comportent une seule pièce et parfois deux, et cela dès le début ou par l'adjonction d'une deuxième pièce plus tard. En ce qui concerne ce type, d'un grand intérêt est la maison N° 4 située dans le village de Vranisht. L'habitation à une pièce plus évoluée est celle portant le N° 5. A la différence de la maison N° 4, l'habitation située au village de Mallkeq (Fig. 14, Tab. II) a un portique par devant son entrée que ferme l'allongement du mur latéral de la maison.

La maison N° 4 diffère considérablement de celle N° 5 par le traitement de sa façade, qui manque absolument dans la première et se distingue clairement dans la seconde par la présence d'une cheminée aussi. Ainsi, tandis que dans la maison de Vranisht l'endroit principal de séjour se situe au milieu de la pièce, autour du foyer, à Mallkeq il a été déplacé dans la partie frontale de la pièce, à proximité du foyer, soit en un endroit qui est bien illuminé. Cette différence fondamentale entre ces deux habitations est dû au phénomène important du déplacement du foyer, à proximité du mur frontal de l'habitation, en conférant à cette partie de la chambre les fonctions d'un séjour.

Dans cette zone les habitations à deux pièces sont assez rares et ne présentent pas la même solution comme dans les maisons de type analogue du Haut Kurvelesh.

L'habitation à demi-étage. Cette maison connait une diffusion assez large dans la zone objet de cette étude, comme du reste dans tout le pays. On la trouve presque dans tous les villages, notamment ses variantes à deux pièces dans la partie supérieure de la maison, dont l'une, la magjeria, est à même le sol. La large diffusion de ce type d'habitation, nous induit à considérer quelque peu différemment les causes de cette composition intéressante dont le volume est interrompu de manière caractéristique, ce qui fait que la pièce supérieure terminale soit à même le sol, bien que située sur le même plan que l'oda. Le matériel recueilli sur place nous induit à dégager la conclusion que la composition à demi-étage a été certainement dictée par la nature même du terrain accidenté, souvent rocheux, sur lequel se dresse l'habitation. Mais parfois celle-ci était construite sciemment sur un terrain escarpé, afin de pouvoir créer à même le sol la pièce dite magjeri, ayant au commencement le foyer au milieu de la pièce et, plus tard, à proximité du mur terminal, de manière à éliminer le plancher de bois et éviter de la sorte toute possibilité d'incendie. Dans certaines maisons du littoral, depuis celles du village de Tragjas, on trouve une plateforme reposant sur une ou deux voûtes parallèles afin de pouvoir construire la magjeri, ce qui témoigne en faveur de nos conclusions. Donc, nous pouvons conclure en affirmant que le terrain escarpé a influé directement à la formation du type d'habitation à demi-étage perpendiculaire. Plus tard, soit par la force de l'habitude que par les avantages pratiques que présentaient la magjeri à même le sol, ce type d'habitation fut construite à dessein sur des terrains escarpés, en créant même souvent artificiellement pour la magjeri un pavement incombustible et pratique.

Des nombreux exemplaires de ce type d'habitation, il convient de mentionner tout d'abord la maison N° 6, située dans le village de Fterre. L'habitation N° 7 (Fig. 15, Tab. III), située

dans le village de Çorraj, constitue une solution plus réussie de ce type de maison.

L'habitation à étage. Ce type de maison connaît une grande diffusion dans notre zone. Nous la retrouvons en différentes solutions, lesquelles, outre les différences quantitatives, soit le nombre différent des pièces, se caractérise par des conceptions diverses concernant la composition, ce qui prouve que l'habitation à étage, la réalisation la plus réussie en ce genre, a suivi une voie de développement claire, en conservant certains éléments essentiels de la composition et certains principes généraux sur le plan architectonique et de construction. En général, les types les plus évolués connaissent une plus grande diffusion dans la zone limitée par le cours inférieur de la Vjose et de la Shushica. Ce fait est dû non seulement au niveau de développement plus élevé de l'agriculture dans cette zone, mais encore au voisinage de la ville de Vlora, comme cela est attesté par certaines habitations du village d'Armen. La zone s'étendant sur les deux berges du cours moyen et inférieur de la Shushica, par contre, est caractérisée par une typologie plus simple où prédomine la maison de deux pièces à l'étage supérieur.

Un des exemplaires plus simples de l'habitation à étage est la maison N° 8 (Fig. 16, Tab. III), située au village de Gjorm. D'un intérêt particulier est aussi la maison N° 9 (Fig. 17, Tab. III), située au village de Mertiraj; construite vers le commencement du XXe siècle, de par sa composition et son traitement elle ne fait que reproduire les anciennes formes, ce qui montre que ce type d'habitation simple a été construite pendant un long temps par les couches moyennes paysannes de cette zone. D'un intérêt particulier, mais dans une direction différente, est aussi la maison N° 10 (Fig. 18, Tab. IV) d'une composition analogue et construite en 1937 au village de Sevaster. Ici le nouveau consiste dans le fait que l'étable traditionnelle à été remplacée par une pièce destinée à l'habitation. Un exemplaire de maison, ayant deux pièces destinées à l'habitation et une composition simple, est celui portant le N° 11 (Fig. 19, Tab. IV), tandis que la maison N° 12 (Fig. 20, Tab. V), située au village de Gumenice, présente une solution plus avancée. Bien que de par sa composition elle ne fait que répéter les mêmes principes régissant l'habitation N° 11, elle se caractérise par une planimétrie rectangulaire plus élaborée et plus logique.

La phase la plus évoluée de l'habitation à étage est représentée par certaines maisons à composition symétrique, ayant en leur centre une pièce ne faisant parfois que fonction de communication ou en installant en son intérieur une chambre destinée à l'habitation. Ces habitations nous les retrouvons principalement dans la partie septentrionale de notre zone. La maison N° 13 (Fig. 21, Tab. V), située au village de Mavrove, en est un exemplaire typique. Deux autres exemplaires, situés au village d'Armen, soit les maisons NN°° 14 et 15 (Fig. 22, Tab. V, VI), se caractérisent par une composition analogue. Mais de pair aux ressemblances avec l'habitation de Mavrove, les exemplaires d'Armen se distinguent par deux différences essentielles, premièrement, la partie centrale de l'habitation est relativement petite et ne fait fonction que de communication et, deuxièmement, le plus important consiste dans l'existence au rez-de-chaussée d'une pièce dite soba. Celle-ci fait fonction de maison du feu. Le fait qu'elle ait été descendue au rez-de-chaussée, un milieu en général non destiné à l'habitation, indique une caractéristique importante acquise sous l'influence de l'habitation urbaine. Un niveau plus élevé quant à la composition est représenté par la maison N° 16 (Fig. 23, Tab. VI), située au village de Amonice. Elle se caractérise par un développement marqué du corps central par devant.

Il convient de mentionner encore certaines habitations d'une composition rigoureusement symétrique et constituant deux unités distinctes traitées de la même manière. Ce sont les maisons destinées à deux frères et que l'on retrouve dans nos campagnes comme dans nos villes. La maison N° 17 (Fig. 24, Tab. VII), située au village d'Amonice, est un exemplaire réussi de cette solution comportant deux unités jumelles.

Parallèlement à la typologie exposée plus haut, caractérisant la majorité écrasante des habitations de cette zone, on rencontre aussi des solutions particulières qui se distinguent des autres par leur composition et ont en commun le type et le traitement des pièces. Premièrement, il convient de citer la maison N° 18 (Fig. 25, Tab. VII) située au village de Bushaj. Les sources orales font remonter sa construction au commencement du XIXe siècle. Une solution avancée représente la maison N° 19 (Fig. 26, Tab. VII), qui se trouve dans le village de Shkoze. Il ne comprend pas l'étable dans son volume. Une place importante dans la composition revient ici aux deux pièces mettant en communication le hayat et le divan et dans l'espace desquelles se développe l'escalier. Ici on relève clairement l'influence de l'habitation urbaine.

Un cas intéressant est aussi la maison N° 20 (Fig. 27, Tab. VIII), qui se trouve au village de Kanine et se caractérise par une forme évoluée. Une solution très rare est celle de la maison N° 21 à trois étages (Fig. 28, Tab. VIII), située dans le village de Drashovice. Au rez-de-chaussée, un vestibule ayant latéralement un annexe conduit à la cave des provisions. Au premier étage il y a deux pièces communiquant entre elles, dont celle située à droite, qui est aussi la plus petite, fait fonction de chambre où l'on prépare la nourriture. Le troisième étage, plus élevé de 40 cm que les autres, se caractérise par une composition planimétrique semblable. On y accède par un escalier intérieur, qui se développe dans la pièce où l'on prépare la nourriture, au-dessus de laquelle se trouve une autre pièce identique. à la première. Le traitement du placard avec un arc à trois centres fait remonter la construction de cette maison à la fin du XIXe siècle.

Dans notre zone, comme dans les autres régions du pays, nombreux sont les cas quand auprès de l'habitation initiale on finit par construire d'autres maisons, afin de satisfaire les besoins en logement de la famille par suite de son accroissement numérique. Ces adjonctions sont accolées à l'habitation initiale, en créant parfois des complexes relativement grands. Un exemplaire typique de ce phénomène est représenté par le complexe d'habitations N° 22 (Fig. 29, Tab. IX) dans le village d'Amonice.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Une place d'intérêt dans l'architecture de l'habitation paysanne de cette zone revient aussi à certaines traces, en vérité peu nombreuses, de maisons flanquées de tours et d'habitations type tour ayant un caractère foncièrement défensif. L'existence de ce type d'habitation est confirmé aussi par les sources orales, mais les dévastations causées par la lutte incessante que la population de la région de la Laberi a dû mener pour l'indépendance et la justice sociale ont conduit à la destruction de ces constructions. Un exemplaire très intéressant d'habitation flanquée d'une tour est conservé encore en ruine dans le village de Drashovica (la maison N° 23 détruite par le feu pendant la Lutte de libération nationale). Actuellement on n'en conserve (Fig. 30, Tab. X) que les ruines de son aile gauche; quant à son aile droite, c'est avec difficulté qu'on peut suivre le tracé de ses murs. L'aile gauche de cette habitation est constituée par sa partie antérieure comprenant le hayat en bas et le tchardak en haut, qui est fermé latéralement. Au rez-de-chaussée se trouve l'étable, dont la partie terminale supporte deux voûtes cylindriques parallèles constituant une plate-forme incombustible pour le foyer de la pièce située à l'étage supérieur. Celui-ci communique dans sa partie postérieure avec la cabinet de toilette et la tour, à un niveau plus élevé du plancher. La tour est dotée de meurtrières; d'autres meurtrières sont pratiquées dans la partie frontale et latérale de l'oda. Il y en a même à l'étable, au-dessous d'une des voûtes. Les meurtrières sont de deux types: simple ou double. Pour émettre un jugement sur la fonction et le caractère de la tour, il faut tout d'abord considérer la position de l'habitation elle-même dans l'agglomération en question. Elle se dresse dans la partie la plus élevée du village, qui ne jouit d'aucune protection par derrière. C'est ce qui explique la construction de cette tour pour des motifs d'observation et de protection; elle ne peut avoir eu d'autres fonctions, en raison aussi du fait que l'habitation elle-même disposait d'un tchardak relativement spacieux, qui a été fermé plus tard et converti en une pièce destinée à l'habitation. Une construction bien distincte de caractère défensif est aussi la tour N° 24 (Fig. 31, Tab. X), qui se trouve à Gumenice. Les sources orales remontent sa construction à la fin du XVIIIe siècle. Cette tour a deux étages, dont l'étage supérieur comporte la seule pièce de séjour. Les nombreuses meurtrières sur sa face méridionale témoignent clairement de sa fonction défensive du village.

Outre les agglomérations rurales habituelles de cette zone, il convient de mentionner les ruines du village de Kallarat et le centre habité de Narta, Kallarat (Fig. 32), un village qui s'étire sur un joli plateau à proximité de la Shushice, fut incendié pendant la Première Guerre mondiale par les armées grecques; quant à Narta, c'est un type intermédiaire entre l'agglomération rurale et urbaine.

Les vestiges de Kallarat, dont une bonne part appartiennent au XIXe siècle, nous permettent d'en déchiffrer la composition. La plupart des habitations de Kallarat sont du type à demi-étage, avec une ou deux pièces à chaque étage et un escalier de pierre extérieur. On y relève aussi les ruines d'habitations plus spacieuses, dont certaines traces indiquent l'existence de volumes ouverts. Les maisons de pierre reproduisent les éléments architectoniques caractéristiques de la zone en question. Il convient de mentionner la présence fréquente de meurtrières dans les murs des maisons (Fig. 33), voire même au nombre de trois dans certains cas.

Narta, un centre relativement grand, situé au nord de la ville de Vlore, s'étend sur un terrain plat, à proximité de la mer, qui, dans le passé, constituait une des principales sources de revenus pour les habitants du pays. Du nombre des anciennes habitations, actuellement il n'y en a pas même une qui n'ait subi des modifications, aussi est-il difficile de tirer des conclusions justes et exactes. Malgré cela, on ne relève pas dans ce centre un type d'habitation ayant remporté la préférence de ses habitants. A Narta prédomine la maison à deux étages (Fig. 34), en général fermée, mais les indices identifiés indiquent que les gens du pays connaissaient également les hall ouverts. Il y avait aussi des maisons à rez-de-chaussée (Fig. 35). Les maisons, accolées les unes aux autres en forme de chapelet, s'étirent avec leurs façades principales ou latérales des deux côtés de rues étroites (fig. 36). Les portes des cours ou des habitations, souvent couvertes par des arcs et dont l'étage supérieur, souvent en forme de console et avec des fenêtres spacieuses et nombreuses, rendent plus vives les rues de ce centre. En tant que principaux matériaux de construction tout d'abord vient la pierre, puis les charpentes de bois et plus tard apparaissent les briques. A Narta connaît une large diffusion la maison à deux étages, ayant une pièce de communication en son milieu et deux autres sur ses côtés. Le caractère des habitations de Narta montre que celles-ci ont des traits relativement proches des maisons de la ville avoisinante.

La zone que nous sommes en train d'examiner, comme il a été relevé plus haut, fait part de la région de la Laberi, tout comme le Haut Kurvelesh et d'autres unités interrégionales. En ce qui concerne la technique de construction, qui de par sa nature même constitue une caractéristique relativement stable et largement diffusée, l'habitation de cette zone est une répétition de celle du Haut Kurvelesh. Un élément important de cette habitation, l'endroit du feu avec ses nombreux exemplaires, s'exprime clairement en tant que développement du foyer, quelque part au milieu de la maison du feu, voire même du foyer à cheminée. A l'heure actuelle il n'existe plus aucune maison du feu ayant conservé le foyer en son milieu, mais les personnes âgées du pays se rappellent fort bien de sa disposition, qui était une solution habituelle non seulement pendant le XIXe siècle et, naturellement, même avant, mais encore pendant les premières années après la libération. De pair à cette disposition du foyer, et cela depuis le XIVe siècle, comme en témoignent les ruines de l'agglomération urbaine à proximité de la forteresse de Borsh et de celle de Kamenice, nous connaissons aussi la disposition du foyer contiguë au mur terminal de la maison du feu, et justement en son milieu. A proximité du foyer il y avait une cavité en forme de niche, couverte d'une pierre en forme d'architrave ou d'une voûte circulaire. Sur le plan cette cavité est de

forme apsidoïdale ou tout simplement rectangulaire. Une solution rare apportée à l'endroit du feu est celle que l'on peut observer dans une ancienne maison du village de Shkoze. Dans la maison du feu, à proximité du foyer, il y a deux niches disposées l'une sur l'autre (Fig. 37), dont celle intérieure est de forme rectangulaire dans sa partie faciale et celle supérieure est couverte d'un voûte.

Dans la zone que nous venons d'examiner, c'est la maison à étage avec une ou plutôt deux pièces qui y a prédominé pendant le XIXe siècle. L'étage au rez-de-chaussée était destiné aux bestiaux que la famille tenait auprès d'elle pendant tout l'année, ainsi qu'aux bêtes de somme. En outre, en raison de la différentiation de classe désormais plus marquée, on continuait à construire des cabanes destinées à l'habitation ainsi que des maisons à même le sol à une ou deux pièces. Les couches aisées se construisaient des habitations plus évoluées et parfois même une construction à part destinée à la réception des amis de la maison. En général les habitations sont simples, d'un caractère défensif et d'une formulation architectonique modeste. Quant à l'aspect extérieur de la maison, les angles de ses murs sont traités soigneusement, les portes et les fenêtres sont encadrées de pierres travaillées mais la corniche est en général des plus simples. L'intérieur de cette habitation est pauvre, la chambre des amis est rarement pourvue d'un plafond et encore plus rarement d'un placard. A la différence du Haut Kurvelesh, dans notre zone, bien que rarement, on relève des petits volumes ouverts en forme de tchardak. La zone voisine au cours supérieur et moyen de la Shushice présente des analogies typologiques évidentes avec l'habitation du Haut Kurvelesh, alors que la zone s'étendant sur la berge droite de son cours inférieur se distingue par des réalisations plus avancées, dûes principalement au rôle important que remplissait l'agriculture, de pair à l'élevage, dans l'économie rurale et à la différentiation de classe plus marquée par rapport à la première zone.

Dans toute la zone que nous venons d'examiner, y compris le Haut Kurvelesh, on relève clairement la continuité et le même esprit typologique ainsi que la persistance relativement longue de plusieurs formes architectoniques reflétant la réalité historique que nous connaissons et qui est à la base du développement relativement lent du processus d'évolution.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

TË DHËNA ARKITEKTONIKE MBI BANESËN E VJETËR FSHATARE TË RRETHIT TË LUSHNJËS

DO NOT COPY

Në këtë artikull do të përshkruajmë banesën fshatare të Lushnjës, të ndërtuar nga fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i shekullit tonë, kohë kur shtyhej origjina e banesave më të hershme që mundëm të eksplorojmë. Si pasojë e transformimeve të mëdha të kryera në fshatin e ri socialist, në Myzeqenë e Lushnjës me shumë vështirësi mund të hasësh në shembuj tipikë banesash të vjetra të fushës. Pjesën më të madhe territoriale të rrethit të Lushnjës e zë fusha e «Myzeqesë së Madhe» ose «Myzeqesë së Lushnjës» në dallim nga «Myzeqeja e Vogël» ose e Fierit, nëndarje etnografike e njohur në dokumento historike që në shekullin XVI[1]. Nga pikpamja etnografike Myzeqeja ndodhet në mes të nëngrupeve të Gegërisë, Toskërisë dhe Labërisë[2] duke u shtrirë nga lumi Shkumbin në veri deri në lumin Vjosë në jug, nga bregu i detit në perëndim deri në vargun kodrinor në lindje. Si relief Myzeqeja paraqet një territor të ulët me një pjerrësi të vogël nga lindja në perëndim. Pjesa lindore e Myzeqesë, një vargëzim kodrinor me pikën më të lartë 299 m në Mollas, që më e përshtatshme për bujqësi, kurse ana perëndimore, e cila zbret deri në nivelin e detit ish më tepër moçalore dhe e përshtatëshme për blegtori. Në këtë mënyrë bujqësia me blegtorinë qenë burimet kryesore ekonomike të Myzeqesë në përgjithësi, pra dhe të Lushnjës në veçanti. Rrethanat historike të kohës për të cilën bëhet fjalë në artikull, lidhen me ndryshimet që pësoi fshati në organizimin ekonomiko-shoqëror të bazuar në pronën feudale të tokës. Shkatërrimi i sistemit ushtarak të timareve fuqizoi pronën feudale të çiflikut. Çifligarët në ndryshim nga spahinjtë paraardhës u lidhën më tepër me tokën, pasi në kushtet e reja të zhvillimit të ekonomisë feudale, ajo u bë një burim i madh të ardhurash. Në shekujt XVIII-XIX e gjithë toka e fushës së Myzeqesë qe pronë e shtetit (familjes mbretërore të sulltanit) e vakëfeve dhe e bejlerëve e agallarëve vendas. Toka nuk i takonte atij që e punonte, pra fshatarit. Pronarët ja jepnin tokën bujqve me rentë, detyrim që çfrytëzonte në palcë fshatarin nga ana e beut. Fillimisht si krahinë me një popullsi kryesisht fshatare, vendbanimet qytetare të krahinës së Lushnjës i takojnë periudhave të vona.

Lushnja, vendbanimi më i rëndësishëm i krahinës, bën pjesë ndër qendrat e reja të banimit, të cilat si qytete lindën nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX, kur dhe u ndërtuan pazaret, mullinjtë, depot, dyqanet etj.[3]. Është rasti të përmendim këtu se si qendër e banuar e fushës së Myzeqesë e përfshirë brënda Kazasë së Beratit, Lushnja në vitin 1679 numuronte 17 shtëpi[4]. Megjithëse bujqësia me blegtorinë ishin burimet kryesore ekonomike të krahinës, me rritjen e tregut të brëndshëm si rezultat i krijimit të mjaft qyteteve, gjatë shek. XVIII-XIX, u vrejt një aktivizim i zej-

1) Rr. Zojzi, **Ndamja krahinore e popullit shqiptar,** Etnografia Shqiptare, Tiranë 1962, 58.
2) **Po aty,** 54.
3) Z. Shkodra, **Esnafët shqiptare,** Tiranë 1973, 337.
4) S. Pulaha, **Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shekulli XVI deri në fillim të shek. XVIII,** Tiranë, 1973, 147.

tarisë fshatare. Nga burimet del se në këtë kohë ishin të njohur zejtarët e Lushnjës për prodhimet e zhukës e të thuprës[5]. Në aspektin ndërtimor-arkitektonik, në krahinën e Lushnjës ka dominuar banesa fshatare me tipare të dallueshme të banesës së fushës nga ajo e ndërtuar në lartësinë kodrinore nga lindja. Lidhur me organizimin e truallit të banuar si dhe me jetesën e fshatarit të Myzeqesë, në një burim të mezit të shekullit XIX thuhet se «Ndërtimet fshatare bujqësore nëpër të cilat të çon rruga kanë një pamje karakteristike. Oborret me shumë ndërtime rrethohen nga një gardh prej kallamash dhe përmbajnë 3 ose 4 shtëpi të vogla nga të cilat njera është për banim, kurse të tjerat shërbejnë për bagëtinë dhe ekonominë. Konstruksioni bëhet prej druri, çatija prej kashte, muret prej kallamash, të cilat në të shumtën e herëve kanë një veshje me baltë ose pleh lopësh... Zjarri digjet drejtpërdrejt në tokë 3-4 këmbë nga midisi i çdo muri. Ka dy dyer në mes të anëve më të gjata të shtëpisë, nga të cilat kryesorja mbyllet vetëm natën[6]. I njejti shpjegim jepet dhe në një burim të fillimit të shekullit tonë[7].

Zgjedhja e tipit të banesës në zonën fushore të Myzeqesë së Lushnjës ishte e kushtëzuar me përbërjen shoqërore të popullsisë në të kaluarën, shumica fshatarë të varfër si dhe me pozitën gjeografike, me klimën e butë dhe me mungesën përreth të materialeve të ndërtimit si guri, tulla, gëlqerja, etj. Materialet rrethanorë më të lehtë për tu siguruar e pa kosto ishin balta dhe kallami, materiale bazë për ndërtimin e banesës së fshatarit të varfër të Myzeqesë.

Tipi dominues i banesës së fshatarit myzeqar ka qënë kasollja përdhese e ngritur me kallama e kashtë. Si e tillë ajo kish gjithmonë karakterin e një ngrehine të përkohëshme, që vështirë se i kalonte dy dhjetëvjeçarë. Për këtë lloj banese, më e përhapura në Myzeqe, bëjnë fjalë Hani në shekullin e kaluar[8] Almaxhia në fillim të shekullit tonë, etj.[9] Sigurisht nuk mund të mendohet se egzistojnë ende banesa të tilla provizore e plot lagështi ndërmjet fshatarëve të sotëm, me kushte shumë më të mira jetese se në të kaluarën e me një konceptim mjaft të avancuar të mënyrës së jetesës. Kasolle të tilla, ku banonte myzeqari më parë sot i gjen vetëm si ambiente për strehimin e bagëtisë. Rreth banesës përdhese të Myzeqesë, që vendasit e quanin «mbërdheckë» mund të shprehemi vetëm duke ju referuar një kasolle të tillë muze të ndërtuar nga kooperativistët e Gorresë, pranë shkollës së fshatit. Në këtë ndërtim është përfaqësuar tipi i «mbërdheckës së Myzeqesë, ku banonin shumica e fshatarëve të fushës fig. 1.

Mbërdhecka paraqet një kasolle me planimetri katërkëndëshe kënddrejtë me përmasa 3,5 x 9 m të përbërë nga dy ambjente me lartësi 2,3 m. ndarë ndërmjet tyre prej një koridori tërthor në mes me gjerësi 1 m, të cilën vendësit e quajnë jarallëk tab. I, a. Hyrja në banesë bëhet nga dera e hapur në njërin nga ballët gjatësor të mbërdheckës, që të çon në jarallëk, i cili komunikon me të dy ambjentet. Zakonisht ambjenti majtas hyrjes ishte oda e miqve dhe e burrave, ndërsa në ambjentin e djathtë ishte oda e grave dhe e zjarrit. Votra e zjarrit, në mes të odës ose afër murit tërthor, ishte gjithmonë pa oxhak, tymi dilte nëpër çati. Këto dy ambjente merrnin dritë seicila nëpërmjet dy dritareve të hapura njëra në ballin e hyrjes e tjetra në faqen anësore, që mbylleshin me kapakë druri nga brënda.

Si banesa të thjeshta e provizore, të ndërtuara me materiale rrethanorë jo rezistentë, «mbërdheckat» si në pamjen e jashtëme ashtu dhe në trajtimin e brendshëm, nuk dallohen për elementë arkitektonikë. Ato ndërtoheshin thjeshtë e shpejt për të plotësuar nevojat imediate për strehim.

Nga ana konstruktive, mbërdhecka ndërtohej prej një strukture me furka (shtylla) druri lisi ngulur në dhe ose mbështetur mbi blloqe guri, lidhur midis tyre me hunj druri horizontalë. Nëpër këta hunj ndërlidheshin dhe kallamat, të cilët vendosur vertikalisht mbushnin hapsirën ndërmjet furkave, duke krijuar në këtë mënyrë murin (paretin) e mbërdheckës. Për izolimin nga ambjenti i jashtëm, pareti me kallama vishej (suvatohej) rëndomët me baltë nga brënda dhe jashtë. Konstruksioni i çatisë realizohej me hunj druri e mbi to me kallama në rolin e patavrave. Çatia ndërtohej me katër kullime uji dhe mbulohej me kashtë. Banesa e përkohshme tip «mbërdheckë», karakteristikë për Myzeqenë e Lushnjës, njihej dhe në pjesën fushore në jug e në veri të Lushnjës. Përdorimi i këtij tipi banese shtrihej në jug gjatë pjesës fushore të Myzeqesë së Fierit e bile deri në Nartë të Vlorës, ku kasollja e tillë ndërtohej me thupra, që rriten përreth, të lyera me baltë[10].

Në këto anë mbulimi i çatisë kryhej me kashtë ose dhe me tjegulla. Duke u bazuar në thëniet e

5) Z. Shkodra, **vep. cit.** 284.
6) G.V. Hahn, **Albanesiche Studien,** Jena, 1854, 73.
7) Bon Berat zu Tomor, Vien, 1911, 84.
8) G.V. Hahn, **vep. cit.,** 73.
9) R. Almaxhia, **Relazione della commissione per lo studio dell' Albania,** Studi Geografici, I, Roma, 1915, 70.
10) R. Almaxhia, **vep. cit.** 71.

DO NOT COPY

vendasve si dhe në artikullin e botuar për banesën e Pojanit të Fierit[11] konkludojmë se tipi i mbërdheckës me jarallëk, që përshkruam më lartë, ku ndahej oda e miqve dhe ajo e burrave nga ajo e grave, është varianti më i zhvilluar i banesës së përkohëshme të Myzeqesë. Variantet fillestare kanë qenë «mbërdhecka» me vetëm një ambjent me derën në qoshe të ballit gjatësor si dhe më pas varianti me dy ambjente jo komunikues midis tyre, por me dy dyer të jashtme në mezin e ballit gjatësor[12]. Sipas burimeve varianti më i zhvilluar; ai me jarallëk, rrjedh nga lidhja e dy kasolleve të vogla njëambjentëshe me të njëjtën çati sipër duke lënë një koridor të ngushtë tërthor ndërmjet dy ambjenteve. Koridori ishte i hapur, pa derë nga të dy ballët gjatësorë të mbërdheckës. Këtë lloj banese Hani e konsideron si tipin kryesor të krahinës së Myzeqesë[13], gjithashtu Urbani më vonë boton dy skica të këtij tipi.[14]

Banesa përdhese provizore të ngritura me kallama ose thupra veshur me baltë, kanë qenë ndërtuar gjatë gjithë ultësirës bregdetare perëndimore të Shqipërisë, si rreth Kavajës[15] e deri në Bregun e Matës në veri siç vëren Nopça në fundin e çerekut të parë të shekullit tonë[16].

Banesa përdhese me thupra e baltë njihej mjaft edhe në zonën kodrinore të Lushnjës. Banesat tip «mbërdheckë» me një ose dy ambjente që përshkruam më sipër ndërtoheshin nga familje me pak persona. Sipas burimeve të shkruara dhe të dhënave gojore, në krahinën e Myzeqesë familjet me shumë persona ndërtonin banesën përdhese me «matkë». Banesa me «matkë» është një ndërtim përdhes me kallama e baltë, mbuluar me tjegulla, në formën e një drejtkëndëshi, në qendër të të cilit ndodhet ambjenti i gatimit me vatrën e zjarrit (matka) rreth të cilit shtjellohen ambjentet e tjera, që lidhen me matkën me anën e një koridori osa hajati. Për këtë lloj banese bën fjalë Rozati në botimin e tij, ku paraqet edhe një skicë planimetrike të saj[17] si dhe K. Zheku në artikullin mbi banesën e Pojanit[18] ku jep një planimetri të një banese me matkë në Krutjen e Sipërme, të rilevuar më 1953 nga A. Gjergji fig. 2. Në fshatin Fier i Ri, të kooperativës së Krutjes hasëm një banesë përdhese gjysëm të rrënuar, të ndërtuar me skelet me shtylla druri,



Fig. 1

me paretet e mureve kallama mbushur me baltë dhe me çati të mbuluar me tjegulla vendi tab. I, b. Në gjendjen e sotme kjo banesë ruhet jo e plotë. Nëse do të bënim një rikonstruksion ideor të kësaj, do të përftojmë një banesë me matkë në qendër, nga të dy anët e së cilës ndodhen dy ambjente banimi, «oda» e miqve dhe e burrave djathtas saj dhe «oda» e grave majtas matkës. Përpara këtyre «odave», në një plan me to ndodhen dy ambjente funksionet e të cilëve nuk dalin qartë. Si trajtim arkitektonik, gjatë ballit të matkës ka qenë hajati me shtylla druri, i kufizuar anash në formë U-je nga dy ambjentet që përmendëm më sipër.

Për një banesë me «matkë» afër Fierit bën fjalë Rozati që në vitin 1915. Në qendër të kompozimit planimetrik ndodhet «matka» për ku hyhet nëpërmjet një hajati, anash të cilit janë disa ambjente për depo. Nga prapa, nëpërmjet një koridori, «matka» komunikon me tre ambjente banimi. Megjithëse, ky tip banese, ndërtohej mjaft nga familjet e mëdha në Myzeqe më parë, sipas burimeve gojore vetëm në Krutje kish rreth dhjetë të tilla, sot në gjithë Myzeqenë nuk ruhet asnjë shembull i banesës me «matkë».

11) K. Zheku, **Shtëpia e banimit në fshatin e Pojanit (Myzeqe), Etnografia** Shqiptare, III, Tiranë, 1965, 78.
12) K. Zheku, **vep. cit.** 88.
13) G.V. Hahn, **vep. cit.** 73.
14) M. Urban, **Die Sie** dlungen **Sudalbaniens**, Ohringen, 1938, 40.
15) R. Almaxhia, **vep. cit.** 71.
16) F. Nopça, **Albania, Bauten, Trakten, Gerate, Nordalbaniens,** Berlin und Leipzig, 1925, 33.
17) U. Rosati, **Relazione della commissione per lo studio dell'Albania,** Roma, 1915, 138, fig. 7.
18) K. Zheku, vep. cit. f. 98, fig. 23.

DOKO COPY

DO NOT COPY

FIG 2



Fig. 2

Tipi më i zhvilluar i banesës së Myzeqesë së Lushnjës, i ndërtuar nga familje në gjendje relativisht të mirë ekonomike gjatë fundit të shekullit të kaluar e fillimit të shekullit tonë, ishte banesa me dy kate. Një banesë e tillë me dy kate, e ndërtuar në vitin 1924 ekziston në fshatin Këmishtaj fig. 3. Banesa dy katëshe, me portik gjatë gjithë lartësisë, me prejardhje nga banesa përdhese, e cila duhet të ketë qenë e njohur në Myzeqe prej kohësh, por që sot nuk haset asnjë shembull i vjetër i saj, është një zhvillim llogjik në lartësi i përdheses me portik. Këtë tip të fundit e gjejmë mjaft të përhapur në fshatrat e Myzeqesë bile dhe në zonën kodrinore siç do ta shohim më tej. Nuk e trajtojmë veçmas banesën përdhese me portik të fushës jo vetëm sepse nuk ruhen ekzemplarë të hershëm të saj por edhe pse burimet gojore nuk e qartësojnë shtrirjen në kohë të saj.

Hyrja në banesën me dy kate në Këmishtaj bëhet në mezin e murit gjatësor tab. II a. Kati i poshtëm përbëhet nga dy ambjente të ndarë prej koridorit në mes. Ambjenti djathtas hyrjes është shtëpia e grave me vatër me oxhak ndërsa ambjenti majtas, është odë burrash. Në fund të koridorit shkallë druri të çojnë në katin e sipërm, ku anash koridorit janë, djathtas shkallës «oda» e burrave me vatër e oxhak dhe majtas «oda e grave». Në ambjentet e banimit mungojnë elementë të tillë si dollape, sergjene, etj. Shtëpia e grave poshtë ka pasur një dollap ushqimesh formë mafili. Të katër ambjentet marrin dritë nëpërmjet tre dritareve secila, dy janë në faqen anësore të banesës. Dritaret janë ma kanate me lëvizje vertikale, ato të katit të sipërm sigurohen edhe me kapakë druri nga brënda. Theksojmë se banesa që po analizojmë, që në fillim të ndërtimit të saj ka pasur dy oxhaqe mbi çati. Oxhaqet e «odave» janë të thjeshta me vija gjeometrike të drejta. Lartësitë e «odave» janë 1,95 m poshtë dhe 2,4 m sipër.

Nyja sanitare, në fillim në katin e sipërm si shtesë nga pas e banesës, ndodhet në katin përdhes, në ballë të koridorit, aneksuar banesës. Elementi më interesant arkitektonik i banesës është portiku, të cilin vëndasit e quajnë me huazimin «ballkon». Është një konstruksion me përmasa 2,3 x 3 m, në mezin e ballit gjatësor të ndërtesës, i ngritur mbi kollona tulle poshtë dhe mbi shtylla druri në nivelin e katit të sipërm, ku një derë e vogël e lidh atë me koridorin e katit. Portiku është i hapur në gjithë volumin e tij dhe mbulohet sipër me një çati të vogël 3-ujse me tjegulla.

Banesat me dy kate të Myzeqesë kanë një zgjidhje tipike konstruktive. E gjithë banesa si strukturë është një skelet dy katësh me shtylla e trarë lisi me seksion kuadratik ose gjysëm të rrumbullakët me përmasa 20 x 20 m. fig. 4. Kollonat në tokë mbështeten mbi blloqe shtufi që luajnë rolin e plintave. Në tre nivele, në nivelin e plintave, në atë të dyshemesë së katit e në mbështetjen e çatisë, shtyllat lidhen me trarë horizontalë me seksion 20 x 20 cm. Veç këtyre qëndrueshmëria e skeletit rritet dhe me pajantime formë diagonalesh ndërmjet shtyllave. Blloqet midis shtyllave e brezave në banesën që studjojmë janë mbushur me mur tulle bylme me «perikota, siç i quajnë tullat në Myzeqe. Fillimisht banesa është ndërtuar me plitharë. Në gjendjen e sotme banesa si brënda ashtu dhe jashtë e tëra është e suvatuar. Tavanet janë me res kallami. Dyshemetë e të katër ambjenteve janë me dërrasë rrënje (lis i butë). Çatia e banesës është me katër kullime uji, mbulohet me tjegulla vendi mbi kallama në rolin e patavrave. Streha e çatisë del 50 cm nga muri. Lisi është përdorur dhe në konstruksionin e çatisë.

Banesa dy katëshe e Myzeqesë ka një oborr të rrethuar me gardh. Në një qosh të oborrit ndodhet pusi me grykë katrore apo rrethore me mur tulle. Ngritja e ujit realizohet me «skelë», një zgjidhje tipike për puset e Myzeqesë, i cili përbëhet nga një tra që ulet e ngrihet ndaj një shtylle druri, ku ajo mbështetet.

Veç këtyre banesave, që ishin tipike për Myzeqenë, në Lushnjë ekziston dhe një banesë 2 katëshe me çardak, të cilën e takuam në një rast të vetëm në Toshkëz. fig. 5. Megjithse nuk përfaqësonte ndonjë tip banese të përhapur në Myzeqe, për interesin funksionalo-arkitektonik që mbart, mendojmë ta paraqesim në këtë material. Në pamjen kryesore kjo banesë kish pësuar ndryshime, të cilat nuk na e bënin të

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

pa mundur sqarimin e gjëndjes fillestare të banesës. Në kompleks banesa në Toshkëz përbëhet nga korpusi kryesor, që është një volum dy katësh me hajat e çardak gjatë gjithë ballit kryesor si dhe nga një volum përdhes ngjitur dy katëshes majtas saj, të cilën vendasit e quajnë «shtëpia e zjarrit», tab. II b.

Nga hajati me një palë shkallë të thjeshta druri me bazamakë transparent, hipet në çardak, i cili duke qenë i ngushtë, 1,8 m ka vetëm funksion lidhës për të dy ambjentet e katit të sipërm. Ambjenti majtas është «oda» e gravë ndërsa në të djathtë është «oda» e miqve. Duke qenë një shtëpi e ndërtuar gjatë viteve 30 nga një familje në gjendje ekonomike, të dy ambjentet, me lartësi 2,2 m kanë vatër dhe oxhak të thjeshtë në murat anësore perimetralë, si dhe tymarë në çati. Ambjentet nga brënda nuk kanë asnjë lloj përpunimi dekorativ. Poshtë në shpinë të hajatit ose jarallëkut siç i thonë vendësit ndodhen dy haure për kafshë. Ambjenti përdhes i shtëpisë «zjarrit» me përmasa 4,8 x 5,8 m, ku gatuhej e piqej buka, ka edhe ky jarallëkun (hajatin) gjatë ballit. Në aspektin arkitektonik kjo banesë, ka një proporcion harmonik ndërmjet dy katëshes dhe përdheses, që reflekton në siluetën e përgjithshme të saj dhe një zgjidhje tërheqëse të pamjes kryesore e cila përftohet nga transparenca e jarallëkut dhe çardakut. Kjo e bën të larmishme pamjen e banesës dhe e thyen atë ftohtësi që japin muret masivë të pamjes kryesore. Duke ju kthyer dhe një herë asaj që thamë se ky tip banese nuk është përfaqësues për Myzeqenë, nuk mund të lemë pa përmendur faktin se ndërtimi i këtij tipi pikërisht në Toshkëz, ka mundësi të jetë influencë nga ndërtues prej Kosturi të cilët erdhën e u vendosën këtu gjatë viteve 30, kur dhe është ndërtuar banesa në fjalë. Konstruktivisht kjo banesë, sikurse dhe dy katshja që analizuam e Këmishtajt, është realizuar me strukturë druri kollonë lidhur me breza horizontalë, përforcuar me diagonale, hapsira (muratura) ndërmjet të cilave është mbushur me plitharë. Kollonat mbështetur në tokë mbi gurë shtufi. Dy banjat e ndërtuara si aneks banesës nga prapa, që komunikojnë me dy ambjentet e sipërme janë ndërtuar me kallama e baltë. Në gjendjen e sotme kati i sipërm e ka muraturën me tulla, e ndoshta e tillë ka qënë që në fillim. Çatia kryesore është me katër kullime, ndërsa përdhesja e ka çatinë me tre kullime uji. Si mbulesë është përdorur tjegulla, kulmet janë të lidhura me llaç. Si lëndë ndërtimi, e cila merrej në pyllin më të afërt, është përdorur rrënja e vidhi. Edhe kjo banesë ka oborrin me gardh, në një qoshe të të cilit ndodhet pusi i ndërtuar me tulla të pjekura mirë që vendësit i quanin tungulla. Uji nxirrej me «Skelë». Pjesa perëndimore e Myzeqesë laget nga deti Adriatik. Në këto anë të Myzeqesë ndodhet zona e populluar e Divjakës, që më parë quhej Karatopaz (Dheu i Zi). Duke i kaluar bregdetit të Divjakës nga jugu në veri, ndodhen një sërë fshatrash si Zharnueci, Miza, Kamenica, etj., ku banesat janë përgjithësisht ndërtime të reja. Këtej tek-tuk shihet ndonjë banesë me hajat, që nuk i kalon të 30 vjetët.

Divjaka është fshati më i populluar i zonës. Edhe këtu si në pjesën tjetër të Myzeqesë banesa më e njohur fshatare ka qenë «mbërdhecka» me kallama e ka-

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

shtë, prej të cilit tip nuk ruhet asnjë shembull. Si banesë më e vjetër në fshat është një tip përdhes me portik para hyrjes, i ndërtuar në vitin 1908 prej një familjeje të pasur. tab. III, a. Ka trajtën planimetrike të një katërkëndëshi kënddrejtë me përmasa 11 x 14 m. Përbëhet nga katër ambjente banimi dy e nga dy të ndara nga koridori në mes, duke qenë kështu një variant i zhvilluar i përdheses me portik me dy ambjente të ndarë prej koridorit. Hyrja ndodhet nga balli më i gjerë i banesës. Portiku në gjëndjen e sotme mungon. Dy ambjentet e para në hyrje janë kryesoret. Ambjenti i djathtë «oda e miqve» nga të dy anët e derës ka dollape muri të trajtuar nga ana dekorative. Ambjenti majtas hyrjes është shtëpia e bukës. Të dy këta ambjente kanë vatër me oxhak si dhe tymar mbi çati. Dy ambjentet e tjera prapa janë për fjetje. Të gjithë ambjentet janë të suvatuara, të shtruara me dysheme dërrase, tavanin e kanë: me res kallami. Në një fazë të dytë banesës nga prapa i janë shtuar anekse ndihmëse si banja, vend për larje etj.

Muret e banesës janë ndërtuar me kollona druri mbi gurë të veçuar, të lidhura me breza poshtë e lartë. Nga të dy anët e kollonave, nga brënda e jashtë janë gozhduar kallama horizontalisht. Brendësia e murit prej kallamash është mbushur me gurë e mbeturina. Pareti i kollonave është suvatuar me llaç gëlqere nga të dy faqet. Dritaret e banesës janë me një ose dy kanate, që lëvizin nëpër kanale horizontalë e futen brënda murit. Lënda e drurit e përdorur është rrënjë (lis i butë) për kollonat dhe vidh për konstruksionin e çatisë. Pranë banesës që përshkruam ndodhet një tjetër identike me të, por më e vonë se e para dhe e ndërtuar me mure tulle. Përbëhet edhe kjo nga katër ambjente dy e nga dy të ndarë prej koridorit në mes. Në qendër të kompozimit të pamjes kryesore është portiku me kollona druri.

Karakteristike për Divjakën qe se atje nuk vërejtëm asnjë banesë të vjetër me dy kate. Në Divjakë ruhet akoma një mulli që prej vitit 1912; i ndërtuar krejtësisht me tulla. Ka planimetri drejtkëndëshe dhe mbulohet me çati dy ujse me tjegulla. Kallkanet e mureve tërthorë e kanë linjën e sipërme të kurbët. Ky mulli ka punuar me motor me karburant. Veç ultësirës së Myzeqesë, në rrethin e Lushnjës përfshihet dhe një varg kodrinor nga lindja, që nis nga ura e Shkumbinit në Rrogozhinë dhe vijon në Dushk, Lushnjë, Karbunarë Fier-Shegan duke pasur dhe shtrirje tërthore nga lindja deri në Dumrenë e Elbasanit. Duke ndjekur rrugën që lidh Lushnjën me Dumrenë gjurmuam banesat e vjetra fshatare në Hysgjokaj, Lekaj e Kasharaj, ku dhe vërejtëm shembuj të vjetër me interes. Nga pikpamja etnografike Hysgjokaj bën pjesë në Darsinë e Peqinit, veç kësaj këto fshatra megjithëse si më afër, pazarin e kryenin në Lushnjë, kishin shumë marrëdhënie me Peqinin dhe Dumrenë e Elbasanit. Në zonën kodrinore janë ndërtuar disa tipe banesash fshatare si banesa përdhese me variantet e saj, me portik apo hajat, banesa me dy kate me çardak dhe ajo me teliz. Edhe në këto anë banesa më e përhapur ka qenë ajo përdhese, e cila haset e ndërtuar në disa variante. Duke qenë një zonë kodrinore, larg fushës, kuptohet se kallami e kashta, materiale bazë në

«mbërdheckat» e Myzeqesë, rrallë gjenin përdorim në këtë lartësi gjeografike, ku këto ja kishin lënë vendin thuprës e bile gurit, si dhe tjegullës në shumicën e rasteve. Trajtimin e banesës përdhese me mure të holla në Hysgjokaj, për mungesë shembujsh ekzistues, do ta bëjmë duke u bazuar në të dhëna të sigurta gojore si dhe në ndonjë rrënojë të ruajtur ende. Varianti më i thjeshtë i banesës përdhese është ai me planimetri drejtkëndëshe me përmasa të vogla, i përbërë prej vetëm një ambjenti, për ku hyhet nga dera e hapur në faqen gjatësore. Konstruktivisht i ndërtuar me kollona druri ngulur në dhe me distancë rreth 1 m midis tyre. Në këtë hapsirë nguleshin 3-4 listela. Muret e banesës bëheshin me thupra, që ndërthureshin horizontalisht në sistemin vertikal listelë-kollonë. Ky mur lyhej me baltë nga brënda e jashtë. Çatia ndërtohej me katër kullime dhe mbulohej me tjegulla e më rrallë me kashtë. Një variant më të zhvilluar përbënte banesa përdhese me dy ambjente e ndërtuar me po ato materiale që përshkruam në rastin e më sipërm. Në të dy ambjentet hyej nga dy dyer të jashtme, pra ndërmjet tyre nuk kishte koridor, (jarallëk) si në tipet e njëjta të fushës.

Në Hysgjokaj ka qenë ndërtuar dhe banesa përdhese me hajat gjatë gjithë ballit gjatësor të banesës, një tip me origjinë të lashtë. Një shembull të tillë rrënojë takuam në qendër të Hysgjokajt fig. 6. Kjo banesë me planimetri drejtkëndëshe me përmasa 6,5x9 m përbëhej nga dy ambjente jo komunikues midis tyre, nga oda e burrave majtas dhe e grave djathtas, të cilat merrnin dritë prej një dritareje hapur në faqen anësore tab. III, b. Konakët me lartësi 2,20 m e me madhësi pothuajse të njëjtë, kishin vendin e zjarrit, në mezin e murit tërthor anësor, pa asnjë trajtim të veçantë e pa tymar në çati. Dyert e konakëve qenë hapur ngjitur njëra me tjetrën në mezin e murit ballor gjatësor. Efektin arkitektonik kësaj banese përdhese ja jepte hajati me gjerësi 2,2 m, që zinte gjithë ballin gjatësor të banesave. Veç funksionit ndërlidhës midis dy konakëve, hajati duhet të ketë pasur dhe ndonjë funksion për përpunimin e prodhimeve bujqësore. Banesa në fjalë ngrihet e tëra në kollona dru lisi 20 x 20 cm me hapësirë 90 cm. midis tyre. Muret qenë ndërtuar me thupra e baltë, të shërbetuara nga brënda e jashtë. Çatia me katër kullime uji mbuluar me tjegulla vendi, konstruksioni i saj tip vendi me cungale. Në ndonjë rast hajatin e shohim të përdoret krejtësisht për depozitim dhe përpunim të prodhimeve bujqësore. Një shembull të tillë hasim në Lekaj, ku banesa përdhese përbëhej nga një ambjent kuadratik me përmasa 5 x 5 m me derën në qoshen e majtë. Hajati me përmasa 3x5m ndodhet jo në ballë të ambjentit por anash tij duke formuar një volum tepër funksional për fshatarin, tab. IV, a.



Fig. 7

Veç banesës përdhese me mure të hollë, në zonën kodrinore përdorim të gjërë kishin gjetur dhe banesat përdhese ndërtuar me mure guri. Tipi i njohur në këto anë ishte përdhesja me mur guri me portik, me prejardhje nga i njejti tip me mure të holla, prej të cilëvet nuk ruhet asnjë shembull. Këto banesa, me formulim planimetrik drejtkëndësh, përbëhen prej dy ambjentesh, të ndarë në mes nga një koridor, për ku hyhet nga dera e hapur në ballin gjatësor, e mbrojtur kjo nga portiku para saj. Një banesë me portik ruhej në Kasharaj, e cila mëgjithëse e transformuar, fliste qartë për trajtën e saj fillestare. Ka qenë përbërë prej odës së grave majtas dhe asaj të burrave djathtas. Koridori në mes i lidhte këto ambjente midis tyre si dhe me ambjentin e jashtëm. Konaku i grave dhe koridori komunikonin me një nyje sanitare, ndërtuar në shpinë të banesës. Ambjentet, të suvatuara, ndriçoheshin nga një dritare e hapur në murin ballor, që mbyllej me dy kapakë dërrase nga brënda. Oxhaqe të rregullt dhe tymar në çati, ambjentet nuk kanë pasur. Një element karakteristik funksional i banesës ishte dollapi i gjellës, një dritare e hapur në qoshen e odës së grave, ku shërbehej gjella për në odën e miqve. Dritarja mbyllej me një kapak druri. Muret e banesës janë ndërtuar me gurë lumi shtufi lidhur me llaç balte. Në qoshet është përdorur gurë shtufi i skuadruar dhe në muraturë brezat lidhës të drurit. Në çati është përdorur lëndë qarr e vidh dhe për patavra janë vendosur kallama. Duke qenë ambjentet pa tavan, patavrat nga ana jugore ku rreh më shumë era, mbulohen me dhe sipër nën tjegulla. Trua-



Fig. 8



Fig. 9

lli i banimit i kësaj banese është mjaft i organizuar dhe racional. Në rastin e martesës së djalit kryetari i familjes ngjitur me banesën kryesore ndërton një të ngjashme me të pranë saj. Karshi kësaj është kasollja e bagëtisë me purteka e kashtë sipër. Më tej ndodhen gazhdarja e misrit dhe shtëpia e bukës si një ambjent përdhes për gatim, i ndërtuar në një kohë të dytë. Banesë përdhese guri me portik hasëm dhe në Lekaj. Në fshatin Kasharaj ruhen disa banesa përdhese me hajat ndërtuar me mure guri. Tipike për këto banesa është se hajati nuk është i hapur krejtësisht por ai është i mbyllur me mur guri nga një krah, kjo sigurisht për ta mbrojtur hajatin si vend pune nga korentet e ajrit si dhe ndoshta edhe me paramendim për ta mbyllur në të ardhmen për ambjente banimi siç ka ndodhur edhe në të dy rastet që do të shohim. Përfaqësuese e qartë e këtij tipi është një banesë e ruajtur në një lagje të veçuar të Kasharajt. fig. 7. Ky objekt me planimetri drejtkëndëshe me përmasa 8,6 x 11 m në faqen ballore ka hajatin të mbyllur nga krahu i majtë me mur guri, me përmasa 3 x 10,4 m. tab. IV, b. Sipërfaqja e banesës përbëhet nga dy ambjente me kubaturë pothuajse të njëjtë, që ndriçohen nga dritare anësore. Ambjenti majtë me vatër e oxhak është oda e grave dhe i djathti është oda e burrave dhe e miqve, dhe ky me vatër dhe oxhak. Komunikimi ndërmjet dy ambjenteve bëhet nëpërmjet hajatit. Të dy ambjentet kanë nyjen e veçantë sanitare, aneksuar prapa banesës. Si në rastin e banesës me portik, edhe në këtë tip është «dollapi i gjellëve» për shërbim në ambjentin e miqve. Ambjentet janë të suvatuara ndërsa dyshemenë e kanë prej dheu të ngjeshur lyer sipër me gëlqere. Muret janë ndërtuar me gurë shtufi lidhur me llaç balte, të përforcuar me breza druri çdo 90-100 cm. lartësi. Në faqen e jashtme të mureve ruhen gjurmë suvatimi pa drejtues me llaç gëlqere me rërë të imët. Muri ballor pas hajatit është suvatuar me baltë me kashtë. Perdja e kallamit të hajatit është e mbyllur me kallama e baltë. Konstruksioni i hajatit është realizuar me kollona të skuadruara 15 x 15 cm të lidhura pa kapitel me brezin e sipërm. Kapiteli i profiluar ruhet vetëm në qoshen e djathtë të hajatit. Çatia me konstruksion urash me lëndë lisi. Patavrat janë kallama të mbuluara nga sipër me llaç të varfër gëlqere kundër depërtimit të erës. Në qoshen e majtë të banesës është adaptuar një ambjent me mur kallamash, duke çfrytëzuar dhe murin e gurit në krahun e majtë të hajatit.

Në lagjen kryesore të Kasharajt hasëm një banesë tjetër përdhese me hajat të mbyllur me mur nga një krah, ku dhe këtu në qoshen e mbrojtur të hajatit është përshtatur një ambjent banimi tab. V, a. Në këtë shembull me hajat vrejmë një organizim tjetër të ambjenteve. Ambjenti i grave majtas lidhet direkt me derë me hajatin, ndërsa në odën e miqve djathtas hyet nëpërmjet një koridori, që i ndan të dy ambjentet. Oda e grave dhe koridori lidhen me nyjen sanitare, pjesë e pandarë e banesës nga ana e prapme e saj. Muret perimetralë të banesës janë prej guri ndërsa muret ndarës të koridorit janë të holla prej kallamash. Si konkluzion mund të themi se banesat me mure të holla me një ose dy ambjente si dhe ba-

DO NOT COPY

nesat e ulta me mure guri me portik apo hajat janë tipet me variantet e tyre, më të njohura ndër banesat e vjetra përdhese të zonës kodrinore të Lushnjës. Në këtë zonë janë ndërtuar edhe banesa dy katëshe. Në ditët e sotme nuk ruhen shumë banesa të vjetra të larta, kështu që nuk jemi në gjëndje të përcaktojmë edhe tipet më të njohura me kat. Megjithatë do të përmendim ndonjë shembull banese të vjetër me kat, ku vërehen elementet funksionalë arkitektonikë të banesave të njohura përdhese si hajati, etj.

Një banesë dy katëshe me çardak ruhet në fshatin Lekaj fig. 8. Kjo banesë me përmasa 5,2 x 9,3 m nuk e ka çardakun nga balli gjatësor i banesës, siç ndodh shpesh, por ai është i vendosur në ballin tërthor më të shkurtër të banesës, në krahun e majtë. Banesa me dy kate në Lekaj, që vendësit e quajnë shtëpi «odë» është ndërtuar rreth 60 vjet më parë tab. V, b. Përbëhet nga një ambjent në çdo kat, nga «burgu» i gjësë së gjallë poshtë dhe nga «oda» e banimit sipër. Oda ka vatrën me oxhak në çati, nga muri i pasëm dhe banjën në qoshe anash. Në një fazë të dytë, hajati e çardaku janë mbyllur me mur në anën tërthore të banesës duke krijuar nga një ambjent në çdo kat. Muret janë ndërtuar me gurë shtufi, të skuadruar nëpër qoshet, të lidhur me llaç balte. Në gjendjen e sotme, në çardak hyet me shkallë të jashtme masive prej guri, ndërsa më parë ka pasur shkallë prej druri të brendëshme që nisnin nga hajati. Në konstruksionin e çatisë është përdorur lis e plep, mbulesa me katër kullime, me tjegulla vendi.

Në Kasharaj hasëm një banesë dy katëshe të ndërtuar në vitin 1914, banesë e tipit me teliz, në gjendjen e sotme mjaft e transformuar fig. 9. Ballkani i mbyllur me dërrasa (telizi) që vendësit e thërrasin divanhane zinte gjithë pjesën e katit të dytë të pamjes kryesore të banesës. Banesa me teliz, e njohur në malësinë e Çermenikës, Tiranës, etj. nuk ka qenë e përhapur në këto anë. Rastisja e kësaj banese jo tipike për zonën, në fshatin Kasharaj, ka domethënjen e saj. Nga pikëpamja etimologjike emërtimi i këtij fshati Kasharaj lidhet me Kasharin e Tiranës. Nga tradita gojore del se banorët e këtij fshati janë me origjinë pikërisht nga Kashari i Tiranës, prej nga duhet të kenë ardhur para shumë kohësh. Kjo banesë e emërtuar nga vendësit «shtëpi odë», është me përmasa 5,6 x 13,5 m të kullës së banimit dhe 1,3 x x 13,5 m të telizit si dhe me lartësi rreth 5 m mbi nivelin e tokës tab. VI, a. Hyrja për në banesë bëhet nga dera dy kanatëshe e hapur poshtë në mezin e murit ballor gjatësor. Kati përdhes përbëhet nga koridori në mes dhe dy «burgje» për kafshë anash. Nga koridori me shkallë druri hipet në «divanhane» (sallon), ambjent në qendër të kompozimit të katit të sipërm. Pjesa shkallëve në divanhane mbulohet me kapakë druri sipër, që vendësit i thonë «qepen. Nga të dy anët e divanhanes ndodhen dy ambjentet e banimit, oda e miqve dhe e burrave majtas me vatër e oxhak dhe oda e grave djathtas me vatër pa oxhak. Odat më parë pa tavan, me muret të suvatuara me baltë e kashtë. Më parë të tre ambjentet kanë pasur nga një banjë në pjesën e pasme, që dilte me trarë konsol në hapësirë. Telizi sot i prishur, që nga ana konstruktive ka qenë një ballkon i mbyllur i mbështetur mbi trarë konsol, komunikonte me derë vetëm me divanhanen, në mes të volumit të katit të sipërm. Në oborrin e banesës ndodhet kuzhina verore, një zgjidhje provizore karakteristike.

Kjo është një kasolle me përmasa 1,5 x 4 m ndërtuar me thupra e baltë me çati një ujse me tjegulla. Për mbrojtjen nga era, përpara saj është ndërtuar një paret me thupra. Pranë banesës ndodhet dhe kasolla e bagëtisë me thupra e baltë e mbuluar me kashtë. Muret e banesës me trashësi 60 cm janë ndërtuar me gurë lumi shtufi të latuar disi. Çdo 0,9 – 1 m në mur janë vendosur breza lidhës prej druri. Në qoshet e mureve janë vendosur gurë të skuadruar mirë. Në ndërtimin e banesës është përdorur lëndë lisi e vidhi. Çatia është me katër kullime mbuluar me tjegulla vendi. Banesa me teliz që ruhet në Kasharaj, e ndërtuar nga fshatarë tiranas të vendosur këtu me kohë, duke qënë më e vonë, nga pikpamja funksjonale është më e zhvilluar se tipi me teliz i malësisë së Tiranës apo Çermenikës, ku përgjithësisht shkallët janë të jashtme. Veç kësaj vendosja e sallonit si ambjent i mesëm dhe njëkohësisht ndërlidhës midis dy ambjenteve të banimit të katit të sipërm, është një zgjidhje funksionale më e përshtatëshme. Në këtë mënyrë këtu telizi nuk ka funksjon lidhës ndërmjet odave, si në Tiranë e Çermenikë[19], por ai qe ndërtuar vetëm si volum ndihmës për përpunimin e produkteve bujqësore si dhe për punë dore shtëpijake. Nga mungesa e dokumentacionit dhe e burimeve të sakta gojore, nuk jemi në gjëndje të bëjmë një rikonstruksion grafik të saktë të telizit.

U munduam të japim një përshkrim të banesave të vjetra tipike fshatare të rrethit, të Lushnjës. Siç e përmendëm dhe në hyrje të artikullit, për vetë tran-

19) A. Muka, **Arkitektura popullore e Shqipërisë së Mesme,** Monumentet, 11, 1976, 200.

DO NOT COPY

sformimet e mëdha të kryera në fshatin tonë socialist, nuk e patëm të lehtë të arrinim në gjurmë të banesave të vjetra, sot të zhdukura ose të adaptuara. Megjithatë mendoj se në bazë të materialit ekzisues, një pjesë e mirë rrënojë, ja kemi arritur qëllimit tonë për prezantimin e tipeve më përfaqësuese ose më me vlerë të krahinës që studjojmë. Sipas burimeve gojore në ndërtimin e banesave në këtë krahinë kanë punuar kryesisht mjeshtër vendas e bile dhe vetë fshatarët në rastin e ngritjes së banesave të përkohëshme të fushës.

Në pikpamje arkitektoniko-funksionale banesat tipike fshatare të Lushnjës inkuadrohen brënda traditës sonë të ndërtimit, pra ato njihen dhe në krahina të tjera të vendit, duke u lidhur me banesat e këtyre krahinave në unitet organik e duke formuar kështu në kompleks një bazë të mirëfilltë studimi për zhvillimin kohor të banesës sonë fshatare.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. I, a BANESE NE FSHATIN GORE



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA KATIT PERDHE

TAB. I, b BANESE NE FIER TE RI



PAMJE KRYESORE
(RIKONSTRUKSION)



PLANIMETRIA KATIT PERDHE

TAB II. a BANESE NE FSHATIN KEMISHTAJ



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE



PLANIMETRIA KATIT PERDHE





PLANIMETRIA KATIT I-RE

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN TOSHKES TAB. II, b



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA KATIT T



0 2 4m

PLANIMETRIA KATIT PERDHE

BANESE NE FSHATIN HYSGJOKAJ (RIKONSTRUKSION) TAB. III, b



PAMJE KRYESORE



0 1 2m

PAMJE ANESORE



0 2 4m

PLANIMETRIA KATIT PERDHE

TAB. III, a BANESE NE DIVJAKE



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE

PLANIMETRIA KATIT PERDHE



0 2 4m

TAB. IV, a

BANESE NE FSHATIN LEKAJ



PAMJE KRYESORE

0 1 2m



0 2 4m

PLANIMETRIA KATIT

TAB. IV, b

BANESE NE FSHATIN KASHARAJ



PAMJE KRYESORE

0 1 2m



PLANIMETRIA KATIT

0 2 4m

TAB. V a

BANESE NE FSHATIN KASHARAJ



PAMJE KRYESORE

0 1 2m



0 2 4m

PLANIMETRIA KATIT PERDHE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB V, b

BANESE NE FSHATIN LEKAJ



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE



PLANIMETRIA KATIT PERDHE



PLANIMETRIA KATIT I-RE

TAB. VI, a

BANESE NE FSHATIN KASHARAJ



PAMJE KRYESORE
(RIKONSTRUKSION)



PLANIMETRIA KATIT PERDHE



PLANIMETRIA



Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

DONNEES ARCHITECTONIQUES SUR L'ANCIENNE HABITATION PAYSANNE DU DISTRICT DE LUSHNJE

RESUME

L'auteur de cet article traite l'ancienne maison paysanne du district de Lushnje, construite vers la fin du siècle dernier et le commencement de notre siècle, période à laquelle remonte l'origine des habitations plus anciennes qu'il a eu l'occasion d'identifier. La plus grande partie de la surface du district de Lushnje est occupée par la plaine dite «Myzeqe e Madhe» ou «Myzeqe e Lushnjes» en distinction de la «Myzeqe e vogël» ou de Fier, subdivision ethnographique résultant des documents historiques dès le XVIe siècle. Du point de vue ethnographique la Myzeqe est limitée par le fleuve Shkumbin au N. jusqu'au fleuve Vjosa au S, ainsi que par le littoral marin à l'O. jusqu'à la chaîne de collines à l'E.

Les circonstances historiques de l'époque, faisant l'objet du présent article, se rattachent à la liquidation du système militaire des timars et au renforcement de la propriété féodale du tchiflik. Les propriétaires (les beys) donnaient aux fermiers la terre en rente, en les exploitant jusqu'à la moelle.

Lushnja, en tant qu'importante agglomération urbaine de la région, fait part des centres habités de récente construction qui virent le jour vers la fin du XVIIIe – le commencement du XIXe siècles. Sur le plan de construction et architectonique, on relève dans cette région une prévalence de l'habitation paysanne avec des traits distinctifs, et cela en considération du fait si celle-ci est construite dans la zone plate ou dans la zone de colline s'étendant à l'E. Le choix du type d'habitation dans la zone plate de la Myzeqe de Lushnje a été conditionné dans le passé par la composition sociale de la population, paysanne dans sa grande majorité, ainsi que par sa position géographique caractérisée par un climat tempéré et l'absence dans les alentours de matériaux de construction comme pierres, briques et chaux. Le type d'habitation paysanne le plus fréquent est la chaumière construite avec des roseaux et de la paille. Nous avons donc affaire à une construction temporaire dont l'existence ne dépasse pas les deux décennies.

Selon les sources écrites et orales, dans la région de Myzeqe les familles nombreuses se construisaient une habitation à rez-de-chaussée comportant la «matka», une construction à même le sol en roseaux et terre argileuse, couverte de tuiles, en forme d'un angle droit, ayant en son milieu la pièce où l'on préparait la nourriture et où se trouvait le foyer dit matka; c'est autour de cette pièce que se développent les autres pièces, qui communiquent avec la matka par un couloir ou le hayat.

Le type d'habitation le plus répandu dans la Myzeqe de Lushnja et construit par les familles ayant une situation économique relativement aisée vers la fin du siècle passé et le commencement de notre siècle, est la maison à deux étages. Un tel exemplaire nous l'avons rencontré à Këmishtaj. L'habitation de deux étages à portique le long de toute son hauteur est une évolution logique en hauteur de la période du portique, type de construction qui est connu depuis longtemps dans la Myzeqe mais dont n'en conserve actuellement pas même un exemplaire ancien. L'étage inférieur comme celui supérieur sont composés par deux pièces séparées par un couloir. Les habitations à deux étages de la Myzeqe ont une solution de construction typique. L'habitation elle-même comporte sur le plan de la structure une charpente à deux étages avec des piliers et des poutres de chêne. Les piliers reposent au sol sur des blocs de pierre ponce faisant fonction de plinthes. Les espaces vides entre les blocs et les bandes sont remplis par des murs de pierre. Dans le village de Toshkez, nous avons rencontré un exemplaire d'habitation à deux étages à tchardak, type de maison qui ne doit pas avoir connu une diffusion dans ces parrages. Dans la partie occidentale de la Myzeqe, qui est baignée par les eaux de la mer Adriatique, se situe la zone peuplée de Divjak. Divjak est le village le plus peuplé de la zone. Ici aussi le type d'habitation paysanne le plus répandu est la «mbërdhecka», construite en roseaux et en paille, dont on n'en conserve plus d'exemplaires. La plus ancienne habitation de ce village est une maison à rez-de-chaussée, avec un portique à son entrée: elle a été construite en 1908 par une famille aisée. A planimétrie rectangulaire, elle se compose de quatre pièces séparées deux à deux par un couloir, Il s'agit d'une variante évoluée du typé à rez-de-chaussée et avec portique, dont les deux pièces sont séparées par un couloir. Outre la dépression de la Myzeqe, dans le district de Lushnje il y a aussi une zone de colline à l'E.; elle commence au pont du fleuve Shkumbin puis s'étend vers Dushk,

Lushnja, Karbunara, Fier-Shegan, et rejoint même collatéralement en direction E. la région de Dumre, district d'Elbasan. C'est dans cette zone que nous avons dépisté d'anciennes maisons paysannes, notamment à Hysgokaj, Lekaj et Kasharaj. Dans cette zone de colline il y a différents types d'habitations paysannes: la maison à rez-de-chaussée dans ses variantes à portique et à hayat, la maison de deux étages à tchardak et celle à teliz (un seul exemplaire).

Nous avons tenté de donner une description des anciennes maisons paysannes les plus typiques du district de Lushnje. En raison des profondes transformations accomplies dans notre campagne socialiste, nous nous sommes heurtés à maintes difficultés pour tomber sur les traces des anciennes habitations, actuellement disparues ou réadaptées aux nouvelles conditions. Malgré cela nous pensons que sur la base du matériel existant, dont une bonne part en ruine, nous avons réussi à distinguer le type d'habitation le plus représentatif ou de plus grand intérêt de la région. Selon les sources orales, il ressort que la construction des maisons dans cette région est notamment le fait des maîtres bâtisseurs du pays et des paysans eux-mêmes quand il s'agissait de construire des habitations temporaires dans la zone plate.

Du point de vue architectonique et fonctionnel les habitations paysannes typiques de Lushnje se conforment à la tradition de construction locale, et se rattachent par une unité organique aux habitations des autres régions du pays, constituant de la sorte une base authentique pour l'étude du développement dans le temps de notre habitation paysanne.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2

tur, vetëm pjesën e hekurit në banja të përgatitura nga tretja e acidit sulfurik teknik në një çesmë në raportin 1:10. Për çdo 1 litër solucion të banjës u shtuan 10 gr. urotropinë teknike, ose glicerinë në rolin e inhibitorit. Këto komponime duke u lidhur në formë absorbtive mbi hekurin, por jo me ndryshkun bëjnë që veprimi i acidit të jetë selektiv. Gjatë pastrimit të ndryshkut në banja acide u tregua kujdes i veçantë për të mos lënë veprimin e acidit deri në atë shkallë sa të linte gjurmët e kalitjes në formë gërvishjesh, ose të përpunimit gjatë përgatitjes së objektit të cilat dëmtojnë pamjen dhe do të kërkonin në procesin përfundimtar një plotësim jo aqë të lehtë.

Mbas tretjes së ndryshkut, për të neutralizuar acidin sulfurik të futur nëpër portë dhe që nuk mund të largohej me anë të një shpëlarjeje të thjeshtë objekti (vetëm hekuri) u zje gjatë dy orëve në një banjë që përmbante për çdo litër një çesme 10 gr. karbonat, ose bikarbonat natriumi. Në rastet kur ky proces nuk ishte e mundur të kryhej për shkak të madhësisë së objektit, ai iu nënshtrua një trajtimi elektrolitik për disa minuta në një banjë të përgatitur me hidroksid natriumi, reagent, në koncentrimin 5%. Densiteti maksimal i rrymës që u përdor ishte 10 A/dcm^2, kurse tensioni 12 V. Gjatë këtij procesi objekti shërbeu si kotodë, ndërsa anodat ishin prej çeliku inoksidabël. Pothuajse gjithnjë banja me madhësi të përshtatshme u përgatitën fare thjeshtë duke përdorur fletë polietileni.

Pastaj ecuria e trajtimit me tanine vazhdoi njëlloj si për grupin e parë, (fig. 2).



Fig. 3

Trajtimi, ishte pak më i komplikuar kur u përpunuan objekte tepër të ndryshkur oksiduar, të montuar mbi dërrasë, nga ku mund të hiqeshin, ose të kombinuar me materiale të tjera. Në këtë rast u punua me dy solucione. I pari u përgatit duke shtuar për çdo porcion të solucionit bazë të tanineve 100 ml. acid fosforik të pastër me koncentrim 80-85%. Hekuri i ndryshkur mbas lagëies dy herë rradhazi me këtë tretësirë u la të thahet dhe pastaj u fërkua me furçë teli. Ky operacion u përsërit dy herë, ose edhe deri gjashtë herë në rastin e objekteve me shumë ndryshk. Procesi i largimit të ndryshkut u ndihmua edhe me anë të përdorimit të frezave dentare kur ishte e nevojshme, ose me furçë teli për sipërfaqet e sheshta. Trajtimi i mëtejshëm u krye me anën e solucionit të tanineve pa shtresë acidi fosforik. Procesi u përsërit të paktën katër herë.

Dy objektet e grupit të tretë, një punim prej hekuri për dritare (fig. 3) dhe një objekt zbukurimi, ndryshonin nga të tjerat sepse ishin të lyer me një shtresë të trashë boje. Pastrimi nga boja u realizua në banja alkaline. Këto u përgatitën me sodë kaustike teknike. Koncentrimi i banjës u zgjodh në vartësi të shtresës së bojës që duhej hequr dhe ishte rreth 10%. Ishte e nevojëshme që solucioni i banjës alkaline të freskohej me porcione të rij të hidroksidit të natriumit. Ky veprim zgjati disa orë. Në fund të procesit boja u kthye në një masë si qull dhe u hoq lehtësisht me anë të ujit të rrjedhëshëm të çesmës, duke e ndihmuar veprimin me fërkim me furçe me fije të forta. Në rastin e përdorimit të bojërave të përziera me llaqe, veprimi i hidroksidit të natriumit është i pasuksesëshëm, ai duhet kordinuar edhe me tretësat e llaqeve.

Mbas heqjes së bojës u aplikua pastrimi i ndryshkut me acid sulfurik dhe pastaj u krye përpunimi me taninë.

Në këtë rast, për arsye të madhësisë së objektit, neutralizimi me sodë, ose trajtimi elektrolitik, nuk u krye. Ndonëse objektet vazhdojnë të ruhen mirë, trajtimi me sodë dhe procesi elektrolitik e shtojnë sigurinë e konservimit.

Provat fillestare të konservimit të hekurit me taninë në laboratorin kimik të Institutit të Historisë janë kryer tre vjet më parë. Një pjesë e objekteve janë ekspozuar gjatë gjithë kësaj kohe në një ambient me lagështi relative që arrin në periudhën e dimrit në masën 95%, e megjithatë me përjashtim të rrafshit të një kambane objektet e tjerë vazhdojnë të ruhen mirë.

Metoda e konservimit të hekurit me taninë është një metodë që jep rezultate të mira; e thjeshtë, e shpejtë dhe pak e kushtueshme. Njëkohësisht të gjithë kimikatet kryesore prodhohen nga industria jonë.

Në vendin tonë ndodhen shumë monumente kulture në përbërjen e të cilëve takohen mjaft elemente prej hekuri me karakter funksional apo dekorativ. Këta elemente të llojeve të ndryshme, që nga dorëzat e dyerve, e deri tek kangjellat e oborreve, dikur të oksiduar në sipërfaqe nga trajtimi përfundimtar i aplikuar nga prodhuesi me qëllim mbrojtje nga ndryshku tashmë ndodhen kush me shumë e kush më pak në procesin progresiv të korrozionit të shkaktuar nga një serë faktorësh[5]. Është bërë si praktikë e përgjithshme lyerja me bojë të zezë e këtyre elementeve, pa i trajtuar më parë kimikisht për të stabilizuar korrozionin. Në raste të tillë masat e marra kanë patur më tepër një karakter iluziv për syrin, se sa kanë dhënë një zgjidhje përfundimtare të çështjes. Një shembull konkret i mos realizimit të konservimit me këtë rrugë janë kangjellat dhe hekurat e dritareve të xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë, të cilat megjithëse janë lyer herë pas here me bojë të zezë e rishfaqin vazhdimisht vende-vende shtresën e ndryshkut. Pavarësisht nga ritmet prishja ka vazhduar në shtresën e bojës. Një vazhdim i tillë, qoftë edhe me ritme të ngadalshme rrezikon me kohë vetë ekzistencën e objektit. Për të ndaluar një përfundim të tillë është e nevojëshme që hekurave t'u bëhet një trajtim i plotë me tanin. Në fund, lyerja me një llak të qëndrueshëm ndaj ujit, përshembull nga ai që shitet në treg me emërtimin «Llak FF» do të japë një siguri më të plotë konservimi.

5) Ritrajtimi i njollave të korrozionit kryhet me të njëjtat tretësira deri sa të arrihet stabiliteti i plotë.

DO NOT COPY

Frederik **STAMATI**

DO NOT COPY

RESUME

La conservation des objets de fer au moyen de substances tanniques est utile surtout dans le traitement d'une série d'objets de musée.

Les objets recouverts d'une couche fine de rouille, après leur nettoyage des graisses, etc. et après les avoir plongés dans un bain d'eau chaude distillée, sont traités avec des substances tanniques ajoutées à une solution d'eau distillée et d'alcool éthylique.

Arpès un «conditionnement» de deux jours, ces objets sont enduits d'une couche de laque et ,en cas de nécessité, d'une couche de paraffine.

Si la couche de rouille est très épaisse, ces objets sont préalablement traités avec une solution tannique comme ci-dessus, mais e y ajoutant de l'acide phosporique. Parfois on utilise aussi l'acide sulfurique pour faire disparaître la rouille, mais en éliminant l'excès d'acide sulfurique avec de la soude. A cette fin on s'est servi aussi du traitement électrolitique de brève durée, suivi d'un traitement avec des substances tanniques.

Si les objets sont couvertes d'une couche épaisse de peinture, leur nettoyage se fait dans un bain alcalinifiant, puis acide et, en dernier lieu, ils sont traités avec des substances tanniques.

Malgré les conditions difficiles d'exposition des objets, les résultats obtenus par ces méthodes sont satisfaisants, aussi ont-elles recommandées pour le traitement des objets de fer relevant des monuments historiques.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

KËSHTJELLA E ISHMIT

Kështjella (fig. 1) është ndërtuar mbi një kodër në lindje të fshatit Ishëm. Prej saj shikimit i hapet një horizont i gjerë. Nga veriu dhe lindja vrojtohet fusha pjellore e Ishmit dhe shikimi ndahet në vargmalin Krujë-Dajt, ndërsa nga perëndimi vrojtohet grykderdhja e lumit, Kepi i Rodonit dhe një pjesë e bregut të Detit Adriatik. Muret ndjekin formën e terenit por duke tentuar gjithnjë për të krijuar linja të drejta, kështu planimetria ka formën e një katërkëndëshi këndrejt pak a shumë të rregullt me përmasa 100 x 40 m, të drejtuar me brinjët më të ngushta veriperëndim-juglindje (fig. 2). Kështu ka dy porta që qëndrojnë përballë njera-tjetrës të hapura në brinjët më të ngushta të katërkëndëshit të formuar nga muret rrethues. Porta kryesore ndodhet nga lindja, ndërsa tjetra, e dorës së dytë, nga perëndimi. Të dy portat lidheshin midis tyre me një rrugicë të shtruar me kalldrëm. Muret forcohen nga pesë kulla të cilat me përjashtim të një kulle këndi me planimetri rrethore dhe një tjetre pesëkëndëshe, kanë forma drejtkëndëshe.

Kullat janë vendosur në këndet e bashkimit të mureve, vetëm njëra ndodhet në mesin e murit jugperëndimor që është ndërtuar në anën me mbrojtje më të dobët natyrore të kodrës. Kulla I dhe kulla II janë ruajtur në lartësinë e mureve ndërsa kullat III, IV dhe V janë krejtësisht të rënuara, prej tyre ruhen në rafshin e tokës vetëm muret anësore, ndërsa muret ballore janë zhdukur krejtësisht.

Kulla I (fig. 1, 2) ka formë planimetrike rrethore me diametër të brendshëm 3,95 m dhe trashësi muresh 1,50 m të cilat bijen vertikalisht mbi terenin. Kjo kullë shërbente për të mbrojtur hyrjen kryesore dhe për të kontrolluar një pjesë të murit jugperëndimor deri tek kulla II. Në gjendjen e sotme kulla ndodhet e mbushur me dhe deri në një lartësi të konsiderueshme.



Fig. 1

Nga elementet përbërëse të saj ruhen vetëm gjurmët e një hyrje me hapësirë drite rreth 1 m. Kjo e fundit komunikonte me shtegun e rojeve të murit jugperëndimor. Ky fakt tregon se lartësia e murit jugperëndimor deri në nivelin e shtegut nuk ka qënë më e madhe se 5 m, ndërsa vetë kulla ngrihej diçka më tepër. Pranë kullës ruhet dhe e vetmja gjurmë e murit të bedenave apo e parapetit i cili ka patur një gjerësi prej 0,60 m, ndërsa gjurmë frengjish ose dritaresh nuk ruhen.

Kulla II (fig. 3). Është një kullë e vogël katërkëndëshe e cila del nga muret 3,05 m dhe ka një gjerësi prej 3,60 m. Muret e saj me gjerësi 1,25 cm bien vertikalisht mbi terenin. Lartësia e ruajtur e tyre nuk e kalon lartësinë e murit rrethues. Në kullë nuk ruhet



Fig. 2



Fig. 3

asnjë element për t'u shënuar, ka mundësi që ajo të ketë qënë e mbushur me dhe në pjesën e brendshme deri në një farë lartësie.

Kulla III (fig. 4) ruan vetëm pjesërisht dy muret anësore si dhe shpatullën e djathtë të hyrjes që ndodhet në mesin e murit të saj të mbrapëm. Nga gjurmët e hyrjes kuptohet se niveli i terenit brenda fortifikimit ka qenë më i ulët seç është sot.

Kulla IV. Është ndërtuar në këndin verior të kështjellës, ka formë katërkëndëshe, del rreth 4 m nga muret e kështjellës dhe ka një gjerësi prej 4,60 m. Muret e saj janë 1,30 m të trashë. Kulla është mjaft e rrënuar dhe prej saj ruhen shumë të dëmtuar vetëm muret anësorë dhe ato në shtrirjen e tyre të plotë. Por në muret e rënuar të kësaj kulle dallohen qartë gjurmët e brezave të drurit. Ato kishin prerje drejtkëndëshe me përmasa 0,10 x 0,10 m dhe vendoseshin 0,15 m brenda faqeve të jashtme të mureve.

Kulla V është gjithashtu mjaft e dëmtuar, muret e saj anësore ruhen në lartësinë 0,50 m ndërsa nga muri ballor nuk ka mbetur asnjë gjurmë. Ndryshe nga kullat e përshkruara deri tani, kjo kullë po të gjykojmë nga një kthesë me kënd të gjerë që dallohet qartë



Fig. 4

DO NOT COPY

në mbarim të faqes jugore të saj, duhet të ketë patur në planimetri trajtë pesëkëndëshe me majë të drejtuar përgjatë aksit diagonal të kështjellës. Kulla ka patur një trashësi muresh prej 1,30 – 1,40 m. Ashtu si kulla I edhe kjo është një kullë këndi, por ndryshe nga e para duke gjykuar nga vendosja e saj, ajo shërbente më tepër për të kontrolluar murin verilindor se sa për të mbrojtur hyrjen kryesore.

Nga asnjë e dhënë nuk mund të nxirret lartësia e plotë e kullave as edhe në ato që kanë shërbyer njëkohësisht edhe për banimin e garnizonit.

Muret e kështjellës janë ndërtuar me gurë rrahorë të nxjerrë nga formacionet shkëmbore në afërsi. Gurët janë lidhur me një llaç të fortë që ka në përbërje shumë gëlqere. Si mbushës është përdorur rërë e ashpër lumi dhe guralecë. Trashësia e mureve nuk është e njëllojtë, ajo varion nga 1,50 – 1,20 m. Trashësinë më të madhe e takojmë tek muri jugperëndimor dhe juglindor të cilët kanë një mbrojtje natyrore më të dobët. Për të shtuar qëndrueshmërinë e mureve janë përdorur në brendësi brezat e drurit. Ato kanë seksion drejtkëndësh me përmasa 0,11 x 0,6 m brezat gjatësore vendosen gjithmonë larg faqeve anësore të murit. Lartësia e mureve në pjesët më të ruajtura nuk i kalon 5 m por duke gjykuar nga gjurmët e zbuluara pranë kullës I, mund të mendohet se lartësia e tyre deri në shtegun e rojeve nuk duhet të ketë qënë më e madhe se kaq. Kështu që po të shtojmë lartësinë e bedenave apo të parapetit do të kemi një lartësi të përgjithshme prej rreth 7 m.

Tereni brenda kështjellës është mjaft më i ngritur nga ai jashtë saj, kështu që muret ju vishen pjesërisht shpateve të kodrës.

Në gjendjen aktuale lartësia e terenit të brendshëm të kështjellës arrin deri në lartësinë e shtegut të rojeve ashtu siç e gjejnë edhe në një kështjellë tjetër të kësaj periudhe, në kalanë e Prezës. Por duhet menduar që një pjesë e konsiderueshme e mbushjeve është krijuar që nga koha e ndërtimit të kështjellës deri në ditët tona dhe sidomos kur ajo e pat humbur rëndësinë e saj të dikurshme. Për shkak të këtij disniveli të terenit gjatë murit jugperëndimor janë hapur gjashtë kanale shkarkuese të ujërave. Tri prej tyre ndodhen midis kullave I dhe II dhe tri të tjerët midis kullave II dhe III. Kanalet e shkarkimit në mure ndodhen në të njëjtin nivel në lartësi rreth 1,40 m nga niveli i jashtëm i terrenit. Vrimat shkarkuese në anën e dukshme kanë trajtë katërkëndëshe me gjerësi rreth 0,25 m dhe lartësi 0,25 – 0,30 m. Nga sipër grykat e kanaleve mbulohen me pllaka të sheshta guri, ndërsa në pjesën e poshtëme kanë nga një pllakë guri që del në formë lugu si dhe dy gurë anësore mbi të që



Fig. 5

shërbenin së bashku për të mos lejuar kullimin e ujërave përgjatë faqeve të mureve (fig. 5). Kanale të tilla janë aplikuar edhe në kështjellën e Durrësit në lartësinë 59 m e ndërtuar gjatë shek. XV[1].

Vlen të përmendet edhe një e thelluar nga ana e brendshme e murit jugperëndimor pranë kullës I. Ajo ka një gjerësi prej 0,60 m dhe gjatësi 2,20 m dhe siç duket ka shërbyer për ndërtimin e shkallëve brenda trashësisë së murit. Po të llogarisim trashësinë dhe gjerësinë mesatare të një këmbëshkalle në raport me gjatësinë e tyre të mundshme do të na rezultojë se në këtë pjesë të fortifikimit lartësia e mureve nga ana e brendshme deri në nivelin e shtegut të rojeve nuk ka qenë më e madhe se 1,60 – 2 m. Kështu mundet të themi se tereni brenda kalasë ka patur një mbushje fillestare prej 3 – 3,5 m. Mbi murin veriperëndimor u gjet dhe e vetmja gjurmë frengjie për top. Ajo ndodhet 11,30 m në jugperëndim të portës së kësaj ane. Frengjia, përshkonte gjithë trashësinë e murit prej 1,65 m të kështjellës. Në planimetri ajo ka formën e një drejtkëndëshi me gjerësi 1,20 m dhe gjatësi sa trashësia e murit. Vendi i daljes së grykës së topit ngushtohet në 0,70 m nëpërmjet të krijimit nga të dy anët të një pature me dalje 0,25 m dhe me trashësi

1) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Durrësit në Mesjetë,** Monumentet 13, 1977.

DO NOT COPY



Fig. 6

0,55 m. Frengji për topa të këtij tipi kemi takuar edhe në dy kulla të periudhës së pushtimit turk në Butrint. Është për t'u vënë re se ky tip frengjie përfaqëson një fazë ndërmjetëse midis frengjive për artileri me planimetri me trajtë trapezi me brinjën e ngushtë të drejtuar nga jashtë që i takojmë jo rrallë në fortifikime të shek. XV dhe frengjitë me hapje nga jashtë të cilat janë karakteristike në vendin tonë për shek. XVIII-XIX. Prototipin e kësaj frengjie në formë dritareje e takojmë në disa fortifikime të ndërtuara nga pushtuesit turq në dekadat e fundit të shekullit. XV ose në fillim të shek. XVI siç janë frengjitë e kullave në kalanë e Prezës të cilat përfundojnë me një të çarë rrethore për fiksimin e grykës së zjarrit. Frengjitë e tipit të Ishmit, të kushtëzuar nga zhvillimi i artilerisë, lejojnë një lëvizshmëri më të madhe të grykës së zjarrit si dhe mundësinë e vendosjes së topave të kalibrave më të mëdhenj. Për këto arsye mendojmë se ky tip frengjie mund të shërbejë edhe si një element ndihmës për datimin e fortifikimeve të ndërtuara gjatë kësaj periudhe.

Hyrjet. Të dy hyrjet e kështjellës janë hapur në brinjët e ngushta të katërkëndëshit të formuar nga muret rrethuese. Në këtë mënyrë ato kanë më pranë kullat anësore të qosheve të cilat shërbenin njëkohësisht edhe për mbrojtjen e këtyre hyrjeve.

Hyrjes kryesore (fig. 6) që ndodhet në mesin e murit juglindor, ndërtuesit janë përpjekur t'i japin një pamje pak a shumë monumentale. Hyrja ka një hapësirë drite prej 2,16 m dhe lartësi 2,60 cm. Në të dy anët ajo kufizohet prej dy kontra fortave me gjerësi rreth 1,5 m të cilat nga muri i kështjellës 0,85 m. Ndërsa vetë hapsira e hyrjes mbulohet me tri harqe sektoriale të ndërtuara me gurë të punuara prej shtufi. Dy harqet e sipërme që janë në një rafsh midis tyre dhe njëkohësisht me murin e kështjellës dalin në forma dhëmbëzimi kundrejt harkut të poshtëm që është i futur më brënda në raport me to. E gjithë porta, në këtë mënyrë kufizohet nga një dhëmbëzim i murit anash saj si dhe i dy harqeve të sipërme. Nga hyrja tjetër që ndodhet përballë të parës dhe përshkon murin veriperëndimor ruhet vetëm shpatulla e djathtë deri në lartësinë 1,20 m si edhe pragu. Nga gjurmët e ruajtura kuptohet se porta ka patur një hapësirë drite prej 1,50 m.

Në lartësi 0,65 m nga faqja e jashtme e mureve ruhen gjurmët e një kanali me prerje drejtkëndëshe 0,25 x 0,25 m i cili shërbente për të lëvizur traun e sigurimit të portës. Për të lehtësuar këtë lëvizje në pjesën e poshtëme kanali është shtruar me pllaka guri të sheshta.

*
* *

Ajo që e bën me interes studimin e kësaj kështjelle është fakti se nga burimet historike njihet me saktësi si qëllimi dhe koha e ndërtimit të saj. Gjatë shek. XVI Ishmi përfshihej në Sanxhakun e Ohrit që ishte një krahinë e mbushur me revolta fshatare dhe trazira për perandorinë Osmane. Për këtë arsye një feudal i pasur i quajtur Mehmet, i cili ishte edhe vetë nga kjo anë, i propozoi Portës së Lartë që të ndërtohej në Ishëm një kala e cila do të ruante vilajetin nga kryengritësit, me kusht që t'i jepej Sanxhaku në sipërmarrje për mbledhjen e detyrimeve fiskale të shtetit[2]. Pas disa hezitimesh Porta e pranoi propozimin e Mehmetit me kusht që të ndërtonte një kala solide dhe të fortë, të pajisur mirë, dhe ajo që është më e rëndësishme ta përfundojë shpejt. Por për shkak të disa kryengritjeve që ndodhën në këtë zonë Mehmeti u tërhoq duke u përgjigjur se «kësaj rradhe një gjë e tillë është e vështirë për t'u realizuar». Atëhere porta urdhëroi Mehmetin që ta ndërtonte sa më parë kalanë që të ndëshkoheshin kryengritësit. Kështu kalaja e Ishmit filloi të ndërtohej në verë të vitit 1572 dhe përfundoi në fillim të vitit 1574[3]. Menjëherë pas përfundimit të punimeve kështjella u pajis me një garnizon prej 410 ushtarësh dhe përkohësisht me dy topa të sjellë nga kalaja e Shkodrës për

2) A. Matkovski, **Kryengritje të pa njohura në Sanxhakun e Ohrit në vitet 1566-1574,** Studime Historike, 3, 1973, 59.
3) A. Matkovski, **Vep. cit.** 59.

DO NOT COPY

deri sa të derdheshin topat e porositur në fonderitë e Perandorisë Osmane[4]. Kështjella e Ishmit u ndërtua kryesisht për të luftuar kundër fshatarëve kryengritës, por ajo i shërbente edhe një qëllimi tjetër dhe pikërisht kontrollit të skelës së Ishmit, ku nxirrej kontrabandë drithi dhe bliheshin armë prej venedikasve[5]. Tregtimi i drithit kontrabandë nga skelat e Shqipërisë e kishte shqetësuar prej kohësh administratën turke. Për këtë arsye edhe në një nga skelat e njohura të tregtimit të drithit në mesjetë siç ishte Bashtova turqit kishin bërë punime plotësuese në kështjellën që ndodhej aty dhe kishin vendosur në të një garnizon. Këto masa ishin marrë para vitit 1521[6]. Kështjella e Ishmit megjithëse e ndërtuar mbi një teren kodrinor ku kushtet e terenit kanë ndikuar deri diku në formulimin planimetrik të saj, ajo ruan tiparet e përbashkëta të ndërtimeve fortifikuese të kësaj periudhe, që kishin si qëllim dislokimin e garnizoneve turke për t'i patur ato si një armë të rëndësishme për konsolidimin e administratës otomane në krahina të ndryshme të vendit tonë dhe për të përhapur sistemin e timareve. Këto tipare janë kryesisht përmasat e vogla të kështjellës si dhe forma e saj e rregullt gjeometrike (në të shumtën e rasteve kështjellat kanë qënë katërkëndëshe) që i përgjigjej më së miri kërkesave të një garnizoni. Si shumica e kështjellave të garnizoneve të ndërtuara rishtazi në këtë periudhë me urdhër të administratës të otomanëve dhe ajo e Ishmit është një fortifikim i dobët për kohën në të cilën u ndërtua, kur siç dihet artileria po zhvillohej gjithnjë e më tepër dhe përdorimi i saj vinte duke u zgjeruar. Për rastin në shqyrtim është kuptimplotë shprehja se kështjella u ndërtua nga bregu i detit në një lartësi të tillë «që nuk godet topi».

Për ndërtimin e kalave të reja turqit merrnin angari popullsinë e zonave përreth, të cilat për këtë arsye edhe për të mos lejuar stabilizimin e administratës turke, hidheshin shpesh në kryengritje për të kundërshtuar ndërtimin e kalave në krahinat e tyre. Garnizonet otomane nuk ndaheshin asnjëherë nga administrata civile e tyre. Kështu në të shumtën e rasteve u përdorën për këtë qëllim fortifikimet ekzistuese të qyteteve tona të cilat vazhduan të ruajnë rëndësinë e një qendre administrative. Shumë kala të futura në thellësi të vendit që u gjykuan nga pushtuesi të pa përshtatshme për vendosjen e kësaj administrate u lanë pas dore ose u prishën për mos u kthyer në qendra rezistence të popullsisë shqiptare. Po pati edhe raste kur qendra e vjetër administrative nuk i përgjigjet kushteve të reja. Kështu mund të kuptohet ndërtimi i kalasë së Korçës pranë asaj të Mborjes që ekzistonte që para pushtimit turk. Në formimin e qendrave të reja administrative luajtën rol edhe disa kala të ndërtuara në fillim për qëllime thjesht ushtarake siç është kalaja e Elbasanit dhe në rastin tonë ajo e Ishmit. Kjo e fundit duke qënë e lidhur dhe me një rrugë me Ohrin e cila përshkonte krejt Sanxhakun dhe me rastin e kryengritjeve fshatare në krahinën e Musit ku ndodhej Ishmi u riparua dhe u vu në përdorim të plotë, u kthye dhe Ishmi në një qendër administrative të krahinës. Këtë mund ta kuptojmë dhe nga toponimi «Pazar» me të cilin thirret qendra e fshatit për prejardhjen e të cilit nuk dihet asgjë nga banorët e sotëm.

DO NOT COPY

4) A. Matkovski, **Vep. cit.** 60.
5) **Po aty** 60.
6) Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Bashtovës,** Monumentet 5-6, 70.

Gjerak KARAISKAJ

LA FORTERESSE D'ISHME

DO NOT COPY

RESUME

La forteresse d'Ishme se dresse sur une colline à l'est du village d'Ishme. Les murs d'enceinte de ce monument constituent un rectangle plus ou moins régulier de dimensions 100 x 40 m et dont les côtés plus étroits regardent en direction N.O. – S.E. Cette forteresse a deux portes. La porte principale est aménagée en direction S.E. et l'autre, d'une importance secondaire, en direction N.O. Ces deux portes communiquainent entre elles à travers une ruelle pavée. Les murs de la forteresse sont flanquées de cinq tours à angle droit, à l'exception d'une tour angulaire qui est de planimétrie circulaire et d'une autre à cinq étages.

Les tours sont disposées aux angles de jonction des murs, une seule d'entre elles se trouve au milieu du mur S.-O. se dressant sur le côté moins protégé naturellement de la colline.

Les murs de la forteresse sont en pierres gréseuses extraites des formations rocheuses se trouvant dans les parrages. Les pierres sont liés avec du mortier solide renfermant beaucoup de chaux. En tant que remplissage, on a employé du sable ruvide fluviatil et de la pierraille. L'épaisseur des murs varie de 1.50 à 1,2 m. La plus grande épaisseur nous la rencontrons au mur S.-O. et S.-E., qui jouissent d'une protection naturelle plus faible. Pour accroître la solidité des murs, on s'est servi de bandes de bois à leur intérieur. Ces bandes ont une section à angle droit de dimensions 0,11 x 0,6 m, les bandes longitudinales sont disposées toujours loin des parements latéraux des murs. La hauteur des murs dans les parties mieux conservées ne dépasse pas les 5 m, mais à en juger de certaines traces découvertes à proximité de la tour I il ressort que les murs n'avaient pas une hauteur supérieure à celle précédente dans l'espace menant jusqu'au sentier de la garde. Ainsi, en y ajoutant la hauteur des créneaux ou celle du parapet, nous avons une hauteur globale d'environ 7 m.

Le terrain à l'intérieur de la forteresse étant d'un niveau plus élevé que dans sa partie extérieure, les murs s'appuient aux flancs de la colline. En raison de cette différence de niveau, le long du mur occidental ont été percés six canaux pour le déchargement des eaux; dans leur partie visible, ces canaux sont de forme carrée, ont une largeur d'environ 2.25 m et une hauteur de 0.25-0.30 m.

Parmi les autres éléments de cette fortification, il convient de mentionner une meurtrière à canon pratiquée dans le mur N.-O. à proximité de l'entrée se trouvant sur ce côté.

Les sources écrites indiquent avec précision le but et la date exacte de construction de cette forteresse. Ishme faisait part au XVIe siècle du Sanxhak d'Ohri, une région constamment en révolte et très troublée. Un féodal riche de nom Mehmet, originaire du pays, proposa à la Sublime Porte «la construction d'une forteresse» pour défendre le vilayet des insurrections qui étaient violentes, à condition toutefois que lui fut reconnu le droit de récolter les impôts et taxes dus à l'Etat. Arpès quelques hésitations la Porte acquiesça à sa demande et donna l'ordre à Mehmet, qui s'était entre-temps repenti par suite de certaines insurrections paysannes qui s'étaient déchaînées dans cette zone, de commencer la construction de la dite forteresse. Les travaux furent entamés pendant l'été 1572 et portés à terme au commencement de l'anée 1574. Plus tard Ishme devint chef-lieu de l'administration régionale, ce qui est attesté par le toponyme «Pazar» par lequel les habitants du pays appellent aujourd'hui le centre de ce village.

DO NOT COPY

KRONIKË E PUNIMEVE RESTAURUESE (VITET 1976-77)

RESTAURIMET NË MONUMENTET ANTIKE DHE MESJETARE



Fig. 1. Zgërdhesh. Muri pranë kullës së rumbullakët (para restaurimit)



Fig. 2. Zgërdhesh. Muri pranë kullës së rumbullakët (Pas restaurimit)

Qyteti Ilir në Zgërdhesh Rr. i Krujës (L. Papajani)

Punimet e vitit 1976 u përqëndruan në murin e akropolit, në mënyrë të veçantë, në portën që lidh pjesën e poshtëme të qytetit me pjesën e sipërme. Nëpërmjet tyre u ngrit një faqe kurtine dhe u përcaktuan drejtimet e mureve të koridorit të portës. Krahas kësaj u krye anastiloza e blloqeve të rënë të portës veriore të qytetit. Përveç punimeve të mësipërme u kryen edhe punime me karakter çlirimi dhe pastrime.

Në vitin 1977 u krye një volum më i madh punimesh në krahasim me atë të viteve të mëparshëm. Gjatë këtij viti u restauruan kulla e rrumbullakët e akropolit me hyrjen e tij, muri ndërmjet kullës së rrumbullakët dhe hyrja si edhe në një mur tarracimi në pjesën jugore të qytetit.

Qyteti Ilir në Klos — Rr. Fierit (L. Papajani)

Në qytetin ilir në Klos të Mallakastrës gjatë vitit 1976 u kryen punime në një pjesë të murit rrethues në anën lindore të qytetit. Në të ishte dëmtuar një nga blloqet e themelit, si pasojë pjesa e sipërme e murit ishte mënjanuar nga jashtë dhe rrezikohej të shembej. Për ta evituar këtë u hoqën me rradhë blloqet e pjesës së sipërme, u betonuan blloku i dëmtuar dhe u rivendosën në vend blloqet e hequr. U punua gjithashtu në pjesën veriperëndimore të qytetit, në portën e vogël dhe në kurtinën ndërmjet saj dhe kullës lindore. Si rezultat i punimeve të pastrimit që u ndërmorën në këtë pikë doli që koridori i portës është me shkallë guri.

Po gjatë këtij viti u punua për konsolidimin e mureve të një banese në pjesën jugore të qytetit të zbuluar nga gërmimet arkeologjike. Muret e saja të lidhur me llaç balte ishin të dëmtuara për ta shmangur dëmtimin e mëtejshëm u rindërtuan pje-



Fig. 3. Bylis. Hekal. Muri pranë portës së madhe (Pas restaurimit.

sët e dëmtuara dhe në pjesën e sipërme u vendos një rradhë gurësh të lidhur me llaç gëlqere, me qëllim që të krijohet një shtresë mbrojtëse.

Bylis – Hekali i Rr. Fierit (L. Papajani)

Në qytetin antik të Bylisit punimet restauruese u përqëndruan në portën e madhe në anën lindore të qytetit, ku gjatë viteve të kaluara janë kryer punime pastrimi që e kanë nxjerë atë pjesërisht në dukje. Punimet e vitit 1976 filluan në pjesën ballore dhe anësore të mureve që e kufizojnë nga ana lindore koridorin e saj. Punimet i vendosën në drejtimet fillestare këto mure duke i gjetur sejcilit bllok vendin e tij. Puna për restaurimin e portës dhe të mureve rrethuese që lidhen me të do të vazhdojnë për disa vjet.



Fig. 4. Klos. Banesa me sterë (pas restaurimit).



Fig. 5. Klos. Banesa me sterë (Para restaurimit)



Fig. 6. Bylis, Hekal. Muri pranë portës së madhe (Para restaurimit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Fontana e Apolonisë (G. Pani)

Fontana e Apolonisë është një kompleks arkitektonik me shumë interes dhe paraqitet si një shembull i veçantë përsa i përket zgjidhjes funksionale të furnizimit me ujë. Punimet për zbulimin dhe restaurimin e monumentit kanë filluar nga viti 1963 dhe kanë vazhduar në mënyrë sistematike për 5 vjet, duke zbuluar pothuajse tërësisht monumentin. Punimet restauruese në fasadën e korpusit qëndror, të paisur me një kollonadë të stilit dorik, ngritur mbi stilobatin i kanë ridhënë monumentit pjesën e tij origjinale.

Monumenti ka qënë rrëzuar nga një lëvizje sizmike e cila përveç dëmtimeve në korpusin qëndror, ka shkaktuar dhe cedimin e rrëshqitjen e terenit të kodrës ku mbështetet monumenti. Kjo rrëshqitje, e



Fig. 7. Varri monumental në Suç të Mirditës (shek. V-VI) (Pas Restaurimit)



Fig. 8. Çezma monumentale e Apollonisë. Pamje e murit mbajtës (Pas restaurimit)

terrenit ka shkaktuar jo vetëm fundosjen e basenit por dhe një çvendosje horizontale të lugut kryesor që grumbullonte ujët për në basen. Muri ku mbështetej lugu, i trajtuar me kontraforte, 3 m i lartë dhe mbi 20 m i gjatë, ishte spostuar 0,50 m nga linja horizontale. Kjo lëvizje që kishte shkaktuar dhe thyerjen e mjaft gurëve rrezikonte shëmbjen e krejt murit, dhe rrëshqitjen e krejt masës së dheut që ndodhej mbrapa tij. Për këtë arsye u pa e nevojshme ndërhyrja restauruese e menjëhershme në këtë sektor. Punimet restauruese kishin për qëllim kryesor rikompozimin arkitektonik dhe ndalimin e ndërtimit të mëtejshëm të monumentit. Për këtë qëllim u bë dhe një studim i hollësishëm i gjendjes së monumentit njëkohësisht u përgatit dokumentacioni i plotë grafik dhe fotografik i të gjithë elementeve. Në mbështetje të të dhënave që u mblodhën nga ky studim u hartua projekti i restaurimit, në bazën e të cilit u kryen punimet e restaurimit dhe konsolidimit.

Gjatë këtyre punimeve u çmontua që nga themeli i gjithë muri dhe u rivendosën përsëri në vendin e tyre mbi 450 blloqe. Në themel u bënë riforcime me materialet e kohës (buto-beton) si nevojë e domosdoshme për konsolidimin e elementeve origjinale të murit të cilët përbëjnë masën kryesore. Me punimet e restaurimit u mblodh dhe mjaft material i rëndësishëm për teknikën e ndërtimit si dhe zgjidhjen arkitektonike-funksionale të monumentit.

DO NOT COPY



Fig. 9. Pjesa e brendëshme e akropolit të kalasë Beratit (Pas restaurimit)

Varri monumental në Suç të Burrelit (A. Baçe)

Varri monumental, i tipit të varreve me qemer me pusetë, gjendej në rënojat e një kishe të shek. IV-VI. Si rezultat i çlirimit dheu në faqet anësore forca shtytëse e qemerit nuk kishte me se të përballohej, kështu që qemeri ishte rrëzuar në 1/3 e tij. Punimet restauruese konsistuan në ripunimin e qemerit me anë të kallëpeve të brëndëshëm prej drrase, mbushjen anësore për ekuilibrimin e shtytjes së qemerit dhe konsolidimin e strukturave të rrëzuara të mureve.

Kalaja e Beratit (A. Baçe – G. Samimi)

Gjatë vitit 1977 punimet shumëvjeçare në kalanë e Beratit u përqëndruan në kështjellë, në rrethimin e dytë. Gjatë kësaj periudhe u pastrua nga brenda ana perëndimore dhe veriore e kështjellës dhe u konsoliduan strukturat murale në gjendje degradimi. Qëllimi i këtyre punimeve ishte kthimi i kështjellës në objekt të vizitueshëm, mbasi për shkak të nivelit të lartë të dheut dhe rënimeve kjo pjesë paraqitej e pavizitueshme, dhe konsolidimi i strukturave të mureve, si i atyre që gjendeshin mbi nivelin e mbushjeve ashtu dhe strukturave që u zbuluan nga pastrimi. Për largimin e dherave të dala nga pastrimi u përdorën vagona dekovili. Pastrimet u kryen duke ju përmbajtur nivelit të pjesës së mesit të kështjellës. Ky nivel përkon me tabanin e kështjellës në fillim të shek. XIX, pas të cilit kështjella u braktis dhe u rrënua. Ndërtimet e kësaj periudhe që ruhen në një gjendje relativisht të mirë i përkasin periudhës së pushtimit turk dhe asaj të zotërimit të Ali Pashë Tepelenës duke paraqitur interes për nga trajtimi arkitektonik.

Gjatë punimeve u zbuluan një sërë ambientesh të mbuluar me qemer ngjitur me murin e kështjellës dhe disa ambiente të ndërtesave një katëshe. Ambientet e mbuluara me qemer paraqiteshin në një gjendje mjaft të degraduar, me qemere të shpërndarë dhe në pjesën më të madhe të rrëzuar. Ambientet përbëhen prej mureve mbi të cilët në një lartësi rreth 1 – 1,20 m nisin qemeret. Prej tyre muret u restauruan në tërë gjatësinë, kurse qemeret nuk u ngritën tërësisht, por vetëm në pjesën e fillimit duke ja humbur gradualisht lartësinë. Mbi të u krijua një mbushje dheu e cila shërben njëkohësisht si rrugë kalimi.

Krahas ambienteve të mësipërme u restauruan dhe harqet e dritareve e të dyerve të ndërtesës. Për këtë u punua prej guri pjesa e mangët e harkut dhe u përforcuan shpatullat.

Kalaja e Gjirokastrës (A. Baçe)

Gjatë vitit 1977 u kryen punime me karakter pastrimi në teritorin e kalasë dhe punime konsolidimi në mesin e anës jugore. Në këtë anë paraqiste rrezikshmëri shëmbje një trakt 7 m i gjatë dhe rreth 2,5 m i lartë. Trakti përbëhej prej dy faqeve nga të cilat e jashtmja ishte rrëzuar. Për konsolidimin e tij faqja e jashtme u plotësua deri në nivelin e sipërm të faqes së brendëshme. Muri u punua me gurë të rrëzuar po nga muret e kalasë të lidhur me llaç bastard.

Kalaja e Krujës (Gj. Frashëri)

Gjatë vitit 1976 punimet u përqëndruan kryesisht në pjesën perëndimore të kalasë, në muret rrethuese. Ndërhyrja për gjurmimin arkitektonik dhe konsolidimin u kryen në murin e jashtëm dhe të brendshëm të oborit të fortifikuar të kalasë. Ato konsistuan në evidentimin e këtij rrethimi të rëndësishëm të buri-

DO NOT COPY



Fig. 10. Muri në veri të teqes së Dollmës dhe evidentimi i pusit të Kalasë.



Fig. 11. Faza e dytë e punimeve për evidentimin e kapelës.

meve të kalasë dhe krijuan mundësi për ndërhyrjet e ardhëshme restauruese. Gjatë këtij viti u krye dhe gjurmimi urbanistik i zonës mbrapa teqes së Dollmës. Fillimisht u bë pastrimi nga dherat dhe hedhurinat, për sqarimin e planimetrisë të një banese të rënuar të mesit të shek. XVIII duke e kthyer në të vizitueshëm këtë pjesë të kalasë. Duke u nisur nga evidentimi i një fragmenti muri rrethues të hershëm; u arrit zbulimi i një kapele bizantine, në të cilën dallohen



Fig. 12. Faza e parë e punimeve për evidentimin e konstruksioneve mbrapa Teqes së Dollmës.

qartë dy faza ndërtimi. Pranë saj u sqaruan edhe një palë shkallë, që të ngjisin mbi muret rrethuese. Përkatësisht u bënë edhe punimet e konservimit të tyre.

Teqeja e Dollmës – Krujë (S. Dashi – Gj. Frashëri)

Gjatë vitit 1977 u bë ndërhyrja restauruese në Teqen e Dollmës. Punimet konsistuan në restaurimin e kornizave dekorative të mbulesës të muraturës së gurit në faqen perëndimore, në çlirimin e tre dritareve lindore nga mbushja dhe në kompletimin e të gjithë të tjerave, restaurimin e krejt mbulesës së monumentit, etj.

Të karakterit të konsolidimit ishin ndërhyrjet për eleminimin e frakturave në kupol, në trompën veriore, në murin lindor dhe në vendosjen përreth tamburit të një brezi të fshehur beton armeje.

Në zonën para teqes së Dollmës, u krye çlirimi i tyrbes, evidentimi i murit rrethues të kullës të shkallëve të saj, të murit në vazhdim verior dhe në zbulimin e pusit të hershëm të kalasë. Një vend të rëndësishëm zunë edhe ndërhyrjet konservuese për sigurimin e tyre.

Kështjella në kanalin e Vivarit – Butrint (Gj. Karaiskaj)

Gjatë vitit 1976 përfundoi faza e parë e punimeve restauruese në kështjellën e Vivarit, që kishin filluar nga viti 1974. Gjatë restaurimit u respektuan

DO NOT COPY



Fig. 13. Pjesa e poshtme e absidës së kishës së Rubikut (pas restaurimit)



Fig. 14. Absida e Kishës së Rubikut Pas restaurimit)

të gjitha periudhat e ndërtimit të kështjellës dhe u ruajtën me kujdes e u evidentuan më mirë gjurmët që vërtetojnë praninë e këtyre fazave. Ju kushtua një kujdes i veçantë vlerësimit dhe restaurimit të fazës së parë të ndërtimit për këtë u restauruan të gjitha frengjitë që përshkonin parapetin si dhe ky i fundit deri në nivelin e ruajtjes së gjurmëve të sigurta. Gjithashtu u restauruan shkallën që të çonin në shtegun e rojeve dhe që i përkisnin kësaj periudhe. Nga dy kullat që i përkisnin periudhës së tretë të ndërtimit u restaurua porta e njerës prej tyre, kullës III, u konsoliduan muret e të dy kullave dhe restauruan frengjitë e tyre. Punime restauruese u kryen dhe në ambjentet e brendshme që mbulohesin me qemer cilindrik guri. Ato konsistuan në plotësimin e ndarjeve të tyre të brendshme që luanin rol edhe në konsolidimin e qemerit, në restaurimin e murit fundor nga ana lindore e ambienteve si dhe në riparimin e hyrjeve dhe mureve të tyre nga ana e brendëshme të fortifikimit. Ndërsa ndërtimit me planimetri rrethore të mbuluar me kupol, ju rikrijua mbulesa me tjegulla.

Kështjella e Mahallasë (Gj. Karaiskaj)

Ndodhet pranë fshatit Gravë të rrethit të Sarandës është një ndërtim i shek. XVIII. Kështjella ka përmasa të vogla në formë trapezi me katër kulla katërkëndëshe në qoshet. Kualiteti i dobët i materialit lidhës kishte bërë që dy nga kullat e ruajtura më në lartësi të ishin në rrezik shëmbje të plotë nga muret e kateve të sipërme të këtyre kullave ruhej vetëm veshja e jashtëme ndërsa nga dritaret dhe frengjitë vetëm disa elemente, të cilat mund të humbisnin po të mos ndërhyhej në kohën e duhur. Gjithashtu rrezikoheshin të binin edhe qemeret e shkallëve për në katet e sipërme të kullave. Dy kullat e tjera ishin rrënuar me kohë dhe në gjendjen egzistuese kishin një stabilitet relativisht të mirë.

Për evitimin e degradimit të mëtejshëm të kështjellës u konservuan dhe muret e kateve të sipërme të dy kullave të para, u fiksuan elementet e ruajtura nga dritaret dhe frengjitë, gjithashtu u restauruan të katër shkallët që të ngjisnin në katet e sipërme të kullave. Me punimet konservuese restauruese të kryera gjatë vitit 1977 u mënjanua rreziku i degradimit të mëtejshëm të kështjellës.

Kalaja e Shkodrës (Gj. Karaiskaj)

Në kalanë e Shkodrës punimet konservuese gjatë vitit 1977 kishin për qëllim vazhdimësinë e mirëmbajtjes së mureve rrethuese dhe kullave si dhe evidentimin e disa ambienteve të mbuluara nga rrënimet në oborrin e tretë të kalasë. Për këtë u ndërmorën punime pastrimi si dhe konsolidimi të mureve dhe disa frengjive.

DO NOT COPY



Fig. 15. Bazilika e Tepes (Elbasan). Fragment i mozaikut të dyshemesë (Pas restaurimit)



Fig. 16. Bazilika e Tepes (Elbasan). Fragment i mozaikut të dyshemesë (Pas restaurimit)

Kisha e Rubikut (A. Baçe)

Punimet në kishën e Rubikut patën për qëllim kryesor izolimin e pjesës së absidës, ku gjenden piktura murale me vlerë të veçantë, nga rreshjet atmosferike dhe lagështia.

Fillimisht është ndërtuar në shek. e XII dhe si tip i përket kishave romanike të shkollës së Rashës. Prej saj ruhet fundi i nefit qëndror me absidën gjysëm rrethore. Piktura murale që i përket një kohe më të vonë, shek. e XIII, vesh absidën si dhe faqet e presbiterit. Për shkak të mosmbulimit të mirë të kësaj pjese, filtrimit të lagështirës nëpërmjet pareteve të murit të paizoluar si dhe pikimit në ambientin e dhiakonikonit piktura gjëndej në kontakt të vazhduar me lagështirën. Ky kontakt bëhej më i rrezikshëm për arsye të prezencës së gazit sulfuror që del nga uzina e përpunimit të bakrit e cila gjendet në afërsi duke krijuar acid sulfurik i cili e dëmtonte së tepërmi pikturën. Për ta shmangur këtë u krye hidroizolimi i plotë i çatisë, suvatimi me llaç hidroizolues i anës së jashtëme, izolimi nga ambjenti i jashtëm me dritare të palëvizëshme dhe riparimi i përgjithshëm i çatisë.

Gjatë hapjes së çatisë të nefit të kishës së vjetër u zbulua se qemeri i kishës mbulohej nga sipër me tjegulla duke e ruajtur formën cilindrike. Me qënë se qëllimi kryesor i punimeve ishte izolimi i çatisë nga rreshjet dhe kjo mënyrë mbulimi nuk pati dhënë rezultat duke u zëvendësuar më tej me çati dy ujse, mbulimi i saj u krye me çati për izolim më të mirë dhe mbulim më të plotë, bishtat e strehës së saj u zgjatën 0,70 m dhe u përdor letra katramat. Ana e jashtëme e presbiterit u izolua me llaç bastard me mbushës pluhur guri. Ky lloj mbushësi që e gjetëm dhe në fragmentet e suvasë origjinale siguron një hidroizolim më të mirë se mbushësi i zakonshëm. Suvatimi u krye në nivelin e shtresës së suvasë të parë duke i lënë të paprekura pjesët origjinale. Po kështu u lanë të paprekura mbushja e dritares së sipërme, gançimi i murit me kllapa metalike dhe një pjesë afresku. Përveç tyre për dallimin e teknikës së ndërtimit u lanë pjesë kuadratike të pasuvatuara. Po kështu pjesët e reja u markuan me datën e kryerjes së punimeve dhe inicialet e institutit.

PUNIMET E RESTAURIMIT NË MONUMENTET E ARTIT

Mozaiku i Apollonisë (S. Kosta)

Punimet u përqëndruan tek banesa me peristil që gjendet paksa më nga perëndimi i manastirit

DO NOT COPY



Fig. 17. Tiranë. Fragment mozaiku të dyshemesë të kishës paleokristiane.



Fig. 18. Apolloni. Fragment i mozaikut të dyshemesë në sek. G.

(sektori G) Vlerat dekorative, mjeshtëria e punimit, këtë mozaik e vë në radhën e veprave të bukura të kësaj qëndre. Mozaiku ishte i mbuluar nga një bimësi e dëndur e cila e mbulonte atë prej vitesh. Ai ishte dëmtuar nga rrënjët e barit të gramit, që i kishte shkëputur vende-vende kubikët nga shtroja. Më e rëndë gjëndja paraqitej në anën jugore të monumentit ku që në gërmimet qenë vënë re shëmbje dhe mungesa të rënda në çerekun e fundit nga ana perëndimore. Heqja e shtresës që mbulonte sipërfaqen e mozaikut u realizua me kujdes duke prerë dhe jo shkulur shkallë-shkallë barërat. Pas zbulimit, në ato pjesë ku kubikët ishin të veçuar nga baza u kryen punime riforcimi, nganjëherë edhe rindërtimi duke ruajtur vendndodhjen e sejcilit kubik, në gjurmët e motiveve dekorative të dyshemesë.

Mozaiku i Antigonesë (S. Kosta)

Monumenti i kultit që ka dysheme të shtruar me mozaik ndodhet në skajin më jugor të mureve rrethues të qytetit të lashtë. Ai shquhet për larminë e motiveve e në mënyrë të veçantë për karakterin e lirë e të guximshëm në ndërthurjen e linjave e njollave dekorative dhe kompozimin dinamik. Elementët figu-



Fig. 19. Sarandë. Çast pune për konservimin e mozaikut pranë PTT.

rativë kompozicionale paraqiten asimetrikë për nga stili dhe mjetet shprehës.

Punimet konservuese synuan në konsolidimin e shtrojës mbi bazë dhe në disa masa me karakter eksperimental kundra bimëve, kryesisht gjembaçëve me herbicid të tipit dalapon dhe spirit hormit. Vende-vende u kryen edhe punime të vogla restaurimi për të qartësuar e plotësuar përfytyrimin origjinal. Paraprakisht u morën masa që gati 2/3 e shtrojës së mozaikut të veçohej nga pjesa e shëmbur duke ndërtuar për këtë qëllim një mur mbajtës provizor i cili do të shërbejë dhe për fazën tjetër të punimeve restauruese. Në këtë mozaik veç të tjerave u përgatit edhe një dokumentacion i hollësishëm grafik, fotografik e përshkrimor.

Mozaiku në bazilikën paleokristiane në Tepe Elbasan (S. Kosta).

Mozaiku mbulon dyshemenë e bazilikës, paraqitej në gjendje degradimi të rëndë dhe kërkonte punime të mirëfillta restaurimi. Puna u përqëndrua në njërën nga katër pjesët e dyshemesë. Punimet konsistuan në çvendosjen dhe rivendosjen e mozaikut. Nga sondazhet në strukturën ndërtimore të mozaikut pas shkuljes u pa qartë shtresa e rudusit, e niveluar me llaç harasan për të cilën u morën masa që të mos dëmtohej por të ruhej si dëshmi. Nga kontrolli që iu bë nivelit të dyshemesë me mozaikë u vu re një pjerrësi në të dy krahët, për nga ana perëndimore dhe veriore, afërsisht 1%. Punime u kryen edhe në muret. Në drejtim të eksperimentimit të materialeve ndërtimore u riçfrytëzua llaçi harasan i përftuar nga shkulja i cili rezultoi i ripërdorëshëm pas pasurimit me elemente të rinj lidhës.

Mozaiku i Sarandës (S. Kosta).

Në të janë kryer punime që kanë rënduar mbi pamjen fillestare sidomos në anën jugperëndimore ku edhe duken dëmtimet më të mëdha. Rrjedhimisht mozaiku kërkonte një ripunim të sipërfaqëshëm që vende vende kaloi edhe në ndërhyrje restauruese në të mirë të evidentimit të vlerave. Punimet u përqëndruan në zëvendësimin e riforcimeve me allçi, të kryera disa vite më parë, me llaç harasan, i cili lidhte më fort e njëkohësisht shtonte mundësitë për një vlerësim më të mirë të vizatimit e të ngjyrës. Pas larjes dhe tharjes së tërë sipërfaqes ajo u fërkua me solucion parafine-benzinë (1 : 10) për të rigjallëruar dekoracionin. Kjo u arrit mirë veçanërisht në zonat ku kubikët ishin të lidhur fort me bazën. Mozaiku i Sarandës, i vetmi mozaik i mbuluar, ze katin e parë të ndërtesës së PTT të qytetit.

Kisha e Shën Todrit — Berat (A. Sadikaj)

Kisha e Shën Todrit, e shekullit të XVI përfaqëson një nga monumentet më me vlerë të artit mesjetar në vendin tonë ku ka punuar Onufri. Punimet e konservimit të pikturës u diktuan nga domosdoshmëria që erdhi si pasojë e ndërhyrjeve konsoliduese në arkitekturë. Masat e konservimit të pikturës patën për qëllim konsolidimin e saj, evitimin e rrezikut të dëmtimit të mëtejshëm si pasojë e degradimit të suportit mbajtës, këto punime evidentuan më mirë dhe pjesën tjetër të pikturës murale në anën veriore e perëndimore të kishës, e cila megjithëse nuk është vepër e Onufrit ka vlera të dukshme artistike dhe i përket po shekullit të XVI.

Punimet në pikturën murale të cilat vunë në dukje edhe mjaft sipërfaqe të tjera të afreskut, të mbuluara me gëlqere, si dhe punimet e arkitekturës krijuan mundësi për ta kthyer këtë monument në një objekt të vizitueshëm duke e plotësuar dhe me një seri ikonash me vlerë të veçantë të cilat ishin kryesisht pjesë e ikonostasit të vjetër të kësaj kishe.

Kisha e Shën Triadhës — Berat (H. Nallbani)

Punimet e konservimit në pikturën bizantine të sh. XIV në kishën e Shën Triadhës, në kalanë e Beratit po vazhdojnë prej disa vjetësh. Punimet e viteve 1976-77 plotësonin masat e përgjithshme konservuese në naos dhe narteks duke mënjanuar rrezikun e rrëzimit të sipërfaqeve të afreskave të dëmtuara, kryesisht në harqet dhe kupolën e kishës si dhe në pjesët e brezit të poshtëm të mureve.

Ndërmjet këtyre punimeve u arrit integrimi i pjesëve të humbura me ato të ruajtura të pikturës dhe u krijuan mundësi për kryerjen e masave të tjera më të thella me karakter restaurues.

Shën Mitri në Boboshticë — Korçë (H. Nallbani)

Masat e ndërmarra në këtë monument patën për qëllim konsolidimin e pikturës së faqes jugore e cila ishte veçanërisht e degraduar si pasojë e cedimit të murit mbajtës. Konsolidimi i pikturës u realizua nëpërmjet imprenjimit të kazeinës dhe lidhjeve të pjesëve të dëmtuara të pikturës, ndërsa shtresa e ngjyrës, e pluhurizuar, u fiksua dhe pastrua duke i bërë më të qarta vlerat artistike të pikturës.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 20. Elbasan. Banesë në lagjen «Karavelije» Rr. Brigada XV Nr. 20 (pas restaurimit).



Fig. 21. Elbasan. Banesë në lagjen «Karavelije» Rr. Brigada XV Nr. 20 (Para restaurimit).

Kisha e Shën Kollit dhe Shën Mërisë — Voskopojë (A. Sadikaj)

Punimet e kryera në to patën si objekt konservimin e pikturës të degraduar në hajatin e kishës, naosin e së cilës e ka afreskuar mjeshtri David Selenicasi si dhe marrjen e masave të ndryshme konservuese në kishën e Shën Mërisë për evitimin e dëmtimit të mëtejshëm të pikturës. Në raste të ndryshme u ndërmorën edhe punime të thella restaurimi si heqja e rivënia e pikturës murale në naosin e kishës Shën Mërisë. Në pikturën murale të kishës së Shën Kollit u fiksuan gjithashtu sipërfaqe të gjera të pikturës së pluhurzuar, nëpërmjet imprejnimit të fiksativit me anën e pompës.

Kisha e Shën Mërisë — Prespë (H. Nallbani)

Punimet në kishën që gjëndet në Ishullin e Prespës qëndrojnë në konsolidimin e sipërfaqeve të dëmtuara të brezit të afreskeve rreth mureve të naosit rreth 2 metër lart dyshemesë. Sipërfaqet e mësipërme paraqiteshin mjaft të degraduara në rrezik rrëzimi. Gjatë punimeve u shkëputën dy medalione me figura dhe një portret në faqen jugore. Po ashtu në faqen perëndimore e veriore u bënë shkëputje dhe rivendosje fragmentesh si dhe u kryen konservimi e pastrimi i pikturës nëpërmjet imprenjimit të suvasë dhe pastrimit të mbeturinave dhe depozitimeve që errësonin vlerat origjinale të pikturës.

Restaurime ikonash (Sektori i artit)

Punime të mirëfillta restauruese u kryen në 20 ikona disa prej tyre mjaft të dëmtuara e me probleme të komplikuara të praktikës së restaurimit. Këto punime si dhe ato që u kryen në ikonostase, si në fragmentet që ruhen në muzeun e Fierit, në dyert e bukura të ikonostasit të katedrales së kalasë së Beratit etj. shërbyen për mënjanimin e faktorëve më kryesorë degradues dhe njëkohësisht dhanë mundësi për rigjenerimin e vlerave artistike të këtyre objekteve me vlerë, të veçantë për artin mesjetar në vëndin tonë.

PUNIMET E RESTAURIMIT NË BANESAT POPULLORE QYTETARE

Banesë në lagjen 8 Nëntori, rruga Petrit Lulo, Nr. 27 (B. Strazimiri)

Banesa në fjalë paraqet një nga shembujt më me interes të ndryshimeve të rëndësishme që pësoi banesa e hapur me çardak, duke filluar që rreth mesit

DO NOT COPY



Fig. 22. Berat. Banesë në lagjen «Çlirimi» Rr. «Tafil Skëndo» Nr. 3 (Pas restaurimit).



Fig. 23. Berat. Banesë në lagjen «13 Shtatori» Rr. «Azbi Beqari» Nr. 47, Kompleksi i musandrës» (Pas restaurimit).

të shekullit XIX. Kjo banesë është ndërtuar e variantit me çardak në qendër. Terani i pjerrët ka kushtëzuar kompozimin me gjysmëkat të ndërtimit. Në katin përdhe banesa ka pasur dy katoj në krahët, ndërsa në katin e banuar pesë ambiente, dy në krahët dhe tre në pjesën fundore. Në vitin 1891 banesa ka pësuar një rindërtim të thellë i cili ka prekur si skemën funksionale ashtu dhe elementet e ndryshëm arkitektonike. Ndryshimi më me rëndësi është mbyllja e çardakut me një perde prej skeleti druri në të cilën janë vendosur shtatë dritare mjaft të larta. Të dy ambientet e krahëve janë gjysmuar duke sajuar respektivisht në të dy krahët nga dy ambiente në vend të ambienteve të mëdhenj origjinal. Ndryshime të rëndësishme kanë pasur gjatë këtij rindërtimi, dritaret, dyert dhe elementet e tjerë prej druri, duke përfshirë këtu dhe mbylljen e strehëve në pjesën ballore.

Në prag të punimeve të restaurimit monumenti, është në gjendje të keqe teknike, struktura e çatisë, muret prej skelet druri dritaret, dyert dhe dyshemetë ishin mjaft të dëmtuara. Në këto rrethana u bë e nevojshme ndërhyrja restauruese. Idea restauruese mbështetej në parimin që monumenti të ruhej në fazën e rindërtimit të vitit 1891, për arsye se këto ndryshime përbëjnë një dëshmi të rëndësishme për zhvillimin në kohë të banesës së hapur me çardak, e cila me përmirësimet që pësoi gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, plotësoi dhe për një kohë kërkesat e një mënyre të re jetese.

Duke u nisur nga ky parim u krye restaurimi i krejt ballit të katit të banuar, me të gjithë elementet konstruktivë dhe arkitektonikë që e formonin, u restaurua konstruksioni i çatisë si dhe u kryen një sërë punimesh restaurimi në strukturat e mureve prej guri, dyshemetë, tavanet, u ribënë mjaft suva të degraduara etj. Pas restaurimit monumenti është një shembull i mirë i zhvillimit në kohë të banesës së hapur me çardak.

Banesa në lagjen «Barrikadë», rruga «Zihni Toska» Nr. 1 Berat (L. Lazimi).

Banesa është e tipit me çardak me një krah. Në rrjedhje të kohës banesa ka pësuar një sërë ndryshimesh të rëndësishme në planin kompozicional. Ajo është ndarë më dysh, duke krijuar një njësi më vehte me ambientet e vargut fundor. Në krahun e djathtë të çardakut, më vonë është shtuar një ambient. Pjesë të ballit të çardakut kishin pësuar ndryshime, ndërsa pjesët origjinale ishin në gjendje mjaft të degraduara.

Gjëndja e monumentit bëri të nevojshme kryerjen e punimit të restaurimit në të. Duke qënë se ndarja e banesës më dysh, përpara vënjes në mbrojtje shtetë-

DO NOT COPY



Fig. 24. Gjirokastër. Banesë në lagjen «Palorto» Rr. «Astrit Toto» Nr. 20 (Pas restaurimit).



Fig. 25. Gjirokastër. Banesë në lagjen «Palorto» Rr. «Astrit Toto» Nr. 20. (Para restaurimit)

rore, kishte tjetërsuar rëndë ambientet fundore, kthimin e tyre në gjendje origjinale, nuk gjente asnjë mbështetje, prandaj ato nuk u prekën. Praktikisht restaurimit iu nënshtrua vetëm pjesa ballore e banesës. Duke qënë se ambienti i shtuar i krahut të djathtë, dëmtonte rëndë kompozimin origjinal të banesës u vendos heqja e tij. Punime të rëndësishme u kryen në çardak pjesa ballore e të cilit u restaurua plotësisht mbi bazën e gjurmëve të plota që ruheshin duke vendosur dhe persianet karakteristike. Trajtim të gjerë pati dhe konstruksioni i çatisë, dyshemetë, dritaret dyert, tavanet etj.

Banesa në lagjen «Çlirimi», Rr. «Tafil Skendo» Nr. 3 Berat (L. Lazimi)

Kjo banesë me çardak në qendër, paraqet një nga shembujt më të zhvilluar të banesës së hapur në qytetin e Beratit. Kompozimi i shtrirë horizontal, çardaku i madh dhe oborri i gjerë përpara, janë tipike për banesat e kësaj lagjeje në dallim nga ndërtimet kompakte në lagjet me trajtë të pjerrët. Nga trajtimi arkitektonik banesa duket se i përket shekullit XVIII.

Monumenti gjatë kohës kishte pësuar një sërë ndryshimesh të rëndësishme si në skemën planimetrike, ashtu dhe në trajtimin e brendësisë, të ambienteve të ndryshme të saj. Gjendja teknike e monumentit, veçanërisht përsa i përket strukturave të drurit, paraqiste dëmtime. Punimet e restaurimit në këtë monument synonin kryesisht në vlerësimin e çardakut të banesës. Në volumin e tij, më vonë ishte sajuar një ambient, i cili dëmtonte rëndë monumentin, prandaj ai u çlirua nga kjo shtresë. Punime të rëndësishme restaurimi u kryen në strukturat e çatisë, në dyshemetë, u ripërtrinë mjaft suvatime etj.

Banesa në lagjen «13 shtatori» rr. «Azbi Beqari» Nr. 47 Berat (E. Riza).

Kjo banesë është pjesë e një kompleksi mjaft të madh në një nga rrugicat më karakteristike të lagjes Mangalem të qytetit të Beratit. Terreni i pjerët ka kushtëzuar ndërtimin valumor me gjysmëkat të banesës. Me interes në këtë monument janë të dy ambientet kryesor të banimit, shtëpia e zjarrit dhe oda e miqve.

Monumenti paraqiste dëmtime të rëndësishme në konstruksionin e çatisë, si dhe kishte nevojë për disa punime të vogla plotësimi në ambientin e odës së miqve. Konstruksioni i çatisë u restaurua plotësisht, duke ruajtur me kujdes tavanin dekorativ të odës së miqve. Në këtë të fundit u kryen punime të vogla

DO NOT COPY



Fig. 26. Elbasan. Banesë në lagjen «Brigada V» (Para restaurimit)



Fig. 27. Elbasan. Banesë në lagjen «Brigada V» (Pas restaurimit)

plotësimi në façaturat e drurit, u krye pastrimi i plotë i oxhakut dekorativ dhe u ribënë pjesërisht një pjesë e suvatimeve. Në shtëpinë e zjarrit u bënë punime plotësimi në musandër.

Banesa në lagjen «Karavelija» rr. «Brigada XV» Nr. 20 Elbasan (L. Lazimi)

Në numurin relativisht të vogël të banesave me çardak në qytetin e Elbasanit, bën pjesë dhe banesa në fjalë. Në gjendjen e sotme monumenti vjen i cunguar pa mundur të përcaktohet qartë zhvillimi planimetrik origjinal. Nuk përjashtohet mundësia që ndërtimi të ketë qenë shtëpi miqsh, ashtu si dhe në disa shembuj që ngjasohen në këtë qytet. Volumi i krahut të djathtë është i mëvonshëm. Volumit ekzistues të monumentit më vonë i ishte shtuar një ambient banimi në sipërfaqen e çardakut, duke mbyllur kështu dy dritare të odës së miqve, nën të në hajat ishte shtruar një ambient i dytë. Gjendja teknike e monumentit në prag të punimeve restauruese ishte jo e mirë. Struktura e çatisë, e degraduar, konstruksionet e mureve me skelet druri të prishura, elementet e drurit të degraduara. Në këto kushte u bë e nevojshme ndërhyrja restauruese në monument. Me që ambienti i sajuar në një pjesë të volumit të çardakut dëmtonte rëndë monumentin, u vendos çlirimi i tij nga ky volum, duke i rikthyer çardakut pamjen origjinale. Punime të plota restauruese u kryen në të gjitha elementet prej druri të çardakut si dhe në konstruksionin e çatisë të monumentit, natyrisht duke përfshirë dhe strehët e hapura për pjesën me çardak dhe të mbyllura për volumin e shtuar më vonë. Në odën e miqve u bë një drejtim i mureve me skelet druri, dritaret u rindërtuan, ndërsa u bë restaurimi i plotë i oxhakut dekorativ dhe tavanit të rrallë punuar me ornamente me teknikën stuk relief.

Banesë në lagjen «Palorto» rr. «Astrit Toto» Nr. 20 Gjirokastër (E. Riza)

Kjo banesë është një nga shembujt e paktë dhe shumë të rëndësishëm, që hedhin dritë mbi një monument me rëndësi në zhvillimin morfologjik të banesës gjirokastrite, pikërisht në atë të futjes së shkallëve brenda dhe krijimit të ambienteve tipike të nëndivanit divanit dhe çardakut. Banesa i përket variantit të thjeshtë me një krah, një nga më të përhapurit e banesës gjirokastrite.

Në planin kompozicional, banesa është mjaft e thjeshtë, njësia kryesore formohet në katin përdhe nga nëndivani e qilari i zahiresë dhe stera përbri, mjaft më e thelluar, me marje uji nga jashtë. Të dy katet e sipërm, mbi këta ambiente, kanë nga një dhomë në seicilin kat. Blloku tjetër afërsisht katror, në të cilin zhvillohen shkallët ka mbi nëndivanin e ngushtë një ambient të vogël, ndërsa në katin e sipërm zhvillohej çardaku.

Monumenti paraqitej në gjendje jo të mirë kon-

struktive, duke bërë kështu të nevojshme ndërhyrjen restauruese. Gjatë studimit të monumentit, duke përfshirë këtu dhe sondazhet përkatëse, u arrit në përfundimin se ai kishte pësuar një serë ndryshimesh në kohë. Kështu në odën e miqve është prishur kompleksi musandër-dhipato, tavani dhe oxhaku dekorativ, konstruksioni i çatisë mbi këtë ambient është rindërtuar, ndërsa strehët origjinale janë shkurtuar. Disa gjurmë të shtyjnë të mendosh se banesa përbri çardakut ka pasur dhe kamerie. Ashtu siç pritej, sondazhet gjatë punimeve të restaurimit provuan se sipërfaqja pranë odës së miqve ka qënë çardak dhe është mbyllur më vonë. Gjithashtu dhe oda në katin e ndërmjemë nuk e ruante më kompleksin musandër dhipato, si dhe dri-



Fig. 28. Banesë në fshatin Sopot të rr
thit të Dibrës (Para restaurimit).



Fig. 29. Banesë në fshatin Sopot të rrethit
të Dibrës (Pas restaurimit).

DO NOT COPY



Fig. 30. Banesë në fshatin Ostren i Vogël të rrethit të Dibrës (Pas restaurimit)



Fig. 31. Banesë në fshatin Ostren i Vogël të rrethit të Dibrës (Para restaurimit)



Fig. 32. Banesë në fshatin Sopot të rrethit të Dibrës (Para restaurimit)

taret origjinale të cilat ishin ndryshuar. E vonë është edhe porta kryesore e banesës, e cila duhet të ketë qënë në ballin kryesor që përfundonte me çardak.

Gjendja teknike e monumentit në prag të punimeve restauruese paraqitej e keqe, muri fundor i banesës, si dhe pjesërisht ai veriori ishin në prag të rënimit, pjesët prej druri si dritare, dyer, shkallë, parmakë, etj. ishin mjaft të dëmtuara. Idea restauruese mbështetej në kriterin e ruajtjes së fazave të mëvonshme të ndërtimit, kështu u ruajt çardaku i mbyllur. Elementet e humbur ose të çvendosur nuk u rindërtuan për arsye të pamjaftueshme të të dhënave, kështu porta kryesore e banesës mbeti në vendin e saj, ndërsa kamerieja nuk u rindërtua. Ky parim nuk u zbatua vetëm në odën e miqve, e cila ishte thuajse e shkatëruar dhe si e tillë paraqiste një boshllëk të pa pranushëm për monumentin. Fragmente elementesh të kompleksit musandër-dhipato, të gjetur në konstruksionin e çatisë, si dhe përpunimi i elementeve të tjerë prej druri, lejuan që të arrihej me saktësi në formulimin origjinal të brendësisë së odës së miqve, duke qënë ky formulim tipologjikisht mjaft i përcaktuar. Rindërtimi i brendësisë së këtij ambienti i kthen monumentit vlera të rëndësishme. Lidhur me elementet arkitektonike të degraduar ose pjesërisht të humbur u ndoq rruga e plotësimit të tyre, apo e rindërtimit sipas modeleve origjinale. Konstruksioni i çatisë u rindërtua, duke arritur në skemën e njohur karakteristike e strehëve të banesës gjirokastrite. Dritaret e odës në katin e ndërmjemë u kthyen në formën origjinale. Në gjendjen pas restaurimit ky monument është një dëshmi e rëndësishme e banesës gjirokastrite veçanërisht në planin tipologjik.



Fig. 33. Banesë në fshatin Sopot të rrethit të Dibrës (Pas restaurimit)

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 34. Banesë në fshatin Helshan të rrethit të Kuksit (Para restaurimit)



Fig. 35. Banesë në fshatin Helshan të rrethit të Kuksit (Pas restaurimit)

Banesa në rrugën «Barikada» Nr. 24 në qytetin e Elbasanit (L. Suli)

Banesa në fjalë përfaqëson një shembull të variantit të kombinuar me hajat dhe me çardak, me diferencë një kati të përhapur në Shqipërinë e Mesme. Banesa është e ndërtuar pjesërisht me mur çerpiçi dhe pjesërisht me mur guri të qarkuar me breza druri. Kati përdhes përmban hajatin, «shtëpinë e zjarrit», qurin në brendësi të banesës, një tjetër të ndërtuar në pjesën e prapme, jashtë volumit të ndërtimit dhe dy ambiente të tjera banimi në pjesën dy katëshe. Kati i parë i banesës përbëhet nga çardaku dhe oda e miqve dhe prej një ambienti të ndërtuar në pjesën ballore të çardakut. Gjatë kohës banesa ka pësuar disa ndryshime, gjithashtu shumë elementë konstruktivë dhe arkitektonikë rrezikoheshin të degradoheshin, prandaj u bë i nevojshëm të bëhej studimi për restaurimin e saj. Gjatë restaurimit u kryen në përgjithësi këto punime: U rindërtuan strukturat e mureve, të cilët ishin degraduar plotësisht dhe u konsoliduan ato që ishin në gjendje më të mirë teknike, gjithmonë duke respektuar teknikën egzistuese. Quri në pjesën e prapme, nuk u rindërtua sepse gjurmët ishin të pa mjaftueshme për këtë qëllim, por u konsoliduan muret perimetral të tij. Ndërhyrje pati sidomos në elementet që përbënin «shtëpinë e zjarrit», e cila është një nga ambientet më interesante të banesës. Në këtë ambient u restaurua musandra prej druri, duke ruajtur në maksimum elementet origjinalë të saj, po në katin përdhes u hoq ambienti shtesë i bërë kohët e fundit, duke nxjerrë në pah akoma më tepër hajatin. U zëvendësuan pjesërisht kollonat prej druri të hajatit u prek në përgjithësi çatija duke ruajtur formën dhe mënyrën e trajtimit të elementeve të saj përbërës, u restauruan shkallët prej druri të cilat të çojnë në çardakun e katit të parë, u zëvendësua konstruksioni i dyshemeve prej druri. Punime restaurimi të plota apo të pjesshme u kryen në dritaret, dollapet e murit, flegrat e dyerve, parmakët e çardakut, gjithashtu u bë suvatimi i brendshëm e i jashtëm, u rindërtuan muret rrethues dhe dera e oborrit. Ndërhyrjet restauruese përveç sigurimit të gjendjes teknike të strukturave të monumentit të përmëndur më sipër vunë më në pah vlerën arkitektonike të tij.

PUNIMET E RESTAURIMIT NË BANESËN FSHATARE

Banesa Nr. 1 në fshatin Sopot Rr. i Dibrës (L. Suli)

Banesa paraqet një nga shembujt më interesantë të banesës me qoshk në Shqipërinë e Veriut. Ndërtimi është tre katësh muratura e të cilit është

DO NOT COPY



Fig. 36. Banesë në fshatin Kostur të rrethit të Kuksit (Pas restaurimit)



Fig. 37. Banesë në fshatin Kostur të rrethit të Kuksit (Para restaurimit)

kryesisht prej qerpiçi dhe pjesërisht prej guri. Banesa kurorëzohet nga çatija katërujshe e mbuluar me tjegulla. Të tre katet përmbajnë nga një ambient të vetëm të vendosur njëri mbi tjetrin. Kati përdhes përmban «ahurin» për strehimin e bagëtive, kati i parë odën e zjarrit mbi të cilën është vendosur oda e miqve me shanishanin (qoshk i vogël) dhe qoshkun. Në prag të punimeve restauruese si pasojë e një tërmeti të rënë në vitin 1967 gjendja teknike e elementeve të ndryshëm të banesës ishte e tillë që kërkonte ndërhyrje të menjëhershme. Fillimisht u rindërtuan pjesët e dëmtuara të muraturës, sidomos në katin përdhes, u rindërtuan shkallët e jashtme prej druri, u zevendësuan një pjesë e dyerve, dollapeve, dritareve duke u mbështetur në elementet origjinale. Ndërhyrje pati dhe në konstruksionin e dyshemesë, u rindërtua plotësisht shanishani në odën e miqve i cili është një nga elementet më të dëmtuar të banesës, u restaurua sqolli, ambienti sanitar i ndodhur jashtë odës së miqve, ndërhyrje pati dhe në veshjen me drasa të qoshkut. U zevendësuan pjesët e dëmtuara të konstruksionit të çatisë duke ruajtur konfiguracionin fillestar, U rindërtuan një pjesë e mureve rrethuese dhe u bë mbulimi i tyre sipas teknikës egzistuese. Me mbarimin e punimeve restauruese të kryera në këtë monument përveç përmirësimit të gjendjes teknike u rrit në një masë të konsiderueshme vlera arkitektonike e tij.

Banesa Nr. 2 në fshatin Sopot (L. Suli)

Banesa e ndërtuar në fillim të shek. XX është dy katëshe me muratura prej qerpiçi dhe pjesërisht prej guri e qarkuar me breza druri. Kati përdhes përbëhet nga dy ambiente për strehimin e bagëtive, kati i parë përmban odën e zjarrit e të miqve, të cilat paraprihen nga divanhanja, në pjesën veriore të së cilës është ndërtuar qoshku. Gjatë kohës ka pasur disa ndryshime siç janë: ndërtimi i dy çatmave në divanhane të cilat e kanë tjetërsuar zhvillimin planimetrik fillestar të saj. Gjatë kohës kjo banesë ka humbur hamanin në qoshen jugore të divanhanes. Përveç këtyre ndryshimeve shumë elemente të banesës nuk ishin në gjendje të mirë teknike, rrjedhimisht u ndërmorën punime restauruese të cilat konsistuan: në çlirimin e ambienteve nga shtesat e mëvonshme siç ishin heqja e çatmave në divanhane, ulja e dyshemesë së qoshkut, u rindërtua banja, u zevendësuan elementet e dëmtuar të dyshemesë, të murit kufizues perëndimor të divanhanes. U restaurua vatra dhe koshi i saj në odën e zjarrit, u zevendësuan elementet e degraduar prej druri të dyerve të dollapeve dhe dritareve dhe u suvatua në përgjithësi kati i banuar. Konstruksioni i çatisë u

DO NOT COPY



Fig. 38. Pamje e pjesshme e zonës muze të shtëpisë së Partisë (gjatë punimeve të restaurimit)



Fig. 39. Mësonjëtorja e parë shqipe e Korçës (Pas restaurimit)



Fig. 40. Vlorë. Shtëpia ku u formua Komiteti Qarkor i Partisë (Pas restaurimit).

prek në një masë të konsiderueshme. Gjithashtu u rindërtua muri rrethues dhe dera dy flegërshe e oborrit. Ashtu si dhe në rastin e parë dhe në këtë banesë punimet restauruese nxorën në pah më tepër vlerat e këtij monumenti. Mbas restaurimit banesa u kthye në muze historik për fshatin.

Banesa Nr. 3 në fshatin Ostren i Vogël rrethi i Dibrës (L. Suli)

Banesa është një ndërtim dy katësh prej guri i cili kurorëzohet nga çatia, katër ujshe e mbuluar me tjegulla. Kati përdhes që shërben për strehimin e bagëtive është i përbërë nga katër ambiente. Kati i banuar përbëhet nga oda e miqve, oda e zjarrit të cilat paraprihen nga divanhanja në sipërfaqen e së cilës dy pjesët fundore të saj shohin të ndërtuar dy qoshqet të cilat janë kufizuar me mure të hollë duke u kthyer në dy ambiente banimi. Banesa në të gjithë gjatësinë e tre pamjeve duke përjashtuar këtu pamjen kryesore qarkohet me teliz.

Gjatë kohës banesa ka pasur disa ndryshime të cilat siç thamë më sipër kanë tjetërsuar anën funksionale dhe kanë dëmtuar vlerën arkitektonike të pamjeve të banesës. Gjithashtu mjaft elemente konstruktive dhe arkitektonik në prag të punimeve restauruese ishin në gjendje degradimi sidomos pjesa e elementeve prej druri. Gjatë ndërhyrjes restauruese u prekën këta elemente: së pari u hoqën dy pjesët e shkallëve prej guri të ndërtuara më vonë dhe u zgjatën 2 rampat e shkallëve prej druri, u rindërtuan një pjesë e konsiderueshme e muraturës prej guri smërçi të pamjes kryesore, u zvogëluan dritaret e zmadhuara gjatë kohës në disa ambiente, u suvatuan në përgjithësi ambientet e katit të banuar, u zevendësuan thuajse i tërë skeleti prej druri dhe veshja me dërasa e telizit dhe u krye restaurimi i çatisë dhe i strehës. Duke qënë se në këtë banesë u kryen punime restauruese në masë të konsiderueshme, mbas restaurimit ajo rifitoj dhe një herë vlerat e humbura gjatë kohës duke u bërë një shembull me vlerë në gjininë e saj.

Banesa Nr. 4 në fshatin Babinë, rrethi i Tropojës (L. Suli)

Banesa paraqet një nga shembujt e banesës të fortifikuar në Malësinë e Gjakovës.

Banesa është një ndërtim trekatësh prej guri. Kati përdhes përmban «ahurin» për strehimin e bagëtive. Kati i parë odën e grave e cila paraprihet nga një koridor i gjerë, kati i dytë, përmban odën e miqve i cili është ambienti më interesant i gjithë banesës. Oda

e miqve paraprihet nga «divanhanja» e cila ze një sipërfaqe relativisht të madhe. Në divanhane në faqen jugore dhe perëndimore është ndërtuar «dyshekllëku» prej guri i paisur me dritare të shumta. Në prag të punimeve restauruese banesa ishte në një gjendje jo të mirë teknike, gjendje kjo që kërkoj ndërhyrje të menjëherëshme në monument. Kryesisht u kryen këto punime: U rindërtuan plotësisht dy faqet e muraturës të gurit të dyshekllëkut, u zevendësuan elementet e dëmtuar të konstruksionit të dyshemesë, çatisë, dyerve, dritareve dhe u bë suvatimi i brendëshëm i dy kateve të banuar dhe u çliruan frengjitë e zëna duke evidentuar kështu akoma më tepër karakterin mbrojtës të banesës. Gjithashtu u restaurua oxhaku i kafes i vendosur në divanhane si dhe u krye injektimi dhe fugatimi i faqeve të jashtëme të mureve të banesës. Punimet e restaurimit dhanë rezultate të kënaqëshme përsa i përket sigurimit të gjendjes teknike të elementeve konstruktivë dhe arkitektonikë veçanërisht të dyshekllëkut prej guri i cili është një nga elementet më të rëndësishëm dhe më i dëmtuari.

Banesa Nr. 5 në fshatin Helshan rrethi i Kukësit (L. Suli)

Banesa ndodhet në kufi me fshatrat që i përkasin malësisë së Gjakovës, por siç do ta shohim më poshtë ajo ashtu si dhe banesa e mësipërme përfaqëson banesën e fortifikuar të kësaj krahine. Banesa është një ndërtim dy katësh me dyshekllëk prej guri kati i parë përmban ahurin për strehimin e bagëtive, ndërsa kati i dytë shërben për banim. Ky kat përmban odën e miqve e cila paraprihet nga divanhanja e cila ashtu si oda e miqve është e mbuluar me tavan prej dërrase. Në divanhane është i ndërtuar dhe oxhaku i zakonshëm. Nga divanhanja kalohet në një koridor të ngushtë i cili të shpie në ambientin sanitar. Komunikimi ndërmjet kateve realizohet nëpërmjet shkallëve të jashtëme prej druri.

Në banesë u kryen këto punime restauruese. U zevendësuan shkallët e jashtme prej druri duke ruajtur në maksimum elementet origjinale që ishin më pak të dëmtuar. U konsoliduan pjesët e muraturës të dëmtuar, u restaurua oxhaku i kafesë i divanhanes, tavani prej drase i saj dhe i odës së miqve, duke respektuar me rigorozitet teknikën e vjetër, u zevendësuan flegrat, kapakët e dollapeve të murit të dëmtuar, u bë suvatimi i brendëshëm i katit të banuar, u zevendësuan gjihashtu elementet e dëmtuar të konstruksionit të drurit të dyshemesë, të çatisë të cilës ju restaurua dhe korniza.

Banesa Nr. 6 në fshatin Kostur rrethi i Kukësit (L. Suli)

Banesa është një ndërtim dy katësh pjesërisht prej guri dhe druri, e mbuluar me një çati me strehë të gjerë. Rëndësi ka fakti që dyshekllëku që kufizon divanhanen në dy drejtime në këtë banesë është prej druri gjë që e shohim dhe në banesat e tjera të krahinës së Hasit ku ruhet një numër relativisht i madh. Dhe në këtë banesë kati përdhes përbëhet nga ahuri i cili si gjithnjë ka shërbyer për strehimin e bagëtisë. Kati parë, divanhanja përpara saj dhe koridori që të çon në ambientin sanitar i dalur ky jashtë volumit të ndërtimit. Gjendja teknike e banesës në preg të punimeve restauruese kërkonte ndërhyrje të menjëherëshme. Këto punime konsistuan në zevendësimin e elementeve që ishin në gjendje degradimi siç ishin elementet përbërës prej druri të rrampës së shkallëve të jashtëme që ndërlidhen me katin e banuar, zevendësimi i elementeve të dëmtuar të dyshemesë, tavanit të odës së miqve, dyshekllëkut prej druri, suvatimi i brendëshëm i odës së miqve. Rindërtimi i skeletit prej druri i ambientit sanitar dhe sqollit që ndodhesh në divanhane, gjithashtu u ndërmorën punime në konstruksionin e çatisë dhe të tymareve.

Ashtu si dhe në banesat e tjera dhe në këtë banesë elementet e drurit u trajtuan me kujdes të veçantë duke i zevendësuar elementet me të njejtin material si egzistuesi (dru lisi) dhe duke i latuar pjesët e dukëshme me sqepar, teknikë punimi kjo që i karakterizon në përgjithësi elementet e drurit të banesave fshatare. Restaurimi i këtij monumenti me vlera të veçanta në gjininë etj. bëri që monumenti të rifitonte përsëri vlerat e tij fillestare.

PUNIMET RESTAURUESE NË MONUMENTET HISTORIKË

Zona muze e Partisë (R. Ballauri)

Në vitin 1976 filloi puna për restaurimin e pesë banesave përreth shtëpisë së Partisë, në mënyrë që ato të përbëjnë një kompleks urbanistik, ku të dalë ideja që Partia Komuniste Shqiptare u formua në gjirin e popullit. Të gjitha këto ndërtesa janë të viteve 20-30 të shekullit tonë, njëkatëshe dhe përdhese. Vija arkitektonike është e thjeshtë dhe pa asnjë ornamentikë. Oborri i shtruar me gurë së bashku me një verandë të hapur përpara çdo banese, shërben edhe si holl për to. Puna për ti restauruar këto banesa do të vazhdojë edhe në vitet e ardhëshme.

DO NOT COPY

Mësonjëtorja e parë shqipe në Korçë. (R. Ballauri)

Punimet u ndërmorën në kuadrin e vitit jubilar (1977) për shkollën e parë shqipe të Korçës. Për këtë qëllim u pa e nevojëshme që në godinë të ndërmereshin një numër ndërhyrjesh restauruese të nevojëshme, si në ambientet e brendshme ku duheshin zëvendësuar disa struktura druri, ashtu edhe në oborrin jashtë dhe në ballët e ndërtesës. Me rastin e 70 vjetorit të shkollës së parë shqipe, më 7 mars 1977, në të u rihap Muzeu i Arsimit i riorganizuar.

Shtëpia ku u formua Komiteti Qarkor i Partisë në Vlorë (R. Ballauri)

Monumenti ndodhet në lagjen Partizani të Vlorës, në një banesë dykatëshe. Në të në dhjetor të vitit 1941 u krijua Komiteti qarkor i Partisë për Vlorën. Me rastin e 35 vjetorit të kësaj ngjarje u ndërmorën punime restaurimi në këtë banesë, që përveç rëndësisë historike, paraqit edhe interes arkitektonik në drejtim të zgjidhjes funksionale të banesës, mënyrës së ndërtimit dhe ornamentikës në dru, gur dhe hekur me të cilat pasurohen ambientet jetësore të saj. Pasi u restaurua, kjo shtëpi e fundit të shekullit të kaluar u kthye në një muze që përjetëson ngjarjen.

DO NOT COPY

CHRONIQUE DES TRAVAUX DE RESTAURATION
(1976-1977)

DO NOT COPY

La ville illyrienne à Zgërdhesh (district de Kruje) — Ll. Papajani

En 1976 les travaux furent concentrés dans le mur de l'acropole, en particulier dans la porte reliant la partie basse à la partie haute de la ville. C'est ainsi que fut édifiée une face de la courtine et que furent déterminées les directions des murs du couloir de la porte. Par ailleurs, il a été procédé à l'anastilose des blocs écroulés de la porte septentrionale de la ville. Dans le même temps furent effectués des travaux de déblaiement et de nettoyage.

En 1977, le volume des travaux effectués était de baucoup supérieur à celui des années précédentes. En fait, on a effectué la restauration de la tour ronde de l'acropole à son entrée, du mur séparant la tour ronde, de l'entrée et d'un mur de terrassement situé dans la partie méridionale de la ville.

La ville illyrienne à Klos (district de Fier) — Ll. Papajani

En 1976, dans la ville illyrienne à Klos de Mallakaster, des travaux ont été entamés dans une partie du mur d'enceinte situé sur le côté oriental de la ville. Un des blocs de ses fondations étant endommagé, la partie supérieure de ce mur penchait vers l'extérieur et risquait de s'écrouler. Pour éviter cela, on enleva une après l'autre les blocs de la partie supérieure, on procéda au bétonnage du bloc endommagé et furent remis à leur place les blocs enlevés. D'autres travaux concernèrent la partie N.-O. de la ville, depuis la petite porte et la courtine jusqu'à la tour orientale. A la suite des travaux de netttoyage effectués à ce point, on s'aperçut que le couloir de la porte avait un escalier de pierre.

Dans le courant de cette même année furent effectués d'autres travaux, et cela pour la consolidation des murs d'une habitation située dans la partie méridionale de la ville et mise au jour par suite des fouilles archéologiques à ce point. Les murs de cette maison étant endommagés et afin d'éviter leur dégradation ultérieure, ou procéda à la reconstruction des parties détériorées, en disposant au-dessus de celles-ci une rangée de pierres liées avec du mortier de chaux, au lieu du mortier de terre argileuse, de manière à créer une couche de protection.

Bylis-Hekal (district de Fieri) — Ll. Papajani.

Dans l'ancienne ville de Bylis, les travaux de restauration furent concentrés dans la grande porte située sur le côté est de la ville, où, dans les années précédentes, les travaux de nettoyage avaient mis au jour une partie de cette cité. En 1976, les travaux concernèrent tout d'abord la partie frontale et latérale des murs limitant son couloir du côté est. Ainsi, il a été possible de déterminer la direction initiale de ces murs et de remettre à sa place chacun de leurs blocs de pierre. Les travaux concernant la restauration de cette porte et de ses murs d'enceinte se poursuivront dans les années a venir.

La fontaine d'Apollonie (G. Pani).

Cette fontaine est un complexe architectonique de grand intérêt et constitue un exemplaire particulier de solution fonctionnelle apportée à l'approvisionnement en eau. Les travaux relatifs à la découverte et à la restauration de ce monument furent entamés en 1963 et se sont poursuivis systématiquement pendant 5 ans, en le mettant au jour presque complètement. Les travaux de restauration effectués dans la façade du corps central, doté d'une colonnade de style dorique et reposant sur le stylobate, ont redonné à ce monument sa partie originale.

Ce monument, qui s'était écroulé par suite d'un tremblement de terre qui en avait endommagé le corps central, a provoqué aussi le tassement et l'éboulement de la colline à laquelle s'appuyait la fontaine. Cet éboulement du terrain a provoqué non seulement l'affaissement du bassin mais aussi un déplacement horizontal de l'auge principale servant à recueillir les eaux. Le mur auquel s'appuyait l'auge, traitée à contreforts et ayant une hauteur de 3 m et une longueur de plus de 20 m, avait subi un déplacement de 0.50 m de la ligne horizontale. Ce mouvement, à la suite de quoi nombre de pierres furent cassées, risquait de provoquer l'écroulement de tout le mur et l'éboulement de la masse de terre se trouvant derrière celui-ci. C'est pourquoi, la décision fut prise d'intervenir immédiatement dans ce secteur. Les travaux de restaurations visaient en premier lieu à la recomposition du monument sur le plan architectonique et à la prohibition de continuer les travaux de construction en cours. C'est à cette fin que furent entreprises des études minutieuses sur l'état du monument, tout en préparant une documentation complète, graphique et photographique de ses éléments. Puis sur la base des données recueillies fut dressé le projet de restauration et l'on passa à son exécution, ce qui conduisit à la consolidation de la fontaine.

Au cours des travaux de restauration, tout le mur fut désas-

semblé depuis ses fondations et plus de 450 blocs de pierre furent remis en place. Les fondations furent renforcées avec des matériaux de nos jours (buto-béton), et cela dans le but de consolider les éléments originaux du mur qui en constitue la masse principale. Grâce à ces travaux, il a été possible de recueillir un matériel important relatif à la technique de construction et aux solutions architectoniques et fonctionnelles.

La tombe monumentale à Suç de Burrel (A. Baçe)

Cette tombe monumentale, du type à voûte en forme de puits, se trouvait parmi les ruines d'une église des IVe-VIe siècles. Par suite du déblaiement de la terre entassée sur les faces latérales de la voûte, celle-ci, n'étant plus en mesure de supporter la poussée de la terre, s'était écroulée dans un bon tiers. Les travaux de restauration ont consisté dans le remaniement de la voûte au moyen de coffrages intérieurs en charpente, dans le remplissage latéral pour équilibrer la poussée de la voûte et dans la consolidation des structures écroulées des murs.

La citadelle de Berat (A. Baçe, G. Samimi)

En 1977 les travaux qui se poursuivaient depuis des années à la citadelle de Berat, furent concentrés dans la forteresse elle-même, dans son deuxième mur d'enceinte. C'est ainsi que furent déblayés à l'intérieur les côtés occidental et septentrional de la forteresse et consolidées les structures des murs dégradées. Ces travaux visaient à rendre la forteresse accessible au grand public, ce qui était empêche par le niveau élevé de la terre et des ruines en cette partie de notre objet, et de procéder à la consolidation des structures des murs, tant de celles se trouvant au-dessus du niveau des remplissages que des structures qui furent mises au jour par suite du nettoyage. Pour l'éloignement de la terre, on s'est servi de wagonnets de decauville. Les travaux de nettoyage furent réalisés en s'en tenant au niveau de la partie médiane de la forteresse. Ce niveau coïncide avec les fondations de la forteresse au XIXe siècle, après quoi celle-ci est abandonnée et tombé en ruine. Les constructions de cette période, conservées dans un état relativement satisfaisant, appartiennent à la période de l'occupation ottomane et à celle de la domination d'Ali Pasha Tepelena; elles sont intéressantes sur le plan de leur traitement architectonique.

Au cours de ces travaux furent mises au jour plusieurs parties couvertes de voûtes à côté du mur de la forteresse et quelques pièces d'habitations à un étage. Les parties couvertes d'une voûte se trouvaient dans un état de dégradation avancée, leurs voûtes n'étant pas à leur place et souvent écroulées. Ces pièces comportaient des murs surmontés de voûtes à un niveau 1-1.20 m environ. Les murs ne furent restaurés qu'en longueur, les voûtes ne furent élevées dans toute leur hauteur que dans leur partie initiale, en diminuant de la sorte graduellement leur hauteur originale. Ils furent remplis dans leur partie supérieure avec de la terre, en créant de la sorte un sentier de passage.

Outre les pièces susmentionnées, on a procédé à la restauration des arcs et des fenêtres de l'habitation. La partie de l'ar qui manquait fut refaite avec des pierres et l'on consolida se culées.

La forteresse de Gjirokastra (A. Baçe)

En 1977 furent entamés des travaux de nettoyage dans le territoire de la forteresse et des travaux de consolidation au milieu de son côté méridional. C'est ici qu'un tronçon de maçonnerie long de 7 m et haut d'environ 2.5 m risquait de s'écrouler Ce tronçon comportait deux faces, dont celle extérieur s'était effondrée. En vue de sa consolidation, la face extérieure de ce tronçon fut complétée jusqu'au niveau de la face intérieure, et cela en reconstruisant le mur avec les pierres écroulées des autres murs de la forteresse et liées avec du mortier maigre.

En 1976, par contre, les travaux furent concentrés principalement dans la partie occidentale de la forteresse, et précisément dans ses murs d'enceinte. Des interventions de dépistage architectonique et de consolidation furent effectuées dans le mur extérieur et intérieur de la cour fortifiée de la forteresse. Elles ont consisté dans la mise en relief de cette importante enceinte relative à l'origine de la forteresse, ce qui a créé les conditions requises à la réalisation d'autres interventions de restauration. Dans le cours de cette même année fut entamé le dépistage urbanistique de la zone située derrière le couvent bektashi de Dollme. On commença par déblayer la terre et les déchets, et cela afin d'éclaircir la planimétrie d'une habitation écroulée relevant de la première moitié du XVIIIe siècle et de rendre plus accessible au grand public cette partie de la forteresse. Partant de la découverte d'un fragment de l'ancien mur d'enceinte, on a fini par découvrir une chapelle byzantine où l'on relève clairement deux phases de construction. Au cours de ces travaux, à côté de cette chapelle fut mis au jour un escalier à travers lequel on accédait aux murs d'enceinte. Dans le même temps furent entamés des travaux concernant leur conservation.

Le couvent bektashi de Dollme, Kruje (S. Dashi, Gj. Frashëri)

C'est en 1977 que fut entamée la restauration du couvent bektashi de Dollme. Ces travaux ont consisté dans la restauration des corniches ornementales de la couverture de la maçonnerie en pierre de la face occidentale, dans le déblaiement des trois fenêtres orientales et dans le complètement de toutes les autres, dans la restauration de toute la couverture de ce monument, etc.

Des interventions de consolidation furent effectuées afin d'éliminer les fissures existantes dans la coupole, dans la trompe septentrionale, dans le mur oriental, et de placer autour du tambour une bande non visible de ciment armé.

Dans la zone située en face du couvent bektashi de Dollme, il fut procédé à la libération du turbeh, du mur d'enceinte

DO NOT COPY

de la tour et de ses escaliers, du mur se prolongeant en direction nord et à la mise au jour de l'ancien puits de la forteresse. Une place importante revient aussi aux travaux effectués pour la conservation de ces éléments.

La forteresse au canal de Vivar, Butrint (Gj. Karaiskaj)

En 1976 fut achevée la première phase des travaux de restauration dans la forteresse de Vivar, travaux qui avaient commencé en 1974, mais en respectant toujours les différentes périodes de sa construction et en conservant minutieusement et en mettant mieux en relief les traces attestant l'existence de ces phases. Un soin particulier fut consacré à la mise en valeur et à la restauration de la première phase de construction. A cette fin furent restaurées toutes les meurtrières amménagées dans le parapet ainsi que le parapet lui-même jusqu'au niveau de conservation de traces certaines. De même fut restauré l'escalier menant au sentier de la garde, escalier appartenant à cette même période. Des deux tours appartenant à la troisième phase de construction, il fut procédé à la restauration de la porte d'une d'entre elles, de la tour III, ainsi qu'à la consolidation des murs de deux tours et à la restauration de leurs meurtrières. D'autres travaux de restauration furent effectués dans les pièces intérieures couvertes de voûtes de pierre cylindriques, Ils ont consisté dans le complètement de leurs cloisons intérieures, qui servaient aussi à la consolidation de leurs voûtes, dans la restauration du mur terminal longeant le côté oriental des pièces et dans la réparation des entrées et de leurs murs à l'intérieur de la fortification. En ce qui concerne la construction à planimétrie circulaire surmontée d'une coupole, on procéda à la construction de sa couverture en tuiles.

La forteresse de Mahalla (Gj. Karaiskaj)

Située à proximité du village de Grave, district de Saranda, c'est une construction du XVIIIe siècle. De petites dimensions, cette forteresse en forme de trapèze est flanquée de quatre tours quadrangulaires. En raison de la mauvaise qualité du liant, deux des tours conservées à une plus haute altitude risquaient de s'écrouler complètement; en plus, il ne restait des murs des étages supérieurs de ces tours, que le revêtement extérieur et quelques éléments des fenêtres et des meurtrières, d'où la nécessité d'intervenir à temps. Les voûtes de l'escalier menant aux étages supérieurs des tours, elles, aussi, risquaient de s'écrouler. Les deux autres tours n'étaient depuis longtemps qu'un amas de ruines et présentent, à l'heure actuelle, une stabilité relativement satisfaisante.

Afin d'éviter la dégradation plus poussée de cette forteresse, il fut décidé de conserver aussi les murs des étages supérieurs des deux premières tours, de fixer les éléments existants des fenêtres et des meurtrières, de restaurer, par ailleurs, les quatre escaliers conduisant aux étages supérieurs des tours. Grâce aux travaux de restauration et de conservation effectués en 1977, le péril d'une dégradation ultérieure de cette forteresse fut évité.

La forteresse de Shkodër (Gj. Karaiskaj)

Les travaux de conservation, entamés en 1977 dans la forteresse de Shkodër, visaient à assurer la continuité dans l'entretien de ses murs d'enceinte et de ses tours et à mettre en relief certains parties couvertes de décombres dans la troisième cour de la forteresse. C'est à cette fin qu'il fut procédé au nettoyage et à la consolidation des murs et de certaines meurtrières.

L'église de Rubik (A. Baçe)

Les travaux entamés dans l'église de Rubik tendaient principalement à l'isolement de l'abside, où il y avait une peinture murale de grand intérêt, afin d'éviter les effets négatifs des précipitations atmosphériques et de l'humidité.

Sa première période de construction date le XIIe siècle, et ce monument appartient au type des églises romanes de l'école de Rasho. Il n'en reste actuellement que la partie terminale de sa nef centrale avec une abside semicirculaire. La peinture murale, qui appartient à une époque plus récente. le siècle, XIII, couvre l'abside et les parements du presbytère. Cette partie de notre monument étant insuffisamment couverte, l'humidité y pénétrait à travers les cloisons du mur non isolé et le diaconicon gouttait après chaque pluie, aussi la peinture était-elle constamment en contact avec l'humidité. Et ce contact devenait encore plus dangereux en raison du gaz sulfureux, libéré par l'usine de traitement du cuivre, se trouvant aux environs de l'église, et qui en se transformant en acide sulfurique ne faisait que détériorer la peinture dont il est question. C'est pourquoi on procéda à l'isolation complète du toit de l'humidité, au crépissage de sa partie extérieure avec du mortier isolant, à son isolation du milieu environnant par des fenêtres fixes et à la réparation générale du toit.

Pendant l'ouverture du toit de la nef de cette ancienne église, il fut relevé que la voûte de celle-ci était couverte de tuiles en conservant sa forme cylindrique. Vu que le but principal des travaux entamés visait à l'isolation du toit des précipitations et que ce mode de couverture n'avait donné de résultats en le substituant plus tard par un toit à deux pentes, on procéda à la construction d'un nouveau toit pour assurer une isolation meilleure et une couverture plus complète, en employant à cette fin du papier goudronné et en allongeant de 0.70 m les extrémités de ses auvents. Quant à la partie extérieure du presbytère, elle fut isolée avec du mortier maigre préparé avec de la poudre de pierre. Ce mode de remplage que nous avons relevé aussi dans des fragments de crépi originaux garantit une isolation meilleure que le remplissage habituel. Le crépissage fut effectué au niveau de la première couche de crépi en ne touchant pas les parties originales. On

DOI 10.2307

DO NOT COPY

a agi de la même manière à l'égard du remplage de la fenêtre supérieure, des crochets métalliques accrochés au mur et d'une partie de la fresque. Par ailleurs, afin de distinguer la technique de construction, les parties quadratiques ne furent pas enduites de crépi. En plus, les éléments restaurés furent marquées de la date d'exécution des travaux et des initiales de notre Institut.

TRAVAUX DE RESTAURATION DANS LES MONUMENTS D'ART

Le mosaïque d'Apollonie (S. Kosta)

Les travaux furent concentrés dans une habitation à péristyle, située quelque peu à l'ouest du monastère (secteur G) (Fig. 1). Sa valeur décorative et son exécution magistrale font de ce mosaïque un des plus jolis objets de ce centre. Depuis des années il était couvert d'une végétation abondante. Il avait été endommagé par le chiendent, dont les racines développées avaient détachés par endroits les petites pierres de son assemblage. La situation se présentait plus sérieuse sur le côté méridionale du monument (Fig. 2), où dès le commencement des fouilles furent relevés des éboulements, et des manques importants dans le dernier quart du côté occidental. L'élimination de la couche couvrant la surface du mosaïque fut réalisée avec soin, en coupant les herbes et non pas en les arrachant (Fig. 3). Après les opérations de déblaiement et de nettoyage, aux endroits où les petites pierres n'étaient pas retenues à leur base, des travaux de renforcement furent entamés; dans certains cas, on effectua même des travaux de reconstruction en placant chaque petite pierre à sa place, et cela sur la base des traces existantes des motifs, décoratifs du plancher.

Le mosaïque d'Antigonée (S. Kosta)

Ce temple, qui a un plancher de mosaïque, se situe à l'extrémité méridionale des murs d'enceinte de cette ancienne ville. Il se distingue par la variété de ses motifs et en particulier par le caractère libre et audacieux de la combinaison des linges et des taches décoratives avec la composition dynamique. Les éléments figuratifs de la composition sont asymétriques du point de vue du style et des moyens d'expression.

Les travaux de conservation ont visé à la consolidation de l'assemblage et à la mise en oeuvre de certaines mesures de caractère expérimental contre les herbes, et principalement contre les chardons, en employant à cette fin des herbicides du type dalapon et spirit hormit. Par endroits furent entamés aussi des travaux de restauration de petite envergure pour éclaircir et compléter la conception originale de l'objet. En tant que mesures préliminaires, il fut décidé de séparer les trois-quarts de la couche de mosaïque de la partie effondrée en construisant à cette fin un mur de soutènement provisoire, qui sera utilisé aussi dans la phase successive des travaux de restauration. Par ailleurs, nous avons préparé une minutieuse documentation graphique, photographique et descriptive.

Le mosaïque de la basilique paléochrétienne à Tepe, Elbasan
( )

Ce mosaïque, couvrant le plancher de la basilique, se trouvait dans un état de dégradation grave, d'où la nécessité d'entreprendre des travaux de restauration. Ces travaux, concentrés dans une des quatre parties du plancher, ont consisté dans le déplacement et la remise en place du mosaïque. Les sondages effectués dans la structure du mosaïque, après l'opération d'arrachage, a fait ressortir clairement la couche de rudus nivellée avec du crépi; aussi des mesures furent-elles prises afin de ne pas l'endommager et de la conserver en tant que témoignage. Le contrôle effectué au niveau du plancher du mosaïque a montré une inclinaison sur ses deux flancs, occidental et septentrional, de près de 1%. Les murs aussi ont été l'obet de différents travaux. En ce qui concerne l'expérimentation des matériaux de construction, le crépi obtenu à la suite de l'arrachage fut réemployé après son enrichissement avec de nouveaux liants.

Le mosaïque de Sarande (S. Kosta)

Ici les travaux ont concerné son aspect initial, surtout sur son côté S.-O. où les signes de détérioration sont plus marquants. En conséquence ce mosaïque exigeait une réélaboration superficielle et, par endroits, une intervention de restauration afin d'en faire ressortir mieux les valeurs, Les travaux consistèrent dans le fait de remplacer les renforcements à base de plâtre effectués il y a quelques années avec du crépi à chaux, qui a une meilleure prise et crée les conditions requises pour une appréciation plus complète de la couleur et des dessins. Après le lavage et le séchage de toute la surface, celle-ci fut élaborée avec une solution de paraffine-benzine dans un rapport 1:10 afin de raviver la décoration. Les résultats furent particulièrement satisfaisants dans les zones où les petites pierres étaient bien retenues à la base. Le mosaïque de Sarande, le seul type de mosaïque couvert, se trouve au premier étage de l'édifice des PTT de la ville.

L'église de Shën Todër, Berat (A. Sadikai)

L'église de Shën Todër, construite au XVIe siècle, représente un des monuments le plus en vue de l'art moyennâgeux chez nous, du fait aussi que ses peintures sont de la main d'Onufri. Les travaux de conservation de la peinture furent dictés par suite des travaux effectués pour la consolidation de l'architecture de ce monument. Les travaux de conservation de la peinture visaient à sa consolidation et au fait d'éliminer la dégration plus poussée de son support portant. Ils firent mieux, ressortir la

DO NOT COPY

partie de la peinture murale située sur le côté septentrional et occidental de l'église; bien que cette peinture ne soit pas sortie de la main d'Onufri, elle est d'un grand intérêt artistique et appartient au XVIe siècle.

Les travaux concernant la peinture murale et qui firent ressortir d'autres surfaces de la fresque couvertes de chaux, ainsi que les travaux concernant l'architecture ont créé les conditions requises pour faire de ce monument un objet accessible au grand public. C'est ainsi que furent complétées nombre d'icônes d'un grand intérêt artistique et appartenant à l'ancien iconostase de cette église.

L'église de la Sainte Trinité à Berat (H. Nallbani)

Les travaux de conservation de la peinture byzantine du XIVe siècle dans l'église de la Sainte Trinité, qui se trouve dans la forteresse de Berat, se poursuivent depuis des années. Les travaux effectués dans les années 1976-77 ne firent que compléter les mesures de conservation générales prises en précédence dans le naos et le narthex, en vue d'éliminer le risque d'écroulement des fresques endommagés, et cela notamment dans les arcs et dans la coupole de l'église ainsi que dans les parties de la bande inférieure des murs.

A travers ces travaux il a été possible d'intégrer les parties manquantes de la peinture à celles conservées et de prendre d'autres mesures de restauration plus profondes.

L'église de Shën Mitri à Boboshtice, Korçe (H. Nallbani)

Les mesures prises visaient à la consolidation de la peinture couvrant la face méridionale de ce monument, qui se trouvait dans un état de dégradation avancé par suite du tassement du mur de soutènement. La consolidation de cette peinture fut réalisée à travers son imprégantio avec de la caséine et la liaison de ses portions endommagées; quant à la couche de la couleur, réduite en poudre, elle fut fixée puis nettoyée, en en faisant ressortir ainsi les valeurs artistiques.

L'église de Saint Nicolas et de la Sainte-Marie à Voskopoje (A. Sadikai)

Les travaux effectués visaient à la conservation de la peinture détériorée couvrant les murs du hayat de cette église, dont le naos est peint à fresque par maître Davit Selenicasi, ainsi qu'à l'adoption d'autres mesures de conservation tendant à éviter l'endommagement plus poussé de la peinture. Dans le même temps, des travaux de restauration plus profonds furent entamés pour enlever et remettre à sa place la peinture murale couvrant le naos dans l'église de Sainte-Marie. Quant à la peinture murale de l'église de Saint Nicolas, des surfaces entières réduites en poudre furent fixées avec une pompe par la méthode de l'imprégnation.

L'église de la Sainte-Marie à Prespe (H. Nallbani)

Les travaux effectués dans cette église, se dressant à l'île de Prespe, ont consisté dans la consolidation des surfaces détériorées de la bande des fresques à proximité des murs du naos et à environ 2 m du niveau du plancher. Les surfaces susmentionnées se trouvaient dans un état de dégradation avancée et, de ce fait, risquaient de s'effondrer. Pendant ces travaux, deux médaillons reproduisant des figures et un portrait furent détachés de la face méridionale. De même, de la face occidentale et septentrionale furent détachés et remis en place des fragments de peinture; puis on procéda à la conservation et au nettoyage de celle-ci, par l'imprégnation du crépi et le nettoyage des débris et des dépôts qui en offusquaient les valeurs originales.

Restauration d'icônes

De véritables travaux de restauration ont eu pour objet 20 icônes, dont quelques-unes gravement endommagées et présentant des problèmes complexes de restauration. Ces travaux ainsi que ceux relatifs à des iconostases, aux fragments conservés au musée de Fier, aux belles cloisons de l'iconostase de la cathédrale de la forteresse de Berat, etc., ont contribué à l'élimination des principaux facteurs de dégradation et créé, dans le même temps, les conditions requises à la réanimation des valeurs artistiques de ces objets de grand intérêt pour l'art moyenâgeux de chez nous.

RESTAURATION DES MAISONS POPULAIRES CITADINES

L'habitation du quartier 8 Nëntori, rue Petrit Lulo, N° 27 (B. Strazimiri)

Cette habitation constitue un des exemplaires plus intéressant mettant en lumière les transformations profondes qu'a subies la maison ouverte à tchardak chez nous, et cela depuis la deuxième moitié du XIXe siècle. Elle est construite selon la variante avec un tchardak en son millieu. Le terrain escarpé a conditionné sa composition à demi-étage. L'étage au rez-de-chaussée comportait deux étables, une à chacune de ses ailes et l'étage destiné à l'habitation, cinq, pièces, deux sur ses côtés et trois autres dans sa partie terminale. Par suite de la reconstruction à fond de cette maison en 1891, son schéma fonctionnel et ses différentes éléments architectoniques en ont été affectés. La modification plus importante est sans doute la fermeture du tchardak au moyen d'un cloison en charpente de bois, dans laquelle furent amménagées sept fenêtres relativement hautes. Les deux pièces disposées à chacune de ses ailes ont été séparées en deux, en improvisant de la sorte deux pièces à chacune des ailes de cette habitation au lieu des gran-

DOKTORIX

des pièces qui existaient auparavant. Au cours de cette reconstruction, les fenêtres, les portes et les autres éléments de bois, y compris la fermeture des auvents dans la partie frontale, ont été l'objet de modifications importantes.

Avant d'entreprendre les travaux de restauration, ce monument se trouvait dans un état technique peu satisfaisant; en effet la structure de son toit, ses murs en charpente de bois, ses fenêtres, ses portes et ses planchers étaient endommagés au point de rendre indispensable l'intervention des restaurateurs. L'idée de la restauration s'est guidée sur le principe de conserver le monument à sa phase de reconstruction en 1891, du fait que les modifications qui lui avaient été apportée constituaient un témoignage important de l'évolution dans le temps de la maison ouverte à tchardak, *laquelle, par suite des améliorations dont elle a été l'objet pendant la deuxième moitié du XIXe siècle, fut en mesure de satisfaire pour une certaine période de temps encore les exgiences du nouveau mode de vie.*

C'est à partir de ce principe que furent restaurés entièrement la partie frontale de l'étage destiné à l'habitation, tous les éléments de construction et architectoniques y faisant part, la structure du toit et les structures des murs de pierre; dans le même temps, d'autres travaux concernèrent les planchers, les plafonds, les crépissages dégradés, etc. Maintenant, après sa restauration, ce monument constitue un exemplaire de relief indiquant l'évolution dans le temps de l'habitation ouverte à tchardak.

L'habitation située dans le quartier «Barrikade», rue Zihni Toska, à Berat (L. Lazimi)

C'est le type de maison à tchardak *sur une de ses ailes. Au fil des années, il a subi d'importantes modifications sur le plan de sa composition. Cette maison est séparée en deux, en créant une unité à soi avec les pièces de la série terminale. A droite du* tchardak *lui fut ajoutée, plus tard, une autre pièce. Par ailleurs, la partie frontale du* tchardak *a enregistré des modifications et ses éléments originaux se trouvaient dans un état relativement dégradés.*

C'est pourquoi il fut décidé de procéder à sa restauration. Etant donné que la séparation en deux de cette maison, et cela avant sa mise sous la protection de l'Etat, avait gravement altéré ses pièces terminales, il n'existait plus aucune base pour les faire revenir à leur état initial; aussi, ces pièces ne furent pas touchées. En pratique, la restauration se limita à la partie frontale de l'habitation. Vu que la pièce ajoutée à son aile droite en altérait gravement la composition originale, il fut décidé, de procéder à son élimination. Des travaux importants furent effectués dans le tchardak, *dont la partie frontale fut restaurée entièrement sur la base des traces existantes ce qui nous a permi d'en conserver les dimensions caractéristiques. Il en fut de même en ce qui concerne la construction du toit, des planchers, des fenêtres, portes, plafonds, etc.*

L'habitation située dans le quartier «Çlirimi», rue Tafil Skendo, N° 3, à Berat (L. Lazimi)

Cette maison à tchardak *en son milieu représente un des exemplaires les plus évolués du type d'habitation ouverte dans la ville de Berat. Sa composition s'étend horizontalement, un grand* tchardak *et une vaste cour par devant sont des éléments typiques aux habitations de ce quartier, qui se distinguent nettement des constructions compactes se dressant dans les autres quartiers édifiés sur un terrain escarpé. Partant de son traitement architectonique, cette habitation semble appartenir au XVIIIe siècle.*

Ce monument avait subi dans le temps une série de transquartiers importantes tant en ce qui concerne son schéma planimétrique que le traitement de son intérieur et de ses différentes pièces. Son état technique, notamment en ce qui concerne les structures de bois, était peu satisfaisant, Les travaux de restauration ont eu principalement en vue la mise en valeur du tchardak. *Dans le volume de celui-ci on y avait ajouté une pièce, qui en affectait gravement l'aspect; aussi, on procéda à son élimination. D'importants travaux de restauration ont concerné aussi les structures du toit, les planchers, le crépissage des murs, etc.*

L'habitation dans le quartier «13 shtatori», rue Azbi Beqari, N° 47, à Berat (E. Riza)

Cette maison fait part d'un complexe relativement vaste, situé dans une des ruelles les plus caractéristiques du quartier Mangalem de la ville de Berat. Le terrain escarpé a conditionné sa construction transitoire à demi-étage. D'un intérêt particulier sont les deux pièces principales de cette maison, soit la chambre du feu et la chambre des amis.

Les détériorations plus importantes concernaient la construction du toit, puis il fallait effectuer d'autres travaux de moindre envergure pour le complètement de la chambre des amis. La construction du toit fut restaurée complètement, en conservant avec soin le plafond ornementé de la chambre des amis. D'autres travaux de moindre importance furent effectués pour le complètement des bandes de bois, pour le nettoyage de la cheminée à ornementation et le crépissage partiel des murs. Dans la maison du feu fu complété le placard.

L'habitation du quartier «Karavelija», rue Brigada XV, N° 20, à Elbasan (L. Lazimi)

Cette maison rentre dans le nombre relativement réduit d'habitations à tchardak *se trouvant à Elbasan. Vu que certaines de ses parties manquent, nous sommes dans l'impossibilité de déterminer clairement l'évolution de sa planimétrie originale. Il se peut que ce fut à l'époque une maison destinée à la réception des amis, comme cela ressort de* quelques exemplaires analogues se trouvant à Elbasan. A

DOCUMENT

son volume initial fut ajouté plus tard une pièce dans la surface du tchardak, en bouchant de la sorte deux des fenêtres de la chambre des amis; par ailleurs, juste au-dessous de cette chambre, fut construite une deuxième pièce. Le monument en question, à la veille des travaux de restauration, se trouvait dans un état peu satisfaisant. En fait la structure de son toit, les constructions de ses murs à charpente de bois et ses éléments de boit étaient détériorés. Dans ces conditions, il était indispensable d'entreprendre des travaux de restauration. Etant donné que la pièce ajoutée dans le volume du tchardak avait gravement endommagé l'aspect de notre monument, la décision fut prise de procéder à son élimination pour redonner au tchardak son aspect initial. Des travaux de restauration complète furent effectués pour la réparation de tous les éléments de bois du tchardak et de la construction du toit, y compris les auvents ouverts relatifs ou tchardak et les auvents fermés relatifs à la pièce ajoutée plus tard. En ce qui concerne la chambre des amis, ses murs à charpente de bois furent redressés et ses fenêtres reconstruites; par ailleurs, la creminé ornementale et le plafond d'une beauté rare exécuté selon la technique du stuc en relief furent restaurés entièrement.

L'habitation du quartier «Palorto», rue Astrit Toto N° 20, à Gjirokaster (E. Riza)

C'est là un exemplaire d'habitation rare et très important du fait qu'il jette une lumière nouvelle sur l'évolution morphologique de la maison gjirokastrite, et notamment sur le déplacement de l'escalier de son extérieur à son intérieur, sur la mise en place de pièces typiques comme le sous-divan, et le tchardak. Cette maison relève de la variante simple à une aile, une des plus diffusées de l'habitation gjirokastrite.

Sur le plan de la composition, cette maison est relativement simple; l'étage au rez-de-chaussée en constitue l'unité principale, il comporte la cave des provisions, et à sa proximité le local de la citerne, beaucoup plus profond, d'où l'on peut puiser l'eau de l'extérieur. Les deux étages supérieurs, au-dessus des dites pièces, ont chacun une chambre. L'autre bloce de forme presque carrée, où se développe l'escalier, dispose au-dessus du sous-divan étroit une toute petite pièce; le tchardak se trouve à l'étage supérieur.

Son état de construction étant peu satisfaisant, nous avons jugé utile d'y intervenir par des travaux de restauration. Les études menées à cette fin, y compris les sondages effectués, nous ont fait aboutir à la conclusion que ce monument avait subi plus d'une modification dans le temps. Ainsi, dans la chambre des amis n'existent plus le complexe musander-dhipato, le plafond et la cheminée ornementale; la construction du toit surmontant cette pièce est de construction récente et les auvents originaux ont été écourtés. Certaines traces nous induisent à penser que l'habitation à côté du tchardak avait dans le temps une niche. Comme nous nous attendions, les résultats des sondages ont montré qu'à côté de la chambre des amis il y avait un tchardak, qui a été fermé plus tard. De même, dans la chambre de l'étage intermédiaire n'existe plus le complexe musander-dhipato; en plus, les fenêtres ont subi des modifications. La porte principale de cette maison, elle aussi, est de construction récente; elle se trouvait probablement sur la façade principale se terminant au tchardak.

Ce monument se trouvait dans un état technique peu satisfaisant: son mur terminal et en partie son mur septentrional risquaient de s'écrouler, d'un moment à l'autre, les éléments de bois comme fenêtres, portes, escalier, rampe, etc., étaient assez endommagés. L'idée de la restauration s'est guidée sur le critère de conserver les phases de construction récentes, comme ce fut le cas du tchardak fermé. Les éléments qui manquaient ou avaient été déplacés ne furent pas reconstruits en l'absence de données suffisantes, exemple la porte principale de l'habitation qui fut maintenue à sa place; quant à la niche, elle aussi, ne fut pas reconstruite. Ce principe ne fut pas appliqué cependant dans la chambre des amis, du fait que celle-ci, étant complètement détruite, constituait une lacune inadmissible pour le monument. La découverte de certains fragments d'éléments du complexe musander-dhipato, dans la construction du toit, ainsi que l'élaboration des autres éléments de bois, nous permirent de recréer avec exactitude la formulation originale de l'intérieur de la chambre des amis, d'autant plus que nous avions affaire à une formulation typologique relativement bien déterminée. La reconstruction de l'intérieur de cette pièce a restitué à notre monument des valeurs importantes. En ce qui concerne les éléments architectoniques dégradés ou disparus en partie, on s'est guidé sur le critère de leur complètement ou de leur reconstruction selon les modèles originaux. La structure du toit fut reconstruite, en lui restituant de la sorte le schéma caractéristique des habitations gjirokastrites à auvent. Les fenêtres de la chambre située à l'étage intermédiaire reprirent laur forme originale. Maintenant, après sa restauration, ce monument constitue une tentative sérieuse de reproduction de la maison gjirokastrite particulièrement du point de vue typologique.

L'habitation de la rue Barrikade, N° 24, dans la ville d'Elbasan (L. Suli)

Cette habitation constitue un exemplaire de la variante combinée à hayat et à tchardak, qui connait une diffusion large dans l'Albanie centrale, à la seule différence qu'elle comporte un étage de moins. Les constructions de ses murs sont à la fois de pisé et de pierres traversés par des bandes de bois. L'étage au rez-de-chaussée comporte le hayat, «la chambre du feu», un qur à l'intérieur de la maison et un autre dans sa partie postérieure, en dehors de son volume, et puis deux autres pièces dans la partie à deux étages. Le premier étage comporte le tchardak et la chambre des amis, ainsi qu'une autre pièce construite dans la partie frontale du

tchardak. *Au fil des années cette maison a subi des modifications, en plus nombre de ses éléments de construction et architectoniques risquaient de se dégrader, ce qui nous induisit à entreprendre des études pour sa restauration. En général, les travaux de restauration ont consisté dans la reconstruction des structures des murs entièrement dégradés et dans la consolidation de ceux dans un état meilleur sur le plan technique, mais en respectant toujours la technique existante. En ce qui concerne le qur situé dans la partie postérieure de l'habitation, il ne fut pas reconstruit du fait que les traces existantes étaient insuffisantes à cette fin; aussi, on ne fit que consolider les murs de son pourtour. L'attention des resturateurs s'est concentrée principalement sur les éléments de bois constituant la «chambre des amis», qui est une des pièces plus intéressantes de cette maison. C'est ainsi que fut restauré le placard de bois, en conservant au maximum ses éléments originaux, mais à l'étage au rez-de-chaussée la pièce qui y avait été ajoutée ces derniers temps fut éliminée, en mettant ainsi mieux en relief le hayat. On procéda à la substitution partielle des colonnes de bois du* hayat; *d'autres travaux concernèrent le toit, en conservant toutefois la forme et le mode de traitement de ses éléments constitutifs; l'escalier de bois menant au* tchardak *du premier étage fut restauré et la construction des planchers de bois fut substituée. Les fenêtres, les armoires pratiquées dans les murs, les battants des portes, les rampes du* tchardak *furent restaurés complètement ou en partie; de même, on effectua le crépissage intérieur et extérieur de l'habitation, on reconstruisit les murs d'enceinte et la porte de la cour. L'exécution de ces travaux ont assuré non seulement une situation technique plus solide à ce monument, mais en ont fait aussi ressortir la valeur architectonique.*

TRAVAUX DE RESTAURATION DANS L'HABITATION PAYSANNE

L'habitation N° 1, dans le village de Sopot, district de Diber (L. Suli)

C'est là un des exemplaires plus intéressants de l'habitation à qoshk *dans l'Albanie du Nord. Nous avons affaire à une maisson à trois étages, dont la maçonnerie est principalement de pisé et en partie de pierres. Son faîte est couronné d'un toit à quatre pentes couvert de tuiles. Chacun de ses trois étages ne comporte qu'une pièce disposée l'une sur l'autre. C'est à l'étage au rez-de-chaussée que se trouve le* ahur, *qui sert d'abri aux animaux; au premier étage il y a la chambre du feu, au-dessus duquel se trouve la chambre des amis dotée du* shanishan *(le petit* qoshk*) et du* qoshk.

Par suite du tremblement de terre de 1967, la situation technique des différents éléments de cette habitation était telle qu'elle exigeait une intervention immédiate. Les travaux de restauration consistèrent tout d'abord dans la reconstruction des parties endommagées de la maçonnerie, et cela surtout à l'étage au rez-de-chaussée, puis de l'escalier de bois extérieur. Par ailleurs, des fenêtres, des placards, des portes furent substitués, en en conservant cependant les éléments originaux. Il en fut de même de la construction du plancher. Le shanishan *de la chambre des amis, un des éléments le plus endommagé de l'habitation, fut reconstruit entièrement. Par ailleurs, on procéda à la restauration de l'évier, du cabinet de toilette situé hors de la chambre des amis, et le* qoshk *fut revêtu en partie de planches de bois. Les éléments détériorés de la construction du toit furent remplacés, en conservant toutefois sa configuration initiale. Une bonne part des murs d'enceinte fut reconstruite et l'on procéda à leur couverture selon la technique existante. A la suite des travaux de restauration, non seulement l'état technique de ce monument s'est amélioré mais aussi ses valeurs architectoniques se sont sensiblement accrues.*

L'habitation N° 2 dans le village de Sopot (L. Suli)

La construction de cette maison remonte au commencement du XXe siècle. Elle est à deux étages, sa maçonnerie est en partie de pisé et en partie de pierres traversées par des bandes de bois. L'étage au rez-de-chaussée comporte deux pièces servant d'abri aux animaux; le premier étage est constitué par la chambre du feu et par la chambre des mais, qui sont devancées par le divanhane *pourvu d'un* qoshk *dans sa partie septentrionale. Au fil des années, cette habitation a subi certaines modifications: entre autres, la construction de deux cloisons dans le* divanhane *qui en a altéré le schéma planimétrique initial: la disparition du* hamam *(la salle de bains) qui se dressait à l'angle sud du* divanhane. *Outre ces modifications, plusieurs autres éléments de cette maison se trouvaient dans un état technique peu satisfaisant, et c'est ainsi qu'il fut décide d'entreprendre des travaux de restauration qui ont consisté, entre autres, dans l'élimination des couches de construction récentes. Mentionnons de leur nombre les cloisons du* divanhane. *Puis d'autres travaux furent effectués pour abaisser le niveau du plancher du* qoshk, *pour reconstruire la salle de bains, pour remplacer les éléments détériorés du plancher et du mur ouest délimitant le* divanhane. *Dans le même temps, on restaura le foyer et son dans la chambre du feu. Les éléments de bois dégradés des portes, des armoires et des fenêtres furent remplacés et l'on procéda en général au crépissage des murs de l'étage destiné à l'habitation. En ce qui concerne la construction du toit, les restaurateurs y intervinrent dans une mesure considérable. Par ailleurs, les murs d'enceinte de la cour et sa porte à deux battants furent reconstruits. Comme dans le premier cas, les travaux de restauration ont fait ressortir les valeurs de ce monument. Actuellement, cette maison est le siège du musée historique du village de Sopot.*

DOKOTOBL

L'habitation N° 3 dans le village d'Ostren i Vogel, district de Diber (L. Suli)

C'est là une construction à deux étages de pierre, dont le faîte est couronné d'un toit à quatre pentes couvert de tuiles. Son étage au rez-de-chaussée, qui sert d'abri aux animaux, comporte quatre pièces. En ce qui concerne l'étage habité, il est constitué par la chambre des amis et la chambre du feu qui sont devancées par le divanhane. *Celui-ci, en ses deux parties terminales, comporte deux* qoshk *délimités par des cloisons peu épais qui en font deux chambres. Le long de ses trois façades, exception faite de la façade principale, cette habitation est cernée de* teliz.

Au fil des années, cette habitation a subi certaines modifications qui, comme on vient de dire, en ont altéré l'aspect fonctionnel et endommage la valeur architectonique de ses façades. Par ailleurs, avant d'entreprendre les travaux de restauration, plusieurs éléments de construction et architectoniques, surtout les éléments de bois, étaient sensiblement détériorés. Les travaux de restauration ont consisté principalement dans les opérations suivantes: élimination des deux parties de l'escalier de pierre qui étaient des constructions récentes et allongement des 2 rampes de l'escalier de bois, reconstruction d'une grande partie de la maçonnerie en pierres de la vue principale, diminution de la dimension des fenêtres de certaines pièces, qui avaient été élargies précédemment, crépissage général des pièces de l'étage habité, substitution presque complète de toute la charpente de bois et revêtement du teliz *avec des planches, restauration du toit et de ses auvents. A la suite des travaux de restauration effectués dans cette habitation, et cela dans des proportions considérables, celle-ci regagna les valeurs qu'elle avait perdues dans le temps pour devenir un exemplaire remarquable en son genre.*

L'habitation N° 4 dans le village de Babine, district de Tropoje (L. Suli)

C'est là un exemplaire de l'habitation fortifiée caractéristique de la Malesi de Gjakova.

Cette maison est une construction à trois étages de pierre. Son étage au rez-de-chaussée comporte le ahur *servant d'abri aux animaux. Le premier étage est constitué par la chambre des femmes, qui est devancée par un couloir large; le deuxième étage, par la chambre des amis qui est la pièce de plus grand intérêt de cette habitation. La chambre des amis est devancée par le* divanhane, *qui occupe une surface relativement grande. C'est sur les faces sud et ouest du* divanhane *que se trouve le* dyshekllëk, *une construction de pierre percée de nombreuses fenêtres. Avant sa restauration, cette maison se trouvait dans un état technique peu satisfaisant, d'où la nécessité d'intervention immédiate. Les principaux travaux effectués sont les suivants: reconstruction complète des deux parements de la maçonnerie en pierres du* dyshekllëk, *remplacement des éléments détériorés de la construction du plancher, du toit, des portes, des fenêtres, etc., crépissage intérieur des deux étages habités et débouchement des meurtrières, en mettant de la sorte encore plus en relief le caractère défensif de cette habitation. Par ailleurs, nous avons effectué la restauration du foyer pour la préparation du café, qui se trouve dans le* divanhane, *et exécuté des opérations d'injection et de jointure sur les parements extérieurs des murs de cette habitation. Ces travaux ont donné des résultats satisfaisant quant à l'amélioration de l'état technique des éléments de construction et architectoniques, et en particulier des éléments de construction du* dyshekllëk *de pierre, une des composantes plus importantes de cette maison et qui avait subi les plus grands dommages.*

L'habitation N° 5 dans le village de Helshan, district de Kukes (L. Suli)

Cette maison se situe aux confins des villages relevant de la malésie de Gjakove, mais, comme on verra plus loin, elle-même et celle décrite plus haut représentent le type d'habitation fortifiée de la dite région. Il s'agit d'une maison à deux étages avec dyshekllëk de pierre; le premier étage sert d'abri aux animaux et le deuxième au logement de ses habitants. C'est ici que se trouve la chambre des amis, devancée par le divanhane, *pourvu d'un plafond en planches de bois tout comme la chambre des amis. Le foyer habituel se trouve dans le* divanhane, *qui, à travers un couloir étroit, donne accès au cabinet de toilette. La communication entre les étages est assurée par un escalier extérieur de bois.*

Les travaux de restauration ont consisté dans la substitution de l'escalier extérieur de bois, en y conservant au maximum ses éléments originaux le moins endommagés. La maçonnerie détériorée fut consolidée; le foyer pour la préparation du café au divanhane, *ainsi que le plafond de bois de celui-ci et de la chambre des amis, furent restaurés en respectant rigoureusement l'ancienne technique. Les battants et les portes des placards furent substitués. En plus, on procéda au crépissage intérieur de l'étage habité; tous les éléments endommagés de la construction du plancher de bois et du toit furent substitués, en restaurant aussi la corniche de ce dernier.*

L'habitation N° 6 dans le village de Kostur, district de Kukes (L. Suli)

Il s'agit d'une maison à deux étages, à la fois de pierre et de bois, couvert d'un toit à auvent large. L'important consiste dans le fait qu'ici le dyshekllëk *délimitant le* divanhane *en deux directions est de bois, ce que l'on observe aussi dans d'autres maisons de la région de Has, où ce type d'habitation connaît une diffusion relativement large.*

L'étage au rez-de-chaussée, ici aussi, le ahur, *a toujours servi d'abri aux animaux. Le premier étage est devancé par le*

DO NOT COPY

divanhane puis vient un couloir conduisant au cabinet de toilette, dont le volume fait saillie de l'édifice. L'état technique de cette habitation exigeait l'intervention urgente des restaurateurs. C'est à cette fin que furent substitués tous les éléments dégradés, entre autres les éléments constitutifs de bois de la rampe de l'escalier extérieur conduisant à l'étabe habité; par ailleurs, les éléments endommagés du plancher et du plafond de la chambre des amis, ainsi que le dyshekllëk de bois, furent remplacés; on procéda aussi au crépissage de la chambre des amis. La charpente de bois du cabinet de toilette et de l'évier, dans le divanhane, fut reconstruite; d'autres travaux concernèrent la construction du toit et des cheminées.

Comme dans les habitations précédentes, ici aussi les éléments de bois furent traités avec soin en les substituant avec des éléments de même matériau (bois de chêne) et en les sculptant avec un hachereau, technique de travail caractérisant en général les éléments de bois des habitations paysannes. La resturation de ce monument de grand intérêt en son genre lui restitua ses valeurs initiales.

TRAVAUX DE RESTAURATION DANS LES MONUMENTS HISTORIQUES

La zone-musée du Parti (R. Ballauri)

En 1976 furent entamés des travaux pour la restauration de cinq maisons situées à côté de la maison du Parti, afin de constituer un complexe urbanistique donnant l'idée que le Parti Communiste d'Albanie est sorti du sein du peuple. Toutes ces habitations, dont la construction remonte aux années 20-30 de notre siècle, sont à un étage et à rez-de-chaussée. Elles se caractérisent par des lignes architectoniques simples et dépourvues de tout ornementation. Chacune d'elles a une cour pavée de pierres et une véranda par devant, qui sert en même temps de hall. Les travaux entrepris pour leur restauration se poursuivront dans les années prochaines.

La première école albanaise à Korçe (R. Ballauri)

Les travaux furent initiés dans le cadre de l'anniversaire de fondation de la première école albanaise à Korçe (1977). Il s'agissait tout d'abord de substituer certaines structures de bois relevant des pièces intérieures et d'intervenir dans la cour de l'école et sur ses façades. A l'occasion du 70e anniversaire de fondation de la première école albanaise, le 1er mars 1977 fut inauguré le Musée de l'Enseignement réorganisé.

La maison où fut constitué le Comité régional du Parti pour Vlore (R. Ballauri)

Ce monument se situe dans le quartier Partizani à Vlore. Il s'agit d'une maison à deux étages. C'est ici qu'en décembre 1941 fut fondé le Comité régional du Parti pour Vlore. A l'occasion du 33e anniversaire de cet événement furent entamés des travaux pour la restauration de cette habitation, qui, en dehors de son importance historique, renferme des éléments d'intérêt architectonique sur le plan de la solution fonctionnelle, le mode de construction et l'ornementation sur bois, pierre et fer de ses différentes pièces. Après sa restauration, cette maison construite vers la fin du siècle dernier, est devenue un musée qui perpétuera l'événement important que fut la création du Comité régional du Parti pour Vlore.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tirazhi: 1500 kopje Formati 70 x 100/12 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri», Tiranë –

DO NOT COPY

DO NOT COPY

11

Çmimi 20 Lekë